



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Auditim i Përputhshmërisë”

Tiranë, korrik 2024

PËRMBAJTJA

NR	Përmbajtja	FAQE
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3 – 5
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore të auditimit.....	3-4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	4-5
II.	HYRJA.....	6-9
1.	Objektivat dhe Qëllimi.....	6
2.	Identifikimi i çështjes.....	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	7
5.	Kriteret e vlerësimit.....	7
6.	Standardet e auditimit.....	8
7.	Metodat e auditimit.....	8
8.	Dokumentimi i auditimit	9
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	10-126
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	10
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	10
2.1.	Pika 1: Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	11-14
2.2.	Pika 2: Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.....	15-21
2.3.	Pika 3: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	22-25
2.4.	Pika 4: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.	26-41
2.5.	Pika 5: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave punimeve civile, mallrave dhe shërbimeve.	42-111
2.6.	Pika 6: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave.....	112-115
2.7.	Pika 7: Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit...	116-119
2.8.	Pika 8: Problematika të dala gjatë auditimit.....	120-125
IV	REKOMANDIME.....	126-149
V.	ANEKSE.....	150-157

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Spitali Rajonal Elbasan është institucion publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr.9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë; i ndryshuar me ligjin nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor”.

Struktura është miratuar nga MSHMS me nr.1378 datë 07.03.2017, për vitet 2020, 2021, me urdhërin me nr. 2005prot, datë 06.05.2022, si dhe urdhërin me nr. 1953 prot, datë 22.06.2023, për vitet 2022, 2023. Bazës ligjore të cilës i referohet miratimi e saj është pika 2, nenin 23, Kreu III, të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në RSH”; të ndryshuar me ligjin nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” vendimit nr. 609, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetësore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, strukturë e cila ka të përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të planifikuar sipas organigramës përkatëse.

Nga auditimi janë konstatuar mangësi kryesisht në zbatimin të kontratave të punimeve civile, në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta në procedurat e prokurimit. Janë konstatuar mangësi në implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe ngritjen e funksionimin e auditit të brendshëm. Institucioni nuk ka statut apo rregullore e cila përcakton funksionet, strukturën, misionin, vizionin, rregullat e spitalit, të drejtat dhe detyrat e personelit, financat dhe çështje të tjera të lidhura me personelin. Ndryshimi i emërtesës të zv.Drejtorëve është bërë pa një VKM të caktuar. Statuti apo rregullorja në të cilën mbështetet Institucioni i përket një rregulloreje të vjetër cila nuk është përditësuar, nuk siguron një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/punonjësve, duke krijuar boshllëk në sistemet e menaxhimit të brendshëm. Janë konstatuar mangësi në menaxhimin e aseteve kryesisht të pajisjeve të reja të cilat nuk janë përdorur pas dhënies me koncesion të shërbimit të hemodializës.

Në hartimin e Projekt Buxheteve nuk janë identifikuar nevojat dhe nuk janë paraqitur kërkesat nga departamentet sipas strukturës organizative, nuk ka shkresa të përgjegjësve të sektorëve apo shërbimeve dërguar grupit punës për hartimin e projekt buxhetit.

Është rekomanduar dëmshpërblimi për mangësitë e konstatuara në zbatimin e kontratave të punimeve civile, përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Janë rekomanduar masa për përmirësimin e procesit të prokurimit, si për sa i përket përlogaritjes së fondit limit, ashtu edhe në hartimin e dokumenteve të tenderit, apo vlerësimin e ofertave.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore të auditimit.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punimeve civile u konstatuan mangësi në lidhje me respektimin e specifikimeve teknike dhe raportimin e punimeve të realizuara në fakt krahasuar me ato të situacionuara me vlerë 7,095,824 lekë.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit: “Blerje lëndë djegëse briket pellet”, “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike” si dhe kontratën koncesionare e shërbimit të hemodializës, janë konstatuar mangësi në hartimin e fondit limit, si dhe mos vënie në funksionim të disa aparatave, shoqëruar me shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet me vlerë 17,645,968 lekë.

- Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve”, nuk është bërë vlerësimi i duhur i ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, duke shpallur fitues një ofertë e cila është më e lartë se e një operatori të mundshëm për kualifikim, me vlerë 11,791,192 lekë, vlerë e cila konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të kriterëve të veçanta, janë konstatuar mangësi në disa procedura si sa i takon kriterëve teknike shtu edhe specifikimeve teknike.

- Janë konstatuar mangësi në implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe ngritjen e funksionimin e auditit të brendshëm.

- Institucioni nuk ka statut apo rregullore e cila përcakton funksionet, strukturën, misionin, vizionin, rregullat e spitalit, të drejtat dhe detyrat e personelit, financat dhe çështje të tjera të lidhura me personelin. Ndryshimi i emërtesës të zv.Drejtorëve është bërë pa një VKM të caktuar. Statuti apo rregullorja në të cilën mbështetet Institucioni i përket një rregulloreje të vjetër e cila nuk është përditësuar, nuk siguron një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/punonjësve, duke krijuar boshllëk në sistemet e menaxhimit të brendshëm.
- Nga auditimi i kontratës koncesionare “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësorë”, rezultoi se janë tejkaluar tavanet buxhetore ndërkohë që në lidhje marrjen e shërbimit mjekësor është vazhduar vetëm për analizat urgjente sipas Alternativën B të pikës 22.4.2 të kontratës koncesionare të laboratorit duke bërë që të kryhen analiza vetëm për raste specifike urgjente duke lënë një pjesë të popullatës pa analiza.
- Në hartimin e projekt buxheteve nuk janë identifikuar nevojat dhe nuk janë paraqitur kërkesat nga departamentet sipas strukturës organizative, nuk ka shkresa të përgjegjësve të sektorëve apo shërbimeve dërguar grupit punës për hartimin e projekt buxhetit.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga auditimi i kryer pranë Spitalin Rajonal Elbasan, për periudhën 01.01.2020 deri datë 31.12.2023, lidhur me përputhshmërinë, rezulton se sistemi i menaxhimit financiar i kontrollit funksionon por jo në nivelin e kërkuar. Konstatohen mangësi të cilat janë të përhapura në procesin e prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave, kryesisht ato të punimeve civile.

A. OPINIONI I AUDITIMIT.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Spitali Rajonal Elbasan për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Opinion i modifikuar (kualifikuar) mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Spitali Rajonal Elbasan janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar (kualifikuar), e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899). Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionit. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Spitalit Rajonal Elbasan, rezultuan:

-Mangësi në zbatimin e kontratave të punimeve civile dhe të furnizimit me pasojë dëm ekonomik me vlerë 9,727,332 lekë.

- Mangësi në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit, shoqëruar më shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet me vlerë 29,437,160 lekë.
- Në realizimin e procedurave të prokurimit konstatohen mangësi kryesisht në procesin e hartimit të dokumenteve të tenderit për vendosjen e kritereve teknike dhe hartimin e specifikimeve teknike.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 1046/1 prot., datë 29.12.2023 “Mbi auditimin e përputhshmërisë në Spitalin Rajonal Elbasan” (me ndryshime), miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.01.2024 deri në 08.03.2024 ushtroi auditim “Mbi përputhshmërisë”, në subjektin “Spitali Rajonal Elbasan”, për periudhën nga 01.01.2020 – 31.12.2023, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.T, (përgjegjës grupi)
2. A.B, anëtar
3. V.B, anëtar
4. Q.M, anëtar.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*) auditoi veprimtarinë e Spitalit Rajonal Elbasan, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, veprimet më arkë e bankë, dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale, procedurat e prokurimeve publike, zbatimi i kontratave etj.

Auditimi u krye me zgjedhje për periudhën 01.01.2020, deri 31.12.2023, bazuar të dhënave të marra në subjekt, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit.

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Ky auditim ka për qëllim kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim vlerësimin e përgjithshëm të përputhshmërisë së aktivitetet të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Çështjet të cilat trajtohen në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, lidhen me: Zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre; planifikimin dhe zbatimin e buxhetit si dhe shpenzimet administrative; zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave; zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit; zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave punimeve civile, mallrave dhe shërbimeve, zbatimin e dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave; si dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

Objektivat e këtij auditimi konsistojnë në:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Nëse shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes.

Spitali Rajonal Elbasan është institucion publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr.9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë; i ndryshuar me ligjin nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor”.

Struktura është miratuar nga MSHMS me nr.1378 datë 07.03.2017, për vitet 2020, 2021, me urdhrin me nr. 2005prot, datë 06.05.2022, si dhe urdhrin me nr. 1953 prot, datë 22.06.2023, për vitet 2022, 2023. Bazës ligjore të cilës i referohet miratimi e saj është pika 2, nenin 23, Kreu III, të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në RSH”; të ndryshuar me ligjin nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” vendimit nr. 609, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, strukturë e cila ka të përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të planifikuar sipas organigramës përkatëse. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 1046/1 prot., datë 29.12.2023 “*Mbi auditimin e Përputhshmërisë*” (me ndryshime) në Spitalin Rajonal Elbasan për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2023.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Drejtimi i Spitalit Rajonal Elbasan është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH.

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Spitalit Rajonal Elbasan, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

5. Kriteret e vlerësimit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; - - Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë

06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar; Ligji nr.9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.559, datë 26.10.2009 “Për aplikimin e tarifave të shërbimeve mjekësore”; Urdhri nr.3272, datë 11.09.2007 “Mbi politikat kombëtare mbi menaxhimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri” dhe rregullorja e brendshme e funksionimit etj.

6. Standardet e auditimit.

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.6.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.6.2020, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”.

7. Metodat e auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit etj.

8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.6.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.6.2020, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.*

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të Projektraportit dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar.

Spitali Rajonal Elbasan është institucion publik në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë; i ndryshuar me ligjin nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor”.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur është konstatuar si më poshtë:

- Dëm ekonomik me vlerë 9,727,332 lekë në zbatimin e kontratave të punimeve civile dhe kontratat e furnizimit.
- Shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, me vlerë 29,437,160 lekë, në realizimin e procedurave të prokurimit.

2.1. Mbi zbatimimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

-Drejtimi i Spitalit Rajonal Elbasan nuk është realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore të Ligjit Nr.9106, “Për shërbimin spitalor”, neni 12 ku citon: Organet e autoritetit spitalor të qarkut janë:

- a) këshilli administrativ;
- b) drejtorja;
- c) komisioni mjekësor.

Mbështetur në nenin 12 të sipërcituar nuk është ngritur Këshilli Administrativ dhe Komisioni Mjekësor. Si rrjedhojë, Spitali Rajonal nuk e ka kryer organizimin dhe funksionimin mbështetur në nenin 13, 14, 15 të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH”. Referuar të dispozitës ligjore të sipërcituar Këshilli Administrativ (KA), ka këto funksione, si më poshtë vijon:

- a) miraton politikat, harton programet tekniko-financiare për konkretizimin e planeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e shërbimit spitalor të qarkut, në përputhje me strategjinë dhe politikat shtetërore shëndetësore, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë;
- b) programon dhe i propozon Ministrisë të Shëndetësisë ndryshimet strukturore të autoritetit spitalor të qarkut;
- c) propozon projektbuxhetin, ndarjen dhe destinacionin e tij;
- ç) vendos për pranimin e dhuratave nga individë ose fondacione dhe shoqata me qëllim bamirësie, si dhe binjakëzimin me spitalet simotra;
- d) i propozon Ministrisë të Shëndetësisë emërimin dhe shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të autoritetit spitalor të qarkut;
- dh) emëron dhe shkarkon drejtorët e spitaleve të qarkut, në bazë të propozimit të bërë nga drejtori ekzekutiv.

Komisioni mjekësor është organ këshillimi teknik i drejtorisë dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve. Komisioni mjekësor kryesohet nga kryetari i zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të kriterëve të vendosura nga Ministri i Shëndetësisë dhe ushtron veprimtarinë e tij për tre vjet. Funksionet e komisionit mjekësor

Komisioni mjekësor i propozon drejtorisë së autoritetit spitalor të qarkut:

- a) blerjen e pajisjeve mjekësore, diagnostike dhe terapeutike;
- b) vendimet, që përfshijnë aspektet mjekësore të punës;
- c) rregullat e organizimit të shërbimeve mjekësore të institucionit;
- ç) vlerësimin, krijimin, mbylljen ose modifikimin e reparteve, spitaleve ose të gjitha njësive funksionale në varësi;
- d) vlerësimin e treguesit cilësor të shërbimeve;
- dh) zbatimin e protokolleve të mjekimit;
- e) trajnimin e personelit mjekësor dhe atij ndihmës;
- ë) shërbimet dhe pajisjet e reja.

Sipas ligjit organik, të sipërcituar Spitali Rajonal Elbasan ka dy nivele drejtimi, kolegjal dhe ekzekutiv.

Drejtimi kolegjal realizohet nga KA i cili rezulton i pa mbledhur, pra, për periudhën 3-vjeçare sipas vlefshmërisë së anëtarit të KA të përcaktuar në ligj. Konkretisht, sipas nenit 13 të ligjit nr. 9106 “Për shërbimet spitalore”,

Këshilli administrativ i autoritetit spitalor të qarkut përbëhet nga:

- a) dy anëtarë të caktuar nga këshilli i qarkut ku ndodhet autoriteti spitalor i qarkut;
- b) një anëtar i caktuar nga çdo këshill bashkiak ku ndodhen spitalet në nivel bashkie;
- c) një përfaqësues i caktuar nga prefekti i qarkut;
- ç) presidenti i urdhrës të mjekut të qarkut;
- d) drejtori i autoritetit spitalor;

dh) drejtori i drejtorisë së fondit të sigurimit të kujdesit shëndetësor të qarkut ose një person i autorizuar prej tij;

e) kryeinfermieri i përgjithshëm i spitalit të qarkut.

Në këtë pikë, përveç anëtarëve dhe përfaqësuesve të tyre, të cilët kanë afat vlefshmërie, autorizimi nuk përjashton Drejtorinë e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të Qarkut nga e detyrimi i tij ligjor të jetë anëtar i KA të Spitalit Rajonal. Gjithashtu nuk vërtetohet në asnjë rast, që Spitali, t'i jetë drejtuar Prefektit për të përmbushur detyrimin e tij, për caktimin e një përfaqësuesi, për në KA të Autoritetit Spitalor të Qarkut Elbasan.

Mos ngritja e kësaj strukture ndikon në uljen e besueshmërisë dhe përpikmërisë së zbatimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë në Spital. Konkretisht, mos veprimet e Institucionit Spitalor në lidhje me themelimin dhe funksionimin e kësaj strukture ka sjellë pasojat e mëposhtme në lidhje me detyrat e Këshillit Administrativ, sipas *Kreu I, neni 6* :

Këshilli Administrativ në zbatim të politikës së Ministrisë së Shëndetësisë mbi bazën e studimeve, projektin zhvillimin e spitaleve (afatgjatë dhe afatmesëm) për investime, pajisje, nevojë për personel, aparaturë etj. Mungesa e këshillit ka sjell mos përditësim të rregullore së spitalit e cila vepron mbi bazën e një rregulloreje e, rregullorja e pa përditësuar nuk i përshtatet ndryshimeve të ligjeve të funksionimit të spitaleve nga viti dhe krijon boshllëk në sistemet e menaxhimit të brendshëm. Nuk analizohen pasqyrat financiare duke rritur riskun e devijimeve të cilat janë materiale nga ana cilësore dhe sasiore dhe që mund të ndikojnë në aktivitetin e përgjithshëm spitalor, nuk analizohet buxheti duke rritur riskun e ndryshimit të destinacionit të shpenzimeve buxhetore dhe nuk jepen opinione për domosdoshmërinë e investimeve të kryera ndër vite në spital, duke kanalizuar studimet vetëm në sektorin juridik dhe financiar të spitalit. Gjithashtu nuk ka bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale që rregullojnë veprimtarinë e SRE. Zgjidhja e ankesave kërkesave të ndryshme. Raport përmbledhës, lidhur me evidencat për: (Zbatim buxheti të SRE; Struktura organizative në SRE; Numri i punonjësve në SRE.

Kjo detyrë kryhet vetëm nga Drejtori i Spitalit duke centralizuar pushtetin e tij ekzekutiv, duke rritur riskun e vendimmarrjes absolute dhe duke krijuar hallkën e parë të dobësisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit të institucionit. Analiza dhe miratimi i rregullave, përcaktimeve rregulloreve të përgjithshme si dhe zbatimi i strukturës së miratuar nga Organi Qendror MSHMS Nga Drejtori i Spitalit pa Këshillin Administrativ, ndikon në organizimin e përgjithshëm të punës në spital, në organigramën e spitalit dhe rrit riskun e punësimeve në pozicione të paanalizuara mirë, ndikon në rritjen e riskut për punësime mbi strukturën e miratuar të punonjësve ose kryerjen e punësimeve të stafit kualifikimet e të cilëve nuk përputhen me pozicionin e punës.

Nga ana e Drejtorit të Spitalit pavarësisht se sipas përcaktimeve të nenit 15 të ligjit të sipërcituar ku thotë që:

Këshilli administrativ mbledhet:

a) jo më pak se 6 herë në vit;

b) me kërkesë të kryetarit ose të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve.

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme zhvillohen me kërkesën e Ministrit të Shëndetësisë në çdo kohë, si dhe me kërkesën e më shumë se gjysmës së anëtarëve.

3. Këshilli administrativ merr vendime me shumicë votash. Vendimet e këshillit administrativ merren kur janë të pranishëm dy të tretat e anëtarëve.

Vendimet e këshillit administrativ mund të anulohen vetëm me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, kur ato bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi ose me strategjinë shtetërore të zhvillimit të shërbimit spitalor.

4. Mbledhja e parë e këshillit administrativ thirret nga drejtori ekzekutiv.

Pra në asnjë rast nuk është bërë përpjekje nga Drejtori i Spitalit të realizojë mbledhje.

-Si rrjedhojë e mos ngritjes së Këshillit Administrativ, pranë Spitalit nuk është ngritur "Komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut", në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", neni 40 , ku citon:

Pranë autoritetit spitalor publik të qarkut ushtron veprimtarinë e vet komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut, i cili është organi këshillimor i tij. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të këtij komiteti përcaktohen me vendim të këshillit administrativ të autoritetit spitalor të qarkut.

Mungesa e Komitetit për planifikimin spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu V, Neni 42, Pika 2 ku citon:

Plani spitalor i qarkut miratohet nga këshilli administrativ, në përputhje me planin shtetëror spitalor, dhe përcakton parashikimin e ndërhyrjeve në qark të lidhura me ngritjen e spitaleve të reja, me transformimin, modernizimin ose mbylljen e spitaleve ekzistuese, me nevojën për një numër shtretërisht të ndarë për rastet akute, kronike, konvaleshente, me efikasitetin e pajisjeve, me rrjetin rrugor dhe kushtet gjeomorfologjike dhe higjieno-sanitare të popullatës. Zgjerimi, transformimi, përveç përshtatjeve të detyruara nga kërkesa funksionale, duhet të realizohen, në përputhje me planin spitalor të qarkut. Në planin spitalor të qarkut duhet të përcaktohen mjetet financiare për ndërtimin e spitaleve të reja, zgjerimin, transformimin ose modernizimin e atyre ekzistuese, blerjen e pajisjeve përkatëse, si dhe për shpërndarjen e tyre, në lidhje me objektivat e përcaktuara nga plani spitalor i qarkut.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe vendimit të Kryetarit, me nr. 08.08.2017, në bazë të rregullore së miratuar, sipas nenit 17, pika 3, neni 22, nga ana e audituesve u kryen intervista me punonjësit e Spitalit si dhe u konsiderua e nevojshme që të kryhen verifikime në terren mbi gjendjen e objekteve të godinave spitalore, në ato godina në të cilat situata ishte më emergjente nga ku nevoja për ndërhyrje, riparime të ambienteve të brendshme ishte e domosdoshme. Nga verifikimi rezultoi se në Godinën e Patologjisë, Ambientet e Morgut nevoja për riparime të brendshme ishte e domosdoshme pasi nuk ishin kryer investime ndër vite. Godinat ishin të vjetra dhe të amortizuara në të cilat ndërhyrjet e brendshme janë më të nevojshme. Problematike paraqitet situata në hyrjen e Spitalit si dhe sheshin e godinave spitalore pasi rezulton se ka mangësi përsa i përket organizimit të tij, nevoja mbi ri-kualifikimin e sheshit është e domosdoshme pasi nuk ka të përcaktuar kapacitetin maksimal të makinave duke bërë që në traun kryesor të lejohen makina mbi kapacitetin normal të tij, duke shkaktuar një situatë kaotike në Spital, e cila më pas mund të sjellë pasoja në mbarëvajtjen e procesit të punës. Gjithashtu shërbimi i urgjencës nuk ka një hyrje të dedikuar veçmas, por aksesohet nga rruga kryesore e cila është e mbingarkuar nga fluksi i madh i lëvizjes së njerëzve.

Në vitin 2023, me urdhrin me Nr.1507 prot., datë 07.09.2023 është krijuar Bordi Drejtues i Spitalit Elbasan, në mbështetje të ligjit nr.55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 të VKM-së nr. 36, datë 27.01.2023, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e spitaleve rajonale, terciare dhe qendrave spitalore rajonale publike, si dhe shkresës, nr. 720/14, datë 28.08.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të përbërë nga 5 anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|---------|--|----------|
| 1. E.R. | (Përfaqësues i MSHMS) | Kryetare |
| 2. A.A. | (Përfaqësues i OSHKSH Elbasan) | Anëtar |
| 3. R.P. | (Përfaqësues i FSDKSH Elbasan) | Anëtar |
| 4. A.P. | (Përfaqësues i Shoqatës së Talasemikëve) | Anëtar |
| 5. L.R. | (Përfaqësues i Komisionit Mjekësor) | Anëtar |

-Urdhri për krijimin e Bordit është bërë nga Drejtori i Spitali pas shkresës së dërguar nga MSHMS e cila i drejtohet Spitalit Elbasan që të realizojë konstituimin e Bordit. Nuk është shprehur baza ligjore të cilës i referohet se: Titullari i Institucionit është përgjegjës për ngritjen e Bordit Spitalor pasi në asnjë moment referuar dhe ligjit nr.55/2022, “Për shërbimin spitalor”, si dhe VKM nr. 36, datë 27.01.2023, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin spitaleve rajonale dhe terciare” nuk e ka të përcaktuar që Drejtori i Spitalit ngre Bordin Drejtues, por lë

të nënkuptohet se kompetenca e ngritjes së Bordit i takon Ministrisë Përgjegjëse për Shëndetësinë, MSHMS.

-Në lidhje me statutin e Spitalit, rezultoi nuk ka një statut të miratuar nga Institucioni. *Statuti është një dokument zyrtar i cili do të shërbente për të përcaktuar strukturën, funksionet, misionin, vizionin dhe rregullat e Spitalit. Ky dokument përcakton gjithashtu mënyrën e veprimit të personelit, të drejtat dhe detyrat e pacientëve, financat dhe çështje të tjera të rëndësishme për menaxhimin dhe funksionimin e Spitalit.* Statuti apo rregullorja në të cilën mbështetet Institucioni i përket një rregulloreje të vjetër cila nuk është përditësuar, e cila nuk siguron një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/punonjësve, e cila krijon boshllëk në sistemet e menaxhimit të brendshëm.

- Sipas strukturës së vitit 2020 dhe në vijim të dërguar nga MSH, ka ndryshim të emërtesës së zv. Drejtorëve. Në fakt, ligji organik në neni 18 të saj shpreh:

1. Drejtoria e autoritetit spitalor të qarkut përbëhet nga:

a) drejtori ekzekutiv;

b) zëvendësdrejtori teknik;

c) zëvendësdrejtori ekonomik;

ç) kryeinfermieri i përgjithshëm.

Pozicioni i dy ZV është riemërtuar ndryshe dhe konkretisht në zv/Drejtor i Shërbimeve Administrative dhe zv/Drejtor i Shërbimeve Mjekësore, kur LSHS neni 18 pika 2 specifikon se: *“Struktura dhe rregullat e funksionimit të administratës së autoritetit spitalor të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.* Ndryshimi në emërtesë, nuk mund të bëhet pa një VKM, edhe pse funksionet hamendësohen të njëjta. Ndryshimi në emërtesë, përveç keqfunksionimit në strukturat drejtuese, të SRE, krijon një situatë joligjore në përcaktimin e nëpunësit zbatues sipas MFK, ku kjo kompetencë i takon drejtuesit më të lartë ekonomik, ZDE, boshllëk në sistemet e menaxhimit të brendshëm.

Si konkluzion, *“në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë për emërimet, funksionimin e strukturave drejtuese”* rezulton se:

- Nuk është ngritur këshilli administrativ;

-Nuk është ngritur komisioni mjekësor;

-Detyrat dhe funksionet përfshirë dhe ato të Këshillit Administrativ (KA), si dhe ato të Komisionit Mjekësor (KM) i ka kryer Drejtori Ekzekutiv duke centralizuar kompetencat, duke rritur riskun e vendimmarrjes absolute dhe duke krijuar hallkën e parë të dobësisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit të institucionit.

-Nuk përcaktohet saktë statusi i Institucionit pasi nuk funksionojnë organet kolegjiale, situatë e cila shkakton mos përcaktim të të drejtave dhe kompetencave të Titullarit. Kjo situatë e shkaktuar bën që të krijohet një situatë e pazakontë pasi dhe kategorizimi i pagave bëhet njëjtë me Spitalet Bashkiake.

-Nuk është ngritur Komiteti për Planifikimin Spitalor. Mungesa e Komitetit për planifikimin spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 *“Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”*, Kreu V, Neni 42, Pika 2.

- Sipas strukturës së vitit 2020 dhe në vijim të dërguar nga MSH, ka ndryshim të emërtesës së Zv. Drejtorëve si më poshtë:

Emërtesa zv Drejtor Ekonomik është bërë zv Drejtor Shërbimesh Administrative; zv Drejtor Teknik është bërë zv Drejtor Shërbimesh Klinike; Pra në asnjë nuk ka mbështetje ligjore të cilës i referohet AK për ndryshimin e emërtimeve.

-Me ndryshimet ligjore nuk ka një statut të miratuar, *i cili do t'i shërbente për të përcaktuar strukturën, funksionet, misionin, vizionin dhe rregullat e Spitalit.* Statuti apo rregullorja në të cilën mbështetet Institucioni i përket një rregulloreje të vjetër e cila nuk është përditësuar, e cila nuk siguron një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/punonjëseje.

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit 1046/1 date 29.12.2023 “Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, si vijon:

- Projekt Buxheti për vitin 2020, 2021, 2022, 2023.
- PBA respektive.
- Buxhetet e miratuara, realizimi i tyre.
- Shpenzimet.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”.
- Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij.
- Udhëzimi nr. 2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me ndryshimet vijuese të tij.

Spitali Rajonal Elbasan është institucion buxhetor në varësi të MSHMS. Financimi i tij kryhet nga FSDKSH për shpenzimet për paga (zëri 600), sigurime(zëri 601), mallra dhe shërbime (zëri 602) e nga MSHMS për shpenzimet për investime (zëri 231).

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

Projekt-Buxheti për vitin 2020

Pas miratimit nga MFE, të Udhëzimit, “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”, “Dërgohet Udhëzimi plotësues i PBA 2020-2022” të ardhur pranë njësisë shpenzuese Spitali Rajonal Elbasan, në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

Me shkresën nr. 1382 prot., datë 09.07.2019 janë dërguar kërkesat për zërat buxhetorë të PBA 2020-2022, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Me shkresën nr. 1107 prot., datë 14.07.2021 është dërguar relacioni për zërat buxhetorë të PBA 2022, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Me shkresën nr. 1170/1 prot., datë 21.07.2022 është dërguar relacioni për zërat buxhetorë mbi hartimin e projekt buxhetit për vitin 2023, pranë FSDKSH-së.

Në mënyrë të përmbledhur zërat buxhetorë paraqiten si më poshtë:

Tabelë nr. 1: Kërkesa Buxhetore për vitin 2020.

Kërkesa Buxhetore 2020	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
Programi	650,642,	89,243	346,280						226,500	1,312,665
	-	-	-							-

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabelë nr. 2: Kërkesa Buxhetore për vitin 2021.

Kërkesa Buxhetore 2021	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
Programi	505,039	69,303	321,100	-	-	-			388,000	1,283,442
				-	-	-				

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabelë nr. 3: Kërkesa Buxhetore për vitin 2022.

Kërkesa Buxhetore 2021	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
Programi	650,642	89,243	328,600	-	-	-				1,068,485

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabelë nr. 4: Kërkesa Buxhetore për vitin 2023.

Kërkesa Buxhetore 2021	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
Programi	552,374	92,246	300,000	-	-	-				944,620

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

- **Miratimi i Buxhetit Vjetor:**

Tabelë nr.5: Buxheti i miratuar për vitin 2020.

Viti 2020/Ilogaria	600	601	602	Totali
Nr 1507/3prot dt 05.02.2020 Burim financimit nga FSDKSH	390 000	65 000	220 000	675 000
Rialokimi I				
Nr 1481dt 18.02.2020 Burim financimit nga FSDKSH	1 000	250	4 750	
Rialokimi II				
Nr 1786 prot 27.02.2020 Burim financimit nga FSDKSH			3 000	
Rialokimi III				
Nr 8936/5 prot 24 02 2020 Burim financimit nga FSDKSH			20 000	
Rialokimi i I V				
Nr 8987 PROT 06.08.2020 Burim financimit nga FSDKSH	448		3.360	
Rialokimi V				
Nr 8123/28 prot dt 16.11.2020 Burim financimit nga FSDKSH	3 000	-1 770	3 000	
Rialokimi VI				
NR 24076/1PROT 30.12.2020 Burim financimit nga FSDKSH			20 000	
Totali	394 448	63 480	274 110	732 038
Raste fatkeqësish Fondi i vecantë 606	1 472.2			
Buxheti paga pasi është shtuar 606	392 975.8			
Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së				

Tabele nr.6

Buxheti i miratuar në vitin 2021, (në mijë lekë)

Viti 2021/llogaria	600	601	602	231	Totali
Nr 659 prot dt 01.02.2021 Burim financimit nga FSDKSH	401 000	64 420	240 000		705 420
Rialokimi I					
Nr. 142/3prot dt 02.02.2021 nga Burim financimit nga MSH për investime				164 687	
Rialokimi II					
Nr. 48 25 PROT dt. 18.03.2021 Burim financimit nga FSDKSH	75 400	12 600			
Rialokimi III					
Nr. 4826/1prot 15.03..2021 Burim financimit nga FSDKSH	1 000	250	4 750		
Rialokimi IV					
Nr. 2460/2 prot dt 17.06.2021 Burim financimit nga MSH për investime				27 000	
Rialokimi V					
Nr. 4113 prot dt 02.08.2021 Burim financimit nga FSDKSH		-3000			
Rialokimi VI					
Nr. 3876/1 prot dt 20,09,2021				59 000	
Rialokimi VII					
NR 5366 PROT 07.10.2021 Burim financimit nga FSDKSH	- 2000		51 063		
Rialokimi VII					
Nr6182 prot dt 19.11.2021 Burim financimit nga FSDKSH	-	-300			
Rialokimi IX					
Burim financimit nga FSDKSH	-		10.000		
Totali	475 400	73 970	305 813	250 687	1 105 870
Raste fatkeqësish Fondi i veçantë 606	951.2				
Buxheti paga pasi është shtuar 606	474 448 .8				

Tabelë nr.7: Buxheti i miratuar në vitin 2022 (në mijë lekë)

Viti 2022/llogaria	600	601	602	231	Totali
Nr. 557 prot dt 25.01.2022 Burim financimit nga FSDKSH	535 000	75 500	300 000		910 500
Rialokimi I					
Nr. 720/2 prot dt 01,03,2022 Burim financimit nga MSH për inestime				68,611	
Rialokimi II					
Nr. 5490dt 07.09.2022			32,000		
Rialokimi III					
Nr. 1111 prot dt 12.07.2022 Burim financimit nga MSH për investime				17,000	
Rialokimi III					
Nr. 6091/25 prot 10.10.2022 Burim financimit nga FSDKSH			30,600		
Rialokimi IV					
Nr. 6762/14 prot16.11.2022	-1,130	300	12,900		
Rialokimi V					
Nr 4298/2 prot dt 17.11.2022 Burim financimit nga MSH për investime				36,725	

Rialokimi VI					
Nr. 6762/14 PROT 30.11.2022 Burim financimit nga FSDKSH	-75,030				
Rialokimi VII					
Nr. 7542/15 PROT 30.12.2022 Burim financimit nga FSDKSH	-500 7,640	-200	9 131		
Totali	465,980	75,600	384,631	122,336	1,048,577
Raste fatkeqësish Fondi i veçantë 606	8,341.5				
Buxheti paga pasi është shtuar 606	457,638				

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabelë nr.8: Buxheti i miratuar në vitin 2023 (në mijë lekë)

Viti 2023 /logaria	600	601	602	231	Totali
Nr. 386/5prot dt 31.01.2023 Burim financimit nga FSDKSH	496,400	82,600	315,100		894,100
Rialokimi I					
Nr 18/5 prot dt 26.01.2023 Burim financimit nga MSH për investime				62,592	
Rialokimi II					
Nr. 2094/9 PROT DT 26.06.2023 Burim financimit nga FSDKSH			4,000		
Rialokimi III					
Nr 2163/5prot 04.017.2023 Burim financimit nga FSDKSH	42,700	7200	0		
Rialokimi IV					
Nr 2651/5 PROT 30.08.2023 Burim financimit nga FSDKSH			5,900		
Rialokimi V					
Nr. 2847/2 prot dt 22.08.2023 Burim financimit nga MSH për investime				10,000	
Rialokimi VI					
Nr. 2768/4PROT 07.09.2023 Burim financimit nga FSDKSH			40,000		
Rialokimi VII					
Nr. 3242/2 prot dt 10.10.2023 Burim financimit nga MSH për investime				90,000	
Rialokimi VII					
Nr. 3708/1 prot dt 23.11.2023 Burim financimit nga FSDKSH	6,920	350	5,000		
Totali	546,020	90,150	370,000	162,592	1,168,762
Raste fatkeqësish Fondi i veçantë 606	874.7				
Buxheti paga pasi është shtuar 606	545,145.2				

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Zbatimi Vjetor i Buxhetit

Realizimi i buxhetit, sipas situacioneve progresive të miratuara në thesar për vitet 2020 dhe 2021,2022,2023, paraqiten si më poshtë në tabelat nr. 9, 10, 11 dhe 12.

Tabelë nr. 9: Zbatimi vjetor i buxhetit të vitit 2020

(në mijë lekë)

N r	Artikulli	EMËRTIM I	Planifikimi 2021	Rialokimi	Fakti	Ndryshimi në vlerë(Rialokimi -Fakti)	Ndryshimi në %
	Kodi				2021		
1	600	Paga	390,000	394,000	387,247	6,753	98.28
2	601	Sigurime Shoqërore	65,000	63,480	63,230	250	99.60

3	602	Mallra dhe Shërbime të tjera	220,000	274,110	270,741	3,369	98.77
4	606	Ndihme ekonomike	1,472		1,472	0	100
			676,472	731,590	722,690	8,900	

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Buxheti i planifikuar i vitit 2020 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 676,472 mijë lekë, ndërsa realizimi është 722,690 mijë lekë. Konkretisht, zëri 600 “Pagat” është planifikuar të jetë 390,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 387,247 mijë lekë. Zëri 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar të jetë 65,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 63,230 mijë lekë. Zëri 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar të jetë 220,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 270,741 mijë lekë.

Tabelë nr. 10: Zbatimi vjetor i buxhetit të vitit 2021 (në mijë lekë)

Nr	Artikulli Kodi	EMËRTIMI	Planifikimi 2021	Rialokimi	Fakti	Ndryshimi në vlerë (Rialokimi -Fakti)	Ndryshimi në %
					2021		
1	600	Paga	401,000	475,400	472,048	3,352	99.29
2	601	Sigurime Shoqërore	64,420	73,970	73,646	324	99.56
3	602	Mallra dhe Shërbime të tjera	240,000	305,813	291,397	14,416	95.28
4	606	Ndihme ekonomike	951		951	0	100
5	231	Investime	-	250,687	250,438	249	99.90
			706,371	1,105,870	1,088,480	17,390	

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Buxheti i planifikuar i vitit 2021 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 706,371 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,088,480 mijë lekë. Konkretisht, zëri 600 “Pagat” është planifikuar të jetë 401,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 472,048 mijë lekë. Zëri 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar të jetë 64,420 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 73,646 mijë lekë. Zëri 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar të jetë 240,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 291,397 mijë lekë.

Zëri 231 është planifikuar të jetë 0 lekë ndërkohë që realizimi është 250,438 mijë lekë.

Tabelë nr. 11: Zbatimi vjetor i buxhetit të vitit 2022 (në mijë lekë)

Nr	Artikulli Kodi	EMËRTIMI	Planifikimi 2021	Rialokimi	Fakti	Ndryshimi në vlerë (Rialokimi -Fakti)	Ndryshimi në %
					2021		
1	600	Paga	535 000	465,980	457,637	8,343	98.20
2	601	Sigurime Shoqërore	75,500	75,600	75,427	173	99.56
3	602	Mallra dhe Shërbime të tjera	300,000	384,631	368,174	16,457	95.72
4	606	Ndihme ekonomike	8,341		8341	0	100
5	231	Investime		122,336	105,764	12,338	86.45
			918,841	1,048,547	1,015,343	33,204	

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 918,841 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,015,343 mijë lekë. Konkretisht, zëri 600 “Pagat” është planifikuar të jetë 535,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 457,637 mijë lekë. Zëri 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar të jetë 75,500 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 75,427 mijë lekë.

është 75,427 mijë lekë. Zëri 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar të jetë 300,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 368,174 mijë lekë.
Zëri 231 është planifikuar të jetë 0 lekë ndërkohë që realizimi është 105,764 mijë lekë.

Tabelë nr. 12: Zbatimi vjetor i buxhetit të vitit 2023 (në mijë lekë)

N r	Artikulli	EMËRTI MI	Planifikimi i 2021	Rialokimi	Fakti	Ndryshimi në vlerë (Rialokimi - Fakti)	Ndryshimi në %
	Kodi				2021		
1	600	Paga	496,400	546,020	544,979	1,041	99.80
2	601	Sigurime Shoqërore	82,600	90,150	89,986	164	99.81
3	602	Mallra dhe Shërbime të tjera	315,100	370,000	364,468	5,532	98.50
4	606	Ndihme ekonomike	874		874	0	100
5	231	Investime		162,592	150,254	12,338	92.41
			894,974	1,168,762	1,150,561	18,201	

Burimi: SRE, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së

Buxheti i planifikuar i vitit 2023 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 894,974 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,150,561 mijë lekë. Konkretisht, zëri 600 “Pagat” është planifikuar të jetë 496,400 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 544,979 mijë lekë. Zëri 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar të jetë 82,600 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 89,986 mijë lekë. Zëri 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar të jetë 315,100 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 364,468 mijë lekë.
Zëri 231 është planifikuar të jetë 0 lekë ndërkohë që realizimi është 162,592 mijë lekë.

Nga auditimi rezulton se:

Buxheti i planifikuar i vitit 2020 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 676,472 mijë lekë, ndërsa realizimi është 722,690 mijë lekë.

Buxheti i planifikuar i vitit 2021 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 706,371 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,088,480 mijë lekë.

Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 918,841 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,015,343 mijë lekë.

Buxheti i planifikuar i vitit 2023 për pjesën që financohet nga FSDKSH dhe MSHMS ka qenë 894,974 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,150,561 mijë lekë.

-Në hartimin e Projekt Buxheteve nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e kryera nga departamentet sipas strukturës organizative, nuk ekziston asnjë shkresë e përgjegjësve të departamenteve dërguar grupit për hartimin e projektbuxhetit.

-Parregullsi në hartimin e kërkesave për barna/materiale mjekësore nga shërbimet përkatëse në SRE; Mungesa e kuadrit rregullator për parashikimin projekt buxhetit për vitet pasardhëse .

Përsa i përket planifikimit për barna dhe materiale mjekësore (sipas dokumentacionit të vëne në dispozicion) për vitin 2020-2024 ato janë hartuar nga sektori i kostos dhe planifikimit duke mos marrë parasysh kërkesat nga shefat e shërbimit dhe farmacia. Sipas informacioneve nga punonjës të farmacisë kjo mënyrë planifikimi për barna dhe materiale mjekësore ka sjellë probleme vetëm për vitin 2023-2024 ,duke shkaktuar mangësi për një sasi të konsiderueshme barnash ,duke detyruar Autoritetin Kontraktor të zhvillojë procedurë prokurimi veçmas nga procedurat që zhvillon MSHMS.

Veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

Znj. D.T., në cilësinë e ish titullarit të institucionit në mospërputhje me Nenin 8¹ të ligjit nr. Nr. 10 296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, dhe Pika 5² e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*.

Z. A.G., në cilësinë e titullarit të institucionit në mospërputhje me Nenin 8³ të ligjit nr. Nr. 10 296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, dhe Pika 5⁴ e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*.

Znj. A.K., në cilësinë e Përgjegjëses së financës për periudhën nën auditim, në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*.

¹ Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit

² Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike

³ Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit

⁴ Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike

2.3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Zbatimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar, mbajtja e regjistrit themeltar për punonjësit dhe pasqyrimi i lëvizjeve. Zbatimi i kontratës kolektive dhe individuale të punës dhe procedurat e rekrutimit të personelit shëndetësor, dosjet e personelit etj.

Spitali Rajonal Elbasan është institucion publik në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë; i ndryshuar me ligjin nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor”.

Struktura e institucionit është miratuar nga MSHMS me nr.1378 datë 07.03.2017, për vitet 2020, 2021, me urdhrin me nr. 2005prot, datë 06.05.2022, si dhe urdhrin me nr. 1953 prot, datë 22.06.2023, për vitet 2022, 2023. Bazës ligjore të cilës i referohet miratimi e saj është pika 2, nenin 23, Kreu III, të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në RSH”; të ndryshuar me ligjin nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” vendimit nr. 609, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, strukturë e cila ka të përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të planifikuar sipas organigramës përkatëse. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, mbështetur strukturën e planifikuar të dërguar nga MSHMS rezulton se është ruajtur struktura në total, madje struktura faktike është me mungesa përkundrejt strukturës së miratuar, kryesisht mungesat lidhen me pozicionin e punës “mjek” e paraqitur si më poshtë:

Tabela nr. 13

Nr. punonjësve	Viti 2020		viti 2021		viti 2022		viti 2023	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	599	560	599	579	583	561	586	570

Burim i të dhënave SRE

Nga intervistat e kryera me sektorin e burimeve njerëzore si dhe nga praktikat e ndjekura nga Institucioni rezultoi se: Marrëdhëniet e punës, procedurat e rekrutimit kryhen sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) “Punëdhënësi punëson në mënyrë të drejtpërdrejte punëmarrësin” si dhe bazuar në udhëzimin nr. 499, datë 02.07.2019, “Për procedurat e pranimit të mjekëve në Institucionet Shëndetësore Publike” të cilat realizohen nëpërmjet platformës elektronike “Mjekë për Shqipërinë”, Kushtet, procedurat dhe format e pranimit, fillimit, mbarimit dhe çdo gjë që lidhet me marrëdhëniet e punës janë të përcaktuara në kontratën individuale dhe kontratën kolektive që lidhet midis punëmarrësve dhe punëmarrësit dhe Spitalit Rajonal Elbasan. Nga auditimi i procedurave, praktikave referuar udhëzimit të sipërcituar si, shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, etj rezultoi se se nuk paraqitet asnjë kandidat. Në disa raste në kërkesat e paraqitura nga Drejtoria në lidhje me nevojat mbi mbulimin e vendeve vakante të krijuara, me konkretisht referuar rastit për mungesën e mjekut Radiolog si dhe në raste të tjera mjekë specialist situata paraqitet tepër alarmante duke qenë se nuk paraqiten kandidat. Çështja e mungesës së mjekëve duhet te trajtohet me shume përparësi qoftë nga ana e Spitali por dhe nga ana e organit qendror MSH si një problem tepër shqetësues duke qenë se mungesa e mjekëve specialist në Spital cenon procesin e punë së Spitalit. Përgjegjësia kryesore bie mbi organin qendror MSHMS pasi është kjo e fundit e cila përgatit strategjinë e sistemit të kujdesit shëndetësor, e cila përfshin politika dhe programe përkatëse të shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë siguron zbatimin e strategjisë së zhvillimit dhe garanton standardet e shërbimit spitalor publik, bazuar në legjislacionin politikën, organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të kujdesit shëndetësor.

Institucioni në disa raste ka vendosur që këto vakanca të mbulohen nga stafi infermieror i cili nuk e ka kualifikimin e duhur për mbulimin apo ushtrimin e këtij funksioni. Spitalet Publike janë të detyruar që procesin apo mbarëvajtjen e punës pavarësisht vakancave të theksuara të

vazhdojë të mbulojë me staf të reduktuar apo me staf të pakualifikuar e cila mund të ndikoj në dhënien e një shërbimi jo cilësor.

Mungesë nr.	Pozicioni
1	Mjek Urgjence
1	Mjek Pneumolog
1	Mjek Neurolog
2	Mjek Kirurg
2	Obsteter Gjinekolog
1	Mjek Neonat
1	Reanimator Anestezist

Ndërkohe që në lidhje me stafin mjekësor kryesisht infermiere vakancat krijohen përkohësisht deri në kryerjen e procedurave të nevojshme ku në bazë të procedurave të rekrutimit të kryera sipas shpalljeve paraqiten kandidat dhe mbushen këto vakanca të krijuara.

Gjatë viteve 2020, 2021, 2022 dhe 2023, në Spitalin Rajonal Elbasan, ka pasur lëvizje të punonjësve në pozicione të ndryshme pune brenda strukturës së saj, dalje në pension si dhe emërimë për vendet e krijuara nga dalja në pension sipas tabelës së mëposhtme:

Vitet	2020	2021	2022	2023
Punësuar	13	10	4	9
Larguar	13	10	4	9

Ne lidhje me lëvizjet apo largimet e ndodhura, rezultoi se nuk ka pasur largime punonjës me efekt ndërprerje të menjëhershme të marrëdhënieve të punës por kryesisht janë largime dalje në pension.

Largime nga puna të punonjësve me efekt financiar negativ.

Përsa i përket largimeve nga puna për periudhën e auditimit, janë larguar 4 punonjës për shkak të suprimimit të vendit të punës të cilët nuk pranuan të lidhin kontratë punë me Shoqërinë koncesionare të Laboratorit. Zyra financës për 4 punonjësit e larguar vendosi ti shpërblejë për vjetërinë në punë punonjësit si më poshtë:

Tabela nr. 14

Lekë

Emri i punonjësit	Pozicioni	Viti i largimit	Nr. i pagave të fituara për 15 ditë	Vite	Vlera përfituar e
M. P.	Laborant	2021	11	22	583,770
B. L.	Laborant	2021	14	28	784,224
A. S.	Laborant	2021	17	29	691,650
D. H.	Laborant	2021	12	24	565,200
					2,624,844

Burimi: SRE

Ky shpërblim i dhënë është mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi Punës”, neni 145, “Shpërblim për vjetërinë”, ku shpreh:

Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Punëmarrësi e humb të drejtën e

shpërblimit për vjetërsi, nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm, për shkaqe të arsyeshme. Shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15 ditësh, mbi çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ekziston në përfundim të marrëdhënieve të punës. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e pagës të vitit paraardhës dhe indeksohet. Shpërblimit për vjetërsi i shtohet shpërblimi që jepet në rastin e zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme ose të zgjidhjes me efekt të menjëhershëm pa shkaqe të arsyeshme.

Vlera e paguar nga Institucioni përbën efekt financiar negative pasi në hartimin e Kontratës Koncesionare në të drejtat dhe detyrimet e Palëve, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta si dhe të tjera detyrime, në moment e hyrjes në fuqi të kontratës duhet të përcaktohej që punonjësit e shërbimit të Laboratorit duhet që të punësohen nga ky i fundit. Pra ndodhur në këto kushte për shkak të mos përcaktimit të klauzolës i’u ka lindur e drejta për të zgjidhur marrëdhëniet e punës me Institucionin dhe si rrjedhojë në bazë të përcaktimeve të bëra në nenin 145 të Kodit të Punës

të përfitojnë shumën e sipërcituar. Për me tepër që kjo vlerë e shlyer nga Institucioni mund të shtohet akoma më shumë në rast vendimi të gjykatës së Apelit.

Proceset gjyqësore të krijuara nga 3 punonjësit të cilët nuk pranuan të lidhin marrëdhëniet e punës me Koncesionarin e Laboratorit:

Emri i punonjësit	Pozicioni	Viti i largimit	Vendimi i gjykatës
B. L.	Laborant	2021	Shkallë të parë/proces
A. S.	Laborant	2021	Shkallë të parë/proces
D. H.	Laborant	2021	Shkallë të parë/proces

Dosjet e personelit

Në lidhje me dosjet e personelit, u audituan me zgjedhje 40 dosje, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në 10 (dhjetë) raste u konstatua mungesa e dokumentacionit duke mos respektuar të gjitha kriteret e Urdhrit Nr.511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik”. Emërimet dhe largimet e punonjësve në SRE janë në mospërputhje me Urdhrin Nr.506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve” Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e personelit të Spitalit Rajonal Elbasan, konstatohet se në përgjithësi mungesat e dokumentacionit janë kryesisht ato të karakterit formal sic janë vërtetim nga prokuroria që nuk ka çështje të hapur, vërtetim gjendje gjyqësore, vlerësime periodike në punë etj, ndërkohë nuk ka mangësi përsa i përket kriterëve të detyrueshme sic janë diploma, certifikata notave, leja e ushtrimit të profesionit nga urdhri i profesionistëve përkatës, CV etj. Në disa raste për shkak dhe të mungesës së personelit shëndetësor nuk disponohen diploma për infermiere por kryesisht shoqërohen me certifikata apo kualifikim të ndryshme. Përgjithësisht për çdo punonjës mbahet dosje e veçantë, me dokumentacionin përkatës dhe kontratën e punës individuale sipas pozicionit të punës.

- Përlllogaritja e pagës sipas të gjithë elementëve përbërës, dokumentacioni justifikues për pagat. Ndalesat mbi pagat dhe transferimi i tyre në llogari të degës së tatimeve. Rakordimi i pagave me listë pagesa, si dhe pasqyrimi në kontabilitet. Zbatimi i dispozitave ligjore për shpërblimet e dhëna gjatë vitit.

Nga auditimi i ushtruar në listëpagesat e punonjësve për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2023 u konstatua se në përlllogaritjen e pagave janë respektuar dispozitat ligjore në fuqi. U verifikuan listë pagesa dhe borderotë, me të gjithë dokumentacionin bashkangjitur justifikues si listë prezencat, elementët e pagës për çdo person për të gjithë periudhën e kontrollit, nga ku rezultoi se çdo element është përlllogaritur sipas VKM-në nr 555 datë 11.08.2011-*Për miratimin e strukturës dhe të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe punonjësve të infermierisë në Sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë*”; e ndryshuar, Ligjin nr 7703 datë 11.05.1993 “*Për Sigurimet Shoqërore*”, i ndryshuar; Ligji Nr.8438 datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, VKM Nr.717 datë 23.06.2009, “*Për pagat e sektorit mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore të ndryshuar*”. Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se në përgjithësi të gjithë elementët e pagës ishin përlllogaritur saktë, klasifikimi i klasave për punonjës mbështetës ishin të sakta konform akteve ligjore në fuqi. Në elementin sipas tabelës Shtesë page për turne dhe mbi kohë, ishin përfshirë, turnet II dhe të III, thirrjet, të cilat nuk e tejkalonin 20 % të pagës mujore bruto, ditët e festave . Shtesat për pozicion ishin të përlllogaritur saktë, si dhe elementi shtesa për kushte punë, apo rreziqe përlllogaritur saktë. U morën me përzgjedhje disa librezat pune për efekt të llogaritjes së elementit të pagesës “vjetërsisë në punë” dhe rezultuan se ato ishin përlllogaritur saktë, në përputhje me borderotë dhe pagesat. Nga kontrolli i ushtruar për dokumentacionin justifikues u konstatua se listë pagesat për cdo muaj janë të shoqëruara me gjithë dokumentacionin justifikues konform akteve ligjore në fuqi si listë prezencat sipas sektorëve, procesverbale për mbajtjen e kohë shënuesve, listë pagesë sipas formatit e-sig 25-a etj. Në dokumentacionin justifikues janë bashkëlidhur urdhërat për emërimet dhe lëvizjet të personelit të konfirmuara nga

titullari i institucionit. Listëpagesat janë firmosur nga specialistët e pagave dhe përmbledhësja është firmosur nga Shefi i planit, nga Përgjegjësi i burimeve njerëzore, nga Shefi i Financës, nga N/Drejtori i shërbimeve. Gjithashtu janë të evidentuara urdhërat për kryerjen e lejeve të zakonshme, si dhe raportet për paaftësi të përkohshme dhe leje lindje. Mbi bazën e këtyre dokumentave janë përgatitur listë pagesat, janë xhiruar në llogaritë individuale të punonjësve pagat respektive duke bërë dhe ndalesat përkatëse. Nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua se ndalesat për efekt të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për llogari të degës së Tatimeve, janë pasqyruar saktë, deklaruar dhe paguar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ndalesat për sigurime e tatime rakordojnë me ato të deklaruar dhe kaluara në bankë. Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se pagat janë kontabilizuar në librat e pagave dhe në libër të madh, u bë kryqëzimi i të dhënave që gjenden në listë pagesë dhe Urdhër shpenzimeve për efekt pagese të pagës neto dhe rezultuan të kuadruara. Pagat e muajit të marra në kontroll me për zgjedhje rakordojnë me listëpagesat dhe me shumatat neto të kaluara në bankë.

2.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit “*Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit*” dhe konkretisht, ligjin nr.24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

4.1.Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes ekonomike. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të viteve 2020-2023 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: banka, magazina, pagat, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve etj.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve 2020-2023, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2020-2023.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit në mbyllje të vitit buxhetor 2020-2023.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat etj).

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2023, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Elbasan për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Elbasan për periudhën audituese, ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Elbasan, pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Përgjegjësi i Degës znj. A.K si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Elbasan brenda afateve ligjore dhe konkretisht:

Për vitin ushtrimor 2020 me shkresë përcjellëse nr.prot.nr.prot.270, datë 19.03.2021.

Për vitin ushtrimor 2021 me shkresë përcjellëse nr.prot.nr.prot.233, datë 15.03.2022.

Për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.prot.nr.prot.242, datë 08.03.2023.

Për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr.prot.nr.prot.252, datë 08.03.2024.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Drejtori i Shërbimit Spitalor Elbasan A.G. dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi i Degës së Financës A.K. Pra, në këtë rast nuk kemi delegime të këtyre detyrave.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Nga verifikimi i ditarit të bankës i mbajtur sipas natyrës dhe sipas destinacionit rezulton të jetë i rakorduar me dokumentin e nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj (ekstrakt banke) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor dhe nuk ka diferenca.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël).
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues.
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur.
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit.***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë institucion, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “**Excel**”.

Konkluzion: Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.

Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III, “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme” në të cilën përcaktohet: *Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njësisë të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur radhën kronologjike si më poshtë vijon: Nën-pika 43. Fillimisht, njësite e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore. Nën-pika 44. Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”. Nën-pika 45. Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.*

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu, dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar.

Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet, etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Spitalit Elbasan për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2020 deri më datën 31.12.2023. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023, rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 1,383,789,281 lekë dhe për vitin 2023 është 1,512,259,510 lekë, i paraqitur në formatin Nr.1 në llogari si më poshtë:

Tabela nr. 15 Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2023

Nr.	Referenca e	EMERTIMI	Ushtrimi I	Ushtrimi Paraardhes
Reshti	Logarive		Mbyllur	
1	A	A K T I V E T	1,512,259,510	1,383,789,281
2		I.Aktivët Afatshkurtra	204,278,977	173,452,277
3		1.Mjete monetare dhe ekujalent te tyre	40,468,678	33,741,381
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	40,468,678	33,741,381
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera tetjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	72,503,704	69,061,732
12	31	Materiale	70,964,075	66,559,900
13	32	Inventar I imet	1,539,629	2,501,832
14	33	Prodhimreproces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose pranë te treteve		
19	38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone per zhvlerësimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketueshme	91,306,595	70,649,164
22	411	Klientë e llogarite ngjashme		
23	423429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	452,320	462,320
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shëndetësorë		

29	437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorë te ndryshëm	1,714,000	6,941,038
33	4342	Operacione me shtetin (Tdrejta)	89,140,275	63,245,806
34	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	-	-
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te marrëdhënieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'ushpermdare ne disaushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		II.Aktivët Afatgjata	1,307,980,533	1,210,337,004
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	6,638,536	6,765,975
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	6,638,536	6,765,975
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e tengjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,153,674,545	1,203,571,029
48	210	Toka, T,roje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	893,138,938	940,146,251
51	213	Rruge, rrjete, vepraujore	14,006,763	14,743,961
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	169,137,540	188,592,326
53	215	Mjete Transporti	15,208,732	19,010,915
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventarekonomik	62,182,572	41,077,576
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktimet eAktiveve Afatgjata	0	
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	-	-
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	147,667,452	-
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	147,667,452	-

Burimi: SRE

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

“Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën **33,741,381** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën **40,468,678** lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim te vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

- *Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”*sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën **33,741,381**lekë dhe në mbyllje të vitit 2023është në vlerën **40,468,678**lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **69,061,732** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **72,503,704** lekë. Llogaritë analitike paraqiten më poshtë:

- *Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”* paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 66,559,900 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 70,694,075 lekë, me një diferencë në

zbritje për vitin ushtrimor prej -4,134,175 **lekë**, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,501,832 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 1,539,629 lekë.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **26,427,484** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **30,638,126** lekë, ku kemi rritje duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes së detyrimeve të shtetit ndaj të tretëve.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, si në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **6,941,038** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën **1,714,000** lekë. **Kjo vlerë është e pa analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, e cila është trashëguar në vite.**

- **Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 63,245,806 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin 2023 që trashëgohen në vitin 2023/4. Gjendja në fund të vitit 2023 e llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën **89,140,275** lekë rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive në pasivin e bilancit: llog. 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën **31,190,034** lekë për faturat e fundit vitit 2023, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën **40,104,828** lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën **4,077,724** lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën **11,915,690** lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën **1,672,799** lekë.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë 467 “**kreditorë të ndryshëm**” në pasiv të bilancit, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **7,521,184** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **2,242,320** lekë.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivitet **afatgjata materiale**;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivitet e blera janë kryer teste për në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet në proces (gjendjen e llog 23I “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **147,667,452**lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **6,765,975** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej **6,638,536** lekë. Me një pakësim gjatë vitit 2023 në vlerën 127,439 lekë.

Inventari i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime"

Llog.	Nr	Emërtimi i aktiveve	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa gjate vitit 2023	Pakësime gjate vitit 2023	Gjendja më 31.12.2023
202		Studime dhe kerkime	6,765,975		-127,439	6,638,536
		TOTALI	6,765,975		-127,439	6,638,536

Konkluzion: Vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej **6,638,536** lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, është e pa analizuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36 i cili përcakton se: “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15 %”.

Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **940,146,251** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **893,138,938** lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(kosto historike)paraqiten në vlerë të barabartë prej **1,201,429,850** lekë.

Tabela nr. 16 Inventari kontabël i llogarisë 212 "Ndërtesa " me 31.12.2023

NR	Objekti	Viti Ndërtimit	Gjendja Me 1.1.2023	Shtesat +	Pakesimet -	Gjendja me 31.12.2023
1	Spitali Pathologjik + Rikonst.rep .Kimikoterapi	1939 +2015	73.925.475			74.165.328
2	Spitali kirurgjikal +skaneri rikonstr	1979 2011	10.896.804			10.896.804
3	Spitali Pediatrik	1983(2007) (2021)	353.131.135			353.131.135
4	Polikl.Specialiteteve	1970	48.518.453			48,518453
5	Rep urgj. Laborator +gabina	1970 + 2010	29.713.664			29.713.664
6	Kapanoni i Spitalit (7+4garazhe infek+magazine)	1965 ,1980	2.105.275			2.105.275

7	Lavanteri , guzhina	1985	2.974.120			2.974.120
8	Reparti morgut	1985	3.695.423			3.695.423
9	Vendroja pediatri	1983	14.728			14.728
10	Pika teknike	1980	1.088.246			1.088.246
11	Muri rrethues Spital	1983	4.296.195			4.296.195
12	Koridori lidhes	2000	11.753.592			11.753.592
13	Rruga spitalit	2000	5.519.632			5.519.632
14	Godina krematori	1975	74.987			74.987
15	Garazh makinash maternitet	1980	934.336			934.336
16	Spitali cerrikut	1960	10.933.497			10.933.497
17	Garazhdi cerrikut	2000	613.000			613.000
18	Zyrat administrates	1970	10.394.402			10.394.402
19	Rrjeti ujesjelles	2003	2.712.585			2.712.585
20	Depozite uji rep dializes	2005	899.406			899.406
21	Biloku i ri kirurgji+Maternit dhe pershtatje dhome te denuarve	2013	439.140.543			439.140.543
22	Muri rrethues i spitalit ana jugore	2017	3.347.646	0	0	3.347.646
23	Rikonstrukcion i Godines rezonances	2018	8.573.809	0	0	8.573.809
24	Urgjenca e re dhe koridori lidhes	2019	175 933 044		0	175.933.044
	TOTALI		1 201 429 850		0	1 201 429 850

Burimi: SRE

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **188,592,326** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën **169,137,540** lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në fillim të vitit 2023 në vlerën **533,931,302** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën **551,813,702** lekë, pra kemi pakësim në vlerën **17,882,400** nga lëvizjet brenda aktiveve, pasi kemi blerje të krijuar me pagesë në vlerën **11,916,000** lekë, si dhe shtesë në vlerë **5,966,400** lekë.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **19,010,915** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **15,208,732** lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **56,864,078** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **24,270,266** lekë, pra kemi pakësim në vlerën **32,593,812** lekë, e cila ka ardhur nga lëvizja brenda aktiveve dhe si amortizim dhe nxjerrje jashtë përdorimit. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2020 deri në fund të vitit 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 17 Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2023

NR	Objekti	Viti Prodhimit	Gjendja Me 1.1.2023	Shtesat +	Pakesimet -	Gjendja me 31.12.2023
1	Autoambulance fiat dukat 0983 A	1994	4.101.617			4.101.617
2	Autoamb benz AA618AZ	2005	7.610.024			7.610.024
3	Autoamb.benz AA106BE	2005	7.610.024			7.610.024
4	Autoamb benz AA284BE	2005	10.410.673			10.410.673
5	Autoamb tip reno El 2951 C	1997	137.000			137.000
6	Autoambulance Tip Wosvagen AA973KX	2014	7.482.000			7482000
7	Autoambulance Tip Wosvagen AA256 VV	2018	6.545.700			6.545.700
8	Autoambulance Tip Ford tranzitAB667CF	2020	6.383.520			6.383.520
9	Autoambulance TipFord TranzAB851CF	2020	6.383.520			6.383.520
10	Ëolsvagen Golf AB 086 IE	2005	200.000			200.000
	TOTALI		56 864 078			56 864 078

Burimi: SRE

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **41,077,576** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **62,182,572**. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **21.568.108** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël

49.980.339 lekë, pra kemi shtesa në vlerën **28.412.231** lekë, e cila ka ardhur nga lëvizja brenda aktiveve.

Inventarizimi i aktiveve për vitet 2020 - 2023

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të çdo viti për Spitalin Sarandë. Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit për vitin 2023”, Urdhër nr. 797, datë 12.12.2023. Urdhër nr. 798, datë 12.12.2023. Urdhër nr. 799, datë 12.12.2023 Urdhër nr. 800, datë 12.12.2023. Urdhër nr. 801, datë 12.12.2023.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2023.

Referuar dokumentacionit të mbajtur nga komisioni konstatohet se për disa njësi kryerja e inventarizimit paraqet mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore, pasi komisioni ka konstatuar mungesa në artikuj të ndryshëm ka kryer diferencat nga gjendja fizike dhe i ka kaluar brenda ditës së inventarizimit në listën “mallra për jashtë përdorimit dhe funksionit”, si më poshtë:

Për vitin 2023

Për objektin “Kirurgji , Maternitet, Radiologji, Mamografi”, komisioni (i përbërë nga A.I, A.D dhe Sh.Z), kanë konstatuar vetëm artikuj ta dalë jashtë përdorimit.

Për objektin “Urgjenca, Eko zemre, Ish Laboratori, Mjete transporti, Urgjenca e vjetër”, komisioni (i përbërë nga E.Z, R.D dhe B.D), kanë konstatuar vetëm artikuj ta dalë jashtë përdorimit.

Për objektin “Pathologji, ORL, Farmaci, Morgu, Magazina Industriale, Sterilizim”, komisioni (i përbërë nga V.T, L.M dhe A.N), kanë konstatuar vetëm artikuj ta dalë jashtë përdorimit.

Për objektin “Pediatri dhe Administratë”, komisioni (i përbërë nga I.D, E.M dhe M.M), kanë konstatuar vetëm artikuj ta dalë jashtë përdorimit.

Për objektin “Poliklinikë, Dispancerisë dhe Bilatarisë”, komisioni (i përbërë nga Xh.K, M.P dhe A.C), kanë konstatuar vetëm artikuj ta dalë jashtë përdorimit.

Në spitalin Elbasan për periudhën e auditimit, nuk është vepruar drejt nga strukturat drejtuese dhe nuk janë marrë masa për asgjësimin e tyre si ngritja e komisioneve të vlerësimit, komisionet e asgjësimit, etj. Veprimet e kryera janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” Inventarizimi i aktiveve, “Përgjegjësitë për inventarizimin” pikat 85,86,87 dhe 89, “Procesi i vlerësimit të aktiveve” pika 96 dhe 98 dhe “Lista e aktiveve të identifikuarra për vlerësim” pikat 102,103 dhe 104.

Tabela nr. 18 Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Nr.	Referenca e	E M E R T I M I	Ushtrimi I	Ushtrimi Paraardhes
Reshti	Llogarive		Mbyllur	
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	115,915,807	87,890,004
66		I.PasivetAfatshkurtra	115,915,807	87,890,004
67		1. LlogaritePagushme	115,915,807	87,890,004
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	31,190,034	15,413,181
69	42	Detyrime ndaj personelit	40,104,828	33,279,788
70	16,17,18	Hua Afatshkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatimtaksa	4,077,724	2,996,903

73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	11,915,690	9,950,902
76	436	Sigurime Shendetsore	1,672,799	1,387,606
77	437,438,	Organizma te tjerë shteterore	103,200	99,600
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike		
80	464	Det. pertupaguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	24,609,212	17,240,840
82	467	Kreditore te ndryshem	2,242,320	7,521,184
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime		
84	49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim (-)		
85		2.Te tjerapasiveafatshkurtra	-	-
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Teardhura per t'uregjistruar vite tpsardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.PasivetAfat Gjata	-	-
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afatgjata		
94		Provizjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,396,343,703	1,295,899,277
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,396,343,703	1,295,899,277
98	101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,232,816,785	1,279,398,736
99	12	Rezultatet embartura		
100	85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	15,859,466	16,500,541
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e vetat e investimeve		
103	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvlerësime		
104	105.106	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	147,667,452	
105	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
106	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
107	109	Rezerva nga Rivlersimi i Aktiveve Afatgjata		
108		Te Tjera		
109	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,512,259,510	1,383,789,281

Burimi: SRE

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **87,890,004** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **115,915,807** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **15,413,181** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **31,190,034** lekë, pra ka ulje të detyrimeve ndaj të tretëve nga viti paraardhës në vitin ushtrimor 2023 në vlerën **15,776,853** lekë. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie, paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 19 Llogaria 401 viti 2023

furnitori	NR fatures	data	vlera	pagesa
C.C miremb. impianistike	149/2023	05.12.2023	500160	mujore
K. sherbim roje	340/2023	30.11.2023	1031491	
D.L	194/2023	08.01.2023	2337444	mujore
G.Th Riparim kondicioner	19/2023	23.12.2023	99900	
F.b lende djegese pellet	16/2023	28.12.2023	1585247	

K. sherbim roje	372/2023	31.12.2023	3402540	mujore
E. riciklim mbetje	2129/2023	30.11.2023	851327	mujore
Fedosupsulatubat e laboratorit	613/2023	14.12.2023	708000	
	645/2023	29.12.2023	1008000	
		28.12.2023	1365000	
Laboratory	262/2023	06.12.2023	5666693	
	353/2023	05.01.2024	8000000	mujore
OSHE	460104191	31.12.2023	465796	mujore
	460102935	31.12.2023	919396	mujore
	460099450	31.12.2023	170916	mujore
	459798087	31.12.2023	16900	mujore
	460103688	31.12.2023	669439	mujore
Ujesjelles	2312	31.12.2023	217056	mujore
	2312	31.12.2023	525408	mujore
	2312	31.12.2023	1440	mujore
Posta	45/2023	03.01.2024	3305	mujore
Albtelecom	89793/2023	06.01.2024	21120	mujore
Medikamenteilma	194298/2023	15.12.2023	106876	
Insitutindetimit	846/2023	19.12.2023	400000	
Alstezomirebautomjete	2110/2023	20.12.2023	1043400	
Fizikaberthamore	1292	15.12.2023	32000	
			31148854	
G.F	438	02.12.2008	38640	Vjetra
OKBT BIOMJEKSORE	MA2	08.04.2011	2540	Vjetra
			41180	
Totali			31190034	

Burimi: SRE

Konkluzion: Referuar analizës së gjendjes së llog.401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, ku në fund vitin 2023 rezulton me një gjendje prej **31,190,034** lekë në të cilën janë akumuluar fatura të palikuiduara të viteve të kaluara si dhe të vitit 2023, të cilave u ka kaluar afatin 30-ditor i pagesës së këtyre faturave në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52⁵, ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 6 “Afati”.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën **33,279,788** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 40,104,828 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën kontabël **2,996,903** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **4,077,724** lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën **9,950,902** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **11,915,690** lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2021 është në vlerën kontabël **1,387,606** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **1,672,799** lekë.

- **Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** nuk ka.

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuarra për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 17,240,840 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 24,609,212 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Elbasan.

- Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 7,521,184 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,242,320 lekë.

Tabela nr. 20 Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Emri I punonjesit	Detyrimi	Det yrimi	Shu ma gjith s	Det yrimi	ja n ar	sh ku rt	m ar s	p ri ll	m aj	qe rs ho r	ko rr ik	g us ht	sh tat or	te to r	ne nt or	dh jet or	Shu ma ndale s.	Detyri m. mbetu r	
	01.01.2023	01.01-31.12 2023	31.12.2023	01.01-31.12 2023													1.1-31.12.2023	dt.31.12.2023	
	1	2	3=1+2		4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	
A. Q.	73320	0	73320		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	73320	
G.M.	24000	0	24000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24000	
N. D.	24000	0	24000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	24000	
P.X.	72000	0	72000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	72000	
F. T.	27000	0	27000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27000	
Xh. D.	27000	0	27000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27000	
A. K.	17000	0	17000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	17000	
T. G.	27000	0	27000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27000	
A. N.	25000	0	25000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25000	
O. C.	22500	0	22500		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	22500	
H.K.	22500	0	22500		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	22500	
B.M.	27000	0	27000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27000	
M. T.	27000	0	27000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27000	
A.C.	27000	0	27000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27000	
B. Xh.	10000	0	10000		0	0	0	10000	0	0	0	0	0	0	0	0	10000	0	
M.A.	10000	0	10000		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10000	
Shuma Totale	462320	0	462320	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10000	452320	
NDAL ESA	PERM BARI MORE																Total i 423	452320	
E.K.	1858000				120000		120000	120000	120000	120000	120000	120000	120000	120000	120000	120000		144000	1714000
E.K.	4730936				11664		11664	11664	11664	11664	11664	11664	11664	11664	11664	11664		23328	4707608

E.P.	352102				3		3	3										1508	20129
					0		0	0										10	2
					1	30	1	1	1										
					6	16	6	6	6										
					2	2	2	2	2										

Burimi: SRE

-Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”(Aneksi nr.B/9) të PF të vitit 2023 paraqitet më poshtë:

Tabela nr. 21 PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE

VITI 2023

(Klasifikimi, sipasNatyresekonomike)

NE / LEKE

Nr. rresh ti	Nr. Llogarij e	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	1,104,847,465	989,790,465
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	-	-
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	-	-
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel		
7	7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
8	702	2.Tatimi mbiPasurine	-	-
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme		
10	7021	Tatim mb ishitjen e pasurise se palujtshme		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	-	-
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar (TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
18	704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksonet nderkombtare	-	-
19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksonet nderkombtare		
23	705	5.Takse e rruges		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		

25	709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
26	75	<i>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</i>	-	-
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
34	71	<i>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</i>	62,143,432	73,692,107
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	1,275,267	1,225,920
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	1,275,267	1,225,920
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	60,868,165	72,466,187
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	60,699,120	72,029,175
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura ngashitja e mallrave e sherbimeve	159,045	
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrimee zhdemtime	10,000	437,012
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	<i>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</i>	-	-
49	760	Nga interesat e huadhënies së brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga kembimetvalutore		
53	72	<i>V.GRANTE KORENTE</i>	1,026,203,492	914,118,296
54	720	1.Grant korent I Brendshem	1,026,203,492	914,118,296
55	7200	Nga Buxheti per NJQP (Qendrore)	937,063,217	850,872,490
56	7201	Nga Buxheti per NJQP (Vendore)		
57	7202	Nga Buxheti per pagesat e posacmete ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti (ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per teardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim i pritshem nga buxheti	89,140,275	63,245,806
62	7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)		

63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	2.Grant korent I Huaj	-	-
65		Nga Qeverite Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		VI.TE ARDHURA TE TJERA	16,500,541	1,980,062
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktiveafatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni i investimeve	16,500,541	1,980,062
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
74	B	SHPENZIMET	1,088,987,999	973,289,924
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	571,367,397	469,470,123
76	6001	Paga, personel i perhershem	556,807,692	460,272,047
77	6002	Paga personel i Perkohshem	14,559,705	9,198,076
78	6003	Shperblime	-	
79	6009	Shpenzimetetjera per personelin	-	
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	89,621,765	77,212,646
81	6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	88,340,275	69,193,711
82	6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	1,281,490	8,018,935
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	415,515,643	405,514,941
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	4,797,630	3,348,976
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	188,414,911	166,338,334
87	6022	Sherbime nga te trete	179,016,676	174,744,454
88	6023	Shpenzime transporti	12,128,738	13,757,012
89	6024	Shpenzime udhetimi		0
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	26,345,013	37,877,882
91	6026	Shpenzime per qeramarrje		0
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesimelegale	2,402,000	7,043,429
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		0
94	6029	Shpenzime te tjera operative	2,410,675	2,404,854
95	603	IV.SUBVECIONE	-	-
96	6030	Subvecione per diference cmimi		
97	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione per siperarrjet individuale		

100	6039	Subvecone te tjera		
101		V.TRANSFERIME KORENTE	874,741	8,341,527
102	604	1.Transferime korente te brendshme	-	-
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	-	
104	6041	Transferime korentete institucione qeveritare te ndryshme	-	
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsove	-	
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	-	
107	605	2.Transferime korente me jashte	-	-
108	6051	Transferime per Organizatat Nderkombetare	-	
109	6052	Transferime per Qeverite e Huaja	-	
110	6053	Transferime per institucionet jo fitimprurse te huaja	-	
111	6059	Transferime te tjera korrente me jashte shtetit	-	
112	606	3.Transferime perBuxhetetfamiljare e Individe	874,741	8,341,527
113	6060	Transferta te paguara nga ISSH e ISKSH	-	
114	6061	Transferta paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	874,741	8,341,527
115		VI. SHPENZIME FINANCIARE	-	-
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	-	-
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte	-	
118	651	Interesa per huamarrje tetj. Brendshme	-	
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise	-	
120	656	Shpenz.nga kembimetvalutore	-	-
121	66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	-	-
122	660	Interesa per huamarrjen ga Qeveri.te Huaja	-	
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb	-	
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme	-	
125		VILKUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	-	-
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivetf inanciare		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	3,441,972	-9,765,300
131		IX.SHPENZIME TE TJERA	15,050,425	22,515,987
132	831	Caktim tea rdhurash te funksionimit per investime	10,164,141	11,087,755
133	8420	Transferim i teardhurave ne buxhet	1,444,312	1,662,932
134	8423	Transferime per efekt te ndryshimit te gjendjes	3,441,972	9,765,300
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES <i>(Rezultati i Veprimtarise se vitit Ushtrimor)</i>	15,859,466	16,500,541

Burimi: SRE

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën **1,104,847,465** lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Elbasan paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 711 **“Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në vlerën **60,868,165** lekë. Kjo vlerë rakordon me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë 7200 **“Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)”** paraqitet në vlerën 937,063,217lekë, e cila përfshin fondet e akorduara nga Ministria e Shëndetësisë.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 **“Financim i pritshëm nga buxheti”** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën **89,140,275** lekë, e cila rakordon me gjendjen në vlerën **89,140,275** lekë të llogarisë analoge 4342 **“Operacione me shtetin (të drejta)”** në bilancit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën **1,088,987,999** lekë paraqitet më poshtë:

-Gjendja e llogarisë 600 **“Paga, shpërblime e të tjera personeli”** paraqitet në vlerën **571,367,397** lekë, e cila përputhet me akt-rakordimin me thesarin për këtë artikull shpenzimesh.

-Gjendja e llogarisë 601 **“Kontribute për sigurime”** paraqitet në vlerën **89,621,765** lekë, e cila përputhet me akt-rakordimin me thesarin për këtë artikull shpenzimesh.

-Gjendja e llogarisë 602 **“Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në vlerën **415,515,643** lekë , e cila përputhet me akt-rakordimin me thesarin për këtë artikull shpenzimesh.

Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është **1,104,847,465** lekë dhe totali shpenzimeve është **1,088,987,999** lekë. Diferenca e tyre në vlerën **15,859,466** lekë rakordon me gjendjen e llog.85 **“Rezultatit e ushtrimit”**.

2.5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave punimeve civile, mallrave dhe shërbimeve.

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2020 deri me datë 31.12.2023, nga Spitali Rajonal Elbasan janë realizuar gjithsej 47 procedura prokurimi, me vlerë 854,182,443 lekë, të ndara si më poshtë:

- Punime civile	3	procedura	me vlerë	443,277,176 lekë
- Mallra	20	“	me vlerë	174,987,230 “
- Shërbime	24	“	me vlerë	235,918,037 “

Në 24 procedurat e shërbimeve, 5 i përkasin shërbimit të ruajtjes fizike, 3 studim/projektim dhe supervizion. Procedura shërbim i hotelerisë dhe lavanderisë me fond limit 116,665,938 lekë, është filluar në vitin 2019 dhe ka përfunduar në 2020 (e audituar).

Nga 47 procedura të realizuara, lloji i procedurës paraqitet si më poshtë:

Negocim pa shpallje	6	procedura	me vlerë	33,518,362 lekë.
Procedurë e hapur	14	“	me vlerë	706,444,612 lekë
Kërkesë për propozim	13	“	me vlerë	42,374,946 lekë
E hapur e thjeshtë	14	“	me vlerë	71,844,523 lekë.

Procedurat “Negocim pa shpallje”, janë realizuar në vitin 2020, në periudhën e pandemisë.

Janë audituar 17 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit rreth 740 milionë lekë, ose afërsisht 86 % e vlerës së parashikuar të prokurimeve. Sa i takon sasisë, është audituar 32 % e numrit të tyre.

Sipas procedurave përkatëse, rezulton si më poshtë:

1. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Rikonstrukcion i poliklinikës së specialiteteve”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi konstatohet që:

Projektzbatimi dhe preventivi përkatës janë përgatitur nga BOE “K. P. & L. C. & I. D. & S.”. Projektit të zbatimit i është bërë opoenca teknike nga Instituti i Ndërtimit dërguar me shkresë nr. 2241/2 prot., datë 06.01.2023. Vlera e preventivit të punimeve është 137,896,180.5 lekë pa TVSH, vlerë e cila është përcaktuar për fondin limit.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Rikonstrukcion i poliklinikës së specialiteteve”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 269, datë 01.02.2023.	3. njësia e prokurimit I.S (juriste)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 267/1/1 prot., datë 01.02.2023. L.R O.T K.T
2. lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (punë).	Xh.K (ekonomiste) A.M (spec.i fushës)	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 137,896,180.5 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 135,380,607.9 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 2,515,572.9 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 07.03.2023	9. Burimi i Financimit Financim buxheti i institucionit	10. Operatorët Ekonomikë 1. BOE “R. C.&N.”, me vlerë të ofertës 113,586,257.1 lekë. 2. OE “L. K.”, me vlerë të ofertës 118,572,535.6 lekë. 3. OE “E.” me vlerë të ofertës ekonomike 135,380,607.9 lekë. 4. BOE “E.-A.&S. 2.” me vlerë oferte 108,444,890 lekë. 5. OE “H.” me vlerë oferte 137,526,387 lekë. 6. OE “B.-I.” me vlerë oferte 123,589,415.2 lekë. 7. OE “B. N” , me vlerë oferte 136,622,965.4 lekë.

		<p>8. BOE “A. C. &Sh.”, me vlerë oferte 114,366,673 lekë.</p> <p>9. OE “E. V.”, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.</p> <p>10. E. Ç., person fizik, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.</p> <p>b.Skualifikuar – 7 OE</p>
<p>11. Ankimime</p> <p>- AK Ska</p> <p>- APP Ska</p> <p>- KPP Ska</p>		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
<p>12. lidhje e kontratës</p> <p>nr. 276/14prot., datë 14.04.2023</p>	<p>13. Vlera e kontratës (me tvsh)</p> <p>157,039,969.4 lekë</p>	<p>14. Afati i kontratës në ditë</p> <p>180</p>

Njoftimi i kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 17, datë 20.02.2023.

Dokumentet e tenderit janë përgatitur nga njësia e prokurimit. APP me email të datës 21.02.2023, ka paraqitur disa rekomandime për përmirësimin e dokumenteve të tenderit, të kësaj procedure. Rekomandimet kanë të bëjnë me stafin e kërkuar, numrin e punonjësve, licencat, makineri, mekanizma, pajisje etj.

Nga ana e Njesisë së prokurimit është hartuar një shtojcë, ku janë reflektuar disa nga rekomandimet e APP.

Nga verifikimi i dokumentacionit të kriterëve të veçanta konstatohet se krahas të tjerave është kërkuar:

- Të ketë të punësuar staf mbështetës inxhinier të profilit strukturist, ndërkohë që në fazën e zbatimit ky proces mund të monitorohet nga inxhinierët e ndërtimit drejtues teknikë.

- Licenca sipas kategorive N.P-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), N.S 8 A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri), N.S 3 (Impiante ngritëse dhe transportues), të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

- Disponimi ose marrja me qira e automjeteve si më poshtë:

Kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës mbi 15 ton, 2 copë.

Kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës minimalisht 10, ton 3 copë.

Kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës 3.5 deri 5 ton, 1 copë.

Kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës deri 1 ton, 2 copë.

Rimorkiator, 1 copë.

Nga verifikimi i punimeve sipas përshkrimit të preventivit, sasia e materialeve të nevojshme për transportim nuk e kalon 1200 ton, nga ku rezulton se kërkesa për 8 automjete është e pa argumentuar. Po ashtu nuk ka procese punimi, sipas të cilave nevojitet rimorkiator.

Është kërkuar disponimi ose marrja me qira e një fadrome, një miniekskavatori dhe një minifadrome, ndërkohë që sipas preventivit volumi që duhet të kryejnë këto mekanizma është vetëm 18.7 m³.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda dhe 5 (pesë) punonjës shoferë kamionësh. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, (bazuar në legjislacionin në fuqi) dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 41, pika 2, ku përcaktohet:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Si pasojë e veprimeve të mësipërme krijohen vështirësi për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit për OE që kanë kapacitet për realizimin e kontratës. Nuk është analizuar në mënyrën e duhur nevoja për licencim, makineri e pajisje të nevojshme për zbatimin e kontratës.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi anëtari i njësisë së prokurimit z. A.M, në cilësinë e specialistit të fushës (ekspert i jashtëm).

Mbi vlerësimin e ofertave.

Komisioni i vlerësimit të ofertave është ngritur me Urdhër të Titullarit të AK z. A.G nr. 267/1 prot., datë 01.02.2023, me përbërje z. L.R, znj. O.T dhe K.T. Punonjësit e mësipërm nuk kanë profesione të cilat nuk janë të fushës për të cilën realizohet procedura e prokurimit. **Ngritja e KVO pa një specialist të fushës është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë Neni 75, pika 1, ku përcaktohet:**

“Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit”.

Theksojmë se institucioni nuk ka të punësuar në organiken e tij inxhinier të fushës së objektit të prokurimit për këtë procedurë, por nuk rezulton të jetë kontraktuar ndonjë punonjës për sipas përcaktimeve të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 75, pika 3. Mungesa e specialistit të fushës krijon vështirësi në vlerësimin e ofertave, sidomos në aspektin teknik. Nga ana e SRE, në mungesë të stafit, duhet të bëheshin përpjekje për kontraktim me specialistë jashtë institucionit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Titullari i AK z. A.G.

Tenderi është hapur me datë 07.02.2023. Vlerësimi i ofertave është përfunduar me datë 23.03.2023.

Njoftimi i fituesit është botuar në Buletinin e APP nr. 30, datë 03.04.2023.

OE të skualifikuar dhe arsyet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

- BOE “E.-A.” Shpk & “S. 2.” Shpk, është skualifikuar për gabime në paraqitjen e ofertës financiare si dhe mos plotësim i kriterit të realizimit të kontratave të punimeve të ngjashme, mungesë autorizimesh etj.

- BOE “A.-2. CO” Shpk & “SH.” Shpk, është skualifikuar për arsye se nuk kanë paraqitur autorizime për zërat e punës që ka marrë përsipër të kryejë sipas akt marrëveshjes duke përcaktuar këtë procedurë përkatëse. Nuk kanë deklaruar drejtues teknikë për disa pozicione, po ashtu mungojnë disa kontrata noteriale për stafin teknik.

- BOE “R. C. & N.” Shpk, është skualifikuar për arsye të paraqitjes së pa plotë të deklaratës për stafin teknik dhe tre punonjës të kualifikuar. Autorizimi i prodhuesit nuk është i saktë. Nuk ka paraqitur dokumentacion që fabrika e prodhimit të inertëve në pronësi apo qira të jetë e licencuar. Një nga OE nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme.

- OE “L. K.” Shpk, është skualifikuar për mangësi në stafin teknik, mangësi në paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve, mungesë e kontraktimit për mjek etj.

- “B.-I.” Shpk, ka mungesë në stafin teknik të një inxhinieri strukturist etj.

Nga verifikimi i ofertave të paraqitura nga OE në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet:

OE “B.-I.” SHPK është skualifikuar me arsyetimin “Bazuar në pikën 2.3.5 në të cilën përcaktohet se: ‘Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë me kontratë noteriale pune me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt të vërtetuar me, diplomë, CV, Libreizat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesae shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

-Inxhinier elektronik; 1 (një)

Me qëllim të një informacioni që KVO mund ta siguronte nga dokumentacion tjetër i kërkuar ne DT, dhe konkretisht nga listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, (dokumentacion i cili nuk përfshihet në përcaktimin e nenit 26 pika 1 në të cilën përcaktohet se “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

2/ “dh” e tij, të VKM Nr. 285 datë sipas të cilës “operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së.

Sqarojmë se ky kriter mund të konsiderohej nga KVO i përmbushur, por në kushtet kur nga KVO janë konstatuar edhe disa mangësi të tjera, Komisioni vendosi të mos ta kualifikojë”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se, OE “B.-I.” SHPK ka deklaruar se ka të punësuar z. B. I. me profesion inxhinier elektronik. Ky punonjës rezulton edhe në licencën e zbatimit të shoqërisë lëshuar me datë 07.07.2022.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave të detyrimeve, rezulton se OE ka paraqitur deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe kontributet sipas shtojcës 8, dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve për taksat vendore, si dhe vërtetim për pagesën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në vërtetimin e paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës, përcaktohet se OE “B.-I.” SHPK, deri me datë 01.03.2023, nuk ka asnjë detyrim tatimor të pa paguar. Në vërtetimin e paraqitur po nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës të datës 21.02.2023, përcaktohet: “...në mbështetje të deklarimeve e pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të dhënave të rubrikave të formularit “Listëpagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, të deklaruara nga subjekti, por që akoma ndodhen në Drejtorinë Rajonale Tatimore, rezultojnë këto të dhëna:

Nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datën 21.02.2023, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 21.02.2023, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 1,437,788 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej: 1,437,788 lekë; Kamatë vonesa për kontributet 0 lekë; Gjoha lidhur me kontributet 0 lekë”.

Nisur nga fakti që nuk ka kamatëvonesa për pagesat në fjalë, OE është brenda afatit për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Nga ballafaqimi i realizuar me datë 27.02.2024, me anëtarin e KVO znj. O.T, pretendohet se mangësitë e tjera të pa përfshira në njoftimin e fituesit, kanë të bëjnë me faktin se nga OE “B.-I.”, nuk është paraqitur si pjesë e stafit teknik ***inxhinier strukturist***. Nga OE “B.-I.”, për plotësimin e këtij kriteri është paraqitur inxhinier i diplomuar sipas profilit ***“Inxhinier për ndërtim civile dhe industriale”***. Nga ana e KVO duhet të kërkoheshin sqarime nëse diplomimi i inxhinierit të paraqitur nga OE përfshin edhe profilin e përcaktuar, për të shqyrtuar mundësinë e konsiderimit si devijim i vogël.

Mos pasqyrimi i të gjitha arsyeve të skualifikimit në njoftimin përkatës, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 31 “Njoftimi i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve”, ku përcaktohet:

“Ky njoftim përmban të gjitha arsyet e skualifikimit të një ofertuesi apo kandidati në një procedurë prokurimi”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “E.” SHPK, rezulton se:

Inxhinieri elektronik z. A. P. ka lidhur kontratë pune me OE “E.” SHPK me datë 18.11.2022. Nuk është i përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe nuk figuron në listë pagesat e tre muajve të fundit (figuron në muajin janar dhe shkurt 2023).

Pavarësisht se ky kriter, në fazën e zhvillimit të tenderit konsiderohet i realizuar me paraqitjen e deklaratimit sipas shtojcës 8, OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, siç ka paraqitur për detyrimet tatimore.

Plani i organizimit të punimeve përbëhet nga vetëm një skicë.

Inxhinieri strukturist i paraqitur nga OE "E." SHPK, nuk figuron në licencën profesionale të shoqërisë, si dhe kontrata e punës me të nuk është e noterizuar.

Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se

Nga ana e KVO nuk është bërë vlerësimi i ofertave në mënyrën e duhur, si dhe nuk është verifikuar me saktësi dokumentacioni i paraqitur nga OE pjesëmarrës. Si OE "B. – I." SHPK ashtu dhe OE fitues "E." SHPK kanë devijime të plotësimit të kriterëve, për të cilat duhet të kërkoheshin sqarimet përkatëse, për të përcaktuar nëse devijimet janë materiale apo jo.

OE "B.-I." SHPK ka paraqitur ofertën financiare me vlerë 123,589,415.2 lekë, ndërsa oferta fituese është me vlerë 135,380,607.9 lekë. Si pasojë e vlerësimit të pa saktë të ofertave të paraqitura në këtë procedurë prokurimi, është nënshkruar kontrata me vlerë më të lartë në shumën **11,791,192 lekë, vlerë e cila konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet.**

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, pika 2, ku përcaktohet:

*"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.
Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material...".*

Ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga z. L. R, znj. O. T. dhe z. K. T.

2. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Rikonstruksion i godinës së Pediatriisë".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi konstatohet që:

Projektzbatimi është realizuar nga Bashkia Elbasan, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 1716/1 prot., datë 20.09.2019. Projektzbatimi i është dorëzuar Qendrës Spitalore "Xhaferr Kongoli" sipas shkresës nr. 5444 prot., datë 11.11.2020. Projektzbatimi dhe preventivi përkatës i vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk është nënshkruar nga asnjë subjekt projektues, apo institucion. Fondet për realizimin e procedurës janë përfshirë në PBA të periudhës 2021-2023, ku likuidimi në masën 20 %, është parashikuar për vitin e parë.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit.

Fondi limit është përlllogaritur me vlerë 301,205,848 lekë. Nga verifikimi i preventivit të zbatimit të punimeve, pjesë e projektzbatimit, rezulton se është parashikuar vlera 272,134,797 lekë pa TVSH dhe 299,869,213 lekë me TVSH. Ndryshimi i vlerës përkon me ndryshimin e disa zërave të punimeve, kryesisht në shtesa në volume, të realizuara nga z. A. K.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: "Rikonstruksion i godinës së Pediatriisë".		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2142, prot., datë 23.11.2020.	3. njësia e prokurimit I. S.	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 2141/1 prot., datë 23.11.2020.
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (punë).	A. K. (spec.fushës) D. K.	A.B. M. A. O.T.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 301,205,848 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 297,461,361.8 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 3,774,486 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 05.01.2021	9. Burimi i Financimit Financim nga buxheti i institutu.	10. Operatorët Ekonomikë 1. BOE "R. C. & Gj. & A. S. & N.", me vlerë të ofertës 248,158,241.2 lekë. 2. BOE "M. & A. K. & Sh.", me vlerë të ofertës 297,461,361.8 lekë. 3. OE "E.-VI" nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

		4. OE “A. T.” nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. 5. OE “M. A.” nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. 6. OE “Sh. 90”, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. b. Skualifikuar – 5 OE		
11. Ankimime - “R. C.” me nr. 137 prot., datë 20.01.2021..	12. Përgjigje e ankesës nga AK -nr. 137/1 prot., datë 26.01.2021	13. Përgjigje ankesës nga KPP -		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës nr. 1462/7 prot., datë 07.09.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 328,945,594.2 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë		
17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi` Vlera 328,025,508.6 lekë	18. Afati i kontratës në ditë. Parashikuar 18 muaj Zbatuar: 18 muaj	19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë		
20. Mbikëqyrësi i punimeve “A. M.” SHPK	Licencë nr. MK 2892/4	Kontrata nr. 4750/4, datë 14.10.2021	Likuiduar	Pa likuiduar lekë
21. Kolaudatori i punimeve “A & E E.” SHPK.	Licencë nr. MK.1756/10	Kontrata Nr. 119 prot., datë 11.02.2021.	Likuiduar	Pa likuiduar
22. Aktkolaudimi nr. 920/1 prot., datë 24.08.2022	23. Akti i marrjes në dorëzim nr. 1438 prot., datë 20.09.2022	24.Fletëhyrja		

Njoftimi i kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 111, datë 01.12.2020. OE “Sh. 90” SHPK dhe OE “A. K.” SHPK, kanë paraqitur ankesë për hartimin e kriterëve, pjesë e dokumenteve të tenderit. Ankesat kanë të bëjë me kërkesën për të disponuar lejen e ndërtimit, bashkëngjitur kontratës së ngjashme, kategoritë e licencave, fuqinë punëtore, stafin teknik, mjetet dhe mekanizmat, kriterin e disponimit të kontratave për materialet dhe shumë kritere të tjera. Bazuar në këto ankesa, është pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesave i përbërë nga anëtarët e KVO. Me shkresa nr. 2199/1 dhe 2000/1 prot., datë 07.12.2020, u është kthyer përgjigje OE ankimes. Nga ana e KVO e përbërë nga znj. A. B., znj. O. T. dhe M. A., janë shqyrtuar ankesat dhe nuk është pranuar asnjë element i tyre.

APP nëpërmjet email të datës 16.12.2020, ka paraqitur rekomandimet për hartimin e dokumenteve të tenderit. Rekomandimet kanë të bëjnë kryesisht me:

- Ndryshimin e klasifikimit për kategorinë NP.1, NP.2, NP.12, NS 18 si dhe heqjen e kërkesave për licencë sipas kategorive NS.9 dhe NS.10.

- Heqjen e kërkesës për inxhinier gjeolog, licencimet e kërkuara nga QKL, numrin e automjeteve dhe mekanizmave, kontratave të nënshkruara për materiale etj. Pas pezullimit të procedurës është ngritur komisioni i shqyrtimit të rekomandimeve i përbërë nga njësia e prokurimit.

Ndryshimet e bëra nuk janë sipas rekomandimeve të APP, me ndonjë përjashtim të vogël.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve është bërë nga z. A. K. Në kriteret teknike, krahas të tjerave janë përfshirë edhe kritere si më poshtë:

- Licencë për zbatim punimesh sipas kategorive NP.1 (B), NP.2 (E), NP.3 (E), NP.12 (D), NS.2 (B), NS.3 (B), NS.4 (D), NS.8 (B), NS.9 (B), NS.10 (B), NS.11 (B), NS.13 (B), NS 14. (B), NS.18 (C), NS.19 (B).

Kategoria NP.12 përfaqëson “Punime të inxhinierisë së mjedisit...”.

NS. 8 “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar.....”

NS.9 “Punime strukturore speciale...”

NS.10 “Shtresa dhe mbistruktura speciale...”

NS.13 “Impiante dhe linja telefonie...”

NS.14 “Impiante të brendshme elektrike...”.

Këto kategori licence nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, konkretisht me punimet e rikonstruksionit të godinës.

Në lidhje me kërkesat për staf teknik është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 2 inxhinierë ndërtimi, 2 arkitektë, 1 inxhinier elektronik, 1 inxhinier mjedisi, 2 inxhinierë elektrikë, 1 inxhinier hidroteknik, 1 inxhinier gjeodet, 2 inxhinierë mekanikë. Krahas tyre, është kërkuar edhe staf mbështetës të përbërë nga 1 inxhinier ndërtimi strukturist, 1 inxhinier telekomunikacioni, ekskavatorist me goma me zinxhirë, 5 manovratorë etj.

Sa më sipër, kërkesa për 1 inxhinierë ndërtimi, 2 arkitektë, 1 inxhinier mjedisi, 1 inxhinier mekanik, është e pa argumentuar dhe nuk përputhet me natyrën dhe volumin e kontratës.

Janë kërkuar mjete dhe mekanizma si 3 kamionë vetëshkarkues me kapacitet 10-12 ton, 2 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbi 20 ton, 3 kamionë vetëshkarkues me kapacitet 3 deri 5 ton, 2 kamionë me vinç (6.5 deri 8.5 ton), 3 kamionçina vetëshkarkuese me kapacitet 1.5 deri 2 ton. Po ashtu janë kërkuar 2 ekskavator me goma, 2 minieskavatorë, 2 fadroma etj.

Nga verifikimi i preventivit dhe grafikut të punimeve rezulton se nevojitet transporti i materialeve në sasinë rreth 2000 m³, volum i cili mund të realizohet nga vetëm një kamion. Kërkesa për 13 kamionë, është absolutisht e pa argumentuar, pasi edhe mjetet autovinç mund të përdoren për transport materialesh. Për realizimin e sasisë së gjermimit të parashikuar është i mjaftueshëm vetëm një mjet gjermimi, ndërsa janë kërkuar 6 të tillë, duke mos argumentuar sasinë e mjeteve të kërkuara.

Vendosja e kriterit licencë III.2.B “Grumbullim, transportim, ruajtje e mbetjeve urbane”, lëshuar nga QKL, është e pa argumentuar. Materialet që transportohet hidhen në venddepozitimet e përcaktuara nga Bashkia Elbasan.

OE duhet të paraqesë kontratë furnizimi kur nuk është vetë prodhues, për tubo HDPE, PVC, brinjëzuar apo PE, si dhe për pllaka. Ky kriter është rekomanduar të hiqet nga APP, por nuk është hequr. Si pasojë e vendosjes së kriterëve të pa argumentuara krijohet vështirësi për marrjen pjesë në tender të subjekteve që kanë kapacitet për zbatimin e kontratës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 26, pika 5, ku përcaktohet:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. I. S., z. A. K. (specialist i fushës), znj. D. K. dhe KVO e përbërë nga znj. A. B., z. M. A. dhe znj. O. T., në cilësinë e komisionit të shqyrtimit të ankesave të OE dhe rekomandimeve të APP.

Mbi vlerësimin e ofertave.

Tenderi është zhvilluar me datë 05.01.2021. Në tender kanë marrë pjesë 6 OE, nga të cilët 3 OE nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë. Nga 6 OE pjesëmarrës në tender janë skualifikuar 5 OE, tre nga të cilët nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike dhe kanë mungesa të theksuara në dokumentacion. BOE “R. C. & Gj. & A. S. & N.” SHPK, ka paraqitur ankesë në lidhje me vlerësimin e ofertave dhe skualifikimin nga gara. Pas pezullimit të procedurës së prokurimit, për shqyrtimin e ankesës është ngritur komisioni përkatës i përbërë nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit. BOE është njoftuar me shkresë nr. 137/1 prot., datë 26.01.2021, për mos pranimin e ankesës. Njoftimi i fituesit është botuar në Buletinin e APP nr. 21, datë 15.02.2021. Kontrata e punimeve është nënshkruar me nr. 2142 prot., datë 12.02.2021, me vlerë 297,461,361.8 lekë pa TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 18 muaj.

Për ndjekjen e zbatimit të kontratës me Urdhër nr. 2142/9 prot., datë __, janë ngarkuar punonjësit znj. A. B., z. A. Sh. dhe z. A. K.

3. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Shërbim i hotelerisë dhe lavanterisë”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi konstatohet që:

Për identifikimin e nevojave është ngritur grupi i punës me Urdhër nr. 1510, datë 30.07.2019. Sasia e nevojshme për larje është përcaktuar 81357 kg në vit. Çmimi për njësi është vendosur 358.5 lekë, bazuar në tre kontrata të ngjashme, duke zgjedhur çmimin më të ulët.

Formulari i njoftimit të kontratës është plotësuar me nr. 2296/2 prot., datë 30.12.2019 dhe është botuar në buletin e APP nr. 53, datë 31.12.2019.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Shërbim i hotelerisë dhe lavanterisë”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2296, prot., datë 30.12.2019.	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit (Njësia e Prokurimit)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 2296/1prot., datë 30.12.2019.
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit Tender i hapur (marrëveshje kuadër me një OE).	B. D. (juriste) Z.P. (specialiste) A. B (ekonomiste)	A.B. A. Q. O. T.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 116,665,938 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 112,272,660 lekë.	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 4,393,278 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 29.01.2020	9. Burimi i Financimit Financim nga buxheti i institucionit.	10. Operatorët Ekonomikë 1. OE “D.” Shpk, me vlerë të ofertës 112,272,660 lekë. 2. OE “S.C.” Shpk, me vlerë të ofertës 107,391,240 lekë. 3. OE “U. S.” Shpk, me vlerë të ofertës 97,628,400 lekë. 4. OE “A.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë financiare. a. Pjesëmarrës në tender 4 OE b. Skualifikuar 3 OE c. Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AKNuk ka ankimim APP.....Nuk ka ankimim KPP.....Nuk ka ankimim		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
12. lidhje e kontratës nr. 2296/10 prot., datë 05.03.2020	13. Vlera e kontratës (me tvsh) 134,727,192 lekë.	14. Afati i kontratës 4 vite.

Në lidhje me dokumentet e tenderit, nga ana e APP nëpërmjet email të datës 09.01.2020, i janë dërguar AK disa rekomandime të cilat kanë të bëjnë kryesisht me specifikimin e kategorisë së licencimit të kërkuar, vendosjen e kriterit të pranueshmërisë për subjekte që kanë makineritë me qira, numrin e makinave larëse dhe stafin teknik. Pas pezullimit të procedurës së prokurimit, nga ana e njësisë së prokurimit janë bërë përmirësimet përkatëse, por nuk është reflektuar në lidhje me stafin teknik, konkretisht me kërkesën e kriterëve të veçanta pika 1.3.5, ku është kërkuar: “*OE duhet të ketë të punësuar një teknik ose inxhinier elektronik/elektromekanik/ mekanik të shoqëruar me diplomën ose dëshminë përkatëse*”. Kjo kërkesë është justifikuar me faktin se për kryerjen e shërbimit do të përdoren makineri e pajisje të ndryshme të cilat kërkojnë mirëmbajtje apo rregullime të vazhdueshme, me qëllim shmangien e defekteve që mund të shkaktojnë mos kryerjen e shërbimit sipas termave të kontratës. Ky justifikim nuk qëndron për faktin se në momentin e nënshkrimit të kontratës, risku kalon në palën kontraktore. Proceset e punës së lavanterisë nuk lidhen me profesionin e kërkuar, madje për nevojën e shërbimit për makineritë larëse OE mund të realizojë nëpërmjet kontrata shërbimesh, blerje të makinerive rezerve, apo mund të disponojë një numër shumë më të lartë se numri i makinerive të kërkuara. Vendosja e këtij kriteri nuk është në përputhje me natyrën e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 28, pika 25, ku përcaktohet:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga znj. B. D., znj. Z. P. dhe znj. A. B..

Ndërkohë që procedura e prokurimit ishte në proces, (formulari i njoftimit të kontratës është plotësuar me nr. 2296/2 prot., datë 30.12.2019 dhe është botuar në buletin e APP nr. 53, datë 31.12.2019), me datë 19.01.2020, është shpallur njoftimi për realizimin e një procedure negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për realizimin e shërbimit të hotelierisë dhe lavanterisë për një periudhë 3 mujore. Kontrata përkatëse është nënshkruar me OE “D.” SHPK me datë 20.01.2020, me çmim njësi 358 lekë/kg, për sasinë 20340 kg.

Për realizimin e procedurës së mësipërme, është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i shfuqizuar, neni 33, pika 2.c, ku përcaktohet:

“Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave publike si më poshtë:

Kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit.

Sa më sipër rezulton se nuk ka një planifikim të saktë në kohë për realizimin e prokurimeve sipas nevojave.

Mbi vlerësimin e ofertave.

Me datë 29.01.2020, është bërë hapja e ofertave në sistemin elektronik. Kanë marrë pjesë 4 OE, nga të cilët tre OE nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë.

OE “A.” nuk ka paraqitur një sërë dokumentesh, si dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

OE “U.” Shpk është skualifikuar për arsye të mos plotësimit të numrit të punonjësve të kërkuar si dhe të mos plotësimit të vlerës së punimeve të ngjashme.

OE “S.C.” Shpk, është skualifikuar për arsyet si më poshtë:

- Dokumentacioni i paraqitur, me anën e të cilit provohet se disponon ambient ku ushtrohet veprimtaria e shërbimit të lavanderisë, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës të marrjes me qira është i parregullt pasi: kontrata e qirasë dhe e nën qirasë është e shoqëruar me vërtetim pronësie dhe kartelë të pasurisë së paluajtshme me nr.40/41, me sipërfaqe 1556 m2, volumi 18, fq.116, e llojit të pasurisë tokë arë, me zonë kadastrale 2670, ndodhur në Mëzes. Pra lloji i pasurisë në kartelë është tokë arë, çka nënkupton që subjekti nuk disponon ambient të përshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e shërbimit të lavanterisë, duke mos plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik e profesional, 1.3, pika 3 të kërkuara në DST.

- Nuk ka paraqitur vetë deklaratën mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit sipas Shtojcës 7.

Sa i përket pronësisë së objektit, nënkuptimi që subjekti nuk disponon ambient të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të lavanterisë, pasi objekti është vendosur në tokë arë është i pa argumentuar për arsyet si më poshtë:

- Për ndërtimin e objektit është dhënë një leje ndërtimi e cila nuk është ezauruar, por që subjekti ka aplikuar për leje legalizimi, vërtetuar nga Agjencia e Legalizimit, Organizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale Tiranë Rurale.

- Për ushtrimin e aktivitetit në të njëjtën adresë është dhënë leje mjedisore nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

- Nga ana e Drejtorisë M.N.Z, pranë Bashkisë Tiranë, në adresën e kompanisë është dhënë Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.

- Spitali Rajonal Durrës i ka lëshuar vërtetim OE "S. C." SHPK (së bashku me dy OE të tjerë) se ka në zbatim e sipër kontratën "Furnizim i shërbimit të lavanderisë", për një afat 30 muaj, me vlerë 171,428,400 lekë, e cila deri në dhjetor 2019, është realizuar në masën 80 %.

Sa më sipër, argumenti se subjekti nuk disponon ambientet të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë nuk qëndron. Edhe dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues, nuk e përcakton destinacionin e objektit.

Në lidhje me paraqitjen e shtojcës 7 "Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme", në dokumentet standarde të tenderit përcaktohen fushat që duhet të plotësohen si më poshtë:

-Operatori ekonomik është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

-Operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë, nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

-Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

-Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

-Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër, nga ana e OE "S. C." është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentin e regjistrimit në QKB, me objekt fushën e veprimtarisë objekt prokurimi.

- Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, se subjekti nuk rezulton me procedim penal.

- Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë se subjekti nuk rezulton të ketë proces penal.

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë për statusin aktiv.

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë për pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8, përcaktohet: "Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik".

Nga ana e KVO, nuk janë kryer verifikime si dhe nuk janë kërkuar sqarime referuar Ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 53, pika 1, pavarësisht se OE i skualifikuar ka kontrata në proces me autoritete të tjerë kontraktorë, ka paraqitur disa vërtetime për plotësimin e kriterëve të përgjithshme. Nuk është marrë në konsideratë kriteri i çmimit më të ulët sipas seksionit 4.2 të dokumenteve të tenderit. OE "S. C.", ka paraqitur ofertë më të ulët se oferta financiare e OE fitues me vlerë 4,881,420 lekë (112,272,660 lekë – 107,391,240 lekë). Sa më sipër rezulton se nuk është marrë në konsideratë devijimi jo material, si dhe nuk ka patur një vlerësim korrekt të dokumentacionit të paraqitur në tender.

Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 53, pika 4, ku përcaktohet:

"Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesa të tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj".

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga znj. A. B., znj. A. Q. dhe znj. O. T.

Raporti Përmbledhës është miratuar nga Titullari i AK datë 25.02.2020. Njoftimi i fituesit është publikuar në Buletinin e APP nr. 8, datë 02.03.2020. Nga ana e OE pjesëmarrëse nuk janë paraqitur ankesa.

OE “D.” SHPK ka paraqitur një kontratë qiraje sipas të cilës administratorja e shoqërisë si dhe ortake e vetme, znj. K. L. ka marrë me qira një objekt ku ushtrohet edhe aktiviteti i lavanderisë, objekt i cili është në pronësi të saj.

Po ashtu edhe OE “S. C.”, ka paraqitur një kontratë nënqiraje, ku përfaqësuesi me prokurë i Shoqërisë “V.” SHPK z. O. Z. ka dhënë me qira (një objekt të marrë me qira nga një subjekt tjetër Shoqërisë OE “S. C.” përfaqësuar me prokurë po nga z. O. Z.

Kontrata e shërbimit është nënshkruar me nr. 2296/11 prot., datë 05.03.2020. Për ndjekjen e kontratës me Urdhër të Titullarit të AK nr. 2296/12 prot., datë 05.03.2020, është ngarkuar grupi i punës i përbërë nga znj. Z. P., znj. E. Z. dhe znj. B. D.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- *Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. B. D., znj. Z.P. dhe znj. A.B.*
- *KVO e përbërë nga znj. A. B., znj. A. Q. dhe znj. O. T.*

Konkluzion:

Nga auditimi i dokumentacionit të kësaj procedure konstatohet se nuk janë vendosur kritere në mënyrë të argumentuar si sa i takon stafit teknik, ashtu edhe makineri pajisje.

Nuk është bërë parashikimi i duhur për fillimin e procedurës së prokurimit, pasi pas një kohe të shkurtër nga fillimi i procedurës së prokurimit, është realizuar një procedure tjetër, për përballimin e nevojave deri në nënshkrimin e kontratës.

4. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Punime meremetime-lyerje në Spitalin Kirurgji-Maternitet”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi konstatohet që:

Kërkesa për përcaktimin e nevojave për ndërhyrje është bërë me Urdhër të Titullarit të AK z. A. G., me nr. 119, datë 15.06.2022, proces për të cilin është ngarkuar znj. P. M., në cilësinë e specialistit të fushës. Në preventivin e përgatitur nga znj. P. M. janë përcaktuar ndërhyrje që kanë të bëjnë kryesisht me përgatitje sipërfaqe dhe hidroizolim solete me sipërfaqe 370 m², riparim tualetesh, riparime dere emergjence si dhe lyerje me bojë e sipërfaqeve të brendshme. Preventivi është hartuar me vlerë 4,175,148 lekë pa TVSH, vlerë e cila është prokuruar si fond limit. Për përcaktimin e çmimeve të zërave të punimeve janë aplikuar manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre të vitit 2015, për zëra që nuk janë në manual, janë hartuar analizat teknike përkatëse.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Punime meremetime-lyerje në Spitalin Kirurgji-Maternitet”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 120, datë 20.06.2022.	3. njësia e prokurimit I. S. (juriste) Xh. K. (ekonomiste) P. M. (spec.i fushës)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. prot., datë -. A. B. O. T. K. T.
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit E hapur, e thjeshtëzuar.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,175,148 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 3,944,659 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 230,489 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 11.07.2022	9. Burimi i Financimit Financim buxheti i institucionit	10. Operatorët Ekonomikë 1. OE “A.C.”, me vlerë të ofertës 3,553,850 lekë. 2. OE “B. N”, me vlerë të ofertës 3,944,659 lekë.

		b. Skualifikuar – 1 OE
11. Ankimime - AK ska - APP ska - KPP ska		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
12. lidhje e kontratës nr. 97416 prot., datë 29.07.2022	13. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,733,590.8 lekë	14. Afati i kontratës në ditë 60

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, ndërsa kriteret e veçanta nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit znj. P. M..

Në kriteret e veçanta të kualifikimit, krahas të tjerave është kërkuar:

- Disponim licence sipas kategorisë NS-3A “Impiante ngjitës dhe transportues (ashensor, shkallë lëvizëse, transportues”, si dhe NS-14 A “Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni”, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratës apo zërave të punimeve të cilat ishin parashikuar për t’u realizuar.
- 3 kamionçina me kapacitet deri 3.5 ton, 3 kamionë me kapacitet 3.5 deri në 5 ton. Bazuar në preventivin e punimeve, është kërkuar një numër i lartë i kamionëve, krahasuar me volumin i cili ishte parashikuar për t’u realizuar.
- Nivelues betoni (helikopter). Në preventivin e punimeve nuk përfshihen shtresa betoni të cilat duhet të nivelohen me mjetin e kërkuar.
- 2 platforma automatike ngritëse me kosh. Kjo kërkesë është e pa argumentuar për faktin se punimet e përcaktuara në preventiv (60 m² veshje kornize me llamarinë zinkato), realizohen nëpërmjet vendosjes së skelerisë së ndërtimit, e kërkuar në sasinë 200 m². Rezulton se kërkesat e mësipërme janë të pa argumentuara, kërkesa të cilat vështirësojnë pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit për subjekte të cilat plotësojnë kapacitetet për zbatimin e kontratës.

Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 41, pika 2, si dhe neni 55, pika 4, ku përcaktohet:

Neni 41, pika 2. “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Neni 55, pika 4. “Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj. P. M., në cilësisë e specialistit të fushës (specialist i jashtëm).

Njoftimi i kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 90, datë 04.07.2022. Tenderi është hapur me datë 11.07.2022, ndërsa procesverbali i vlerësimit të ofertave është hartuar me datë 19.07.2022.

Në tender kanë marrë pjesë dy OE, nga të cilat është skualifikuar një. Skualifikimi i OE me ofertë më të ulët financiare është bërë për arsye se:

- Nuk ka paraqitur në shtojcën 8, nivelues betoni dhe platformë automatike ngritëse me kosh.
- Tekniku i ndërtimit nuk figuron në listëpagesa me kodin përkatës.
- Shtojca nr. 2 është paraqitur e pa nënshkruar.
- Në sigurimin e ofertës së paraqitur nuk është specifikuar bashkimi i operatorëve ekonomikë.
- Nuk përmbush kapacitetin teknik sa i takon kërkesës për realizimin e punimeve të ngjashme.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se OE “A. C.” ka paraqitur dokumentacion të rregullt për punime të ngjashme, konkretisht realizimin e kontratës “Rikonstruksion i magazinës në rrugën ‘Gani Banaj’, në objekt me shërbime artizanale, Bashkia Patos”, të vërtetuar me situacion përfundimtar të nënshkruar nga Bashkia Patos, si dhe formular vlerësimi të nënshkruar nga kjo bashki (81 % e punimeve i përkasin OE “A. C.”), si dhe kontrata të tjera. Anëtar i tjetër i BOE “6. P.”, ka paraqitur dokumentacion të rregullt për zbatimin e kontratës me Universitetin Politeknik të Tiranës.

Konsiderohet mangësi në paraqitjen e ofertës nga BOE, fakti se në listëpagesa nuk është paraqitur tekniku i ndërtimit, sipas kodeve të punësimit, të përcaktuar në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, i ndryshuar.

Njoftimi i fituesit është publikuar në Buletinin e APP nr. 102, datë 25.07.2022. Kontrata e punimeve civile është nënshkruar me nr. 97416 prot., datë 29.07.2022, me OE “B. N”, me vlerë 3,944,659 lekë pa TVSH, ose 4,733,590.8 lekë me TVSH.

Mbi zbatimin e kontratës.

Kontrata e punimeve civile është nënshkruar me nr. 97416 prot., datë 29.07.2022, me OE “B. N”, me vlerë 4,733,590.8 lekë me TVSH. Për mbikëqyrjen e punimeve është caktuar z. A. M. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar 2 muaj. Bazuar në dokumentacionin e dosjes së procedurës së prokurimit (njoftimi i përfundimit), punimet kanë përfunduar me datë 29.09.2022, brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Situacioni përfundimtar është hartuar me vlerë 4,733,590.8 lekë me TVSH. Punimet kanë të bëjnë me përgatitje sipërfaqe dhe hidroizolim në sasinë 370 m², heqje dhe vendosje derë emergjence, lysterje me bojë hidroplastike tavane dhe mure të brendshme si dhe riparimi i tualeteve.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

- znj. P. M, në cilësinë e specialistit të fushës (eksperti i jashtëm).

5. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Supervizion për rikonstrukcionin e pediatriisë”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi konstatohet që:

Për përllogaritjen e fondit limit me Urdhër të Titullarit të AK nr. -, datë 07.12.2020, është ngarkuar z. A. K. Fondi limit është miratuar me vlerë 3,183,559 lekë. Fondi limit është përllogaritur bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Supervizion për rikonstrukcionin e godinës së Pediatriisë”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 119, prot., datë 08.01.2021.	3. njësia e prokurimit I.S. Juriste	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 119/1 prot., datë 18.01.2021.
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim	I.Sh. Ekonomiste A. K., Inxhiner (specialist i fushës, ekspert i jashtëm)	A. B. D.K. O. T.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 3,138,559 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 2,771,167.3 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 367,391.7 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 18.01.2021	9. Burimi i Financimit Financim nga buxheti i institucionit.	10. Operatorët Ekonomikë 1. OE “A. M.”, me ofertë financiare me vlerë 2,771,167.3 lekë. 2. BOE “N.-G.” shpk & “D.” SHPK, me ofertë financiare me vlerë 2,805,833 lekë. 3. OE “Gj. & C.” SHPK, me ofertë financiare me vlerë 2,798,349 lekë. b. Skualifikuar – 0 OE
11. Ankimime - AK ska - APP ska - KPP ska		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
12. lidhje e kontratës nr. prot., datë 11.02.2021	13. Vlera e kontratës (me tvsh) 3,325,400.7 lekë	14. afati 540 ditë

Njoftimi i kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 11, datë 25.01.2021.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik”, rezulton se ndër të tjera është kërkuar:

- Licenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë:

NP – 12;	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
NS – 1;	Punime për prishjen e ndërtimeve.
NS – 2;	Impiante hidro-sanitare, kuzhina.
NS – 8 a.b.c;	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
NS – 9;	Punime strukturore speciale.
NS – 10;	Shtresa dhe mbistruktura speciale.
NS-20;	Shpime GjeologoInxhinierike.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të punimeve, konstatohet se sipas kategorive të mësipërme nuk ka punime.

- Shoqëria duhet të ketë Drejtues Teknik në përbërje të saj si me poshtë:

Inxhinier ndërtimi	drejtues teknik 1 (një); listëpagesa 3 (tre)	
Inxhinier Hidroteknik	“ 1 (një);	“ 1 (një)
Inxhinier Mjedisi/Kimist teknolog	“ 1 (një)	
Inxhinier Gjeolog	“ 1 (një)	
Arkitekt	“ 1 (një)	

Po ashtu është kërkuar një inxhinier IT dhe një ekspert vlerësimi të ndikimit në mjedis.

Për kontratën në fjalë nuk janë parashikuar lote, po ashtu punimet janë të përqendruara vetëm në një godinë. Punimet kanë të bëjnë me ristrukturime dhe sisteme si ai elektrik, kondicionimit etj. Vlera e punimeve civile është rreth 95 milionë lekë. Kërkesa për staf 4 inxhinierë ndërtimi, 2 inxhinierë hidroteknikë është shumë mbi nevojat e kontratës. Kërkesa për inxhinier gjeolog dhe arkitekt, janë të pa argumentuara, pasi kontrata është zbatim punime rikonstruksioni dhe nuk përfshin projektim fasadash, apo punime gjeologjike.

Është kërkuar që shoqëria duhet të ketë të punësuar 20 apo më shumë punonjës, një numër i lartë për nevojat e mbikëqyrjes së punimeve të kësaj kontrate.

Vendosja e kriterëve në mënyrë të pa argumentuar bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 26, pika 5, ku përcaktohet:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi anëtari i njësisë së prokurimit z. A. K., në cilësinë e specialistit të fushës (ekspert i jashtëm).

Mbi vlerësimi i ofertave.

Në tender kanë marrë pjesë 3 OE, të cilët janë kualifikuar. Është shpallur fitues oferta me vlerë më të ulët. Për këtë procedurë nuk ka patur ankesa. Nënshkrimi i kontratës është bërë me vlerë 2,771,167.3 lekë pa TVSH, ose 3,325,400 lekë me TVSH.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

Anëtari i njësisë së prokurimit z. A. K., në cilësinë e specialistit të fushës (ekspert i jashtëm).

6. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse pelet”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u

konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse pelet NR-REF-56475-01-20-2023			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar/Mallra Urdhëri Prokurimit nr.156 prot , datë 17.01.2023	1.1 Komisioni identifikimit të nevojave dhe përlogaritjes të vlerës limit të kontratës Urdhëri nr. 13/1, datë 04.01.2023 1. V. T 2. I. Sh. 3. Z. P. Komisioni i testimit të tregut urdhëri nr.13 datë 04.01.2023 1. Sh. Z. 2. S. D. 3. A. C.	2 Njësia e Prokurimit 1. I. S. 2. Xh. K. 3. E. Z.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr.156/1 , dt. 17.01.2023. 1. L. R. 2. O. T. 3. K. T.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 8,252,268 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSh) 7,317,139 lekë ose 75,9 lekë çmim/njësi, 75,9 lekë/kg Operatori Fitues: OE “F.&B.” SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 935,129 lekë	
7/1 Data e hapjes së tenderit Datë 02.02.2023	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit (FSDKSH)	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 1 OE	
7/2 Data e lidhjes së kontratës; Kohëzgjatja e kontratës: Datë 17.02.2023 MK 12 muaj			

Nga shqyrtimi i praktikës të sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumenteve të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave etj).

Në lidhje me “*ndarjen e detyrave*” për punonjësit e përfshirë në procesin e prokurimit u konstatuan mangësi si më poshtë:

Nga auditimi rezulton se nuk është bërë një ndarje e qartë e detyrave ndërmjet zyrtarëve/punonjësve të përfshirë në procesin e prokurimit.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt, “Blerje lëndë djegëse briket pellet”, rezultoi se në përcaktimin e komisioneve sipas urdhrave përkatës, nuk përcaktohet saktë komisioni i përlogaritjes së nevojave, pasi ka ndryshim te një anëtari pa urdhër të veçantë të titullarit. Gjithashtu, në përcaktimin e komisioneve duhet të sigurohet një ndarje e qartë dhe përcaktimi i drejtë, referuar këtu dhe ngritjes me urdhër të veçantë të komisionit të emërtuar komisioni i identifikimit të nevojave, komisioni i cili kryen dhe funksionin e inicimit të procedurës, ndërkohë që kjo detyrë apo indicia e zhvillimit të procedurës duhet gjithmonë të jetë e referuar nga struktura përfituese e mallit, në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 2, pika 1, 2, a), neni 73, neni 74 si dhe Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Mos zbatim i kërkesave ligjore në lidhje me MFK, mos përcaktimi i gjurmës së auditimit e cila rrit riskun e e krijimit të hallkës së dobësisë për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Përlogaritja e fondit limit për procedurën “Blerje lëndë djegëse briket pellet” është kryer jo në përmbajtje me parimet e Ligjin për MFK, pasi në identifikimin e sasisë së lëndës djegëse,

në përcaktimin e kohëzgjatjes së orarit të ndezjes së kaldajave duke qenë se nuk ka një bazë ligjore të cilës mund ti referohet, AK mund të ishte mbështetur në praktikat më të efektshme apo më të dobishme të realizuara nga Institucione të ngjashme por kohëzgjatja e ndezjes si dhe sasia e përlllogaritur nga AK është më e lartë se ajo e realizuar nga këto Institucione të ngjashme. Me urdhrin me nr.13/1 prot, datë 04.01.2023 është ngritur komisioni i identifikimit të nevojave dhe përlllogaritjes të vlerës limit të kontratës, me përbërje, (znj. V. T., znj. I. Sh., znj. Z. P.). Ky komision pasi identifikoi nevojat, kreu përlllogaritjen e fondit limit për periudhën, (01.01.2023-15.03.2023) dhe (15.11.2023-31.12.2023), e përkthyer 120 ditë kalendarike, që përkon me sezonin e dimrit ose sezoni i ndezjes së kaldajave. Vlera e fondit limit të përlllogaritur është 8,252,268 leke pa TVSH. Në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, në përcaktimin e sasisë rezultoi se: Komisioni, është mbështetur mbi bazën e konsumit apo harxhimit të lëndës djegëse (briket pelet), të mbajtur ndezur për 12 orë pune pranë godinave në të cilat ndodhen kaldajat. Sipas procesverbalit të hartuar rezultoi se konsumi i lëndës djegëse është si më poshtë:

Shërbimi	Konsumi/1 orë	Konsumi/12 orë
Patologji	30kg	360 kg
Kirurgji materinitet	35kg	420 kg
Urgjenca	20 kg	240kg
Neurologjia	20kg	240kg
Kardiologjia	20 kg	240kg
Pediatra	20 kg	240kg
Totali		1740 kg

Gjykimi i audituesve: Në përcaktimin e kohëzgjatjes së orarit të ndezjes prej 12 orësh, AK nuk ka një bazë ligjore apo një VKM në fuqi, (referimin ligjor, normativat e përcaktuara nga institucione përgjegjëse, udhëzim të MSHMS etj), e cila argumenton apo justifikon orarin apo kohëzgjatjen e përcaktuar, duke bërë që të mos jepet argumentimi se përse është e nevojshme që kaldajat do të mbahen ndezur 12 orë në ditë. Grupi i auditimit siguroi të dhëna në lidhje me praktikat e ndjekura nga Institucione të ngjashme me të njëjtën natyrë shërbimi, me të njëjtat kushte klimaterike nga Spitali Rajonal Berat, Spitali Rajonal Gjirokastër, në të cilat kontratat e realizuara janë të suksesshme dhe nuk janë evidentuar problematika sa i përket sigurimit me ngrohje, nga ku rezultoi se kohëzgjatja e përcaktuar është mesatarisht 6-9 orë ndezje. Pra në rast se AK do ti referohej praktikave të ndjekura, nga këto Institucione, marr si referim 9 orë në ditë, përlllogaritja e fondit limit do ishte si më poshtë:

Shërbimi	Konsumi/1 orë	Konsumi/12 orë	Konsumi/9 orë	Diferenca
Patologji	30kg	360 kg	270kg	
Kirurgji materinitet	35kg	420 kg	315kg	
Urgjena	20 kg	240kg	180 kg	
Neurologjia	20kg	240kg	180 kg	
Kardiologjia	20 kg	240kg	180 kg	
Pediatra	20 kg	240kg	180 kg	
Totali		1740 kg	1305 kg	435 kg

Pra $435 \text{ kg} * 120 \text{ ditë} = 52.200 \text{ kg} * 75,9 \text{ cmimi/kg} = 3,961,980 \text{ leke pa TVSH}$, vlerë e cila përbën një shpenzim të njësisë, në mungesë të një menaxhimini me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 5, neni 8, neni 12, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

AK, zyrtarët e përfshirë në procesin e prokurimit, referuar përlllogaritjes së fondit limit duhet t'i referohen praktikave të mira të cilat janë të dobishme si dhe i sjellin Institucionit përdorim me ekonomikitet të fondeve në zbatim të parimeve të Ligjit për MFK. Pra referuar procedurës, “Blerje briket pellet” AK, mund të marr në konsideratë praktikat e ndjekura nga Spitalet e tjera Rajonale, metodologjinë e ndjekur nga ana e tyre, në të cilat kontratat e lidhura me kontraktor privat kanë rezultuar të suksesshme dhe vlera e realizuar është më e ulët se ajo e Spitalit Rajonal Elbasan.

-Në lidhje me çmimin, komisioni është mbështetur në testimin e tregut me mesataren e 3 ofertave të administruara, nga ku vlera mesatare e tyre është 85,6 lekë/kg.

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik” si më poshtë:

Mos argumentimi i kritereve të vendosura nga AK, e cila mjaftohet vetëm me listimin e tyre në terma të përgjithshëm në të cilën evidentohet vetëm baza ligjore të cilën i referohet AK por pa u kryer asnjë argumentim teknik referuar kapaciteteve teknike, specifikimeve teknike, etj. Në lidhje me kriteret e veçanta për kualifikim, pjesë e dokumenteve të tenderit (DST) të hartuara dhe miratuara nga AK, të cilat janë kërkuar me qëllim për të vërtetuar përmbushjen e kapaciteteve teknike nga OE, pika 2.3 (Kapaciteti teknik, pika 2.3.4) ku kërkohet:

Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira 2(dy) kaldaja që punojnë me lëndë djegëse pelet.

Te dhenat teknike per kaldajat e ujit janë si me poshtë :

-Fuqia 500 kW

-Tensioni elektrik 380V

-Fuqia termike nominale 500 kW

-Fuqia Termike e kthyer 450 kW

-Rendimenti 87%

-Kapaciteti i silozit ditor 1-2 m3

- Për pajisjet teknike ne pronësi operatori duhet te paraqesë , kontratë shitblerje noteriale ose akt zhdoganimi.

Kërkesa apo kriteri i përcaktuar është i paargumentuar nga ana e NJP, pasi nuk ka dhënë arsytimin mbi nevojën se përse OE duhet të disponojnë apo te kenë në pronësi 2 kaldaja me parametrat e sipërcituar, për më tepër që nuk ka udhëzim për këto OE se si duhet te veprojnë në lidhje me kaldajat si psh (kaldajat duhet të jenë në pronësi pasi malli duhet të përputhet me to, kaldajat duhet ti dorëzojë pranë AK pasi AK nuk ka mjaftueshëm buxhet të sigurojë blerjen e tyre, OE duhet të disponojë kaldaja pasi në rast konstatim defekti duhet ti riparojë apo zëvendësojë ato etj). Mos përcaktimi i drejtë i tipologjisë së kontratës, pra mos argumentimi i kritereve teknike, mund të ndikojë në përcaktimin e çmimit. Në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike OE kanë ofertuar mbi bazën çmim/kg për mallin objekt prokurimi, por nuk është e përcaktuar se çmimi përfshin apo nuk përfshin dhe dorëzimin e kaldajave. AK mund të veprojë duke e ndarë kontratën me lote nëse përveç nevojës për mallin objekt prokurimit ka nevojë që ti vihen në dispozicion dhe kaldajat. Pra nga ana e NJP duhet të mirë argumentohet çdo kërkesë apo kriteri i mundshëm në mënyrë të tillë që ato kërkesa apo kriteret të kuptohen qartë , të jenë të lidhura ngushtë me tipologjinë e kontratës si dhe duhet të sigurojë një trajtim të barabartë ndërmjet ofertuesve. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, neni 78, pika 2. Ligji nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, Ligji nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 5, neni 8.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE, për të cilin, referuar procesverbaleve përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	“S. k.” shpk	8,194,425	Kualifikuar
2	“F.&B.” shpk	7,317,139	Kualifikuar/Fituesi

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar 2(dy) OE, si pjesëmarrës të vetëm në garë duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit si oferta më e ulët OE **“F.&B.” shpk**.

Si konkluzion, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit **nuk ka vlerësuar drejtë** OE pjesëmarrës në garë.

Nga auditimi i procedurës, referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, pas hapjes së ofertave në ditën dhe orën e përcaktuar, rezulton se KVO-ja, pasi shqyrtoi ofertat e paraqitura ka kualifikuar 2 OE, si pjesëmarrës të vetëm në garë duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit si oferta më e ulët OE **“F.&B.” shpk**. Nga auditimi i dokumentacionit të OE të shpallur fitues **“F.&B.” shpk**, rezultoi se nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST pika (2.2 kapaciteti teknik, pika 4). Katalogu i paraqitur në SPE dhe në dokumentacionin fizik rezulton se: (nuk është i vulosur nga ofertuesi, nuk ka të markuar modelet për artikujt që ofron sipas specifikimeve teknike, nuk është deklaruar numri i fletëve si dhe nuk identifikohet firma prodhuese). Veprime në kundërshtim me ligji nr. 162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”**, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, neni 82, pika 2.

7. Mbi auditimin e ushtruar për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë”, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, **“Për prokurimin publik”**, Ligjit për MFK, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë” NR-REF-35758-07-07-2022			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur/Shërbim Midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar Urdhër Prokurimi nr.1071 prot , datë 04.07.2022	1.1 Komisioni i përlogaritjes fondit, Urdhëri nr. 783, datë 25.05.2022 4. M. J. 5. Q. H. 6. Sh. Z. Komisioni i testimit të tregut urdhëri nr.763, datë 23.05.2022 1.A. C. 2.K. T. 3.S. D.	2 Njësia e Prokurimit 4. I. S. 5. I. Sh. 6. Sh. Z.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr.1071/1prot , dt. 04.07.2022 1. A. B. 2. O. T. 3. K. T.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 55,150,800 lekë	5. Oferta fituese (pa TVSh) 54,440,758 lekë ose 324,052 cmim/njësi ose pagë/vendë roje/ 3 turne(4.98 roje) Operatori Fitues: OE “K. 1” SHPK		6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 710,052 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Datë 08.08.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit (FSDKSH)		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës/Data e lidhjes MK: 24 muaj ;datë 18.08.2022			

Nga shqyrtimi i të gjithë praktikës të sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumenteve të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“përlllogaritjen e fondit limit”**: Fillimisht me urdhërin me nr. 783 prot, datë 25.05.2022, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, me përbërje, M. J. (Kryetar), Q. H. (anëtar), Sh. Z. (anëtar). Ky komision sipas procesverbalit të mbajtur datë 27.05.2022 e ka kryer përlllogaritjen e fondit limit, mbështetur në analizën e kostos, mbi bazën e disa komponentëve të përfshirë si (*Paga bazë mujore, Sigurimet Shoqërore, Shtesë page për vështirësi, turni II, turni III, shtesë mbi pagën 24 orë turni I, turni II, turni III, testim tregu me 3 oferta për sistemet e alarmit dhe monitorimin me kamera*), e trajtuar më hollësisht si më poshtë:

-Paga bazë minimale mujore sipas VKM-së, nr. 158 datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, ku përcaktohet se: Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik ose fizik, vendas ose i huaj të jetë 32,000 lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë punë në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës, si dhe Ligjit nr. 75/2014, “Për SHPSF, neni 18, pika g, ku parashikohet se, paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale mujore e përcaktuar me VKM;

• **Sigurimet Shoqërore, referuar VKM-së nr. 77 datë 28.01.2015, “Për kontributin e detyrueshëm dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, pjesa e punëdhënësit, është 16.7%;**

-Paga bazë minimale mujore përlllogaritet: $32,000 + 50\% = 48,000$ leke/muaj.

-Paga në orë përlllogaritet: $48,000 : 174 \text{ ore/muaj} = 275$ leke/orë.

• **Shtesë page për vështirësi, turni II, turni III; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, neni 81, për çdo orë punë të kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jepet e drejta e një shtese mbi pagën, jo më pak se 20% e pagës orare. Çdo orë pune e kryer nga ora 22.00 deri në 06.00 jepet e drejta e një shtese mbi pagën, jo më pak se 50% e pagës orare.**

Viti 365 ditë: $12 \text{ muaj} = 30.41$ ditë punë mesatare mujore.

Shtesa mbi pagën e përlllogaritur 24 orë turni (I,II,III)

Turni II (3 orë x 30.41 ditë/muaj x 275 lekë/orë x 20 %) : 4,98 roje = 1,010.71 lekë

Turni III (3 orë x 30.41 ditë/muaj x 275 leke/orë x 50 %) : 4.98 roje = 6,738,07 lekë.

Përlllogaritja e fondit limit e përmbledhur sipas tabelës më poshtë:

Nr	Preventiv/zërat e shpenzimeve	Lekë
1	Shpenzime për pagë bazë	48,000
2	Shtesë mbi pagën turni II	1,010.71
3	Shtesë mbi pagën turni III	6,738.07
4	Shpenzime për sigurimë shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	9,310.04
	Kostoja në muaj për një punonjës	65,058.82
A	Cmimi neto në muaj (65,058.82 x 4.98 roje x 7 vende)	2,267,950
B	Kostoja në muaj për monitorimin e kamerave dhe sistem alarmi (Shërbim ruajtje me 4(katër) sinjal alarmi dhe monitorimi i 1 sistemi kamera vëzhgimi non stop 24 orë) me cmime tregu, PV test 5 sisteme x 6000 leke/muaj)	30,000
	Cmimi neto pa tvsh për një muaj (A+B)	2,297,950
	Cmimi neto pa tvsh (A+B) 24 muaj	55,150,800

Cmimi neto me tvsh (A+B) 24 muaj	66,180,960
---	-------------------

Në lidhje me përlllogaritjen e mësipërme komisioni është mbështetur gjithashtu në rekomandimin e përbashkët të APP me nr. 15116 prot, dhe KPP me nr. 1858 prot, datë 20.12.2017, “Rekomandim mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit dhe zhvillimin e procedurës” por duke aplikuar pagën bazë minimale në shkallë vendi 32,000 lekë pasi në rekomandimin e përbashkët të APP dhe KPP e vitit 2017 paga minimale në shkallë vendi ishte 24,000 lekë. Fondi limit i përlllogaritur është bërë duke përfshirë 7 vende roje me 3(tre) turne si më poshtë:

Nr	Vendroje	Turnet	Koha e ruajtjes	Sistemi/Elek	Koef	Roje	Tarifa mujore pa tvsh	Vlera vjetore pa tvsh	Vlera per 24 muaj
1	7	3	24 orë/7 ditë	4	1.66	34.86	1,619,964	2,267,921	54,430,125
Totali+sistemi alarmi dhe kamera									55,150,800

-Në lidhje “*përlllogaritjen e fondit limit*”, në përcaktimin e numrit të turneve 7 vend-roje me 3 turne, AK **nuk ka vepruar drejt** pasi në mbulimin me shërbim me roje, mund të merrte në konsideratë që mbulimi me shërbim të ofrohej me më pak punonjës shërbimi, në zbatim të parimeve të Ligjit për MFK, e cila lidhet me një shpenzim të njësisë në mungesë të menaxhimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

Së pari, në Godinën e Administratës si dhe Godinën e Telemjekësisë nuk është e nevojshme që mbulimi me shërbimin të ofrohet me 3 turne duke qenë se (*Godina e Administratës, Telemjekësia, Kirurgjia*) ndodhen fare pranë njëra tjetrës, në një perimetër të afërt me një fushëpamje të qartë të cilat mund të monitorohen lehtësisht nga një punonjës shërbimi pas orës 16.00 pasi bie ndjeshëm dhe fluksi lëvizjes, pra që përkon me turnin e II dhe të III.

Së dyti, në (*Godinën e Administratës dhe Telemjekësisë*) në lidhje me mbulimin me shërbim duhet të ishte marr në konsideratë që mbulimi i shërbimit të realizohet me 1.5 turne me 12 orë. Pra duke qenë se Godina e Administratës pas orarit zyrtar të punës qëndron e mbyllur si dhe Telemjekësia qëndron gjithmonë e mbyllur dhe vetëm në raste specifike përdoret nga mjeku kur vlerëson gjendjen e pacientit në distancë, mbulimi i shërbimit me 12 orë, pra 1.5 turne nuk do cenonte sigurinë Institucionit pasi ky shërbim mbulohet nga punonjësi i shërbimit i Maternitetit i përcaktuar me 3 turne.

Nr	Vendroje	Turnet	Koha e ruajtjes	Sistemi/Elek	Koef	Roje	Tarifa mujore pa tvsh	Vlera vjetore pa tvsh	Vlera per 24 muaj
1	5	3	24 orë/7 ditë		1.66	24.9	1,619,964	19,493,568	38,987,136
2	2	1.5	12 orë/5 ditë		1.18	3.54	230,305	2,763,660	5,527,320
3			24 orë/7 ditë	4 sisteme alarmi dhe kamera			30,000	360,000	720,000

	Totali							45,234,456 lekë	45,234,456
--	--------	--	--	--	--	--	--	--------------------	------------

Rekomandim:

Referuar tabelës së mësipërme **grupi auditimit gjykon** që 5 vend-roje (Kirurgjia, Urgjenca, Godina e Sëmundjeve Interne, Materniteti si dhe Poliklinika), të mbulohen me shërbim 24 orësh me 3 turne e përlllogaritur si vijon 5vend-roje x 3 turne x 1.66 koeficienti zëvendësimit të rojeve x 65,058 lekë tarifa mujore 1 roje =1,619,964 leke/muaj x 24 muaj=38,878,660 leke pa TVSH.

Ndërkohë që Godina e Administratës si dhe Godina e Telemjekësise, përlllogaritet si vijon, 2 vendroje x 1.5 turne x 1,18 koeficienti i zëvendësimit të rojeve x 65,058 lekë tarifa mujore 1 roje =230,305 leke/muaj x 24 muaj/MK =5,527,320 lekë pa TVSH.

Pra referuar përlllogaritjes së kryer për të gjithë shërbimin vlera e fondit limit do ishte 45,234,456 leke pa tvsh, me një diferencë nga ajo e përlllogaritur nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit 55,150,800-45,234,456 = **9,916,344 leke pa TVSH**. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 12, neni 73, neni 76; Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 5, neni 8, neni 12; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Në lidhje me “**korrespondencën me Shoqërinë I.G**” SHA, kërkesat lidhur me mbulimin e shërbimit nga ana e shoqërisë:

Me shkresën me nr. 868 prot, datë 03.06.2022 pas kryerjes së përlllogaritjes të fondit limit AK, Qendra Spitalore “Xhaferr Kongolli”, Titullari i saj, referuar pikës 10, të VKM-së, nr .177 datë 04.04.2019, “Për krijimin e shoqërisë I.G”, për ofrimin e shërbimeve të ruajtjes dhe të sigurisë ndaj personave fizikë, juridik dhe private, i drejtohet Shoqërisë , që të informojë AK, nëse kjo e fundit është e gatshme të marr përsipër mbulimin e shërbimeve të sigurisë godinave/ambienteve si më poshtë:

Numri i vendrojeve	Numri i turneve	Numri i punonjësve të nevojshëm	Afati i lëvrimit
7 (shtatë)	3 turne 24 orë cdo ditë kalendarike	34.86 punonjës	24 muaj
5 objekte sistem elektronik	Monitorim sistem kamera vëzhgim 24 ore	Monitorim sistem kamera vëzhgim non stop dhe ruajte 4 objekte me system alarmi	24 muaj

- Shërbim i ruajtës sigurisë fizike 7 vendroje/poste pune, me punonjës shërbimi për 24 orë.
- Shërbim ruajtje me sistem elektronik të 5 objekteve, përfshirë monitorimin e kamerave të vëzhgimit të ambienteve të jashtme të godinave të spitalit non stop 24 ore.
- Fondi limit i planifikuar për 24 muaj është në vlerën 55,150,800 lekë pa tvsh.

Ndodhur në këto kushte me shkresën me nr. 1071/3 Shoqëria, “I.G” SHA i ka kthyer përgjigje Autoritet Kontraktor, Spitalit Rajonal “Xhaferr Kongolli” Elbasan, nga ku argumenton si vijon: *Bazuar në kërkesën dhe specifikimet e përcaktuara nga ana juaj mbi shërbimin e sigurisë, si dhe referuar tarifave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Ekonomisë me nr. 407/1, datë 14.06.2019, “Për Mënyrën e përlllogaritjes së Tarifave të Shërbimeve Specifike, që ju ofrohen Subjekteve Private Publike”, sipas tabelës do të gjeni përlllogaritjen e vlerës së kontratës 12 mujore:*

Nr	Vendroje	Turnet	Koha e ruajtes	Sist/ elektr	Koef	Roje	Tarifa pa tvsh	Tarifa mujore pa tvsh	Vlera vjetore pa tvsh
1	7	3	24 orë/7ditë		1.66	34.86	71,243	2,483,530	29,802,373
2			24orë/7 ditë	4			190,206	760,824	9,129,888

Totali			34.86	-	3,244,354	38,932,259
--------	--	--	-------	---	-----------	------------

Fondi limit total i përlllogaritur nga ana e shoqërisë "I.G" SHA është 38,932,259*2 vjet=77,864,519 lekë pa tvsh për 24 muaj.

Më pas AK, i ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. 868/2 prot, datë 22.06.2022 shoqërisë, "I.G" SH.A ku shprehet:

Përsa i përket propozimit nga ana juaj për ofrimin e këtij shërbimi konstatojmë:

Shërbimit të kërkuar nga ana jonë, konsiston në vlerën 77,864,514.5 lekë pa tvsh të përlllogaritur nga ana juaj për 24 muaj, kundrejt FL të përlllogaritur nga ana jonë prej 55,816,800 lekë pa tvsh, pra një diferencë prej 22,000,000 lekë më tepër.

Me shkresën me nr. 1071/1 prot, datë 01.07.2022, Shoqëria i kthen përgjigje AK, ku shprehet: *Shoqëria "I.G" SH.A, pasi vlerësoi kërkesën tuaj mbi shërbimin e ruajtes dhe sigurisë së objekteve nën administrimin tuaj, në aspektin Teknik, financiar, dhe ligjor, ka vendosur se është në kushtet e pamundësisë së ofrimit të shërbimit të sigurisë për objektet e Qendrës Spitalore "Xhaferr Kongoli", me 34.86 punonjës shërbimi dhe 5 sisteme elektronike, brenda fondit të subjektit 55,150,800 lekë pa TVSH. Gjithashtu, bëjmë me dije, se Shoqëria "I.G" SHA, shpreh mundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë për objektet e Qendrës Spitalore "Xhaferr Kongoli", në cdo kohë, me 24.05 punonjës shërbimi dhe 3 (tre) sisteme vëzhgimi dhe alarmi me fond 54,816,291 lekë pa TVSH, dhe se në rast se do të vijoni me prokurimin e këtij shërbimi, ju duhet të shtoni në Dokumentet Standarde të Tenderit fjalinë, "Kjo marrëveshje kuadër dhe çdo mini kontratë e lidhur me subjektin privat të shërbimit të sigurisë do të konsiderohet e zgjidhur nëse shoqëria "I.G" SH.A, shpreh mundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë.*

AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve":

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit "për përcaktimin/hartimin e krieteve të pranimit/kualifikimit", datë 07.07.2022 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të VKM nr.285 datë 19.05.2021, neni 78, pika 2; "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 15, neni 22.

Në procesverbal Njësia e prokurimit ka listuar kriteret e kërkesave të veçanta për kualifikim, në të cilin është mjaftuar me pasqyrimin në terma të përgjithshëm se; "...për kriteret e përcaktuara njësia e prokurimit ka zbatuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 ndërsa në asnjë rast nuk ka argumentim në lidhje me vendosjen e kërkesave dhe kriteret e kualifikimit, por është mjaftuar vetëm me pasqyrimin se, vendosja e këtyre kërkesave është në mbështetje të VKM, të ligjit. Baza ligjore së cilës i referohet NJHDT është pjesa e së drejtës që AK, ka për të parashikuar në kriteret e vendosura për nevojën e licencave profesionale, lista e punonjësve, fuqia punëtore, mjetet dhe pajisjet teknike dhe të tjera mjete të nevojshme, ndërsa numri kërkuar nga AK në lidhje me to, është detyrimi që ka AK për të argumentuar vendosjen e këtyre krieteve.

Mos argumentimi me hollësi i krieteve për kualifikim nuk justifikon apo ligjëron vendosjen e tyre e cila mund të krijojë hapësirë për hartim të gabuar të krieteve teknike të kualifikimit dhe mund të shoqërohet me ankesa nga ana e OE si dhe mund të mos stimulojë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin "Për prokurimin publik".

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE, për të cilin, referuar procesverbaleve përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	“K.1”shpk	54,440,758	Kualifikuar/Fituesi

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të dates 08.08.2022, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar 1(një) OE, si pjesëmarrës të vetëm në garë duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit.

8. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “F.V Pajisje hotelerie dhe mjekësore për Pediatriinë e Spitalit Elbasan”, me 2(dy) lote.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelle të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “F.V Pajisje hotelerie dhe mjekësore për Pediatriinë e Spitalit Elbasan ” REF-99073-06-24-2021			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e ndarë në lote Mbi kufirin e ulët monetar Urdhër Prokurimi nr.950/1 prot , datë 21.06.2021	1.1 Komisioni i përlogaritjes fondit, Urdhri pa nr pro 783, datë 17.05.2021 7. A. C. 8. K. T. 9. R. D.	2 Njësia e Prokurimit 7. B. D. 8. Z. P. 9. D. M.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr.950/2prot , dt. 01.06.2021 1. A. B. 2. D. K. 3. O. T.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 22,500,000 lekë Loti I : 11,726,400 Loti II: 10,773,600	5. Oferta fituese (pa TVSh) Fitues Loti I: M. shpk 11,210,438 leke Loti II: B. shpk 8,977,000 leke	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Loti I :515,962 leke Loti II:1,796,600 leke	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Datë 19.07.2021	8. Burimi Financimit Investim (MSHMS)	9. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Loti I :Numër 4 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës/Data e lidhjes MK: 24 muaj ;datë 18.08.2022		Loti II :Numër 5 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 2 OE	

Nga shqyrtimi i të gjithë praktikës të sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar në një dosje i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve ligjore, pasqyruar në inventarin e dokumenteve të dosjes. Ato përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës (informacionin e përgjithshëm dhe atë specifik, kërkesat kualifikuese specifike, specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit të mallrave etj).

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, në lidhje me **“përlogaritjen e fondit limit”**:

Fillimisht me urdhrin nr. 733, datë 17.05.2021 është ngritur grupi i punës i emërtuar **“Komisioni i konstatimit të nevojave, hartimit të specifikimeve teknike për pajisjet mjekësore dhe hotelerie për vënien në shfrytëzim të spitalit Pediatrik të rikonstruktuar”**, me përbërje, (I. P., E. D., L. P., D. M., Z. P.). Ky komision identifikoi nevojat, nga ku me me anë të procesverbalit të mbajtur përcaktoi listën e pajisjeve të nevojshme të hotelerisë dhe ato mjekësore për tu prokuruar. Në përcaktimin e nevojave dhe hartimin e specifikimeve teknike komisioni veproi duke marr në konsideratë gjendjen e amortizuar të pajisjeve të hotelerisë, mungesën e theksuar në pajisjet mjekësore ku përfshihen dhe fluksometrat e oksigjenit për sistemin e ri të gazrave mjekësore, si dhe kapacitet e shtuara në ambientet e reja që po rikonstruktohen.

Pas identifikimit të nevojave dhe hartimit të specifikimeve teknike për pajisjet e mësipërme , në zbatim të urdhrit të Titullarit pa nr protokolli, më datë 17.05.2021 është ngritur komisioni i

testimit të tregut me përbërje, (A. C., K. T., R. D.), i cili me procesverbalin më datë 21.05.2021, testoi tregun si dhe mbi bazën e ofertave të administruara, përcaktoi vlerën e fondit limit të përlogaritur me kriterin oferta më e ulët e mesatares së 3 (tre) ofertave. Ofertat si më poshtë:

Loti I, “F.V pajisje hotelerie për Pediatriinë”

1.E. shpk NIPT L.....J oferta 1,263,650 lekë pa tvsh çmim/njësi;

2.D.-A. shpk NIPT L.....N oferta 1,327,900 lekë pa tvsh çmim/njësi;

3.S. G. NIPT L.....K oferta 1,504,800 lekë pa tvsh çmim/njësi;

Cmimi më i ulët për njësi 1,174,000 lekë pa tvsh; Cmimi më i ulët mbi bazën e vlerës totale të kontratës për lotin I 11,726,400 lekë pa tvsh.

Loti II, “F.V pajisje mjekësore për Pediatriinë”

1.E. shpk NIPT L.....J oferta 4,099,490 lekë pa tvsh çmim/njësi;

2.D.-A. shpk NIPT L.....N oferta 4,498,022 lekë pa tvsh çmim/njësi;

3.S. G. NIPT L.....K oferta 4,156,100 lekë pa tvsh çmim/njësi.

Çmimi më i ulët për njësi 3,963,700 lekë pa tvsh. Çmimi më i ulët mbi bazën e vlerës totale të kontratës për lotin II 10,773,600 lekë pa tvsh.

Loti I+Loti II =22,500,000 lekë pa tvsh vlere e fondit limit të përlogaritur.

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve si dhe specifkimeve teknike”:

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e kriereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

-Konkretisht, konstatohet se në NjP në hartimin e kriereve të veçanta kualifikuese, për procedurën e prokurimit ka hartuar dhe miratuar dokumentet e tenderit, kërkesat për kualifikim, specifkimet teknike, termat e referencës me publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik të nënshkruar nga NJHDT. Në procesverbal Njësia e prokurimit ka listuar kriteret e kërkesave të veçanta për kualifikim, në të cilin është mjaftuar me pasqyrimin në terma të përgjithshëm se; “...për kriteret e përcaktuara njësia e prokurimit ka zbatuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 ndërsa në asnjë rast nuk ka argumentim në lidhje me vendosjen e kërkesave dhe kriteret e kualifikimit, por është mjaftuar vetëm me pasqyrimin se, vendosja e këtyre kërkesave është në mbështetje të VKM, të ligjit. Baza ligjore së cilës i referohet NJHDT është pjesa e së drejtës që AK, ka për të parashikuar në kriteret e vendosura për nevojën e licencave profesionale, lista e punonjësve, fuqia punëtore, mjetet dhe pajisjet teknike dhe të tjera mjete të nevojshme, ndërsa numri kërkuar nga AK në lidhje me to, është detyrimi që ka AK për të argumentuar vendosjen e këtyre kriereve.

Veprime **në mospërputhje** me nenin **78**, pika **2** të VKM RRPP Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin **15** dhe **22** të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citon: “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifkimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Për sa më sipër, për shembull në lidhje me kërkesat për kualifikim, që lidhen me kapacitetin Teknik, autoritetet/entet kontraktore duhet ta argumentojnë dhe nga ana teknike çdo kriter të përcaktuar.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit për të cilin, referuar procesverbaleve përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës janë paraqitur OE si më poshtë:

Loti I: “F.V Pajisje hotelerie për Pediatriinë”

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	M. shpk	0,00	Skualifikuar
2	M. Shpk	11,210,438	Kualifikuar/Fituesi
3	G. M. Shpk	9,006,000	Skualifikuar
4	F.Shpk	0,00	Skualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar 1(një) OE pjesëmarrës duke e shpallur fitues të procedurës së prokurimit, duke skualifikuar 3(tre) OE pjesëmarrës pasi e konsideroi dokumentacionin e tyre si jo të rregullt dhe jo në përputhje me DST si më poshtë:

1.F. Shpk

K.....N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e mëposhtme : Nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në DST duke mos plotësuar Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit

2. M. Shpk

K.....H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e mëposhtme : Nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në DST duke mos plotësuar Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit

3. G.M. Shpk

K.....J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e mëposhtme : Nuk ka paraqitur certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuara në DST, Kapaciteti Teknik pika 2.3.4

Nuk ka paraqitur certifikatë ISO 13485 :2016 ose ekuivalente duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuara në DST, Kapaciteti Teknik pika 2.3.5

Nuk ka paraqitur katalogët e mallrave të ofruar duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuara në DST, Kapaciteti Teknik pika 2.3.7

Loti II:F.V Pajisje mjekësore për Pediatriinë”

Nr.	OE/NIPT	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1	A. T. Shpk	0,00	Skualifikuar
2	M. Shpk	10,278,014	Kualifikuar
3	B.A. shpk	8,977,000	Kualifikuar/Fituesi
4	F. Shpk	0,00	Skualifikuar
5	I. shpk	0,00	Skualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar 2(dy) OE pjesëmarrës duke shpallur fitues të procedurës së prokurimit si oferta më me vlerën më të ulët “**B. A.**” shpk, duke skualifikuar 3(dy) OE pjesëmarrës pasi e konsideroi dokumentacionin e tyre si jo të rregullt dhe jo në përputhje me DST si më poshtë:

1. “A. T.” Shpk

L.....G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme: Nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në DST duke mos plotësuar Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit

2. “F.” Shpk

K.....N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e mëposhtme : Nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në DST duke mos plotësuar Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit

3. “I.” Shpk

L.....A

Arsyet e mëposhtme : Nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në DST duke mos plotësuar Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit

Zbatimi i kontratës

Loti I “F.V pajisje hotelerie për Pediatriinë e Elbasanit”, Kontrata me Nr.950/9 prot, datë 20.08.2021 lidhur ndërmjet OE “M.” shpk me NIPT L.....A si dhe AK, Spitalit Rajonal “Xhaferr Kongoli” Elbasan. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 15 ditë kalendarike. Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave është ngritur me urdhrin Nr.1284, prot, datë 26.08.2021 me përbërje si vijon, (A. Q., L. M., I. Sh.). Kontraktori ka kryer dorëzimin e parë të mallrave më datë 26.08.2021 brenda afatit, 6 ditë pas lidhjes së kontratës në vlerën 1,782,366 lekë ndërkohë që pjesën e mbetur e ka dorëzuar sipas fletë-hyrjes nr.8 më datë 07.09.2021, pra 4 ditë kalendarike me vonesë nga afati 15 ditor i përcaktuar në kontratë vlera prej 9,428,072 lekë pa tvsh.

Në këto kushte referuar neni 24 (*Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar*), neni 24.1, dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogarriten me tarifat e mëposhtme ditore: a) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë sa 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimumi mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Sa më sipër aplikimi i dëmit do të përllogaritet $4/1000 \times 9,428,072 \times 4 \text{ ditë} = 150,849 \text{ lekë pa TVSH OE "M." shpk}$. Në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk ka dokumentacion justifikues si certifikata origjinës mallit, test-rapot, certifikatë cilësie etj, bazuar në rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), me nr. 2106, datë 24.03.2021, rekomandime të veçanta:

-Për kontratat e tipit mall;

Duhet të respektohen termat e përcaktuar në kushtet e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave dhe dokumentacioni shoqërues (të përcaktuar në kontratën e nënshkruar) si:

-Certifikata e cilësisë; Certifikata e origjinës; certifikata e garancisë; raport- testet si dhe cdo dokument tjetër, i kërkuar në procedurën e prokurimit përkatës;

Si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, pika 37 (dokumentimi i lëvizjes së aktiveve) ku citon:

Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë).

Pra në asnjë rast nuk vërtetohet cilësia e mallrave të ofruar pasi në procesin e dorëzimit të tyre nuk është dorëzuar asnjë dokument provues nga OE siç është theksuar më sipër në rekomandimin e APP dhe duke bërë që procesi i pranimit të mallrave është kryer pa vërtetuar cilësinë e tyre.

Pranimi i mallrave pa mbajtur në konsideratë rekomandimin e APP, lidhet me pranimin e mallrave jashtë specifikime teknike duke mos dhënë garanci që mallrat e ofertuar janë sipas standardeve të miratuara.

Loti II “F.V Pajisje mjekësore për Pediatriinë e Spitali”, Kontrata me Nr.950/10 prot, datë 20.08.2021 lidhur ndërmjet OE B.”shpk me NIPT J.....E si dhe AK, Spitali Rajonal “Xhaferr Kongoli” Elbasan.

Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 15 ditë kalendarike. Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave është ngritur me urdhrin Nr.1284, prot, datë 26.08.2021 me përbërje si vijon, (A. Q., L. M., I. Sh.). Dorëzimi i mallrave është bërë me datë 25.10.2021 e firmosur nga përfaqësuesi i firmës dhe nga anëtarët e komisionit marrjes në dorëzim të mallrave të cilët

kanë përcaktuar që mallrat janë sipas specifikimeve teknike dhe i kanë marr në dorëzim. Referuar kushteve të përcaktuara kontratës së lidhur dhe afatit të marrjes në dorëzim të mallrave përcaktuar 15 ditë kalendarike 20.08.2021-03.09.2021, kontraktori ka dorëzuar mallrat 52 ditë kalendarike me vonesë. Në këto kushte referuar neni 24 (*Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar*), neni 24.1, dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogarriten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë sa 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimumi mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Për sa më sipër aplikimi i dëmit do të përllogaritet $4/1000 \times 10,772,400 \times 52 \text{ ditë} = 2,240,659$ **lekë pa TVSH OE "B." shpk**

Në procesin e marrjes në dorëzim, komisioni nuk i është përmbajtur rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), me nr. 2106, datë 24.03.2021, rekomandime të veçanta: *-Për kontratat e tipit mall;*

Duhet të respektohen termat e përcaktuar në kushtet e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave dhe dokumentacioni shoqërues (të përcaktuar në kontratën e nënshkruar) si:

-Certifikata e cilësisë; Certifikata e origjinës; certifikata e garancisë; raport- testet si dhe çdo dokument tjetër, i kërkuar në procedurën e prokurimit përkatës;

Si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik, pika 37* (dokumentimi i lëvizjes së aktiveve), neni 54 ku citon:

37) Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë).

54)Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.

Pra në asnjë rast nuk vërtetohet cilësia e mallrave të ofruar pasi në procesin e dorëzimit të tyre nuk është dorëzuar asnjë dokument provues nga OE siç është theksuar më sipër në rekomandimin e APP dhe si rrjedhojë procesi i pranimit të tyre është bërë pa vërtetuar cilësinë e tyre.

Pranimi i mallrave pa mbajtur në konsideratë rekomandimin e APP, lidhet me pranimin e mallrave jashtë specifikime teknike duke mos dhënë garanci që mallrat e ofertuar janë sipas standardeve të miratuara. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*"; Rekomandimi i APP me nr. 2106, datë 24.03.2021; Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik*". Nuk garantohet përmbushja e specifikimeve teknike për mallrat e ofruar.

9. Mbi auditimin e ushtruar për procedurën e prokurimit me objekt: "F.V të ndarjes së ambienteve spitalore me materiale të lehta".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", Ligjit për MFK", si më poshtë:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Objekti	Kërkesa	Urdhër Prokurimi	OE fitues	Klasifikimi	Vlera e fituar	Urdhër shpenzimi	Fatura tatimore/vlere	Akt-marrja në dorëzim
F.V te ndarjes së ambienteve spitalore	Po	1872/1, datë 16.12.2022	Deliu 3D	1	938,640	Pjesor Nr.933, datë 28.12.2022	Nr25/2022, datë 27.12.2022	27.12.2022

-Nga shqyrtimi i praktikës të sipërcituar konstatohet që:

Me urdhrin me Nr.1872 prot, datë 15.12.2022 është ngritur komisioni i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit me përbërje, (K. T., E. A., S.D.).Ky komisioni kreu përlllogaritjen e vlerës limit në të cilën u përcaktuar vlera e përlllogaritur 938,640 lekë pa TVSH. Hartimi i kriterëve teknike u krye nga Njësia e Prokurimit e ngritur sipas urdhrit të Prokurimit nr. 1872/1, në të cilën u vendosën kriteret e nevojshme mbi përmbushjen e tyre nga ana e OE.U vendos që hartimi i kriterëve të behet nga Njësia e Prokurimit për shkak të natyrës specifike të procedurës në të cilën përfshihen kriteret teknike të cilat nuk mund të hartohen nga KBV pasi ky komision nuk ka ekspert fushe dhe si rrjedhojë u ngrit njësia e prokurimit me ekspert fushe me z. A. M. i punësuar me kontratë të përkohshme me të ardhura dytësore.

AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve si dhe specifitimeve teknike”:

Në lidhje me hartimin e kriterëve teknike u konstatua që hartimi i tyre është jo në përputhje me tipologjinë e kontratës pasi janë kërkuar kriteret e panevojshme dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit si më poshtë:

OE ofertues duhet të paraqesin Licenca Profesionale për ndërtim ku të përfshihen kategoritë e më poshtë për këto kategori:

NP-1; NP-2A; NP-4A; NP-5A; NS-1A; NS-2A; NS-4A; NS-6A; NS-7A; NS-18A.

Nevojat mbi disponimin e licencave profesionale sipas kategorive të mësipërme të përfshira janë të tepërta dhe jo në përputhje me tipologjinë e kontratës pasi licencat e sipërcituara lidhen me kategoritë e punimeve që OE janë të licencuar të kryejnë dhe jo me cilësinë e materialeve apo produkteve që ato zotërojnë. Pra licencat e mësipërme i përkasin kategorive kryesisht si (ndërtime civile dhe industriale, punime gërmimi në tokë, rrugë, autostrada, mbikalime, etj.), punime të cilat OE janë të licencuar për të kryer ndërkohë që tipologjia e kontratës lidhet me furnizimin, vendosjen e materialeve të nevojshme për ndarjen e ambienteve spitalore si (vetrate alumini+derë, ndarje mur xhami, perde me tub inoksi) që nuk lidhen me kryerjen e këtyre punimeve sipas kategorive të sipërcituara.

Si konkluzion, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme që në zhvillimin e procedurave ti përmbahet përcaktimeve ligjore në fuqi, pasi të mirë argumentohet çdo kërkesë apo kriter i mundshëm në mënyrë të tillë që ato kërkesa apo kriteret të kuptohen qartë, të jenë të lidhura ngushtë me tipologjinë e kontratës si dhe duhet të sigurojë një trajtim të barabartë ndërmjet ofertuesve. Mos përcaktimi jo i drejtë i kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e kontratës sjell përdorim të fondeve pa **ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet** duke mos iu përmbajtur përcaktimeve të bëra në nenin 5, neni 8, të Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, neni 78, pika 2; Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 5, neni 8.

Në përfundim, për sa konstatuar më sipër, në mospërputhje me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **ngarkohet me përgjegjësi:** Njësia e prokurimit me përbërje: z. A.M. ekspert fushe Inxhinier, znj. A. Q. dhe znj. I. Sh.

10. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Blerje kite, reagente dhe materiale konsumi laborator”, më REF -44180-11-20-2019, për vitin 2020.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

1. Urdhër Prokurimi nr. 2115 prot datë 20.11.2019	3. Hartuesit e dokumenteve te tenderit -B. D. -jurist -Q. H.-ekonomist - A. B.-ekonomiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2115/1 datë 20.11.2019 - A. B. -Kryetare -M. Z. -Anëtare -O. T. -Anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 17,083,333 Lot 1. Kite dhe reagente për laboratorin me fond limit 16,432,900 leke pa tvsh. Lot 2. Materiale konsumabel për laboratorin me fond limit 650,433 leke pa tvsh.	6. Oferta fituese (pa tvsh) Lot 1 për vlerën 16,412,900 lekë Lot 2 për vlerën 650,353 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lot 1 20,000 leke Lot 2 80 leke
8. Data e hapjes së tenderit 23.12.2019	9. Burimi Financimit Fond 15,000,000 leke nga Buxheti i Shtetit 2,083,333 leke nga të ardhurat dytësore	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _1_OE b) S'kualifikuar ska OE, c) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës Drafti i Marrëveshjeskuadërn.1310/36, datë 17.11.2022 Kontrata 1 nr .1310/42 date 25.11.2022	15. Vlera e kontratës 89,972,500 lekë pa tvsh Vlera e kontratës I (me tvsh) 16,416,000lekë	16. Afati i kontratës në dite Nga nënshkrimi me afat 4 muaj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Fondi limit

Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit dhe te ardhurat dytësore. Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike. Më shkresën me nr.1259 prot., me datë 07.11.2019 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale delegon te drejtën e kryerjes se disa procedurave te prokurimit publik për materiale mjekimi specifike për shërbimin spitalor. Me shkresën nr. 2007 prot. Date 31.10.2019 Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë urdhrin “Për ngritjen e komisionit të konstatimit të nevojave ,përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për objektin blerje kite dhe reagente dhe materiali konsumi laboratorit”, i përberë nga znj. Q. H., znj. A. B. dhe znj. F. K.. Grupi i punës ka paraqitur shkresën për përlllogaritjen e fondit limit ,ku për sasi të i është referuar kërkesës të bërë nga shefi i shërbimit te laboratorit (pa nr. prot) dhe për çmimet është marre si reference kontrata e mëparshme e nënshkruar me operatorin ekonomik “G.” shpk. Në llogaritje ë fondit limit, nuk është kërkuar nga spitale të tjera sa është çmim i këtyre i këtyre produkteve. Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit te kontratës” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktor ka nxjerre urdhrin e prokurimit me nr. 2115 prot. date 20.11.2019 për procedurën e prokurimit "Procedure e hapur mbi kufirin e ulet monetar me objekt" Blerje kite reagent dhe materiale konsumi laborator, më fond limit 17,083,333 lekë pa TVSH, ku vlera 15,000,000 lekë është vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, vlera 2,083,333 leke pa tvsh vene ne dispozicion nga te ardhurat dytësore.

Lot 1. Kite dhe reagente për laboratorin me fond limit 16,432,900 leke pa tvsh.

Lot 2. Materiale konsumabël për laboratorin me fond limit 650,433 leke pa tvsh.

Me urdhrin nr 2115/1 prot. date 20.11.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përberë nga znj. A. B., znj. M. Z. dhe znj. O. T.

Specifikimet teknike dhe kërkesat për kualifikim

Hartimi i kriterëve dhe specifikimeve teknike të DST-ve, pas hedhjes në SPE disa nga kriteret janë ndryshuar sipas rekomandimeve të APP-së, të administruar me nr. 2223 date 13.12.2019. Sipas shtojcës nr. 2080/5 prot. Date 16.12.2019 u be modifikimi i kriterëve për dst-të.

Nga KVO është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave më datë 23.12.2019. Referuar këtij procesverbali, ka rezultuar se kanë paraqitur ofertë te vlefshme 1 Operatore Ekonomike, përkatësisht:

Për Lot 1 -Operatori ekonomik "G." me formular ofertën në vlerën 16,412,900 lekë pa Tvsh.

Për Lot 2-Operatori ekonomik "G." me formular ofertë në vlerën 650,353 lekë pa Tvsh.

Në përfundim, mbi bazën e raportit përmbledhës me numër prot. 261/6 datë 02.03.2022, dhe formularit te njoftimit të fituesit, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik "G." shpk për te dy lotet e kësaj procedure prokurimi, përkatësisht me vlerat si më poshtë:

Lot 1 për vlerën 16,412,900 lekë pa TVSH.

Lot 2 për vlerën 650,353 lekë pa TVSH.

Me vendimin me nr. 2115/3 prot. date 30.12.2019 është titullari i autoritetit kontraktor ka miratuar raportin përmbledhës te hartuar nga komisioni i vlerësimit te ofertave dhe ka vendosur te shpalle si fitues ne prokurimin publik me objekt "Blerje kite dhe reagente, Lot 1 kite dhe reagente për laboratorin" operatorin ekonomik "G." shpk, me vlere 16,412,900 leke pa TVSH. Sipas buletinit nr.1 te datës 13.01.2020 për procedurën e hapur, mallra, e REF-44176-11-20-2019, formulari i njoftimit te fituesit, shpallur fitues.

Për LOT 1 OE "G." shpk me vlere te ofertës çmim/njësi 776.435 leke pa TVSH.

Për Lot 2 OE "G." shpk me vlere te ofertës çmim/njësi 11.088,45leke pa TVSH.

Me date 10.02.2020, komisioni i vlerësimit te ofertave ka mbajtur procesverbalin mbi verifikimin e dokumentacionit te paraqitur nga OE "G." shpk, ku konstaton se dokumentacioni origjinal përpurthet me atë të paraqitur ne sistemin elektronik te APP-së.

Ne vijimësi është nënshkruar drafti i marrëveshjes kuadër me nr 2115/5 date 10.02.2020 me objekt "Blerje kite, reagent dhe materiale konsumi për laboratorin ,marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ,ku te gjitha kushtet janë te përcaktuara ,me afat 12 muaj me vlere te pritshme te kontratave qe mund te lidhen gjate marrëveshjes kuadër 17,063,253.9 leke pa tvsh.

Në draftin e marrëveshjes kuadër përcaktohet se zbatimi marrëveshjes kuadër do të behet nëpërmjet dërgimit të ftesave të OE, palë në MK, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

Me date 10.02.2020 është nënshkruar kontrata me nr. 2115/6 me objekt “Blerje kite, reagente dhe materiale konsumi për laboratorin, me vlere për lotin 1, 9,898,500 leke pa tvsh.

Për lotin 2 402,450 leke pa TVSH.

Vlera e plote e kontratës që do ti paguhet kontraktuesit 10,300,950 leke pa TVSH dhe 12,361,140 leke me tvsh.

Me date 12.06.2020 është nënshkruar kontrata me nr. 2115/7 me objekt “Blerje kite, reagente dhe materiale konsumi për laboratorin ,me vlere për lotin 1, 6,514,400 leke pa tvsh.

Për lotin 2 247,904 leke pa tvsh.

Vlera e plote e kontratës që do ti paguhet kontraktuesit 6,762,304 leke pa tvsh dhe 8,114,765 leke me tvsh.

Duke marre shkas nga problematikat e konstatuara në këtë procedure prokurimi ,grupi i auditimit konstaton se kriteret e përcaktuara në DST-të për këtë procedure nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 27 të VKM-së 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jete në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 1 pika a,c,d dhe nenit 20 të LPP-së për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, që përben diskriminim ndaj operatoreve ekonomike.

Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Elbasan përpara zhvillimit të kësaj procedure prokurimi ka firmosur një kontrate huapërdorje “Dhënien në përdorim të aparaturave dhe pajisjeve laboratorike ,duke ruajtur te drejtën e pronësisë pala huadhënëse”, kontrata nr. 1994 prot. date 29.12.2019,me një afat 10 mujor.

Mbi bazën e të dhënave të këtyre pajisjeve Autoriteti Kontraktor Elbasan ka përcaktuar në dst-të për këtë procedure prokurimi kriteret dhe specifikimet teknike që duhet të plotësojnë operatorët ekonomike për tu kualifikuar.

Grupi i auditimit konstatoi se specifikimet teknike të vendosura nga AK kanë kufizuar konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik, në kundërshtim me nenin 23, ligji nr. 9643 date 20.12.2006 ,“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 dhe 5, ku shprehimisht parashikohet se:

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

11. Mbi audidimin e procedurës së prokurimit “Blerje kite dhe reagente dhe materiale konsumi për vitin 2021.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

1.Urdhër nr. 2269 15.12.2020	Prokurimi prot datë	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit -I.S.-Juriste -Q.H.–Ekonomist -I. B.-Farmacist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2269/1 -A. B. -D. K. -O. T.
Perilogaritja e fondit limit 1.Q. H., shkrese pa nr prot			
5. Fondi Limit (pa tvsh) 19,999,550			7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)

Lot 1 17,578,000 Lot 2 2,421,550		0339.16 13,357.44
8. Data e hapjes së tenderit 10.10.2022	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit 15,000,000 Fond nga te ardhurat dytesore 4,999,550	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _1_OE b) S'kualifikuar ska OE, c) Kualifikuar__1 OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës Drafti i Marrëveshjes kuadër nr.2269/8, datë 17.02.2021 Kontrata 1 nr. 2269/9 date 17.02.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 19,999,550 leke pa tvsh 16,278,750 leke me tvsh	16. Afati i kontratës në dite

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Fondi për këtë procedure është akorduar nga Buxheti i Shtetit ne vlerën 15,000,000 leke pa tvsh dhe 4,999,550 leke pa TVSH vene në dispozicion nga të ardhurat dytësore.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Nga shefi i sektorit të planifikimit dhe prokurimeve z. Q. H. është bërë përlllogaritja e fondit limit kiteve, reagenteve dhe materialeve konsumabel të laboratorit për periudhën deri në fund të vitit 2021, sipas preventivit të konfirmuar nga zv/drejtoresha e shërbimeve administrative znj. A. B. dhe te miratuar nga titullari i AK.

Me shkresën me nr. 2269 prot., me datë 15.12.2022, Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e prokurimit “Blerje kite dhe reagente dhe materiale konsumi laborator, i ndare ne lote si me poshtë:

Lot 1, kite dhe reagente për laboratorin me fond limit 17,578,000 leke pa TVSH.

Lot 2, Materiale konsumabel për laboratorin me fond limit 2,421,550 leke pa TVSH. Procedure e hapur mbi kufirin e ulet monetar.

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference çmimet e kontratës se mëparshme Në llogaritje ë fondit limit, nuk është kërkuar nga spitale të tjera sa është çmim i këtyre i këtyre produkteve.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (shfuqizuar), Neni 59 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike dhe kërkesat për kualifikim

Hartimi i kriterëve dhe specifikimeve teknike të DST-ve, pas hedhjes në SPE ato janë ndryshuar sipas shtojcës nr. 2268/4 date 12.01.2021.

Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të kualifikimit, është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës, kjo në kundërshtim me përcaktimet e nenit 61 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, *çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.*

Nga KVO është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave më datë 04.02.2021. Referuar këtij procesverbali, ka rezultuar se ka paraqitur ofertë 1 Operator Ekonomik, përkatësisht:

Për Lot 1 -Operatori ekonomik "G." me formular ofertë në vlerën 17,568,000 lekë pa TVSH.

Për Lot 2-Operatori ekonomik "G." me formular ofertë në vlerën 2,413,650 lekë pa TVSH.

Në përfundim, mbi bazën e raportit përmbledhës me numër datë 11.02.2021, dhe formularit të njoftimit të fituesit, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik "G." sh.p.k për të dy lotet e kësaj procedure prokurimi, përkatësisht me vlerat si më poshtë

Lot 1 për vlerën 17,568,000 lekë pa TVSH ,çmim për njësi 845,360 leke pa TVSH.

Lot 2 për vlerën 2,413,650lekë pa TVSH, çmim për njësi 96,148 leke pa TVSH.

Me vendimin me nr. 2269/6 prot. date 11.02.2021 titullari i autoritetit kontraktor ka miratuar raportin përmbledhës të hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe ka vendosur të shpallë si fitues në prokurimin publik me objekt "Blerje kite dhe reagente, Lot 1 kite dhe reagente për laboratorin" operatorin ekonomik "G." shpk, me vlere të pritshme të kontratave 17,568,000 leke pa TVSH dhe çmim për njësi 845,360 leke pa tvsh dhe lot 2 me vlere pritshme kontratës 2,413,650 leke pa TVSH dhe çmim/njësi 96,148 lekë pa tvsh.

Sipas buletinit nr.1 të datës 13.01.2020 janë për procedurën e hapur, mallra, REF-44176-11-20-2019 , formulari i njoftimit të fituesit, shpallur fitues:

Për LOT 1, OE "G." shpk me vlere të ofertës çmim/njësi 776.435 leke pa TVSH.

Për Lot 2, OE "G." shpk me vlere të ofertës çmim/njësi 11.088,45leke pa TVSH.

Me date 10.02.2020 komisioni i vlerësimit të ofertave ka mbajtur procesverbalin mbi verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE "G." shpk, ku konstaton se dokumentacioni origjinal përputhet me atë të paraqitur në sistemin elektronik të APP-së.

Duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara në këtë procedure prokurimi ,grupi i auditimit konstaton se kriteret e përcaktuara në DST-të për këtë procedure nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 27 të VKM-së 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jete në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 1 pika a,c,d dhe nenit 20 të LPP-së për të shmangur çdo kriter apo kërkesë ,që lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, që përben diskriminim ndaj operatoreve ekonomike.

Grupi i auditimit konstatoi se specifikimet teknike të vendosura nga AK kane kufizuar konkurrencën duke orientuar procedurën drejt një produkti specifik duke favorizuar vetëm një operator ekonomik, në kundërshtim me nenin 23, ligji nr. 9643 date 20.12.2006 ,“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 dhe 5, ku shprehimisht parashikohet se:

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

5. 5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen, detyrimisht në këto specifikime.

Konkretisht:

Reagent për instrumentat SAT 450
Reagent për Autoanalizatorin Hematologjik Benesphera
Reagent për Autoanalizatorin Hematologjik Maglum 800
Reagent për I-Chroma Reader

Nga auditimi i konstatua që: Kërkesat kualifikuese kanë zvogëluar konkurrencën në procedurat e prokurimit: Blerje kite dhe reagente”, specififikimet e vendosura kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik duke favorizuar vetëm një operator ekonomik. Përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Elbasan ka marre me hua nëpërmjet kontratave të huapërdorjes aparaturat nga operatori ekonomik “G.” sh.p.k. Karakteristikat teknike të përshkruara në specififikimet teknike janë njësoj me aparaturat e OE fitues dhe pa përdorur termin ekuivalent, duke orientuar procedurën e prokurimit drejt OE të shpallur fitues, me pasoje kufizimin e pjesëmarrjes dhe ngushtimin e konkurrencës. *Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Q.H., I. S., I. B., në cilësinë e anëtarëve njësisë së prokurimit. A. B. në cilësinë e zv- drejtoreshës së shërbimeve administrativë.*

Përlllogaritje jo e saktë e fondit limit, duke krijuar risk për keqmenaxhim të fondeve publike. Në të gjitha procedurat e prokurimit me objekt: “Blerje kite dhe reagente dhe materiale konsumi”, të zhvilluara nga Spitali Rajonal Elbasan, të audituara, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera për përlllogaritjen e fondit limit. Autoriteti kontraktor për përlllogaritjen e fondit limit të procedurave të prokurimit me objekt ‘Blerje kite dhe reagente dhe materiale konsumi “është referuar në çdo kohe vetëm kontratave të mëparshme të nënshkruara me operatorin ekonomik “G.” sh.p.k. Nëpërmjet testimi të tregut AK do të kishte krijuar hapësira për konkurrencën e hapur.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Q. H. ish përgjegjës në sektorin e planifikimit dhe prokurimeve, në cilësinë e anëtarit përlllogaritjen e fondit limit.

Në opinionin e grupit të auditimit, Drejtimi dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike,

-Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se Neni 2 “Qëllimi”

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

-Ligjin nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

12. Procedura e prokurimit me objekt “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj”, me REF-43355-11-14-2019.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj.
--

1. Urdhër Prokurimi nr.2070 prot., datë 12.11.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 1, datë 12.11.2019	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2070/1 prot., datë 12.11.2019 A. B. A.Q. O. T.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedure e hapur-Marrëveshje kuadër”	B. D.- jurist Z. P. -specialiste Ar. B. -ekonomiste	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 10,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 10,000,000 leke	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 12.04.2021	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 8,000,000 leke TA dytësore 2,000,000 leke	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- ka; KPP- ka Operatori ekonomik “M.-T” Operatori ekonomik “P.-M.”	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa 2093/1 prot. date 20.11.2019	13. Përgjigje Ankesës nga KKP 07/2020
b. Zbatimi i Kontratës		
13. Lidhja e kontratës M.K nr. 2070/10 prot., datë 03.02.2020 K.SH nr. 588 prot., datë 11.03.2020	14. Vlera e kontratës (me tvsh) 12,000,000 leke	
15.Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli Likuiduar për vlerën 10,510,000 Mos realizim I plote I kontratës për shkak te pandemisë Covid-19 .	16.Afati i kontratës në ditë 17 mars 2020 sipas nevojave të AK-së	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 8.000.000 lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat dytësore te institucionit në vlerën 2,000,000 lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i fondit limit

Me shkresën nr. 1925 Prot., datë 17.10.2019 nga titullari i Autoriteti Kontraktor është nxjerre urdhri për ngritjen e komisioni për konstatimin e nevojave dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”, i përberë nga Z. P., E. Z.. Me shkresën pa nr. prot. grupi i përllogaritjes i kanë përcjellë drejtorit të përgjithshëm informacion mbi përllogaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike.

Grupi i punës, në mbështetje të argumentimit të sasisë së mbetjeve që parashikohen të gjenerohen përgjatë vitit 2020, i është referuar sasisë së mbetjeve të gjeneruara në vitin 2019. Për përllogaritjen e vlerës limit të fondit limit grupi i punës ka përcaktuar si çmim reference çmimin e kontratës se mëparshme të nënshkruar me operatorin ekonomik “E.” me objekt “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore” për vitin 2019.

Nuk ka një relacion qe të përshkruaje sasinë totale të mbetjeve të gjeneruara dhe të pritshme të dhe sasi të sipas kodeve përkatëse (Katalogu Shqiptar i Klasifikimit të Mbetjeve).

Përllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave

të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, studimit të tregut, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” ku është shprehur se: 1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës..

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga Z. P., E. Z.

Me shkresën nr. 2070 datë 12.11.2019 nga titullari I AK-së është nxjerre urdhri i prokurimit për procedure me objekt “**Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore**” me **fond limit 10,000,000 leke pa TVSH**, procedurë e hapur mbi kufirin e ulet monetar, me afat 12 muaj. Njësia e prokurimit përbehej nga B. D., A. B. dhe Z. P.

Me shkresën nr. 2070/1 prot., datë 12.11.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përberë nga A. B., M. Z. dhe O. T.

Zhvillimi i procedurës

Nga shoqëria M.-tel sh.p.k është paraqitur pranë AK-se formulari i ankesës i administruar me nr. 2093 prot. datë 18.11.2019, ku citon se “nga shqyrtimi i kriterëve të pjesëmarrjes në DST disa prej kriterëve janë të paligjshme e në shpërpjesëtim me objektin e tenderit. Konkretisht: Pika 3.1 , -Objekti prokurimit janë mbetjet e rrezikshme spitalore të klasifikuara me kodet 18.01.03,18.01.01,18.01.02,18.01.08 (Sipas VKM-së Nr.798 date 29.09.2010.

-leje mjedisore Tipi B dhe leje mjedisore Tipi A, miratuar nga Ministria e Mjedisit ,ku te përfshihen kodet përkatëse te mbetjeve spitalore objekt i prokurimit. Licenca III2.B lëshuar nga QKL ku përfshihen kodet sipas objektit te prokurimit.

Në VKM, KODI 18.01.03 nuk citohet fare. Ju lutem korrigjoni Dst dhe të cilësoni rastet kur i referoheni VKM-së dhe rastet kur duhet t’i referoheni Katalogut shqiptar të mbetjeve si në rastin konkret....

-Përderisa AK e ka vendosur sasinë e mbetjeve ne total dhe nuk ka saktësuar llojet e mbetjeve qe do te largohen po kështu duhet te kërkoje qe dhe leja mjedisore të jenë të përgjithshme duke e bërë këtë kërkesë të jete në raport me objektin që do të prokurohet.

Pika 8 kriterëve te veçanta “AK ka vendosur që operatorët ekonomike duhet te paraqesin kontenitore plastike (që do te mbushen me mbetje) me peshe te caktuar ndërkohe qe kjo kërkesë është jo ne përputhje me objektin, nuk ka logjike dhe nuk ka lidhje me shërbimin e kërkohet sepse, çfarëdo përmase te ketë kontenitori plastik qe do te paraqesë OE kjo nuk paraqet asnjë interes për AK.

Ankesa e OE “M.-T.” u shqyrtua nga komisioni i vlerësimit të ofertave në zbatim të urdhrit 2070/3 date 18.11.2019.

Me shkresën nr.2093/1 prot. datë 20.11.2019 I është kthyer përgjigje OE “M.-t.” në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesën e sipërcituar. KSHA është shprehur për secilin nga pretendimet e OE “M.-T” duke argumentuar që pretendimet nuk qëndrojnë dhe ankesa nuk pranohet.

Nga shoqëria P.-M. sh.p.k është paraqitur pranë AK-se formulari i ankesës i administruar pranë spitalit rajonal Elbasan me nr. 2103 date 19.11.2019, ku pretendohet nga OE ankimues që:

- që të specifikohet jo vetëm me numra por edhe me fjale (siç përshkruhen llojet e mbetjeve edhe nga legjislacioni) se cilat mbetje konkretisht kërkohen në këtë procedure, dhe te hiqen nga kërkesat e kësaj procedure mbetjet amalgame që krijohen nga kujdesi dentar...

-Sa i përket pretendimit të dyte, vërtete AK ka te drejte te kërkoje nga operatori të paraqesë

dëshmi për mjetet 23 dhe pajisjet teknike në realizim të kontratës, por jo sipërfaqen ku këto pajisje dhe mjete qëndrojnë apo operojnë. Kjo sepse sipërfaqja e mjeteve ka të beje me kapacitetin e tyre dhe jo me vete ekzistencën e mjetit. Në botën ku jetojmë, qëllimi i zhvillimit është që të prodhohen makineri që të kenë me shume kapacitete përpunimi dhe të mund të zënë sipërfaqe sa më të vogla. Ndaj në këtë rast, Autoriteti mund të veje kushte për kapacitetet përpunuese të makinerive por jo për sipërfaqen ku qëndron kjo makineri. Gjithashtu është absurde që në kriteret e tenderit të vendosen kushte sa i përket sipërfaqes ku OE kryen proceset administrative. Kjo sepse përmasat e zyrave ku kryen aktivitetin administrativ kompania nuk ndikojnë fare në procesin objekt të kësaj kontrate. Gjithashtu ky kriter bie ndesh me përcaktimet e nenit 23/1/2 të Ligjit 9643 të "Prokurimeve Publike" ku përcaktohet që specifikimet teknike duhet të vendosen në përputhje me objektin e kërkesës dhe në çdo rast duke mos prishur konkurrencën.

Me shkresën nr.2203/2 prot. datë 20.11.2019 i është kthyer përgjigje OE "M.-t." në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesën e sipërcituar. KSHA është shprehur për secilin nga pretendimet e OE "P.-m." duke argumentuar që pretendimet nuk qëndrojnë dhe ankesa nuk pranohet.

Sipas përcaktimeve të ligjit për prokurimet publike operatorët ekonomike ankimes paraqiten njëkohësisht ankesë pranë KPP.

Autoriteti Kontraktor bëri modifikimin e kriterëve të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit sipas Vendimit 07/2020 të Komisionit të Prokurimeve Publike.

Nga Agjencia e Prokurimeve Publike në kuadër të asistencës që APP iu jep autoriteteve kontraktore janë dërguar me e-mail rekomandimet për saktësim - riformulim të kriterëve, rekomandime të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht:

2. Në pikën 3.3 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: "Vërtetim se zotëron (pronësi ose këtë duhet të paraqesë faturën e blerjes ose kontrate qiraje)" impiant trajtimi konfort objektit të prokurimit. Për këtë duhet të paraqesë faturën e blerjes ose kontrate qiraje".

Në lidhje me dokumentet e kërkuar mbi vërtetimin e disponimit të impiantit të kërkuar, APP rekomandon që AK të lejojë mundësinë e paraqitjes edhe të çdo dokumenti tjetër, krahas faturës dhe kontratës së qerasë, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, për vërtetimin e disponimit në pronësi apo me qira (si psh: fatura e zhdoganimi etj).

3. Në pikën 3.3.5 të kapacitetit teknik, në lidhje me kërkesat e cilësisë, AK ka kërkuar që OE të jetë i pajisur me certifikatat: "Certifikate EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë; Certifikate EN ISO 14001:2015 Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit; Certifikate BS OHSAS 18001:2007 Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Pune".

Për sa më sipër, së pari, në lidhje me certifikatën BS OHSAS 18001:2007, rekomandojmë që AK të pranojë edhe OE të cilët disponojnë certifikatën me standardin e azhornuar dhe ekuivalent të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018.

Së dyti, Duke marrë në konsideratë se AK në kërkesat e certifikatave i është referuar edhe standardit EN apo EN/ISO, në kuptim të: nenit 23 të LPP, pika 3/a, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; faktit që ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, rekomandojmë që për standardet e mësipërme, AK të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN apo SSH/EN/ISO mbi konformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Së fundmi, në lidhje me kërkesat e cilësisë, sugjerojmë që AK të mbështetet në përcaktimet e nenit 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, dhe krahas kërkesës së certifikatave përkatëse, të

përcaktojë edhe se: "...Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga RSH".

4. Në pikën 3.3.6 të kapacitetit teknik, në lidhje me kërkesat mbi mjetet që duhet të disponojë OE, sugjerojmë që krahas bazimit në standardet e OBSH, në shtojcën | të Udhëzuesin kombëtar për administrimin e sigurt të mbetjeve spitalore, AK të bazohet edhe në pikën 9.3.3 të këtij Udhëzuesi si dhe në legjislacionin përkatës dhe në VKM nr.798 datë 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore".

5. Në pikën 3.3.8 të kapacitetit teknik, në lidhje me kërkesat e kontenitorëve një përdorimesh plastike, sugjerojmë AK që krahas referencës së standardeve OBSH dhe VKM nr.798 datë 20.09.2010 "Mbi mbetjet spitalore", në lidhje me llojin e kontenitorëve dhe etiketimit të tyre, të bazohet edhe në "Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të mbetjeve spitalore".

6. Së fundmi, sugjerojmë gjerësisht që rekomandimet e mësipërme në lidhje me mjetet, kontenitorët, apo edhe ambientin dhe e impiantet, AK duhet t'i mbajë në konsideratë edhe në ha në hartimin e specifikimeve teknike. Gjithashtu, në këto specifikime, sugjerojmë AK të përfshijë kërkesën e pajisjes me sinjalistikën dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambientin/ambientet përkatëse të Autoritetit kontraktor, në bazë të VKM nr.798, datë 29.09.2010 dhe Udhëzuesit kombëtar "Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore".

B. Në procedurën e prokurimit në fjalë, janë evidentuar edhe kritere të veçanta, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim. Konkretisht:

1. Në pikën 3.1 të kapacitetit ligjor/profesional të operatorëve ekonomik, AK ka kërkuar: "Leje Mjedisore Tipi B dhe Leje Mjedisore Tipi A, miratuar nga Ministria e Mjedisit, ku të përfshihen kodet përkatëse të mbetjeve sipas objektit të prokurimit".

Lidhur me pikën e mësipërme, APP sheh të nevojshme që AK të mirë argumentojë teknikisht nevojën e kërkesës së Lejes Mjedisore të Tipit B krahas lejes mjedisore të tipit A, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet ligjore për këto leje mjedisore, dhe faktin se çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

2. Në pikën 3.3.2 të kapacitetit teknik, në lidhje me numrin e punonjësve, AK ka kërkuar: "Numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës Janar - Tetor 2019 të jetë jo më i vogël se 10 (dhjete) punonjës;..."

Në lidhje me pikën e mësipërme, mbështetur në vlerën dhe tipologjinë e objektit të prokurimit, APP sheh të arsyeshme që AK të mirë argumentojë teknikisht nevojën për vendosjen e numrit të punonjësve të kërkuar për realizim të këtij shërbimi (jo më i vogël se 10 punonjës).

3. Në pikën 3.3.9 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: "Te kryeje aktivitetin në një sipërfaqe ndërtesë jo më të vogël se 300 m² sipas Lejes Mjedisore".

Lidhur me pikën e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se, trajtimi i mbetjeve spitalore Gjithashtu rekomandojmë që AK të shoqërojë këtë kërkesë me dokumentet konkretë provues mbi disponimin e ambientit/ndërtesës në bazë të nenit 28/2 të VKM nr.914 datë 29.12.2014: "Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për këtë procedure nuk është bere argumentimi teknik i kritereve të vendosura por vetëm është cituar baza ligjore në kundërshtim me përcaktimet e nenit 61 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit i përbërë nga B.D., Z. P., A. B..

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës, si dhe sistemit elektronik të APP, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 (dy) operator ekonomik:

Operatori ekonomik "M.-t." sh.p.k., me ofertë ekonomike në vlerën 9,000,000 lekë pa TVSH

Operatori ekonomik "E. R." sh.p.k., me ofertë ekonomike me vlerë 10,000,000 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar pa nr. prot., datë 28.04.2021, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik "E.-R." sh.p.k., me ofertë në vlerën 10,000,000 lekë pa TVSH.

Në vijimësi me date 03.03.2020 është nënshkruar drafti i marrëveshjes kuadër me nr. 2070/10 me vlere të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjate marrëveshjes kuadër në vlerën totale 12,000,000 leke me TVSH me afat 12 muaj .

Me date 11.03.2020 është nënshkruar kontrata nr. 588 prot ,me objekt "Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore" ,me vlere 12,000,000 leke me TVSH ,me afat të realizimit të kontratës nga data e nënshkrimit sipas nevojave të AK-së.

Zbatimi i kontratës

Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit, dokumentacioni që shërben për shlyerjen e faturës dhe që i bashkëlidhet urdhër shpenzimeve përkatëse janë situacioni, proces-verbal, konfirmim mbi asgjësimin e tyre, Shoqëria "E. R." është likuiduar për vlerën 10,510,000.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", ne baze te VKM nr. 798, datë 29.09.2010, "Për miratimin e rregullores, 'Për administrimin e mbetjeve spitalore'", strukturat spitalore si krijues të mbetjeve janë përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë. Në zbatim të kriterit mbi procedurën që vijon për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimit, asgjësimi i produktit final te trajtuar do të kryhet nga shoqëria koncesionare "I. E. B. S." sh.p.k., me të cilën OE ka lidhur marrëveshje të datës 07.01.2020, me afat deri 07.01.2021, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj.

Sipas akt-marrëveshjes "E. R." sh.p.k do të depozitohet çdo mbetje të gjeneruar të llojit spitalore të trajtuara, pranë zonës së trajtimit të mbetjeve Tirane (ZTMT), Sharrë, duke njoftuar paraprakisht me e-mail në adresën zyrtare të shoqërisë koncesionare: për dërgesën për depozitim.

Në vijim të akt marrëveshjes sipërcituar, OE nuk përcjell asnjë dokument justifikues për të vërtetuar se marrëveshja është ende në fuqi. Si rrjedhojë, edhe pse shërbimi i kërkuar dhe i paguar nga ana e AK është trajtim dhe asgjësim, pra përfshirë edhe asgjësimin e produktit final te trajtuar, nuk dokumentohet përmbushja e detyrimeve.

Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të produktit final të trajtuat, të përfituar nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk dihet ku derdhen këto mbetje, të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin publik.

Nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentacioni me qëllim vërtetimin e asgjësimit të mbetjeve, shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës.

Nga auditimi u konstatuan parregullsi në dokumentimin e realizimit të procesit të asgjësimit të produktit final të trajtuar. Duke marrë parasysh llojin e mbetjeve të trajtuara dhe dëmin që mund të shkaktojë në mjedis hiri(produkti final i trajtuar) që mbetet pas asgjësimit të mbetjeve, mos përmbushja e këtij detyrimi, për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve sjell ndikim në mjedis dhe në shëndetin publik.

Per veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit znj. B. D., znj. Z. P. dhe znj. A. B.

13. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj", viti 2021.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj.

1. Urdhër Prokurimi nr.2138 prot., datë 23.11.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 1, datë 12.11.2019 I. S.- jurist Z.P.- specialiste I. Sh.–ekonomiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2138/1 prot., datë 23.11.2020 A. B. D. K. O. T.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur-Marrëveshje kuadër” per 24 muaj.	3.Grupi per konstatimin e nevojave,perllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike nr.2065prot. datë 12.11.2020 1.Z. P. 2.E. Z. 3.E. M.	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 20,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 19,7500,000 lekë (98.75%)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 250,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 12.04.2021	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 13,000,000 leke pa TVSH TA dytesore 7,000,000 leke pa TVSH	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- ka; KPP- ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK 2222/ date 07.12.2020	13. Përgjigje Ankesës nga KKP 14/2021
b. Zbatimi i Kontratës		
13. Lidhja e kontratës M.K nr. 2138/14 prot., datë 04.03.2021 K.SH nr.2138/14 prot., datë 26.05.2021	14. Vlera e kontratës (me tvsh) 23,700,000 leke me TVSH	
15.Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli 19,908,000 leke	16.Afati i kontratës në ditë 24 muaj	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 13.000.000 lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat dytësore të institucionit ne vlerën 7,000,000 lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me shkresën nr. 2065 Prot., datë 12.11.2020 nga titullari i AK-së është nxjerre urdhri për ngritjen e komisioni për konstatimin e nevojave dhe përlllogaritjen e fondit limit për objektin “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”, i përbëre nga znj. Z. P., znj. E. Z. dhe znj. E. M.. Me relacionin pa nr. Prot. dhe pa date grupi i përlllogaritjes ka paraqitur sasinë e parashikuar të mbetjeve për asgjësim sipas regjistrit faktit të vitit 2019 ku si çmim reference është marre çmimi i kontratës se mëparshme me OE “E.” me vlerë çmim/njësi 400 lekë pa TVSH.

Planifikimi i nevojave për marrëveshjen kuadër për vitet 2021-2022 ka qene 50,000 kg.

Nuk ka një relacion qe të përshkruaje sasinë totale të mbetjeve të gjeneruara dhe të pritshme të dhe sasitë sipas kodeve përkatëse (Katalogu Shqiptar i Klasifikimit të Mbetjeve).

Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, studimit të tregut, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014,

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 59 “Perlllogaritja e vlerës limit të kontratës” ku është shprehur se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës..

2. *Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”*

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga Z. P., E.Z., E. M.

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për këtë procedure nuk është bere argumentimi teknik i kriterëve të vendosura por vetëm është cituar baza ligjore në kundërshtim me përcaktimet e nenit 61 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit përbërë nga I. S., Z. P., I. Sh.

Me shkresën nr. 2138 date 23.11.2020 nga titullari i AK-së është nxjerre urdhri i prokurimit për procedure me objekt “**Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore**” me **fond limit 20,000,000 leke pa TVSH**, procedurë e hapur mbi kufirin e ulet monetar, me afat 24 muaj. Njësia e prokurimit përbehet nga I. S.-juriste, I. Sh.-ekonomiste, Z. P.-specialiste.

Me shkresën nr. 2138/1 prot., datë 23.11.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përberë nga A. B., D. K., O. T.

Kriteret e vendosura janë ndryshuar me procesverbalin date 04.12.2020 pas konstatimeve të njësisë se prokurimit për saktësimin e disa kriterëve.

sipas vendimit 07/2020 te komisionit te Prokurimeve Publike.

Zhvillimi i procedurës

Nga shoqëria M.-t. sh.p.k është paraqitur pranë AK-se formulari i ankesës i administruar me nr. 2222 prot. date 07.12.2020, në ankesën e paraqitur citon se “*AK të bëjë një përlllogaritje të afërt në kg për secilën kategori që ata gjenerojne në mënyre që ashtu si ne, por dhe çdo operator ekonomik pjesëmarrës në këtë procedure tenderimi ta këtë me të qarte përlllogaritjen e kostos, dhe rrjedhimisht çmimin që do të ofroje.*

Nga shqyrtimi i kriterëve të pjesëmarrjes ne DST disa prej kriterëve janë te paligjshme e ne shpërpjesëtim me objektin e tenderit. Konkretisht:

Pika 3.1 , -Objekti prokurimit janë mbetjet e rrezikshme spitalore të klasifikuara me kodet 18.01.03,18.01.01,18.01.02,18.01.08 (Sipas VKM-së Nr.798 date 29.09.2010

-leje mjedisore Tipi B dhe leje mjedisore Tipi A, miratuar nga Ministria e Mjedisit, ku të përfshihen kodet përkatëse të mbetjeve spitalore objekt i prokurimit. Licenca III2B lëshuar nga QKL ku përfshihen kodet sipas objektit te prokurimit.

Ne VKM ,KODI 18.01.03 nuk citohet fare. Ju lutem korrigjoni Dst dhe të cilësoni rastet kur i referoheni VKM-së dhe rastet kur duhet ti referoheni Katalogut shqiptar te mbetjeve si në rastin konkret...

Ankesa e OE “M.” u shqyrtua nga komisioni i vlerësimit të ofertave në zbatim të urdhrimit 2138/7 date 07.12.2020.

Me shkresën nr.2222/1 prot. date 07.12.2020 i është kthyer përgjigje OE “M.-t.” në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesën e sipërcituar. KSHA është shprehur për secilin nga

pretendimet e OE "M.I" duke argumentuar që pretendimet nuk pranohen përveç pikës 1, për përcaktimin e sasive përkatëse sipas kodeve, kërkesë që është pranuar nga AK.

Me vendimin nr.14/2021 date 12.01.2021, në lidhje me ankesën e paraqitur nga OE "M.-T." KPP ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE "M.-T." sh.p.k, për procedurë e prokurimit me REF-80546-12-01-2020, me objekt "Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, më fond limit 20,000,000 leke pa TVSH dhe lejon AK të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Me urdhrin pa nr. Prot. date 28.02.2021 është ngritur komisioni për vlerësimin e mostrave i përberë nga K. Z., R. B., V. N.

Nga komisioni për vlerësimin e mostrave me date 04.02.2021 u mbajt procesverbali për testim të mostrave në prokurimin me objekt "Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore". Sipas procesverbalit të dy OE pjesëmarrës plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në dst për mostrat e paraqitura për vlerësim.

Sipas procesverbalit të vlerësimit dhe të dhënave nga SPE për këtë procedurë prokurimi morën pjesë 2 operatore ekonomike, konkretisht:

Operatori ekonomik "E. R." me formular të ofertës ekonomike çmim/njësi e paraqitur 395 leke pa TVSH, dhe çmim total 19,750,000 lekë pa TVSH.

Operatori ekonomik "M.-T." shpk me formular të ofertës ekonomike çmim për njësi 240 leke pa TVSH, çmim total 12,000,000 leke pa TVSH.

Nga operatori ekonomik Medi-tel u paraqit formulari i ankesës i administruar pranë SRE me nr. 277 prot. date 11.02.2021,,

-Sipas procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës i ngritur për vlerësimin e mostrave, Oe "M.-t. "plotëson specifikimet teknike sipas dst-ve për mostrat e paraqitura.

-Sipas procesverbalit të vlerësimit të mbajtur nga komisioni i vlerësimit OE nuk plotëson pikën 8 të dst- Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmase një përdorimesh, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për çdo përmasë, sipas Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.

Nga njësia e prokurimit është shqyrtuar ankesa e OE "M.-t.", ku janë shqyrtuar të gjitha pretendimet e paraqitura në ankese dhe KSHA ka vendosur që pretendimet nuk qëndrojnë dhe ankesa nuk pranohet.

Sipas raportit përmbledhës të mbajtur me date 01.03.2021 në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave komisioni vendos të shpallë fitues të kësaj procedure prokurimi OE "E." me vlerën 395 lekë çmim/njësi dhe vlerë të pritshme kontratave 19,750,000 leke pa TVSH.

Me date 04.03.2021 është nënshkruar drafti i marrëveshjes kuadër me nr. 2138/14 me vlerë të prishmë të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër në vlerën totale 12,000,000 lekë me TVSH me afat 24 muaj.

Me date 04.03.2021 është nënshkruar kontrata nr. 2138/14 prot, me objekt "Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore", me vlerë 19,750,000 leke pa tvsh dhe 23,700,000 leke, e TVSH., më date fillimi datën 20.04.2021.

Për vitin 2021 7,963,200 leke me TVSH.

Për vitin 2022 11,944,800 leke me TVSH

Për vitin 2023 3,160,000 leke me TVSH.

Neni 8 AK rezervon të drejtën për të mos e tërhequr të gjithë sasinë e mallit objekt kontrate, nëq nuk do ta gjejë të nevojshme dhe në këtë rast nuk do të mbaje asnjë përgjegjësi financiare.

Formulari njoftimit kontratës date 17.08.2021.

Në zbatim të kriterit mbi procedurën që vijon për depozitimin e produktit final të trajtuar, asgjësimi i produktit final të trajtuar do të kryhet nga shoqëria koncesionare "I. E. B. S." sh.p.k., me të cilën OE ka lidhur marrëveshje të datës 08.12.2020, me afat deri 08.12.2021,

duke filluar nga data e nënshkrimit të saj.

Sipas akt-marrëveshjes “E. R.” sh.p.k do të depozitohet çdo mbetje te gjeneruar të llojit spitalore te trajtuara, pranë zonës se trajtimit të mbetjeve Tiranë (ZTMT), Sharrë, duke njoftuar paraprakisht me e-mail në adresën zyrtare të shoqërisë koncesionare: për dërgesën për depozitim.

Në vijim të akt marrëveshjes sipërcituar, OE nuk përcjell asnjë dokument justifikues për të vërtetuar se marrëveshja është ende në fuqi. Si rrjedhojë, edhe pse shërbimi i kërkuar dhe i paguar nga ana e AK është trajtim dhe asgjësim, pra përfshirë edhe trajtimin e hirit të prodhuar, nuk dokumentohet përmbushja e detyrimeve.

Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të hirit të përfituar nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk dihet ku derdhen këto mbetje, të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin publik.

Nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentacioni me qëllim vërtetimin e asgjësimit të mbetjeve, shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës.

Veprime në kundërshtim me pikën 2, 3 dhe 4, neni 21, ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, sipas së cilit:

-Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton kushtet e përgjegjësisë dhe specifikon se në cilat raste krijuesi fillestar mban përgjegjësi për të gjithë zinxhirin e trajtimit dhe në cilat raste përgjegjësia ndahet mes tij dhe zotëruesit të mbetjeve apo u delegohet aktoreve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit.

-Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rrethanat në të cilat përgjegjësia për organizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve mbartet, plotësisht apo pjesërisht, nga prodhuesi i produktit që krijon mbetjet dhe rrethanat kur këto përgjegjësi mund të ndahen me shpërndarësit e këtij produkti.

-Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre.

Si dhe në kundërshtim me shkronjën e), pika 5, kreu II, VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për administrimin e mbetjeve spitalore””, sipas së cilit:

Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për: të gjitha demet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.

4.Nenin 2, neni 8 dhe neni 52, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku cilësohet:

- “Titullarët e njësive publike, të përmendura në neni 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.”

-Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”.

- “Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik”.

Pika 5, Neni 21, Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, sipas së cilit:

Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

Neni 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se Neni 2 “Qëllimi”

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Nga autoriteti kontraktor nuk është realizuar mbikëqyrja e kontratës sipas përcaktimeve të nenit 77 të VKM 914 date 29.12.2014, ku shprehet qartë se:

Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe/ose organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. 2. Mospërbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. 2. Mospërbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së.

Konkluzione

-Grupi i auditimit konstatoi se specifikimet teknike të vendosura tentojnë të kufizojnë konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një operatori ekonomik, në kundërshtim me nenin 23, ligji nr. 9643 date 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 dhe 5, nenin 2.

-Operatori ekonomik “E.R.” sh.p.k, është i vetmi operator ekonomik fitues për të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor Elbasan përgjatë 4 viteve në lidhje me objektin e prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”.

- Parregullsi në dokumentimin e realizimit të procesit të asgjësimit të produktit final të trajtuar (hirit). Strukturat spitalore si krijues të mbetjeve janë përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë. Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të produktit final të trajtuar, të përfutur nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk dihet ku derdhen këto mbetje, të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin publik.

Per veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit B. D., Z. P., A. B.

- Për sa trajtuar në këtë pjesë, nga B. D., Z. P., E. Z., E. M., është paraqitur observacioni me shkresën nr. 539/36 prot., datë 29.03.2024, në lidhje me aktkonstatimin nr. 20, datë 21.03.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Grupi i përlllogaritjes së fondit i është referuar përcaktimit ligjor për fondin limit duke qene se neni i mësipërm përcakton se metodat që duhet të përdoren janë alternative të njëra tjetres dhe jo kumulative.

Ne lidhje me kriterin e argumentimit të specifikimeve teknike, duhet të sqarohet se baza ligjore

e referuar për procedurën në fjale përmban të gjitha kërkesat dhe kriteret teknike që duhet të përmbushen në proceset e evadimit të mbetjeve spitalore.

Personat e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të kontratës kanë bërë disa here vizita në terren në ambientet e kontraktorit “E.-R.”

Kërkesa e instalimit të një frigoriferi të tille është vetëm për të siguruar garanci maksimale, sidoqoftë rregullat e sipërcituara përcaktojnë temperaturën me të lartë të lejueshme, por nuk vendosen kufi për temperaturën e ulet.

Lejet mjedisore të subjektit në fjale, e kanë si pjesë të kushteve pasjen gjatë gjithë kohës aktive të kontratës me subjekt të pajisur me leje mjedisore për depozitimin e produktit final.

Duhet saktësuar se gjurma e auditimit janë formularët e transferimit të mbetjeve që mbahen nga kontraktori.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në akt konstatimin e mbajtur për këto procedura prokurimi janë sqaruar në detaje problematikat e konstatuara.

Strukturat spitalore si prodhues të mbetjeve spitalore në zbatim të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve spitalore” kanë për detyrë ndjekjen e kontratave deri në asgjësimin e produktit final të trajtuar.

Persa i përket monitorimit të kontratës dhe vizitave në terren nuk keni paraqitur fakte dhe argumente shtesë,

Pretendimet tuaja qëndrojnë pjesërisht, vetëm për pjesën argumentimit të kërkesës për frigoriferin..

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

14. Procedura e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës”, viti 2022.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës”		
1. Prokurim nr.1066/1 Prot., datë 25.07.2022	Urdhër	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur		4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1066 prot., datë 07.07.2022 S. D. –Kryetar I.Sh.- Anetare A. C.-Anetare
5.Fondi Limit (pa tvsh) 14,166,667	6. Oferta fituese (pa tvsh) 13,995,000	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 171,667 lekë 98.7 %
8. Data e hapjes së tenderit Data 15.08.2022	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- s’ka; KPP- s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës		
13. Lidhja e kontratës K.SH nr.1066/6 prot., datë 31.08.2022 Amendim kontrate 1066/13 nr.prot. 29.09.2022	14. Vlera e kontratës (me tvsh) 16,794,000 lekë me TVSH 13,995,000 leke pa TVSH	

15.Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli	16.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 30 ditë
--	--

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 14,166,667 lekë. Kjo procedurë nuk është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Lidhur me përlogaritjen e fondit limit,

Nga Ministria e Shëndetësisë është dërguar me email kërkesa “*për marrje masash për ngritjen e grupeve të punës për të përlogaritur fondin limit ,specifikimet teknike me qellim hedhjen e procedurës së prokurimit menjëherë me marrjen e miratimit nga MFE*”, për zërin e investimit “*Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës sp.Elbasan*”. Në e-mailin e dërguar MSHMS ka vendosur shënimin që “*Për procedure e mallrave afatet e lëvrimin të mos vendosen me shume se 30 ditë*”.

Me urdhrin e brendshëm të titullarit të AK-së me nr. 1029 prot. datë 27.06.2022 i përberë nga D. M. –inxhinier biomjekësor, J. B.-mjek okulist, A. Xh. –mjeke okuliste, për konstatimin e nevojave, hartimin e domosdoshmërisë listës së pajisjeve dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “*Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës spitalit Elbasan*”.

Grupi i punës ka dorëzuar procesverbalin pa nr. Prot. me date 01.07.2022 për konstatimin e nevojave dhe specifikimeve teknike. Pajisjet biomjekësore të domosdoshme për kryerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të kataraktës janë:

- a.Mikroskop kirurgjikal i avancuar okulistik cope 1
- b.Fakoemulsifikator (PHACO,) cope 1
- c.Biometer i tipit A scan cope 1

Me urdhrin e brendshëm të titullarit të AK-së me nr. 1066 prot. date 01.07.2022 është ngritur grupi i punës i përberë nga S. D.–, I. Sh., A. C., për testimin e tregut, përlogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit me objekt “*Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës spitalit Elbasan*”.

Grupi i punës hartoi procesverbalin pa nr. Prot. date 06.07.2022 për testimin e tregut dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, nëpërmjet ofertave ekonomike të marra nga operatorët ekonomike E. sh.p.k, M. sh.p.k dhe OE “G.-A.” sh.p.k.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me shkresën nr. 1066/1 prot. date 25.07.2022 është nxjerre urdhri i prokurimit nr. 140 për prokurimin e objektit “*Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës sp. Elbasan*”, me fond limit 14,166,667 leke pa TVSH vene në dispozicion nga buxheti i shtetit, lloji i procedurës e hapur. Njësia e prokurimit është përberë nga: I. S. –juriste, Xh. K.-ekonomiste, D. M.-Inxhinier biomjekësor.

Me urdhrin nr. 1066/2 date 25.07.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përberë nga A. B., O. T. dhe R. D.

Në kundërshtim me përcaktimet e nenit 78 të Vendimit nr. 285, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, *çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.*

Ne procesverbalin e hartimit të kriterëve të kualifikimit, është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës. Konkretisht për piken 2.3.4 të DST-ve ku citohet se: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për pajisjen e ofruar ku në çdo rast të dokumentohet*

lidhja e distributorit me prodhuesin për ofertim të pajisjes objekt i kësaj procedure. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si telefon, faks, e-mail, ëbsite nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”.

Argumentimi i bërë për piken 2.3.5 nuk përcakton teknikisht dhe nuk justifikon vendosjen e kësaj kërkesë për kualifikim dhe është në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, neni 1, neni 20 dhe neni 36 pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite:

“Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 28, pika 2 ku është shprehur se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Për autorizimin e prodhuesit është shprehur dhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendim nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Nga vlerësimi i këtij rasti, rezulton se auditimi i kryer në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë DPPSH ka konstatuar mungesë të konkurrencës në procedurat prokuruese të mirëmbajtjes së disa aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të kufizimit në lëshimin e autorizimit të prodhuesit vetëm për një operator, konstatim i cili ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve kualifikues dhe specifikimeve në DST, të cilat vendosen nga vetë Autoriteti Kontraktor. Vendosja e këtyre kriterëve, në respektim të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet”.

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” apo “Super specifikimit” Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendim nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” apo “Super specifikimin” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në

dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Nga NJHDT ne DST pika 2.3.7 është përcaktuar se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **EN ISO 13485:2012/EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësorë ose ekuivalente, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit. ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë. Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë”.

Përsa i përket kësaj kërkesë Agjencia e Prokurimit Publik është shprehur në Rekomandimin me nr. 8197 te datës 03.02.2018 “Autoritetet Kontraktore në dokumentet e tenderit për mallra apo edhe në rastin e punëve publike, kërkojnë që operatorët ekonomike të paraqesin përveç autorizimit të prodhuesit, katalogëve ,skedave teknike apo raporteve të testimi ,edhe certifikata të ndryshme ISO që prodhuesi (i cili nuk ka lidhje me procesin) duhet të disponojë ,veçanërisht certifikatë te menaxhimit te cilësisë së prodhuesit të mallit .

Ne nenin 46,pika 2 te LPP parashikohet se: Autoriteti kontraktor mund te kërkojë edhe certifikata, te lëshuara nga organet e pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë ,përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit”

Në nenin 30 të VKM-se Nr. 914,datë 29.12.2014 parashikohet se: AK për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt i prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkoje ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Operatorët ekonomike ofertues në një procedure ,në varësi të objektit të prokurimit ,mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit , dhe e sigurojnë mallin/shërbimin nga këta të fundit, apo distributoret e autorizuar prej tyre. Në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO të prodhuesit rezulton ti adresohet palëve të treta (prodhuesit/distributorit), të cilat nuk janë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përberë nga I. S., Xh. K. dhe D. M.

Zhvillimi i procedurës

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 15.08.2022, si dhe sistemit elektronik të APP, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 3 (tre) operator ekonomik “C. PH.” sh.p.k., me ofertë në vlerë 12,900,000 lekë pa TVSH, operatori ekonomik “P.” sh.p.k., nuk ka paraqitur oferte ekonomike, dhe operatori ekonomik “G.-A.” sh.p.k me ofertë me vlerë 13,995,000 lekë pa TVSH.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar pa nr. prot., datë 30.08.2022, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ” **G.-A.” sh.p.k me ofertë me vlerë 13,995,000 lekë pa TVSH.**

Operatori ekonomik “P.” sh.p.k është s’kualifikuar për mos plotësim të specifikimeve teknike. Në vijim është lidhur kontrata me nr. 1066/9 prot., datë 31.08.2022, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitalit Rajonal Elbasan të përfaqësuar nga z. A. G., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit ekonomik “G.-A.” sh.p.k përfaqësuar nga administratori M.n K., në vlerën 13,995,000 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e kontratës është 30 ditë nga nënshkrimi i saj.

Me urdhrin nr. 1462 date 26.09.2022 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të pajisjeve biomjeksore për shërbimin e okulistikës, i përberë nga A. Q., A. I. dhe D. M.

Likuiduar me:

-Urdhër shpenzimin nr.631 , datë 06.10.2022 për vlerën 8,994,000 lekë, nëpërmjet BKT-së, është likuiduar Shoqëria “G. A. F.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “F.V vendosje pajisje biomjeksore për shërbimin e okulistikës”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike nr. 9/2022, datë 26.09.2022, procesverbal i vlerësimit, Procesverbal i marrjes në dorëzim, fletë-hyrje 7 date 26.09.2022.

- Urdhër shpenzimin nr.805, datë 30.11.2022 për vlerën 7,675,200 lekë, nëpërmjet BKT-së, është likuiduar Shoqëria “G. A. F.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “F.V vendosje pajisje biomjeksore për shërbimin e okulistikës”. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike nr. 20/2022, datë 25.11.2022, procesverbal i vlerësimit, Procesverbal i marrjes në dorëzim pa nr. prot. date 25.11.2022 ,flete-hyrje nr 10 date 25.11.2022;

15. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Blerje pajisje mjekësore për shërbimin e ORL-së”.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje pajisje mjekësore për shërbimin e ORL-së ”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 558, datë 27.03.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 48, datë 27.03.2023 I.S.- juriste Xh.K.- ekonomist/ sektori i kostos D. M.- inxhinier biomjekësor	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 558/1, datë 27.03.2023 L. R. O. T. R.D.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,422,299 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 4,958,000 leke	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 464,299 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 17.01.2022	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- ka OE G.f. 679 nr.prot date 06.04.2023 KPP- s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Modifikim i kritereve të dst-ve	13. Përgjigje Ankesës nga KKP Refuzim i ankesës
b. Zbatimi i Kontratës Mallrave		
14.Kontrata nr. 588/11 prot. 19.06.2023 Urdhër shpenzimin nr. 490, datë 31.07.2023 për vlerën 5,949,600 lekë Urdhër shpenzimin nr. 1544, datë 19.05.2022 për vlerën 142,021.60 lekë	17.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 60 ditë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga te ardhurat dytësore me vlerë 5,422,299 lekë lekë.

Kjo procedurë nuk është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me shkresën nr. 389 Prot., datë 20.02.2023, nga titullari i AK-së është ngritur urdhri për konstatimin e nevojave dhe specifikimeve teknike për procedure e prokurimit me objekt

“Blerje pajisje mjekësorë për shërbimin e ORL-së”.

Grup i punës i përberë nga M. K. Shef Shërbimi ORL, Ai Bi –infermiere e sallës ORL, D. M. – specialist biomjekësor nëpërmjet procesverbalit të mbajtur me date 22.02.2023 paraqiten nevojat dhe specifikimet teknike për procedure e prokurimit “Blerje pajisje mjekësorë për shërbimin e ORL-së”

Me urdhër nr. 411 prot. date 22.02.2023 është ngritur komisioni për testimin e tregut për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje mjekësorë për shërbimin e ORL-së”, i përberë nga V. T., I. Sh., A. C.

Nëpërmjet procesverbalit të mbajtur me dt. 27.02.2023 grupi i punës i ngritur për testimin e tregut ka propozuar që çmimi baze për përlllogaritjen e fondit limit të jete mesatarja e çmimeve/njësi të testuara. Grupi i testimit të tregut ka marrë për baze ofertat ekonomike të 3 OE.

OE G. A. F. me vlerë totale të ofertës ekonomike në shumen 4,473,700 lekë pa tvsh.

OE M. sh.p.k me vlerë totale të ofertës ekonomike në shumen 5,230,200 lekë pa tvsh.

OE D. sh.p.k me vlerë totale të ofertës ekonomike në shumen 4,774,600 leke pa tvsh.

Me shkresën nr. 17/81 date 10.03.2023 MSHMS ka miratuar shpenzimet nga të ardhurat dytësore për zërin “Blerje pajisje mjekësorë për shërbimin e ORL-së” deri në vlerën 6,506,759 lekë me TVSH.

Njësia e prokurimit ka hartuar preventivin dhe ka përcaktuar se fondi limit për procedure e sipërcituar është 5,422,299 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr. 588/1 date 27.03.2023 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përberë nga L. R., O. T. dhe R. D.

Në për procesverbalin e mbajtur për hartimin e kriterëve nuk është argumentuar teknikisht kriterit 2.3.6 për ISO prodhuesi dhe për kriterin 2.3.3 të autorizimit të prodhuesit.

Me shkresën nr. 558 prot. është nxjerre urdhri i prokurimit me nr. 48 date 27.03.2023 për prokurimin e objektit “Blerje pajisje mjekësorë për shërbimin e ORL-së me vlerë të fondit limit 5,422,299 lekë pa TVSh, procedure e hapur e thjeshtuar. Njësia e prokurimit përbehet nga I.S. –juriste, Xh. K.-ekonomiste, D. M. –inxhinier biomjekësor.

Zhvillimi i procedurës

Nga OE “Almedical” është paraqitur formulari i ankesës i administruar pranë AK-së me shkresën nr. 679 date 06.04.2023. Sipas OE ankimes “*Ne dst-të ,pika 2.3.5 është kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi*”.

Konstatohet se nga kërkimet tona se këto artikuj Audiometer diagnostic, tipanometer diagnostic, me përshkrim 100 % të specifikimeve në dst i përket kompanisë prodhuese I., dhe kjo kompani rezulton që ka një distributor në Shqipëri i cili është “S. M.”, që ka të drejtën ekskluzive të tregtimit të produkteve të “I.”. Në këtë situatë kompania jone pale e interesuar për të marrë pjesë në këtë procedure prokurimi, nuk mund të sigurojë dot letrën e autorizimit nga kompania “Intracoustics”, dhe në baze të përshkrimit të artikullit AK nuk ka lënë hapësirë për opsionin ekuivalent të artikullit. Ky produkt do të ketë një prezantues të vetëm që plotëson të gjitha specifikimet teknike të produktit, dhe rrjedhimisht do e çojë atë në fitues të procedurës.

Sistem/irrigim/aspirim e veshit me sensor me përshkrim 100 % të specifikimeve në dst i përket kompanisë prodhuese “E. A.”. Në këtë situatë kompania jone pale e interesuar për të marrë pjesë në këtë procedure prokurimi, nuk mund të sigurojë dot letrën e autorizimit nga kompania I., dhe në baze të përshkrimit të artikullit AK nuk ka lënë hapësirë për opsionin ekuivalent të artikullit. Ky produkt do të ketë një prezantues të vetëm që plotëson të gjitha specifikimet teknike të produktit, dhe rrjedhimisht do e çojë atë në fitues të procedurës.

Si për procedurën e sipërcituar edhe për këtë procedure konstatohen të njëjtat problematika për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre .

Titullari i Ak-së me shkresën nr. 588/5 date 12.04.2023 ka miratuar vendimin e Komisioni të shqyrtimit të ankesës (i përberë nga L. R. ,R. D., O. T.) ku vendosi, të mos pranojë ankesën e

OE "A." sh.p.k sipas konstatimeve dhe argumenteve përkatës.

Me vendimin nr. 409/2023 KPP vendos mos pranoje ankesën e Operatorit ekonomik ankimues duke e vlerësuar si jashtë afateve për mos paraqitjen njëkohësisht të ankesës pranë Ak-së dhe KPP sipas përcaktimeve të ligjit për prokurimin publik.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar pa nr. prot., date 16.06.2023 datë 25.01.2022, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, sipas të cilit rezulton që në këtë procedure prokurimi morën pjese operatorët ekonomik

OE "A." shpk me vlere e ofertës ekonomike në shumën 4,620,000 leke pa tvsh.

OE "G. A." shpk me vlere e ofertës ekonomike në shumën 4,958,000 leke pa tvsh.

OE "A. F." shpk me vlere e ofertës ekonomike në shumën 5,269,700 leke pa tvsh.

OE "E." shpk me vlere e ofertës ekonomike në shumën 5,392,000 leke pa tvsh.

U vlerësua si e vlefshme oferta e operatorit ekonomik "G.-A." shpk.

Me date 19.06.2023 është nënshkruar kontrata me nr. 588/11 prot. ndërmjet Qendrës Spitalore "Xh.Kongoli" Elbasan, përfaqësuar nga drejtori z. A. G. dhe operatorit ekonomik "G.-A." shpk me vlere të kontratës 5,949,600 lekë me TVSH me afat 60 dite nga data e nënshkrimit të kontratës.

Likuiduar me:

- Urdhër shpenzimit nr. 490, datë 31.07.2023 për vlerën 5,949,600 lekë, nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare, është likuiduar Shoqëria "G. A. F." shpk, me objekt shpenzimi "Blerje pajisje mjekësore për ORL-në". Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike nr. 28/2023, datë 20.07.2023, Flete-hyrja nr. 6. Date 20.07.2023.

Në procedurat e prokurimit me objekt: "Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës" dhe "Blerje pajisje mjekësore për shërbimin e ORL-së" janë konstatuar edhe problematikat si më poshtë vijon:

1. Lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike të cilat janë reflektuar edhe në DST, për të dy procedurat konstatohet në mbështetje të parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon procedurën e prokurimit publik, sipas së cilit kriteret e vendosura nga OE duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor rregullator "Për pajisjet mjekësore", për realizimin e kësaj procedure duhet të ishin vendosur edhe kriteret e tjera kualifikuese, si :

-Ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim të regjistrimit të pajisjes mjekësore artikujt. të AKBPM-ja ose deklarate paraprake, për garantimin e regjistrimit të pajisjes mjekësore të AKBPM-ja, pas shpalljes fitues, sipas ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore".

Persa i përket zbatimit të kontratës

Në Kontratën e furnizimit të nënshkruara nga AK Spitali Rajonal Elbasan për të dy procedurat e prokurimit të sipërcituara, konkretisht kontrata lidhur me nr. 1066/9 prot., datë 31.08.2022, dhe kontrata 588/5 date 19.06.2023, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 "Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli", pika 1, ku është shprehur në mënyrë se "Duhet të respektohen termet e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi "Kushtet e dorëzimit" të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat", që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor.

Gjithashtu nuk ka raport instalimit/funksionimi të pajisjes dhe formular trajnimi të personelit mjekësor që do ta përdor pajisjen.

Për realizimin e kontratës nr. 1066/9 prot ,date 31.08.2022 nga operatori ekonomik "G.-A." nuk është hartuar deklarata sipas përcaktimeve të nenit 10 të Ligjit "Për pajisjet mjekësore "ku

përcaktohet se:

1. Çdo person, fizik ose juridik, që i bashkon së bashku pajisjet që mbartin markimin CE, brenda kufijve të përdorimit të specifikuar nga prodhuesit e tyre, me qëllim vendosjen e tyre në treg, si një sistem apo paketë procedurale, anashkalon procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe harton një deklaratë, në të cilën shprehet se:

- a) ka verifikuar përputhshmërinë e ndërsjellë të pajisjeve me udhëzimet e prodhuesve dhe ka kryer veprimet e tij në përputhje me këto udhëzime;
- b) ka paketuar sistemin ose paketën procedurale dhe ka paraqitur informacionin përkatës për përdoruesit e fundit, duke përfshirë udhëzimet përkatëse nga prodhuesit;
- c) i gjithë aktiviteti u nënshtrohet metodave të duhura të kontrollit dhe inspektimit të brendshëm.

Nga Autoriteti Kontraktor në zbatim të përcaktimeve të nenit 107 të VKM 285 datë 19.05.2021 nuk është përcaktuar me urdhër personi përgjegjës i cili merr informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

Konkluzion

-Në kriteret e hartuara nga njësia e prokurimit për këtë procedure prokurimi, në kundërshtim me rekomandimin e APP-së, në procesverbalin e hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës.

-Kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit për procedurat e sipërcituara nuk mundësojnë trajtim të njëjtte për të gjithë kandidatet dhe shërbejnë si pengesë për konkurrencën e hapur.

Kriteret e veçanta në DST janë të pa plota dhe nuk garantojnë cilësinë e mallit.

-Operatori ekonomik i shpallur fitues për këtë procedure prokurimi "G.-A." për pajisjet e furnizuara që mbartin markimin CE, brenda kufijve të përdorimit të specifikuar nga prodhuesit e tyre, me qëllim vendosjen e tyre në treg, si një sistem apo paketë procedurale, nuk ka paraqitur deklaratë ku të shprehe se:

- a) ka verifikuar përputhshmërinë e ndërsjellë të pajisjeve me udhëzimet e prodhuesve dhe ka kryer veprimet e tij në përputhje me këto udhëzime;
- b) ka paketuar sistemin ose paketën procedurale dhe ka paraqitur informacionin përkatës për përdoruesit e fundit, duke përfshirë udhëzimet përkatëse nga prodhuesit;
- c) i gjithë aktiviteti u nënshtrohet metodave të duhura të kontrollit dhe inspektimit të brendshëm, e gjithë kjo kundërshtim me ligjin Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore" neni 10 .

-Nga autoriteti kontraktor për marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore nuk është kërkuar paraqitja e dokumenteve që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, si certifikata e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e garancisë, kjo në kundërshtim me rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2106 datë 24.03.2021.

Në specifikimet teknike është vendosur si "Specifikim i tepërt" apo Autorizimi nga prodhuesi dhe Certifikate ISO prodhuesi.

Marrja në dorëzim e mallrave në mungesë të certifikatës së origjinës së mallit dhe të regjistrimit pranë AKBPM, raport testet e fabrikës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi I. S., Xh. K. dhe D. M., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi A. Q., A. I., D. M. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

16. Mbi auditimin e procedurës "Mirëmbajtje e pajisjeve radiologjike", 3 lote, marrëveshje kuadër me fond limit 15,756,383 lekë pa TVSH, për vitin 2021.

Sipas dokumentacionit te vene ne dispozicion konstatohet qe:

Procedura e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e pajisjeve radiologjike", 3 lote, marrëveshje kuadër me fond limit 15,756,383 lekë pa TVSH, per vitin 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 2141 prot, datë 23.11.2020	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit -I. S. juriste -D. K. ekonomiste -D. M. inxhinier Komisioni per konstatimin e nevojave D. M. D. K. Q. H. Komisioni i testimit te tregut R. D. K. T. A. C.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 2141/1 prot, datë 23.11.2020 -A. B.; kryetare -E. Sh.; anetar -O. T. ; anetare
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e hapur, marrëveshje kuadër"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 15,756,383 lekë Fondi limit per lotët e realizuara Lot 1 5,220,384 Lot 2 1,180,000 Lot 3 9,355,999	6. Oferta fituese (pa tvsh) Lot 1 5,220,360 lekë Lot 2 1,179,960 lekë Lot 3 9,355,992 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 24 lekë 40 lekë 7 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 21.12.2020	9. Burimi Financimit 10,000,000 leke Fond nga buxheti i shtetit 5,756,383 leke Fond nga te ardhurat dytesore	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _ Lot 1 H.& L. shpk Lot 2 H.& L. shpk Lot 3 B.E. b) S'kualifikuar __-__0_OE, c) Kualifikuar __1__ OE per secilin Lot
11. Ankimime-ska	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik _-
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Drafti i marrëveshjes kuadër nr 2141/8 prot. date 09.02.2021 Lidhja e kontratës, loti 3 nr. 2141 prot., datë 09.02.2021 Lidhja e kontratës, loti 1,2 nr. 2141 prot., datë 26.01.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 15,756,383 leke pa TVSH 11,227,190 leke me TVSH 7,680,384 leke me TVSH	24 muaj nga nënshkrimi 24 muaj nga nënshkrimi 24 muaj nga nënshkrimi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën pa nr. Prot me dt 02.11.2020 pa nr. prot. doktor A. M. kirurg ortoped dhe K. P. K/inf i salles se operacionit jane drejtuar drejtorisë se spitalit, duke kërkuar mirëmbajtjen e pajisjes Grafi-fluoroscopi i tipit C-Arm.

Me shkesën pa nr. prot. e datës 02.11.2020 Shefi i shërbimit te Imazheri –Radiologji paraqet kërkesën për mirëmbajtje te disa aparaturave mjekësorë.

Nga specialisti biomjekësor Ing. D. M. është paraqitur një analize teknike për domosdoshmërinë e kryerjes se procedurave te prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e pajisjeve radiologjie".

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm pa nr. Prot , datë 03.11.2020, është ngritur grupi i punës (komisioni) për konstatimin e nevojave dhe përlllogaritjen e fondit limit, i përberë nga D. M., D. K., Q. H..

Me shkresën pa nr. Prot date 09.11.2020 me urdhër të drejtorit të përgjithshëm është ngritur komisioni për testimin e tregut, i përberë nga R. D., K. T., A. C. Grupi i punës beri testimin e tregut nëpërmjet ofertave ekonomike të operatoreve ekonomike D. Shpk, B. E., Ing A. T. (OEnuk ka ne fushën e veprimtarisë të përcaktuar objektin e prokurimit), fondi limit u përcaktua ne baze te çmimit me të ulet për çdo artikull.

Përlllogaritja e fondit limit është paraqitur me shkresën pa nr. Prot. dhe pa date nga D. K. ekonomiste dhe Q.H. shef i sektorit të prokurimeve.

Në shkresën për përlllogaritjen e fondit limit citohet se “*Persa i përket përlllogaritjes së fondit limit për pajisjen e re te futur ne këtë procedure Aparat grafi mobile analog dhe aparat grafi c-arm, zërat 2 dhe 3 ne lotin 3,eshte marre për baze çmimi me i ulet në testimin e tregut*”,,,

Preventivi, për procedurën “mirëmbajtje e pajisjeve radiologjike, është hartuar nga D.M., konfirmuar nga zv. drejtoresha e shërbimeve Administrative A. B. dhe miratuar nga drejtoresha e përgjithshme.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM), në kartelat e mbajtura për pajisjet mjekësore, nuk janë identifikuar: data e blerjes, vlera (reale ose të vlerësuar), të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes. raportime për problem me pajisjen mjekësore. Përshkrimi i përgjithshëm i problemit ose i shërbimit të nevojitur. Pjesët e këmbimit të përdorura gjatë riparimit/mirëmbajtjes.

Autoriteti Kontraktor, para shpalljes së kësaj procedure duhet të kishte hartuar planin e mirëmbajtës së pajisjeve mjekësorë për çdo vit.

Me shkresën me nr. 2141 date 23.11.2020 titullari i Ak-së ka nxjerre urdhrin e prokurimit për procedurën “Mirëmbajtje pajisje radiologjike” me fond limit 15,756,383 leke pa TVSH , e ndare në 3 lot, Lot 1 Mirëmbajtje te aparateve grafi e prodhuesit Philips: me fond limit 5,220,384 leke pa TVSH.

Lot 2 Mirëmbajtje e aparatit mamografi e prodhuesit IMS me fond limit 1,180,000 leke pa TVSH.

Lot 3 Mirëmbajtje e aparatit grafi e prodhuesit Toshiba 9,355,999 leke pa TVSH.

Lloji i procedure e hapur ,marrëveshje kuadër me afat 24 muaj .

Njësia e prokurimit e përberë nga I. S. ,D. K.,D. M.

Me shkresën nr. 2141/1 prot. date 23.11.2020 është ngritur komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përberë nga A. B., E. Sh., O. T.

Sipas Raportit përmbledhës te mbajtur me date 29.12.2020 për këtë procedure prokurimi ,pa nr. prot. ne këtë procedure prokurimit morën pjesë operatorët :

Për Lotin 1 OE “H.& L.” sh.p.k me vlere të ofertës ekonomike 5,220,360 leke pa TVSH ,dhe çmim/njësi 217/515 leke pa tvsh.

Për Lotin 2 OE “H.& L.” sh.p.k me vlere të ofertës ekonomike 1,179,960 leke pa TVSH ,dhe çmim/njësi 49/165 leke pa TVSH.

Për Lotin 3 OE “B. E.” shpk me vlere të ofertës ekonomike 9,355,992 leke pa TVSH ,dhe çmim/njësi 389,833 leke pa TVSH.

Me vendimin nr. 2141/3 date 29.12.2020 titullari i AK-së ka vendosur te miratoje raportin përmbledhës dhe klasifikim përfundimtar të bere nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe të shpalle fitues, për:

Për Lotin 1 OE “H.& L.” sh.p.k me vlere të ofertës ekonomike 5,220,360 leke pa TVSH ,dhe çmim/njësi 217/515 leke pa TVSH.

Për Lotin 2 OE “H.& L.” sh.p.k me vlere të ofertës ekonomike 1,179,960 leke pa TVSH ,dhe çmim/njësi 49/165 leke pa TVSH.

Për Lotin 3 OE “B. E.” sh.p.k me vlere të ofertës ekonomike 9,355,992 leke pa TVSH ,dhe çmim/njësi 389,833 leke pa TVSH.

Me date 26.01.2021 është nënshkruar drafti i MK me vlere të prishme të kontratave që do të

lidhen gjate marrëveshjes kuadër në total 6,400,320 leke pa TVSH.

Në vijimësi është nënshkruar kontrata me nr. Prot 2141 date 26.01.2021 me objekt “Mirëmbajtje pajisjes radiologjike”.

Lot 1 “Mirëmbajtje e aparateve grafi i prodhuesit Philips” me vlere 5,220,360 leke pa TVSH.

Lot 2 “Mirëmbajtje e aparatit mamografi” i prodhuesit IMS” me vlere 1,179,960 leke pa TVSH.

Vlera totale e kontratës 6,400,320 leke pa TVSH dhe 7,680,384 leke me TVSH.

Per vitin 2021

Lot 1 “Mirëmbajtje e aparateve grafi i prodhuesit Philips 2,392,665 leke pa TVSH.

Lot 2 “Mirëmbajtje e aparatit mamografi” i prodhuesit IMS 540,815 leke pa TVSH.

Vlera totale e kontratës për 2021 është 2,933,480 leke pa TVSH dhe 3,520,176 leke me TVSH.

Për vitin 2022

Lot 1 “Mirëmbajtje e aparateve grafi i prodhuesit Philips me vlere 2,610,180 leke pa TVSH.

Lot 2 “Mirëmbajtje e aparatit mamografi” i prodhuesit IMS me vlere 589,980 leke pa TVSH.

Vlera totale e kontratës për 2022 është 3,200,160 leke pa TVSH dhe 3,840,192 leke me TVSH.

Për vitin 2023

Lot 1 “Mirëmbajtje e aparateve grafi i prodhuesit Philips me vlere 217,515 leke pa TVSH.

Lot 2 “Mirëmbajtje e aparatit mamografi” i prodhuesit IMS me vlere 49,165 leke me TVSH.

Vlera totale e kontratës për 2023 është 266,680 leke pa TVSH dhe 320,016 leke me TVSH.

Me date 09.02.2021 është nënshkruar drafti i Marrëveshjes kuadër për lot 3 “Mirëmbajtje e aparatit grafi e prodhuesit Toshiba “.Vlera e pritshme e kontratave qe do te lidhen gjate marrëveshjes kuadër në total 9,355,992 leke pa TVSH.

U nënshkrua kontrata me nr. Prot. 2141 date 09.02.2021 me objekt “Mirëmbajtje pajisje radiologjike” Lot 3, me vlere totale te kontratës 9,355,992 leke pa TVSH dhe 11,227,190 leke me TVSH.

Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje Full-Risk e pajisjeve radiologjike”, për nevojat e SRE për 24 muaj” me fond limit **15,756,383** lekë pa TVSH, e ndare sipas prodhuesve të pajisjeve mjekësore dhe jo ekuivalent dhe operatorë ekonomike fitues është ai që ka autorizim nga prodhuesi për blerje/shërbim mirëmbajtje pajisje mjekësore.

Nga NHDT, pika 3.3.3 përcakton se: *Operatori ofertues duhet të jetë i pajisur me autorizim prodhuesi për mirëmbajtjen e pajisjeve të përfshira në këtë procedure dhe për furnizimin me pjesë këmbimi*

Argumentimi i bërë për piken 3.3.3 te kapaciteti teknik tek DST nuk përcakton teknikisht dhe nuk justifikon vendosjen e kësaj kërkesë për kualifikim dhe është në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, neni 1, neni 20 dhe neni 36 pika 5 ku është shprehur në mënyrë:

“Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 28, pika 2 ku është shprehur se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Për autorizimin e prodhuesit është shprehur dhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendim nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë se “Nga vlerësimi i këtij rasti, rezulton se auditimi i kryer në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë DPPSH ka konstatuar mungesë të konkurrencës në procedurat prokuruese të mirëmbajtjes së disa aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të kufizimit në lëshimin e autorizimit të prodhuesit vetëm për një operator, konstatim i cili ka të

bëj me përcaktimin e kritereve kualifikuese dhe specifikimeve në DST, të cilat vendosen nga vetë Autoriteti Kontraktor. Vendosja e këtyre kritereve, në respektim të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet”.

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” ,Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendim nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Në kundërshtim me përcaktimet e nenit 61 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Ne procesverbalin e hartimit të kritereve të kualifikimit, është cilësuar vetëm referimi ligjor i kritereve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kritereve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi grupi i përllogaritjes së fondit limit, njësia e prokurimit, zv/drejtori i shërbimeve administrative, drejtoresha e përgjithshme. Ish zv. drejtoresha e shërbimeve Administrative A. B. për miratimin e preventivit për prokurim.

17. Mbi auditimin e procedurës “Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësorë CT-skaner dhe rezonance magnetike”, marrëveshje kuadër me afat 24 muaj me fond limit 26,344,800 lekë pa TVSH.

Sipas dokumentacionit të vene në dispozicion konstatohet që:

Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësorë CT Skaner dhe Rezonance Magnetike Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 muaj,		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1350 prot, datë	3. Hartimi i dokumenteve të tenderit -I. S.; juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 1350/1 prot, datë

03.08.2023	-Xh. K.; ekonomiste -D. M. inxhinier biomjekesor	03.08.2023 - O. T.; kryetare -R. D.; anetar -A. Q.; anetare
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur , marrëveshje kuadër”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 26,344,800 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 26,344,800 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 28.08.2023 .	9. Burimi Financimit Fond nga buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _ H.& L.shpk b) S’kualifikuar __-__0_OE, c) Kualifikuar __1__ OE
11. Ankimime-ska	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik _-
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Drafti i marrëveshjes kuader nr 1350/7 prot. date 01.09.2023 Lidhja e kontratës, 1 nr. 1350/8 prot., datë 01.09.2023 Lidhja e kontratës, loti 1,2 nr. 2061 prot., datë 27.12.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 31,601,706 leke 26,344,800 5,268,960 leke me TVSH 15,806,880 leke me TVSH	24 muaj nga nënshkrimi 24 muaj nga nënshkrimi 24 muaj nga nënshkrimi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 541/14 Prot., datë 12.06.2023 nga MSHMS është deleguar e drejta e kryerjes se procedurës se prokurimit te shërbimit te mirëmbajtjes te pajisjeve mjekësorë.

Me shkresën nr. 1329 prot. date 31.07.2023 urdhër për ngritjen e komisionit te ri-testimit te tregut për procedurën e prokurimit “**Mirëmbajtje e pajisjeve te mëdha mjekësorë CT-skaner dhe rezonance magnetike**”, komisioni i përberë nga K. T., A. C., S. D.

Nga grupi i ngritur për studimin e tregut për procedurën e sipërcituar ,u paraqit procesverbali me dt. 02.08.2023 dhe u mor si reference çmimi me i ulet nga 2 ofertat e operatoreve ekonomike qe paraqiten ofertat e tyre ekonomike.

Me shkresën me nr. 1329/1 date 02.08.2023 nga titullari i AK-së është ngritur komisioni për përlllogaritjen e fondit limit te kontratës, i përberë nga V. T.-Ekonomiste, I. Sh.-Ekonomiste, M. J.-jurist.

Me shkresën pa nr. prot date 03.08.2023 nga komisioni i hartimit te fondit limit u paraqit pranë sektorit te prokurimeve përlllogaritja e fondit limit dhe preventivi i miratuar nga titullari i AK-së.

Në kartelat e mbajtura për pajisjet mjekësore, nuk janë identifikuar, data e blerjes, vlera (reale ose të vlerësuar), të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes. raportime për problem me pajisjen mjekësore. Përshkrimi i përgjithshëm i problemit ose i shërbimit të nevojitur. Pjesët e këmbimit të përdorura gjatë riparimit/mirëmbajtjes, në kundërshtim me udhëzimin nr.30 date 27.12.2011 “Menaxhimi i aktiveve në njësitë publike”.

Me shkresën nr. 1350 prot. date 03.08.2023 nga titullari i AK-se është nxjerre urdhri i prokurimit te fondit 26,344,800 lekë pa TVSH, për procedurën e prokurimit “**Mirëmbajtje e pajisjeve te mëdha mjekësorë CT-skaner dhe rezonance magnetike**”, *procedurë e hapur, mbi*

kufirin e ulet monetar ,marrëveshje kuadër me afat 24 muaj. Njësia e prokurimit përbehej nga I. S.-juriste, Xh. K.-ekonomiste, D. M.-inxhinier biomjeksor.

Me shkresën nr. 1350/1 date 03.08.2023 u ngrit komisioni i vlerësimit te ofertave, i përberë nga O. T., R. D. dhe A.Q.

Dst-jane janë ndryshuar pas rekomandimeve të APP-së.

Sipas raportit përmbledhës te mbajtur për këtë procedure prokurimi pa nr. prot ,date 31.08.2023, të miratuat nga titullari i AK-së, ne këtë procedure prokurimi mori pjese një OE dhe u shpall fitues:

H.&L. shpk me **26,344,800** leke pa TVSH.

Në vijimësi u nënshkrua drafti marrëveshjes kuadër me nr. 1350/7 date 01.09.2023 me vlere 26,334,800 leke pa TVSH .

Me date 01.09.2023 me nr. 1350/8 prot, u nënshkrua kontrata ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Elbasan i përfaqësuar nga drejtori A. G. dhe Operatori ekonomik “H.&L.” shpk me administrator R.C., me vlere 5,268,960 leke me tvsh me afat deri 31.12.2023.

Në kundërshtim me përcaktimet e nenit 78 të Vendimit nr. 285, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, *çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.*

Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të kualifikimit, është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhëne argumentimin teknik konkret të kriterëve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës. Konkretisht për piken 2.1.2 të DST-ve ku citohet se : *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e pajisjeve që do të mirëmbaje ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi për Shqipërinë, për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, për objektin e prokurimit.*

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer ose fotokopje e motorizuar.

Kjo është në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, neni 1, neni 20 dhe neni 36 pika 5 ku është shprehur në mënyrë:

“Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 28, pika 2 ku është shprehur se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Për autorizimin e prodhuesit është shprehur dhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendim nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë se “Nga vlerësimi i këtij rasti, rezulton se auditimi i kryer në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë DPPSH ka konstatuar mungesë të konkurrencës në procedurat prokuruese të mirëmbajtjes së disa aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të **kufizimit në lëshimin e autorizimit të prodhuesit vetëm për një operator**, konstatim i cili ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve në DST, të cilat vendosen nga vetë Autoriteti Kontraktor. Vendorsja e këtyre kriterëve, në respektim të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet”.

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” ,Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendim nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, Drejtimi dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar efijencën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

-Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 është shprehur në mënyrë se Neni 2 “Qëllimi”

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

-Ligjin nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, ku është shprehur në ligjëratë të drejt “Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efijencë.

-Neni 2 “Qëllimi i ligjit” Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”.

18. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj”, viti 2023.

Nga dokumentacioni i vene në dispozicion u konstatua që:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj.		
1. Urdhër Prokurimit nr.986 prot., datë 24.05.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit I.S.- juriste Z. P. specialiste Xh. K. –ekonomiste Komisioni për identifikimin e nevojave, hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit 1.V. T.-kryetare 2.I. Sh.-Anetare 3.Z. P.-Anetare	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 986/1 prot., datë 24.05.2023 L.R. S. D. E. Z.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur-Marrëveshje kuadër” me afat 12 muaj		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,440,740 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 8,247,600 leke pa TVSH (97.7%)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 193,140 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 12.04.2021	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 7,762,721 leke pa TVSH. TA dytesore 678,019 leke pa TVSH.	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- ka; KPP- ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP 564/2023
b. Zbatimi i Kontratës		
13. Lidhja e kontratës M.K nr. 986/9 prot., datë 20.05.2021 K.SH nr.986/10 prot., datë 04.09.2023	14. Vlera e kontratës (pa tvsh) 660,000 lekë 4,948,560 lekë pa TVSH	
15.Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli	16.Afati i kontratës në ditë ⁶ 31.12.2023	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 7.762.721 lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat dytesore të institucionit në vlerën 678,019 lekë pa tvsh.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me shkresën nr. 1350/1 datë 30.03.2023 MSHMS lejon Ak të procedojë me kryerjen e procedurës së prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”, për një periudhë kohore deri në realizimin e procedurës së përqendruar të prokurimit nga MSHMS.

Me shkresën nr. 912 Prot., datë 15.05.2023 nga titullari i AK-së është nxjerrë urdhri për ngritjen e komisionit për konstatimin e nevojave dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”, i përberë nga Z. P., I. Sh., V. T. Me shkresën pa nr. prot dhe date 16.05.2023 grupi i përllogaritjes ka paraqitur hartimin

⁶Për shkak të përjashtimit të OE për të fituar kontrata publike me afat 10 (dhjetë) muaj e 7 (shtatë) ditë.

specifikimet teknike për procedurën e sipërcituar dhe fondit limit ku si çmim reference është marre çmimi i kontratës së mëparshme me OE "E." me vlerë 385 leke/kg sipas kontratës të nënshkruar me dt.20.04.2023, sipas relacionit sasitë janë përcaktuar sipas regjistrit faktik të vitit 2022.

Si për procedurat e sipërcituara për të njëjtin objekt prokurimi AK nuk i është referuar edhe alternativave të tjera për përcaktimin e vlerës së fondit limit por vetëm kontratave të ngjashme të nënshkruara me OE "E.-R."

Gjithashtu me shkresën pa nr prot me date 16.05.2023 grupi i punës ka paraqitur preventivin për procedure e prokurimit" të miratuar nga titullari i AK-së, ku përcaktohet një sasi prej 20,880 kg dhe vlerë 10,128,888 leke me TVSH.

Nuk ka një relacion që të përshkruaje sasinë totale të mbetjeve të gjeneruara dhe të pritshme të dhe sasitë sipas kodeve përkatëse (Katalogu Shqiptar i Klasifikimit të Mbetjeve).

Me shkresën nr. 986 date 24.05.2023 nga titullari i AK-së është nxjerre urdhri i prokurimit për procedure me objekt "**Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore**" me **fond limit 8,440,740 leke pa TVSH**, procedurë e hapur e thjeshtuar, MK me afat 12 muaj. Njësia e prokurimit përbehet nga I. S.-jurist, Xh. K. dhe Z. P.

Me shkresën nr. 986/1 prot., datë 24.05.2023 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përberë nga L. R., S. D., E. Z.

Kriteret e vendosura janë ndryshuar sipas vendimit 07/2020 të komisionit të Prokurimeve Publike.

Zhvillimi i procedurës

Nga shoqëria "M.-T." shpk është paraqitur pranë AK-se formulari i ankesës elektronike date e ankesës 01.06.2023, në ankesën e paraqitur citon se "*kriteri në lidhje me numrin e të punësuarve të vendosur të vendosur nga AK është abuziv dhe vendosja e këtij kriteri shkel në mënyrë haptazi barazinë në tendera. Po kështu kundërshtojmë dhe përcaktimin në lidhje me stafin që kërkohet, konkretisht numri i përcaktuar i punonjësve të kërkuar. Kërkesa për punonjës administratë, roje, sanitar –minimalit 8 është i paqarte pasi nuk specifikohet numri për secilin profesion". Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të këtë jo vetëm impiantin/makinerinë kryesore por dhe atë backup është diskriminues dhe nuk është në përputhje me dispozitat ligjore. Në rastin konkret janë vendosur kushte dhe kritere për të shkelur barazinë në tendera për faktin se AK ka parapërcaktuar fituesin sepse këto impiante disponohen vetëm nga një OE e konkretisht shoqëria "E. R." sh.p.k. Pika 2.1 ,duhet të vendoset kriteri që kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë të realizohet me autoklavim /teknologji ekuivalente dhe/ose incinerimit, 18.01.01, 18.01.03, 18.01.04.*

Ankesa e OE M. u shqyrtua nga komisioni i vlerësimit të ofertave në zbatim të urdhrin 986/4 date 05.06.2023.

Me shkresën nr.986/5 prot date 07.06.2023 i është kthyer përgjigje OE "M." në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesën e sipërcituar. KSHA është shprehur për secilin nga pretendimet e OE M. duke argumentuar që pretendimet nuk qëndrojnë dhe ankesa nuk pranohet .

Me vendimin nr. 564/2023 KPP ka vendosur të pranojë pjesërisht ankesën e OE ekonomike "M.-t." sh.p.k dhe që autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dst.

AK ka bërë modifikimin e kriterëve sipas shtojcës 1223/1 date 24.07.2023 në zbatim të vendimit 564/2023 të komisionit të Prokurimeve Publike pas shqyrtimit të ankesës të paraqitur nga OE "M.-T." shpk dhe sipas email-it që APP ka dërguar AK-se nga asistencë që Agjencia e Prokurimit Publik iu jep enteve/autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit. Në kundërshtim me përcaktimet e nenit 78 të Vendimit nr. 285, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, *çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.*

Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të kualifikimit, është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës. Për te njëjtin objekt kontrate përgjatë viteve AK ka dyfishuar numrin e punonjësve të kërkuar për realizimin e kontratës, duke mos e justifikuar këtë kërkesë, konkretisht për piken 2.3.3 të DST-ve, ku përcaktohet se: *Operatori Ekonomik duhet ta ketë jo më pak se 18 persona të punësuar për muajin Prill 2023. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:*

Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore;

Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për muajin Prill 2023.

Me vendimin nr. 631/2023 prot. Date 14.07.2023 KPP vendos:

Të mos leje AK për vijimin për hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit për mos zbatim të plote të vendimit të KPP nr. 564/2023 date 05.07.2023, në lidhje me piken 2.3.3.

AK ka modifikuar dst-te sipas shtojcës 1223/1 date 11.07.2023 .në zbatim të vendimit të KPP 564/2023 dhe në vijim të rekomandimeve të APP-së dërguar në SPE date 02.06.2023.

AK ka modifikuar serish dst-të sipas shtojcës 1276/1 në zbatim të vendimit nr.631/2023 të KPP.

Me vendimin nr. 698/2023 KPP ka vendosur të lejoje AK për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-70711-05-26-2023 me objekt “Grumbullim, trajtim, asgjësim i mbetjeve spitalore, me fond limit 8,440,740 lekë pa TVSH.

Sipas raportit përmbledhës në këtë procedure prokurimi morën pjesë dy operatore ekonomike OE“E. R.” me formular të ofertës në vlerën 8,247,600 leke pa TVSH.

OE “M.-T.” me formular të ofertës në vlerën 7,934,400 lekë pa TVSH.

KVO vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga OE M.-T. nuk është i plotë.

Është shpallur fitues OE “E. R.” shpk me vlerën 8,247,600 lekë pa TVSH.

Në vijimësi është nënshkruar marrëveshja kuadër me nr. prot. 986/9 date 04.09.2023 ndërmjet Spitalit Rajonal Elbasan e përfaqësuar nga A. G. dhe OE E. R. e përfaqësuar nga E. M., me vlerë të pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër 8,247,600 lekë pa TVSH. Kohëzgjatja e MK 12 muaj.

Me datë 04.09.2023 është nënshkruar kontrata nr.986/10 date 04.09.2023 me vlerë 4,948,560 lekë pa TVSH, me afat deri 31.12.2023.

Zbatimi i kontratës

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, në baze të VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, strukturat spitalore si krijues të mbetjeve janë përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë. Në zbatim të kriterit mbi procedurën që vijon për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimit, asgjësimi i produktit final të trajtuar do të kryhet nga shoqëria “E.-E.” sh.p.k., me të cilën OE ka lidhur marrëveshje të datës 26.05.2023, me afat deri 3 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj me të drejtë ripërtëritje nëse kushtet e marrëveshjes nuk janë shkelur.

Sipas akt-marrëveshjes “E.- R.” sh.p.k do të depozitoje mbetje të gjeneruar përgjatë marrëveshjes së punës së saj, mbetje të cilat janë të lejuara sipas legjislacionit në fuqi.

Në vijim të akt marrëveshjes sipërcituar, OE nuk përcjell asnjë dokument justifikues për të vërtetuar se marrëveshja është ende në fuqi. Si rrjedhojë, edhe pse shërbimi i kërkuar dhe i paguar nga ana e AK është trajtim dhe asgjësim, pra përfshirë edhe asgjësimin e produktit final të trajtuar, nuk dokumentohet përmbushja e detyrimeve.

Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të produktit final të trajtuar, të përfituar nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk dihet ku derdhen këto mbetje, të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin publik.

Nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentacioni me qëllim vërtetimin e asgjësimit të

mbetjeve, shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës.

Veprime në kundërshtim me pikën 2, 3 dhe 4, neni 21, ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, sipas së cilit:

-Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton kushtet e përgjegjësisë dhe specifikon se në cilat raste krijuesi fillestar mban përgjegjësi për të gjithë zinxhirin e trajtimit dhe në cilat raste përgjegjësia ndahet mes tij dhe zotëruesit të mbetjeve apo u delegohet aktoreve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit.
-Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rrethanat në të cilat përgjegjësia për organizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve mbartet, plotësisht apo pjesërisht, nga prodhuesi i produktit që krijon mbetjet dhe rrethanat kur këto përgjegjësi mund të ndahen me shpërndarësit e këtij produkti.
-Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre.

Si dhe në kundërshtim me shkronjën e), pika 5, kreu II, VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, sipas së cilit:

Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.

Nenin 2, nenin 8 dhe nenin 52, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku cilësohet:

-“Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.”
-Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”.
-“Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik”.

Pika 5, Neni 21, Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, sipas së cilit:

Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

Neni 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se Neni 2 “Qëllimi”

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Nga autoriteti kontraktor nuk është realizuar mbikëqyrja e kontratës sipas përcaktimeve të nenit 107 të VKM 285 date 19.05.2021 ,ku shprehet qartë se:

6. Personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës lidhur me ecurinë e zbatimit të kontratës, përgatisin informacione të vazhdueshme për problematikat në këtë proces dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, të cilat ia përcjellin personit përgjegjës për prokurimin, me qëllim raportimin prej këtij të fundit, pranë APP-së.

7. Personi apo strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës.

Konkluzione

-Grupi i auditimit konstatoi se specifikimet teknike të vendosura tentojnë të kufizojnë konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një operatori ekonomik, në kundërshtim me nenin 23, ligji nr. 9643 date 20.12.2006 ,“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 dhe 5, nenin 2.

-Operatori ekonomik “E.-R.” sh.p.k , është i vetmi operator ekonomik fitues për të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor Elbasan përgjatë 4 viteve në lidhje me objektin e prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”

- Parregullsi në dokumentimin e realizimit të procesit të asgjësimit të produktit final të trajtuar (hirit). Strukturat spitalore si krijues të mbetjeve janë përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë. Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të produktit final të trajtuar, të përfituar nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk dihet ku derdhen këto mbetje, të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin.

Kerkesat teknike të vendosura tentojnë të kufizojnë konkurrencën duke orientuar procedurën drejt një operatori ekonomik.

19. Mbi auditimin e kontratës së punimeve civile “Rikonstruksion i Godinës së Pediatriisë”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj kontrate konstatohet që:

Kontrata e punimeve civile “Rikonstruksion i godinës së Pediatriisë është nënshkruar me nr. 2142 prot., datë 12.02.2021, ndërmjet Qendrës Spitalorë “Xh.Kongoli” Elbasan përfaqësuar nga Drejtori znj. D.T dhe BOE “M. & A. K. & Sh.” SHPK, përfaqësuar nga Shoqëria “M.” SHPK, me vlerë 328,945,549.2 lekë me TVSH. Afati i zbatimit të punimeve është përcaktuar 18 muaj. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “A.M.” SHPK.

Dorëzimi i sheshit të ndërtimit, akt piketimi dhe njoftimi për fillimin e punimeve mbajnë datën 19.02.2021.

Gjatë zbatimit të punimeve janë konstatuar diferenca me shtesa dhe pakësime, të cilat janë reflektuar duke mbajtur procesverbalin përkatës dhe hartimin e preventivit të rishikuar. Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me datë 11.08.2022. Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është nënshkruar me nr. 1438 prot., datë 20.09.2022, nga përfaqësuesi i kontraktorit, mbikëqyrësit të punimeve, komisionit të përbërë nga z. A. Sh., z. A. M., z. K. T., znj. Z.P. dhe z. R. D. si dhe Titullarit të AK z. A.

Akti i kolauditimit është hartuar me nr. 920/1 prot., datë 24.08.2022. Në procesverbalin përkatës cilësohet se nuk ka defekte të pa korrigjuara.

Nga ana e Përgjegjës të Degës Teknike z. A. Sh. është hartuar relacioni nr. 1436/1 prot., datë 20.09.2022 dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Teknologjisë z. R. D., relacioni nr. 1436 prot., datë 20.09.2022, të cilat paraqesin disa defekte të punimeve të realizuara. Këto defekte kryesisht kanë të bëjnë me sistemin data dhe telefonisë, mungesa e pajisjeve për vënien në punë të CCTV, vendosjen në punë të pajisjeve të sinkronizimit të orëve, vendosjen e kompresorëve të ajrit, kaldajave, mos përfundim i linjës kryesore të gazit, mungesa e certifikimit për ashensorin si dhe prova për gjendjen funksionale të gjeneratorit.

Në procesverbalin e datës 20.09.2022, mbajtur nga grupi i marrjes në dorëzim, cilësohet se kontraktori merr përsipër riparimin e defekteve deri me datë 30.10.2022.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike dhe verifikimet përkatëse të punimeve në objekt, konstatohet:

- Sipas zërit të punimeve A.6.8 “Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil, t = 5 cm + rrjetë + suva”, u konstatua se është certifikuar sasia 3147.3 m³, me çmim 2.800 lekë/m². Nga verifikimi në objekt (pa prezencën e mbikëqyrësit të punimeve), rezulton se është përdorur polisterol i thjeshtë. Verifikimi është bërë në raste dhe sipërfaqe të kufizuar, për arsye se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të padukshme, kryesisht në daljen e tubave të kondicionimit, apo ndërprerje të shkallëve të emergjencës. Në dosjen teknike nuk janë paraqitur fotografi të procesit të ndërtimit të fasadës, për të konkluduar më saktë mbi realizimin apo jo në tërësi të këtij procesi punimi. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu I, pika 8.3, ku përcaktohet:

“Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi sigurohet nga sipërmarrësi për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, që mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve, etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit çdo javë”.

Nga verifikimi i punimeve në objekt, rezulton se për realizimin e fasadës nuk është përdorur polisterol kompakt jeshil, por polisterol i thjeshtë.

Bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave dhe të analizave teknike të tyre”, çmimi sipas analizës nr. 2.538/c “Veshje muri me polisterol të thjeshtë, t = 5 cm + rrjetë + suva” është 1,947 lekë/m². Në pamundësi të përcaktimit të materialit të vendosur, **vlëra 2,684,647 lekë** [3147.3 m² (2,800 lekë/m² – 1,947 lekë/m²)], konsiderohet e përfituar padrejtësisht nga Kontraktori BOE “M. & A. K. & Sh.” SHPK, si pasojë e mos respektimit të specifikimeve teknike në vendosjen e materialit, si dhe mos rishikimin e çmimit duke e përshtatur me çmimin e materialit të vendosur dhe jo atë të parashikuar.


Më poshtë paraqiten foto të marra në objektin “Godina e Pediatrisë”, në Spitalin Rajonal Elbasan.



Mos vendosja e materialit sipas specifikimeve teknike, ndikon në mos arritjen e parametrave të termoizolimit sipas parashikimit, për pasojë shpenzim më i lartë i energjisë elektrike.

- Sipas zërit A.6.6 “Tavan i varur me pllaka gipsi rezistente ndaj lagështirës tualete”, është certifikuar sasia 793 m², me çmim 3,111 lekë/m². Për këtë zë punimi ishte parashikuar sasia 175 m². Bazuar në librezën e masave, llogaritja e sasive është bërë në dy seksione, sasia e të cilave është mbledhur. Në seksionin e parë sasia e tavanit është përlllogaritur në shumën 181 m², ndërsa ka një shtesë e cila nuk është argumentuar. Pavarësisht njoftimit, mbikëqyrësi i punimeve nuk është paraqitur, në mënyrë që të sqarohet mënyra e përlllogaritjes së sipërfaqes sipas zërit të mësipërm.

- Sipas zërit A.12.2 “Dalje për vaditje” është certifikuar sasia 193 copë, me çmim 6,000 lekë/copë. Nga verifikimi në objekt rezulton se janë vendosur 120 copë, me një diferencë të raportuar 73 copë më tepër. Në mungesë të mbikëqyrësit të punimeve, nga ana e grupit të auditimit, u bënë verifikime për realizimin e këtij zëri punimi. Rezulton se sistemi i vaditjes me daljet përkatëse është realizuar vetëm në zonën jugperëndimore të godinës. Për këtë zë punimi konstatohen edhe dëmtime. **Vlera 438,000 lekë** (73 copë x 6,000 lekë), është certifikuar më tepër.



- Sipas zërit A.6.5 “Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm, korridore”, është certifikuar sasia 983.17 m², me çmim 2,100 lekë/m². Nga verifikimi i përlllogaritjeve në librezën e masave, rezulton se nuk është bërë zbritja e sipërfaqes që zënë ndriçuesit, sipas zërit F.3.2 “F. ndriçues katror panel inkaso Led 40 W, 60 x 60 cm, IP 40, 4000 K, me difuzor opal, i kompletuar me të gjithë aksesorët për instalim jashtë murit”, për sasinë 174 copë. Sasia 62 m² (174 copë x 60 cm

x 60 cm) e certifikuar më tepër sa i takon materialit (çmimi i pllakës së gipsit 1,444 lekë/m²). **Vlera 89,547 lekë** (62 m² x 1,444 lekë/m²), është certifikuar më tepër.

- Tek veshje fasade me pllaka qeramike sipas zërit A.6.9 janë përfshirë pllaka qeramike për shkallët e emergjencës në sasinë 16.5 m². Tek shkallët e emergjencës, nuk kemi të bëjmë me shtrim pllakash qeramike, por pllaka grez. Çmimi i paraqitur për pllakë grez sipas zërit A.5.3, është 2,500 lekë/m², ndërsa për pllakë qeramike sipas zërit të mësipërm 3,500 lekë/m². Sa më sipër, është certifikuar është certifikuar më tepër **vlera 16,500 lekë** [16.5 m² x (3,500 – 2,500) lekë/m²].

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, ku përcaktohet:

“...Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit...”

- Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4, ku përcaktohet:

“Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve “A. M.” SHPK.

Sa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 15, datë 21.03.2024.

20. Mbi auditimin e kontratës së punimeve civile “Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Elbasan”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj kontrate konstatohet që:

Kontrata e punimeve civile “Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Elbasan”, është nënshkruar me datë 14.04.2023, ndërmjet SR Elbasan përfaqësuar nga z. A. G. dhe OE “E.” SHPK, përfaqësuar nga z. E.B., me vlerë 157,039,969.4 lekë. Afati i zbatimit të punimeve është përcaktuar 6 muaj. Fillimi i punimeve është përcaktuar brenda 10 ditëve nga data e disponimit të lejes së ndërtimit nga AK. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur BOE “K. P.” & “I. D. & S.” SHPK, përfaqësuar nga Shoqëria “K. P.” SHPK.

Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se njoftimi për fillimin e punimeve është bërë kontraktori me shkresë të protokolluar në SR Elbasan nr. 857, datë 08.05.2023. Po ashtu, nga mbikëqyrësi i punimeve është bërë njoftimi përkatës, protokolluar në SR Elbasan me nr. 857/1 prot., datë 08.05.2023, me datë fillimi të punimeve 08.05.2023. Dokumentacioni i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, akt piketimi i punimeve, janë mbajtur po në këtë datë. Kontraktori me shkresë nr. 169 prot., datë 17.10.2023, ka paraqitur një kërkesë për lirimin e sheshit të ndërtimit, ku përcaktohet: “Brenda njollës së sheshit të ndërtimit dhe gjurmës së objektit ndodhen disa linja të ndryshme (të papërcaktuara) telefonie, interneti ose kabllori, të cilat pengojnë vazhdimësinë e punimeve”. Për këtë kërkohet nga SR Elbasan zhvendosja/spostimi i të gjitha linjave të cilat ndodhen brenda njollës së sheshit të ndërtimit, pasi pengohen punimet për ndërtimin e fasadës. Për sa më sipër, si dhe për arsye të disa problematikave të evidentuara, si rrjedhja e ujërave në bodrumin ku do vendosen depot e ujit etj., është kërkuar shtesë në afatin e përfundimit të punimeve për 45 ditë.

Bazuar në kërkesën e mësipërme, amendimi i kontratës është bërë me nr. 1806/2 prot., datë 14.11.2023, sipas të cilës afati i përfundimit të punimeve përcaktohet data 31.12.2023. Njoftimi për përfundimin e punimeve është protokolluar në SR Elbasan me nr. 2074 prot., datë

29.12.2023. Bazuar në periudhën e parashikuar si dhe shtesën e afatit, punimet kanë përfunduar në afat.

Akti i kolauditimi është mbajtur me datë 27.02.2024, nga kolaudator z. E. S. me licencë nr. MK 4193. Situacioni përfundimtar është hartuar me vlerë 157,039,000 lekë.

Gjatë zbatimit të punimeve është konstatuar se ka ndryshime të volumeve të përlllogaritura në preventivin përkatës si me shtesa ashtu dhe me pakësime, por nuk ka zëra të rinj të punimeve. Nga rishikimi i preventivit, vlera e kontratës ngelet e pandryshuar ku është përdorur vetëm fondi rezervë.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Sipas zërit A.8.9 “Struktura të holla betoni C 16/20, për kunetat e jashtme”, është përfshirë shtresa e betonit për ndërtimin e kunetës me dimensione 114.26 ml x 0.25 cm x 0.52 ml, me çmim 18,000 lekë/m³, ndërsa sa i takon zërit A.8.10 “Kunetë betoni 23 x 18 x 100 cm, marka e betonit 250”, nuk janë përfshirë punime. Punime të cilat rezultojnë në realizim shtresash, janë kanalizuar si punime struktura të holla, për të cilat në manualët e çmimeve të ndërtimit, konsiderohen zëra të ndryshëm, gjithashtu dhe çmime të ndryshme. Diferenca vjen për shkak të teknologjisë së ndërtimit, pasi për strukturat e holla nevojitet vendosje armature formësimin e betonit deri në krijimin e fortësisë, ndërkohë që për shtresa nuk është i nevojshëm përdorimi i armaturave. Bazuar në manualët e çmimeve të ndërtimit të vitit 2015, analiza 2.262/4 “Shtresa betoni C 16/20”, çmimi për këtë zë punimi paraqitet 8,525 lekë/m³. Sa më sipër, **vlera 140,230 lekë** [14.8 m³ x (18,000 lekë/m³ – 8,525 lekë/m³)], është certifikuar dhe më tepër dhe përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “E.” SHPK.

- Nga verifikimi i librit të masave sipas zërit A.3.8 “Tavan i varur me pllaka gipsi 60 cm x 60 cm”, certifikuar në sasinë 385 m², me çmim 2,200 lekë/m², rezulton se nga sipërfaqja e llogaritur nuk është zbritur sipërfaqja që zënë ndriçuesit Led në masën 73 m² (203 copë x 0.6 m x 0.6 m). Ndriçuesit e vendosur në tavanin përkatës zënë hapësira, për të cilat nuk nevojitet vendosja e pllakave të gipsit, hapësirë e cila duhet zbritur në përlllogaritjen e sipërfaqes së tavanit të realizuar. **Vlera 105,412 lekë** (73 m² x 1,444 lekë/m²), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori.

- Sipas zërit A.3.7 “F.V tavan me kartonxhes”, është situacionuar sasia 1487.3 m². Bazuar në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit (2015), në analizën 2.297/a, në përlllogaritjen e kostos është përfshirë edhe zëri “kornizë dekorative gips”, me çmim 112.1 lekë/m² (95 lekë/m² + 18 % shpenzime plotësuese dhe fitimi). Nga verifikimi në objekt rezulton se tavanet nuk janë realizuar duke vendosur kornizën dekorative, të cilat për objekte të tilla nuk aplikohen, por që gjithsesi, çmimi i aplikuar duhet të rishikohej në mungesë të tyre. **Vlera 166,726 lekë** (1487.3 m² x 112.1 lekë/m²), është certifikuar padrejtësisht.

- Sipas zërit A.7.4 “Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva”, është certifikuar sasia 1821.8 m², me çmim 2,650 lekë/m². Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike (fotografi), rezulton se nuk është vendosur polisterol kompakt jeshil, por polisterol i thjeshtë. Bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimet të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, manuali nr. 2, sipas analizës nr. 2.358/c “Veshje muri me polisterol të thjeshtë t = 5cm rrjetë + suva”, çmimi është 1,947 lekë/m². **Vlera 1,280,725 lekë** [1821.8 m² (2,650 lekë/m² – 1,947 lekë/m²)], është certifikuar më tepër dhe përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “E.” SHPK.

Theksojmë se nga ana e grupit të auditimit nuk mund të përcaktohet dendësia e polisterolit të vendosur në mungesë të mostrave, si dhe për faktin se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të padukshme. Në çmimin e materialit “Polisterol”, ka ndikim të ndjeshëm dendësia e materialit. Në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit, paraqitet polisterol me dendësi të ulët. Mos vendosja e materialit sipas specifikimeve teknike, ndikon në mos arritjen e parametrave të termoizolimit sipas parashikimit, për pasojë shpenzim më i lartë i energjisë elektrike.

Me datë 19.03.2024, me prezencën e përfaqësuesit të mbikëqyrësit të punimeve z. A.K., u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt, kryesisht punime të dukshme. Në

përgjithësi rezulton se janë realizuar punime me cilësi të mirë si dhe sistemet ishin funksionale. Për disa zëra punimesh u konstatuan mangësi në lidhje me sasinë dhe respektimin e specifikimeve teknike si më poshtë:

- Sipas zërit A.8.13 “Trotuar me pllaka, pa bordurën e betonit”, është certifikuar sasia 729 m² nga të cilat sasia 650.7 m², është realizuar në ambientet jashtë përreth godinës, ndërsa sasia 78.3 m² është certifikuar në territorin brenda godinës. Çmimi i aplikuar për këtë zë punimi është 1,650 lekë/m². Nga matjet për sasinë e certifikuar jashë objektit rezulton sasia 487 m², me një diferencë 163.7 m² (650.7 m² – 487 m²). **Vlera 270,105 lekë** (163.7 m² x 1,650 lekë/m²), është certifikuar më tepër dhe përfutur padrejtësisht nga Kontraktori “E.” SHPK.

Sipas zërave A.6.1. “Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë zinkato 100 mm”, A.6.2. “Ulluk shkarkimi horizontal zinkato 33 cm”, A.6.4. “Veshje kornize me llamarinë zinkato”, punimet janë realizuar me material llamarinë të bojatisur dhe jo llamarinë me veshje zinkato, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, ku përcaktohet:

“...Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit...”

- Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4, ku përcaktohet:

“Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme ka përgjegjësi:

Mbikëqyrësi i punimeve BOE “K. P.” & “I. D. & S.” SHPK.

2.6. Mbi zbatimimin e dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave.

Spital Rajonal Elbasan e ushtron aktivitetin në përputhje me Ligjin Nr. nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 55/2022, dhe Ligjin Nr.10 107, Datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, me objekt, “Përcaktimi i veprimtarisë së shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë, mënyrës së organizimit, administrimit, si dhe përcaktimi i rregullave për hapjen, mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë dhe mbylljen e spitaleve publike dhe jopublike” si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore, udhëzime, urdhra të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, MSHMS) Buxheti i Spitalit financohet nga Fondi për artikujt 600,601,602, (mallrat, shërbimet, pagat etj), sipas Kontratës së lidhur ndërmjet Fondit, DRF-Spital, Kontrata S/2020, S/2021, S/2022, S/2023, me objekt “Financimi nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor i shërbimeve shëndetësore spitalore të ofruara në spitalin publik për popullatën”, në të cilën përcaktohen, (shërbimet shëndetësore spitalore që financon fondi, bazën ligjore në të cilën mbështetet kontrata, të drejtat dhe detyrimet e spitalit në shërbimet spitalore) ndërkohë që shpenzimet për investimet kapitale financohen nga organi qendror MSHMS. Referuar kontratës së lidhur cila bën të mundur zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve spitalore nga ana e Spitalit. Spitali krijon të ardhura mbështetur në urdhrat dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë si: Urdhri Nr.3715 prot, datë, datë 12.10.2009, “Mbi zbatimimin e sistemit të referimit të pacientëve në shërbimin spitalor”, ku përcakton:

1. Çdo person që ka nevojë të marrë shërbim në institucionet shëndetësore publike. duhet të paraqitet fillimisht tek mjeku i familjes, tek i cili është i regjistruar. Në momentin e paraqitjes ai duhet të jetë i pajisur me librezën shëndetësore dhe një dokument identifikimi.
2. Çdo person i kryen ekzaminimet laboratorike dhe imazherike në institucionet shëndetësore publike nëpërmjet rekomandimit të mjekut të familjes ose të mjeku i përgjithshëm.
3. Nëse mjeku i familjes e gjykon që diagnostikimi apo trajtimi i rastit kërkon konsultë. me të specializuar, atëherë e rekomandon për të specialisti përkatës.
4. Të gjithë pacientet që paraqiten tek mjeku specialist për konsulta mjekësore ose ekzaminime laboratorike apo imazherike duhet të kenë në mënyrë të detyrueshme rekomandimin e mjekut të familjes, librezën e shëndetit dhe një dokument të identifikimit. Pacientët që nuk kanë këto dokumente paguajnë shumën e parashikuar (aktin mjekësor që do të kryejnë).
5. Mjeku specialist, pranë poliklinikës së specialiteteve në rreth, shtron pacientin në spitalin e rrethit ose e referon atë për konsulte apo trajtim me të specializuar në poliklinikën e specialiteteve të rajonit përkatës duke e pajisur me rekomandimin përkatës.
6. Pacienti që trajtohet në një spital rrethi dhe ka nevojë për diagnostikim, ekzaminime dhe trajtime që nuk sigurohen nga ky spital, të dërgohet me epikrizë shoqëruese në spitalin rajonal pas konsultës së firmosur nga mjeku kurues, shefi i shërbimit spitalor dhe drejtori ose personi i autorizuar prej tij. Vendimi i argumentuar për referimin e pacientit në një spital më të specializuar të dokumentohet në kartelë personale të pacientit. Të gjitha rastet e referuara për kurim ose ekzaminim në një spital tjetër të dokumentohen në një regjistër të veçantë dhe të ruhen në arkivën e spitalit dërgues.
7. Mjeku specialist pranë poliklinikës së specialiteteve në rajon, shtron pacientin në spitalin e rajonit ose e referon atë për konsultë apo trajtim më të specializuar në vizitat ambulatorie të Spitalet Universitare, të pajisur me rekomandimin përkatës.
8. Pacienti që trajtohet në një spital rajonal dhe ka nevojë për diagnostikim, trajtim dhe ekzaminime më të specializuara, të pajiset me epikrizë dhe të dërgohet pranë Spitaleve Universitare, pas konsultës të firmosur nga mjeku kurues, shefi i shërbimit dhe drejtori i spitalit ose personi i autorizuar prej tij. Vendimi i argumentuar për referimin e pacientit në një spital më të specializuar të dokumentohet në kartën personale të pacientit. Të gjitha rastet e referuara për kurim ose ekzaminim në një spital tjetër, të dokumentohen në regjistër të veçantë dhe të ruhen në arkivën e spitalit dërgues.
9. Drejtorja e institucionit afishon në vende të dukshme mënyrën e organizimit të konsultës (vendi, ditën, turnin) dhe tarifën për çdo konsultë apo ekzaminim mjekësor, personat e pasiguruar apo të pa pajisur me dokumentacionin e lart përmendur.
10. Të gjitha rastet e përcaktuara si urgjenca mjekësore që referohen për trajtim spitalor nga shërbimi ambulator duhet të kenë rekomandimin nga mjeku i përgjithshëm dhe i familjes, ndërsa ata të dërguar nga spitali rrethit për në spital rajonal ose spitalet Universitare, duhet të kenë epikrizën përcjellëse të firmosur dhe vulosur nga mjeku i rojes dhe shefi i shërbimit përkatës.
11. Nga ky rregull përjashtohen urgjencat mjekësore ekstreme, kur pacienti shkon direkt në spital.
12. Të gjithë personat që nuk zbatojnë sistemin e referimit do të përfitojnë shërbime sipas tarifave të shërbimit shëndetësor të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe të afishuara në institucionet shëndetësore publike.

13. Personat përfitojnë recetën me rimbursim vetëm kundrejt zbatimit të sistemit të referimit.
14. Në rast mosrespektimi të sistemit të referimit nga personeli mjekësor në të gjitha nivelet e shërbimit, do të penalizohet me kushtin penal në vlerën 10,000 lekë; në rast përsëritje penalizohet në vlerën :10,000 leke; me pas zgjidhje e kontratës së punës.
15. Kundrejt sanksioneve të penalitetit të vendosura në pikën 14 të këtij urdhri, personi i penalizuar mund të ankimojë në autoritetin që vendos penalitetin (Drejtorinë Spitalore, Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shëndetësore, DSHP, DSHPQ) brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit. për sanksionin e vendosur ndaj tij. Autoriteti përkatës kthen përgjigje brenda 10 ditëve nga dita e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit të Autoritetit që vendos penalitetin, personi mund të animojë pranë instucioneve qendrore (Ministri të Shëndetësisë, ISKSH) brenda 5 ditëve nga marrja e përgjigjes. Institucioni përkatës kthen përgjigje brenda 30 ditësh.
16. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të përsëritura, për drejtuesin e institucionit shëndetësor do të zbatohen masa administrative sipas dispozitave të kodit të punës dhe Kontratës Kolektive , deri në shkarkim nga detyra.
17. Për zbatimin e këtij urdhërohen ngarkohen, DRSKSH, Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë, Drejtoritë e Shëndetit Publik, Drejtoritë e Spitaleve në Rrethe, Drejtoritë e Spitaleve Rajonale dhe Spitaleve Universitare.
18. Për monitorimin e këtij urdhri ngarkohen Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor/DRSKSH, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Planifikimit Spitalor dhe Drejtoria e Auditit, në Ministrinë e Shëndetësisë.

Udhëzimit nr. 3715/1 datë, 26.10.2009, “Për regjistrimin, identifikimin dhe lëvizjen e pacientëve brenda Institucione Shëndetësore”, i cili organizon dhe disiplinon ofrimin e shërbimeve shëndetësore ndaj pacientit, në sistemin parësor. dytësor dhe atë terciar, ku përcakton:

- 1- Në çdo institucion shëndetësor publik që kryejnë vizita, ekzaminime dhe konsulta mjekësorë, të vendoset zyra e recepsionit dhe arkëtimit.
- 2- Pika e parë e kontaktit e pacientit në një institucion shëndetësor do të jetë recepsioni.
- 3- Recepsioni bën planifikimin e vizitave dhe konsultave sipas shërbimit, ku përcakton mjekun, ditën, dhe orën. Planifikimi i vizitave bëhet nëpërmjet telefonit ose duke shkuar pranë institucionit që ofron shërbimin. Punonjësi i recepsionit çdo ditë printon dhe shpërndan pranë mjekëve përkatës, grafikun e vizitave të planifikuara.
- 4- Pacienti kur paraqitet te mjeku i tij i familjes, do të identifikohet pranë recepsionit me librezën e shëndetit dhe mjetin e identifikimit. Kur pacienti është referuar për konsultë të specializuara ose ekzaminime të ndryshme, duhet të paraqesë edhe rekomandimin përkatës.
- 5- Recepsioni duhet të jetë i pajisur me telefon, kompjuter, regjistër për vizitat (të printuar ose elektronik).
- 6- Recepsioni duhet të regjistrojë gjeneralitetet e pacientit, kodin e mjekut dhe të qendrës shëndetësore nga rekomandohet, arsyeja pse është rekomanduar, i siguruar, i pasiguruar. numrin e librezës së shëndetit, kodin e pacientit.
- 7- Drejtoria e institucionit pajis recepsionin me grafikët e shërbimeve për vizitat, ekzaminimet, konsultat duke përcaktuar datat, orarin dhe emrat e dhënësve të shërbimit.
- 8- Recepsioni pajis pacientin me mandat-arkëtimin përkatës. Kur pacienti paraqitet në qendrën shëndetësore. për të marrë shërbim: a) për pacientët e siguruar do të lëshohet nga recepsioni një mandat arketimi ku shënohet shërbimi që kërkon si dhe "i siguruar" që tregon se nuk është nevoja të paraqitet pranë arkës për të kryer pagesën. b) Pacientët e pasiguruar do të pajisen me mandat-arkëtimin ku shënohet shërbimi që do të marrin si dhe vlera e shërbimit dhe pasi të kryej pagesën, me mandatin e vulosur “U pagua” do të shkojë në shërbimin e kërkuar. Kur pacienti paraqitet për konsultë të specializuara ose ekzaminime të ndryshme në institucionet e specializuara: a) Për pacientet e siguruar dhe të rekomanduar do të lëshohet nga recepsioni një mandat-arkëtimin ku shënohet shërbimi që kërkon si dhe nëse je i siguruar.

Udhëzimit Nr.559, datë 26.10.2009 “Për aplikimin e tarifave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët e pasiguruar dhe ata pa referim”, listës së afishuar miratuar “Për tarifën për shërbimet mjekësore në kujdesin shëndetësor parësor, të specializuara dhe spitalor, liste e cila përcakton tarifën për çdo shërbim për personat jashtë sistemit të referimit, apo për ato persona që nuk janë të siguruar dhe pa referim sipas aneksit nr. 2.

Nga të dhënat e zyrës së statistikave u konstatua se për periudhën objekt auditimit ky spital ka mbuluar me shërbim 275064 vetëm për vitin 2023, pacient të siguruar nga qyteti i Elbasanit si dhe zonat rurale në varësi të këtij spitali për periudhën objekt auditimi. Nuk ka ndonjë marrëveshje të shkruar për ofrimin e këtyre shërbimeve por çdo rast paliativ apo në gjendje të rëndë drejtohet në këtë spital për marrjen e një shërbimi më të specializuar.

Në Spital gjendet recepsioni i cili bën arkëtime nëpërmjet mandateve arkëtimeve të vizitave për konsulta të specializuara, konsulta ambulatoriale si dhe për çështje administrative për

shembull tërheqje kopje ekzaminimesh mjekësore etj. Recepti është i vendosur në godinën e Shërbimit të Konsultave dhe është i pajisur me libër arke. Sa i takon ligjshmërisë dhe saktësisë së veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë nga kontrolli është konstatuar se pagesat për shërbimet e përfituara kryen pranë këtij recepti sipas mandat arkëtimeve të cilët përmbajnë emrin e pacientit, emrin e mjekut referues nëse ka kodin e pacientit, të dhëna për pacientin, shërbimin e përfituar, vlerën e tij, nëse pacienti është i siguarur dhe i rekomanduar. Në fund të ditës mbahet një proces verbal për dorëzimin e faturave ditore midis arkëtares dhe ekonomistes së financës, në të cilin përmbledhen lloji i shërbimit dhe pagesat e kryera për të bashkëlidhur me mandat arkëtimeve përkatëse si dhe derdhjet e të ardhurave të gjeneruara në llogarinë përkatëse si të ardhura thesari për çdo mandat arkëtimi.

Zyra e financës disponon të dhënat leket e arkëtuara sipas shërbimeve mjekësore të ofruara, e cila rakordohet me degën e thesarit, dega e thesarit e cila i dërgon të dhëna në lidhje me derdhjet e bëra.

Për sa më sipër, në zbatim të sistemit të referimit Spitali ka përfituar të ardhura dytësore nga aktiviteti spitalor që kryen për shërbimet e ofruara, për personat të cilët nuk kanë zbatuar sistemin e referimit apo janë paraqitur për të marrë shërbim në Spital të pasiguarur, si dhe pa rekomandimin përkatës (tabelat përkatëse gjenden në aneksin nr. 2).

Përveç të ardhurave të krijuara nga pacientët jashtë sistemit të referimit, Spitali ka krijuar të ardhura dhe nga qiratë e objekteve që zotëron, tarifën e parkingut, tarifa për lëshimin e vërtetimeve etj.

Tarifa e parkimit të automjeteve në ambientet e spitalit është përcaktuar nga administrata e spitalit në shumën 100 leke për automjet për çdo hyrje, pa përcaktim të kohës së qëndrimit, e cila është vendosur pa një analizë apo argumentim.

Të ardhurat e krijuara në vitet periudhë auditimi janë në vlerën 36,407,150 lekë. Nga të dhënat e paraqitura, rezultoi se ka përpunime midis numrit të makinave të rirregjistruara, të identifikuar nëpërmjet sistemit elektronik të traht kryesor si dhe shumës së arkëtuara, e cila është bërë derdhje në bankë. Kjo paraqitet edhe në tabelën përmbledhëse.

Tabela nr. 22

Viti	Vlera e të ardhurave nga parkimi
2020	6814150
2021	8064800
2022	12384700
2023	9143500
	36407150

Burimi: SRE

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve rezultoi se janë arkëtuara nga ana e Spitalit dhe më pas janë bërë derdhje në bankë.

Të ardhurat nga qiratë

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për periudhën objekt auditimi (01.01.2020-31.12.2023), Spitali Rajonal Elbasan ka lidhur kontratat e qirasë sipas përshkrimit të mëposhtëm.

1-Kontrata e vendosjes së bankomateve të bankave të cilat janë vendosur në ambientet e spitalit.

Në lidhje me të ardhurat dytësore si dhe kontratat e qerases mbështetur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 801-825, (akti ligjor të funksionit të kësaj ndërmarrje) si dhe nr, 529, datë 08.06.2011 i ndryshuar me anë të VKM Nr, 54 “Për dhënie me qira ose enfitoteze pasurive shtetërore”.

Kontratë e lidhur në datë 31.12.2019 me Nr 1698/1 Prot, ndërmjet Qendra Spitalore Elbasan dhe subjektit “Banka Kombëtare Tregtare”. Kjo kontratë është e vlefshme nga data 01.01.2020 deri në datë 31.08.2020 dhe subjektit “BKT” duhet ti paguaj Spitalit Rajonal Elbasan një shumë prej 15.000 lekë në muaj. Në datë 01.09.2020, me Nr 1515 Prot, është kryer rinovimi i kontratës me afat 1-vjeçar deri në datë 31.08.2021 si dhe një kontratë po me afat 1-vjeçar në datë 01.09.2021, me Nr 1306 Prot, deri në datë 31.08.2022. Me përfundimin e kësaj kontrate nuk janë kryer më veprime ndërmjet tyre edhe pse BKT ka dërguar një shkresë zyrtare për rinovimin e kontratës. Aktualisht në ambientet e spitalit vijon të operojë përsëri ky subjekt. Prej datës 23.01.2023 dhe deri aktualisht Spitali Rjonal Elbasan ka lidhur një kontratë qiraje për vendosjen e bankomatit me bankën e nivelit të dytë “C. Bank” Duke qenë se BKT vijon të kryej shërbimin e saj me bankomat brenda këtyre ambienteve prej datës 31.08.2022 e në vazhdim të ardhurat e munguara për Spitalin Rajonal Elbasan janë në vlerë **240.000** lekë. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2100 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5, si dhe VKM Nr, 54 “Për dhënien me qira ose enfitoteze pasurive shtetërore”, Kreu I, pika 6, ku përcaktohet:

“Institucioni shtetëror, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore, që jep me qira, për një afat deri në 1 (një) vit”.

2.7. Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

I/a. Mjedisi i kontrollit.

Dokumentacioni i shqyrtuar për auditimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit përfshin:

- Rregulloren e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë datë 6.1.1998 *“Rregullore e shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor (Spitalor).*

- Strukturat organike të miratuara në vite.

- Raportet tematike të auditimit të brendshëm.

- Dokumentet e brendshëm të lëvizjes së mallrave, pagesave, situacionet e ndryshme etj. Baza ligjore referuese në ndihmë të auditimit për vlerësimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit është Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Urdhri i Ministrisë të Financave nr. 108 datë 17.11.2016 *“Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, udhëzimet specifike në zbatim të ligjit të mësipërm etj.

Menaxhimi financiar dhe Kontrolli ka hasur disa problematika:

- Spitali Rajonal Elbasan nuk ka depozituar asnjë deklaratë apo raport vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk ka plotësuar pyetëtorin e vetëvlerësimit për vitet objekt auditimi.

-Njësitë nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

-Elementët e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar kuptohen pak nga njësitë dhe ka nevojë për përditësimin dhe rritjen e njohurive për ngritjen e një sistemi të fortë kontrolli për të ofruar siguri të arsyeshme në lidhje me arritjen e objektivave që lidhen me funksionimin, raportimin, përputhshmërinë dhe vendimmarrjen.

-Mungesa e një rregulloreje të përditësuar sipas strukturave të përditësuara organike, mungesa e vetëvlerësimit të brendshëm me anë të pyetëtorit, mungesa e regjistrimit të risqeve dhe elementëve të tjerë të vlerësuar në bazë të manualit për menaxhimin financiar për kontrollin, evidenton nevojën për përmirësimin e gjendjes në vazhdimësi dhe marrjen e masave për funksionimin si duhet, në bazë të vlerësimit sipas përbërësve të secilit prej pesë komponentëve.

-Në kuadër të përmirësimit të mjedisit të kontrollit, si një komponent i MFK nuk është identifikuar nevoja për hartimin e politikave, për miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë, të planit strategjik vjetor, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave.

-Nuk janë kryer trajnime të mjaftueshme nga insitucioni për të bërë të mundur njohjen e këtyre koncepteve dhe përmbushjen e kërkesave ligjore për raportimin për gjendjen e sistemeve të kontrollit të kësaj njësie.

-Nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan janë zbatuar pjesërisht përcaktimet ligjore të bëra në nenin 20, 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se:

Mjedisi i kontrollit përmban:

-Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;

-Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.

Menaxhimi i riskut përmban:

-Identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike

miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht:

-procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta;

-Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin;

-Miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi,

Këto sisteme sigurojnë:

-Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

-Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

-Janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.

-Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

-Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. Struktura e njësisë është e miratuar nga njësi qendrore (Ministria e Shëndetësisë).

-Në funksion të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, në nenin 12, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë nivel i menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të Spitalit. Ky nëpunës duhet të mbulojë funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Në bazë të kërkesave të këtij neni "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues", cilësohet se "Nëpunësi zbatues i njësisë publike është punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike, me diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike ose juridike, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike".

-Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Marrëdhëniet e punësimit rregullohen nga Kodi i Punës. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave ka të drejtë të ndër marrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, por konstatohet se në mungesë të rregullores së përditësuar, nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Qëndrimi mbështetës – Gjatë auditimit u konstatua se në përgjithësi ka mangësi në kuptimin e kontrollit të brendshëm dhe rolit të secilit pozicion në këtë sistem dhe për këtë arsye nevojitet trajnim i vazhdueshëm.

I/b. Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të vënë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore.

-Vendosja e objektivave: Përgjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se njësi nuk ka objektiva të vendosura dhe në vijim plane pune për arritjen e këtyre objektivave. Si njësi e

varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë, institucioni zbaton disa strategji sektoriale të hartuara dhe miratuara nga MSH, siç është, strategjia e shëndetit publik etj.

-Nga auditimi në lidhje me menaxhimin e riskut konstatohet se nuk ka vlerësim dhe kontroll të risqeve, të cilat venë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrisë së Riskut dhe Strategjisë së Riskut në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nenit 8/a, 10, 11 dhe 21, të këtij ligji. Mungesa e hartimit të regjistrisë së riskut dhe strategjive përkatëse për menaxhimin e tyre ka ndikuar në mos evidentim të risqeve dhe të problematikave lidhur me riskun të cilat nuk trajtohen rast pas rasti.

I/c. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme.

Ndarja e detyrave - Në institucion në sektorin ekonomik janë të ndara detyrat ku funksionet e punës janë të ndara ndërmjet detyrave specifike. Në këtë mënyrë u konstatua se paraqiten nga persona të ndryshëm kërkesat, autorizimet kryhen nga persona të tjerë dhe regjistrimi e pagesa janë të ndara nga njëra tjetra. Për çdo qendër kostoje ka nga një ekonomist të veçantë ku mbahen të dhëna dhe regjistrohen në bazë të fletë hyrjeve dhe daljeve përkatëse. Në sektorin e financës përgatiten pagesat të cilat bashkëlidhen të gjithë dokumentet shoqërues justifikues të cilat autorizojnë kryerjen e pagesave.

Sistemi i dy firmave - Të gjitha pagesat e kontrolluara për dokumentimin e sistemit të kontrollit të brendshëm ishin të firmosura nga punonjës të ndryshëm. Nga ana tjetër, edhe në lëvizjet e brendshme të mallrave, bashkëngjitur fletë hyrjeve apo fletë kërkesave për përdorimin e materialeve ishin të shoqëruara me nënshkrimet e të dy punonjësve.

I/d. Informim komunikimi.

Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme. Institucioni aktualisht nuk ka faqe zyrtare (website) ku të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth aktivitetit të tij.

I/e. Monitorimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar. Në këtë institucion, titullari informohet vazhdimisht nga drejtuesit e mesëm dhe të ulët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve periodikë.

Në drejtim të vlerësimit të auditimit të brendshëm si një element i sistemit të kontrollit të brendshëm u evidentua se me strukturën periudhë auditimi, ka vetëm një punonjës specialist auditit. Bazuar në strukturën organike të institucionit, ky specialist është pjesë përbërëse e Sektorit të Çështjeve Ligjore dhe Auditimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, pika 2, ku përcaktohet:

“Njësia e auditit të brendshëm është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike”.

Auditimi i brendshëm funksion me vetëm një punonjës, i cili është ende i pa certifikuar, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2026 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3, ku përcaktohet:

“Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”.

Pavarësisht mangësive në plotësimin e njësisë së auditimit të brendshëm, nga punonjësja aktuale, janë ushtruar auditime, ku në përgjithësi rezulton si më poshtë:

- Për periudhën objekt auditimi, është hartuar plani strategjik 2023 – 2025, rregullore e auditit të brendshëm dhe karta e auditit të brendshëm.

- Janë hartuar programe, raporte auditimi dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse. Në përgjithësi, nga auditimi i brendshëm është konstatuar se:

- Pacientë të ndryshëm, kryejnë vizita pa rekomandim si dhe pa realizuar pagesën e detyrimit financiar duke qenë të pa siguruar. Po ashtu, pacientët referohen për të kryer analiza laboratorike, numri i të cilave nuk rakordon ndërmjet kabineteve, si dhe realizimi i këtyre analizave realizohet pa realizuar më parë pagesën në arkë.

- Nga verifikimi i arkës ka rezultuar se raporti që printohet në fund të ditës, nuk është i detajuar për secilin zë shërbimi.

- Në shërbimin e maternitetit janë konstatuar mospërputhje midis shkarkimeve (tërheqjeve nga pavionet) sipas të dhënave nga programi i farmacisë, me shkarkimet sipas kartelave të hedhura nga sektori i kostos, pra për periudhën e audituar rezulton të jetë konsumuar më shumë nga sa është tërhequr. Çmimet e materialeve dhe barnave në kartela kishin ndryshime me çmimet e farmacisë.

Arrihet në konkluzionin se elementët e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar kuptohen pak nga njësia dhe ka nevojë për përditësimin dhe rritjen e njohurive për ngritjen e një sistemi të fortë kontrolli për të ofruar siguri në lidhje me vendimmarrjen.

2.8. Problematika të dala gjatë auditimit.

1. Trajtim ankese.

Në zbatim të pikës 5 Programit të Auditimit “Çështje të tjera të dala gjatë auditimit”, pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) është paraqitur ankesa e paraqitur nga punonjësja B. Ll. (H.), me pozicion pune infermiere në shërbimin e poliklinikës me objekt: *“Mbi ligjshmërinë e transferimit nga shërbimi e poliklinikës në shërbimin e kujdesit paliativ dhe njësisë së kimioterapisë”*, protokolluar në KLSH me shkresën Nr.153 prot., datë 26.01.2024.

Rrethanat: Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, *“Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”*, neni 21, pika 1, i ndryshuar; si dhe Urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë me nr.383, datë 22.06.2023, *“Miratimi i strukturës organike”*, me urdhrin nr.1302 prot, datë 25.07.2023 të Drejtorit të Spitalit znj. B. Ll. i komunikohet transferimi si infermiere nga shërbimi i poliklinikës në shërbimin e kujdesit Paliativ.

Me shkresën me nr. 1400 prot, datë 16.08.2023, znj. B.Ll. paraqet pranë Drejtorisë së Spitalit ankesën, në të cilën kërkon arsyetimin dhe argumentat e lëvizjes së kryer si dhe vënien në dispozicion të kopjes së Urdhrit nr. 383, datë 22.06.2023, *“Miratim i strukturës organike”*, nga ku një kopje e ankesës i drejtohet dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Me urdhrin nr. 1400/1 prot, datë 16.08.2023, Drejtoria i kthen përgjigje znj. B.Ll. ku i citon se: Sipas ndryshimeve të bëra në Strukturën Organike të Spitali Rajonal Elbasan, në zbatim të Urdhrit nr. 383, datë 22.06.2023 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në shërbimin e Poliklinikës është suprimuar pozicioni i infermieres ECHO, pozicion të cilin e mbulonit ju. Gjendur në këto kushte, në zbatim të Kodit të Punës, jemi të detyruar të kryejmë transferimin tuaj në infermiere në Shërbimin e Kujdesit Paliativ dhe Njësisë së Kimioterapisë pasi janë hapur 4 (katër) vende të reja për infermiere ndryshe nga struktura e vjetër ku kishte vetëm 2 (dy). Sa i përket kërkesës tuaj për të kaluar si teknike imazherie në spital, aktualisht është një kërkesë e pamundur të realizohet si shkak i mungesës së vendeve të lira të punës.

Shërbimi i Imazherisë është i plotësuar dhe me strukturën e re nuk ka patur ndonjë ndryshim Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të Strukturës Organike të Shërbimit të Poliklinikës, sipas kërkesës tuaj.

Me pas në zbatim të VKM nr. 419, datë 04.07.2018 *“Për krijimin, mënyren e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”*, Urdhrit nr.18, datë 17.01.2019, *“Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Mënyrën e Funksionimit dhe të Organizimit të Operatorit të Kujdesit Shëndetësor”*, të Ministrisë së Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), Drejtoria Qendrore i drejtohet Operatorit të Kujdesit Shëndetësor Elbasan ku informon këtë të fundit mbi ankesën e paraqitur të shkresës me nr. 2433/1 prot, datë 30.08.2023, me lëndë: *Shkresë përcjellëse për trajtim dhe vlerësim* si më poshtë: Operatori i Kujdesit Shëndetësor Elbasan i përgjigjet Drejtorisë Qendrore nga ku i shpjegon: *Në lidhje me ankesën e znj. B. Ll. dhe nga komunikimet me Spitalin Rajonal Elbasan, ju informojmë se nga Strukturat e reja të ardhura nga MSHMS Tiranë, është suprimuar vendi vakant Infermier në ECHO i cili mbulohet nga Znj. B. Ll.*

Për shkak të këtij ndryshimi Spitali Rajonal Elbasan propozon transferimin e znj. B. Ll. në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Kernioterapisë, ku nga 2 (dy) infermierë u oënë 4 (katër) infermierë.

Gjithashtu theksojmë se Znj. B.Ll. do të ketë dhe ka të njëtin trajtim në pagë dhe po ashtu do të jetë infermiere që do të mbulojë vetëm turnin e parë, për shkak të natyrës së punës që ka kjo Klinikë (të sëmurët e kryejnë kimioterapinë vetëm gjatë paradites, ose turnit të parë).

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën nr.1471/1 prot datë 06.09.2023 të Spitalit Rajonal Elbasan.

Konkluzion:

Nga ana jonë u verifikua struktura organizative e miratuar nga MSHMS me nr. 2005 prot, datë 06.05.2022, për vitin 2022 si dhe struktura me nr.1953/1 prot, datë 22.06.2023, nga ku rezultoi se është suprimuar pozicioni Infermier në ECHO i cili mbulohet nga znj. B. Ll. Ndodhur në këto kushte u vlerësua që znj. B.Ll. duke marr në konsideratë faktin që për shkak të eksperiencës të saj transferimi të bëhet në shërbimin e kujdesit paliativ dhe njësisë së kimioterapisë për shkak dhe të natyrës specifike të shërbimit pasi kujdesi paliativ trajton jo vetëm çështje e vuajtjes fizike nga sëmundja, por edhe çështje që lidhen me të drejtën njerëzore. Për me tepër që znj. B.Ll. do të mbulojë vetëm turnin e parë për shkak se të sëmurët e kryejnë kimioterapinë vetëm gjatë paradites. Në lidhje me këtë çështje gjithashtu me datë 04.03.2024 u zhvilluar një takim ballafaques me znj. B.Ll. dhe Përgjegjësën e Burimeve Njerëzore në të cilin iu komunikua znj. B.Ll. verbalisht vendimi mbi transferimin e saj për shkak të suprimimit të vendit të punës, që vjen për shkak të miratimit të strukturës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Më pas në lidhje me pozicionin e përcaktuar pranë Kujdesit Paliativ si infermiere në prani të grupit të auditimit iu bë e ditur znj. B.Ll. që intensiteti apo fluksi i punës është i përballueshëm pasi ai repart ka disa infermiere dhe mjeke të cilët kanë peshën me të madhe të punës. Gjithashtu iu bë e ditur se duke marr parasysh faktin që është alergjike nuk do të cënohet apo do ti krijohet vështirësi në procesin e punës. Gjithashtu në shërbimin e Kujdesit Paliativ znj. B.Ll. do të mbulojë vetëm turnin e parë.

2. Mbi administrimin e aparaturave të hemodializës.

Në lidhje me aparaturat e dializës pas lidhjes së kontratës koncesionare “Për ofrimin e shërbimit të Hemodializës” duke qenë se me lidhjen e kontratës koncesionare, këto aparatura nuk i shërbejnë më Institucionit pasi në kontratë nuk është përfshirë përdorimi i tyre, nuk është ndërmarr asnjë veprim në lidhje me procedurën që do ndiqet në lidhje me ato aparatura si psh (*nxjerrjen jashtë përdorimit, përfshirjen në kontratën koncesionare, dhurimin për një Spitali tjetër etj*) Pra këto aparatura të reja në gjendje pune kanë qëndruar të magazinuara prej vitit 2016 duke mos kryer asnjë procedurë apo veprim të caktuar në lidhje me to, duke korresponduar me MSHMS. Pra, ndryshe nga Inventarizimi periodik të cdo viti të aktiveve të Spitalit, për këto aktive nuk është përcaktuar apo propozuar një rregull specifik në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, dhurimin etj. Si rrjedhojë nuk është hartuar gjurma e auditimit për monitorimin e këtyre aktiveve në kundërshtim me nenin 8, pika 1, 8,a), b), c), d) të Ligjit nr.102096, datë 08.07.2010 “Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; si dhe pikën 5, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku citon:

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike⁴ në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

Miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

Situata është shprehur në mënyrë më të detajuar si më poshtë:

Kontrata Koncesionare “Për shërbimin e Hemodializës” të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Tregtare “D.” shpk me nr. 1503/44 prot, datë 10.02.2016, me objekt:

- "Ofrimi i shërbimit të hemodializës pranë spitaleve rajonale Shkodër, Lezhë, Korçë, Elbasan, Vlorë,

-Rehabilitimi i hapësirave ekzistuese në Shkodër, Vlorë dhe Elbasan, rehabilitimi i ambienteve dhe ndërtimi i hapësirave të reja në Korçë dhe Lezhë,

-Pajisje me aparatura laboratorike si cellcounter, autoanalizator biokimik dhe analizator imunologjik dhe të tjera shërbime të përfshirë në objektin e koncesionit" etj.

Kjo kontratë ka për qëllim përmirësimin, ndërtimin dhe rinovimin e ambienteve bazuar në standardet më të larta dhe ofrimin e shërbimit sa më pranë qendrave të banimit për pacientët. Bazuar në VKM nr. 308, datë 21.05.2014, "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor", e cila përcakton paketat e shërbimeve shëndetësore dhe çmimet përkatëse që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në të cilën përfshihet paketa e shërbimit të Dializës, rezultoi se: Përpara lidhjes së kontratës koncesionare, shërbimi i hemodializës ofrohej nga Spitali i cili ishte i pajisur me aparaturat e nevojshme të cilat ofronin shërbimin e Hemodializës të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 23

Nr	Emertimi	Prodhuesi	Modeli	NR.Inventari	Nr. Serie	Viti I Prodhimit	Cmimi
1	Zbutes Uji per dialize	Fresenius	AquaB 500I	18855	54750077	2004	474,000
2	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19180	5VCAY087	2004	1,128,906
3	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19181	5VCAY083	2004	1,128,906
4	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19182	5VCAY093	2004	1,128,906
5	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19183	5VCAY091	2004	1,128,906
6	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19185	5VCAY082	2004	1,128,906
7	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19186	5VCAY086	2004	1,128,906
8	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19187	5VCAY089	2004	1,128,906
9	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19184	2SXAE164	2012	2,298,000
10	Aparat Dialize	Fresenius	4008 S	19189	OVCATG42	2013	1,761,543

Burimi: SRE

Nga intervistat e kryera me punonjësit si dhe komisionin e Inventarizimit të aktiveve duke u mbështetur në të dhënat e inventarizimit të kryer në mënyrë periodike për çdo vit rezultoi se 8 aparatura janë të viteve 2004 dhe tërësisht të amortizuara pasi jetëgjatësia e tyre është mesatarisht 10 vjet ndërkohë që 2 aparatura, konkretisht me nr. 9, nr. 10 janë drejt amortizimit total, por në vitin 2016 që përkon me fillimin e kontratës koncesionare kanë qenë të reja dhe në gjendje pune. Nga ana e Ministrisë si organ qendror si dhe nga Drejtoria e Spitalit nuk është kryer asnjë veprim apo korrespondence në lidhje me procedurën që do të ndiqet në lidhje me to. Si rrjedhojë duhet të ishin marr masa dhe të ishte përcaktuar një procedurë si psh (*nxjerr jashtë përdorimit të tyre, dhurimi i tyre një Spitali Rajonal etj.*). Nga ana e Institucionit këto pajise gjithashtu mund të ishin dhuruar për një Spitali Rajonal apo Bashkiak, pasi duke qenë se ofrimi i shërbimit të dializës nënkupton një proces të vështirë dhe specifik :kur një i sëmurë humb përfundimisht funksionin e veshkave, i cili matet me Urenë në gjak > 200 mg/dl, Kreatinin > 8 mg/dl, apo GFR < 10 ml/min, i sëmurë i nënshtrohet procesit të mjekimit me veshkë artificiale (Hemodializë apo Dializë Peritoneale). Pra në këtë rast dhënia e aparaturave për një Spitali tjetër Rajonal apo Bashkiak do të lehtësonte marrjen e mjekimit për pacientët në nevojë dhe larg qytetit të Tiranës.

Mos kryerja apo mos ndjekja e një procedurë të caktuar sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin për MFK dhe Udhëzimin për Menaxhimin e Aktiveve mbi aparaturat e dializës, pas lidhjes së kontratës koncesionare, për 2 nga ato aparatura të cilat në momentin e lidhjes së kontratës koncesionare ishin të reja dhe në gjendje pune.

Nga intervistat e kryera me punonjësit si dhe komisionin e Inventarizimit të aktiveve duke u mbështetur në të dhënat e inventarizimit të kryer në mënyrë periodike për çdo vit rezultoi se 8 aparatura janë të viteve 2004 dhe tërësisht të amortizuara pasi jetëgjatësia e tyre është mesatarisht 10 vjet, ndërkohë që 2 aparatura, konkretisht me nr.9, nr.10 janë drejt amortizimit

total, por në vitin 2016 që përkon me fillimin e kontratës koncesionare kanë qenë të reja dhe në gjendje pune. Nga ana e Ministrisë dhe Drejtorisë së Spitalit, përpara, gjatë, dhe pas lidhjes së kontratës koncesionare nuk është kryer asnjë veprim praktik apo korrespondence në lidhje me aparaturat e reja të vitit 2012, 2013 si dhe procedura që do të ndiqet në lidhje me to. Si rrjedhojë duhet të ishin marr masa dhe të ishte përcaktuar një procedurë si psh (*nxjerr jashtë përdorimit të tyre, dhurimi i tyre një Spitali Rajonal, përfshirja në kontratë etj*). Nga ana e Institucionit këto pajise gjithashtu mund të ishin dhuruar për një Spitali Rajonal apo Bashkiak, pasi duke qenë se ofrimi i shërbimit të dializës nënkupton një proces të vështirë dhe specifik: kur një i sëmurë humb përfundimisht funksionin e veshkave, i cili matet me Urenë në gjak > 200 mg/dl, Kreatinin > 8 mg/dl, apo GFR < 10 ml/min, i sëmuri i nënshtrohet procesit të mjekimit me veshkë artificiale (Hemodializë apo Dializë Peritoneale). Pra në këtë rast dhënia e aparatrave për një Spitali tjetër Rajonal apo Bashkiak do të lehtësonte marrjen e mjekimit për pacientët në nevojë dhe larg qytetit të Tiranës.

Veprime në kundërshtim me ligjit nr.10 2096, datë 08.07.2010 “*Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nën 8, pika 1, 8,a), b), c), d) dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pika 5.*

Shpenzim i njësisë në mungesë të një menaxhimi me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve për 2 aparaturat e reja në gjendje pune me vlerë **4,059,543 lekë**. Mos propozimi i një rregulli specifik në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen apo dhurimin e tyre për dy nga aparaturat e reja në gjendje pune në momentin e lidhjes së kontratës koncesionare e të cilat me lidhjen e kontratës dalin jashtë funksionit.

Kontrata Koncesionare e lidhur ndërmjet MSHMS dhe anëtarëve të Konsorciumit, “E. S.” Shoqëri Franceze (25%), “L.” Shoqëri Shqiptare (41.7%), A. L. S. B.V Shoqëri Hollandeze (33.3%) me nr. 1924/2 prot, datë 10.04.2019, “*Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore*”,

Ministria e Shëndetësisë i ka dërguar për ndjekje Kontratën e koncesionit /PPP “*Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore*” me anëtarët e Konsorciumit nënshkruar nga MSHMS në Prill 2019, me qëllim sigurimin apo ofrimin e Shërbimeve Laboratorike Mjekësore për Popullatën nëpërmjet disa kushteve, rregullave apo udhëzimeve të përcaktuara në kontratë si:

-*Investim i kryer nga koncesionari i cili do ri projektoje dhe modifikojë nëse është e nevojshme përshtatjen e ambjenteve duke i siguruar gjithashtu dhënien e shërbimit sa më cilësor në procesin e kryerjes së analizave në përputhje me standardet e kërkuara dhe ato të OBSH.*

-*Kryerja e analizave për Pacientët e Referuar, identifikimi i tyre bëhet nga Mjekët Referues në përputhje me Sistemin e Referimit të cilët referojnë pacientët për të kryer analizat.*

-*Bashkpunimi i Koncesionarit me Spitalet Referuese ku përgatiten formularët e referimit të analizave të cilat duhet të jenë në përputhje me paketën e shërbimit të ofruar nga Koncesionari me disa elementë të përfshirë si (emri i Spitali Referues, numri i identifikimit të Spitalit, Emri i Mjekut Referues, cdo informacion për të verifikuar rregullat e vendosura nga Autoriteti, emrin e Pacientët të Referuar, numrin e identifikimit të Pacientit, Barkodin) si dhe rregulla të tjera të cilësuar në Kontratë.*

-*Plotësim i formularit të nënshkruar si dhe përcjellja drejt koncesionarit në 2 kopje.*

-*Procesi kryerjes së analizave deri në marrjen e rezultateve të analizave.*

-*Etj.*

Kjo kontratë gjithashtu ka të përcaktuar (Të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme të Koncesionarit), si:

Detyrimet e Koncesionarit

a)*Koncesionari do të përgatis të gjithë dokumentet e projektimit dhe do të kryejë punimet;*

b)*Financojë, prokurojë, instalojë dhe mirëmbajë pajisjet;*

c)*Ndërtojë rrjetin e shtresëzuar dhe logjistikën e lidhur me të për realizimin e Shërbimeve;*

d)*Do të punësojë personelin;*

e)*Do të shfrytëzojë Objektet Laboratorike si dhe do të realizojë shërbimin;*

Të drejtat e Koncesionarit

Autoriteti do ti garantojë koncesionarit dhe do të detyrojë Spitalet Referuese që ti garantojnë Koncesionarit, të drejtat mbi Lokalet dhe ambientet e përcaktuara në nenin 8, nga data e dorëzimit të Lokaleve deri në mbarim të kohëzgjatjes apo datën e zgjidhjes së parakohshme të kontratës;

b) Autoriteti do ti japë dhe do të detyrojë Spitalet Referuese që ti japin Koncesionarit, nga Data Reale e Komisionimit të Objektivit Laboratorik, në Spitalin përkatës Referues, ekskluzivitetin për ofrimin e Shërbimeve tek Pacientët e Shtruar të Referuar dhe Pacientët e Urgjencës të Spitalit Referues, përveçse sikundër parashikohet në nenin 3.3.2; Në lidhje me Pacientët Ambulatorë të Referuar, Autoriteti nuk mund t'i japë ekskluzivitet Koncesionarit për sa kohë që Pacientët Ambulatorë të Referuar janë të lirë të kryejnë Analiza me shpenzimet dhe kostot e tyre me ofrues të tjerë të Shërbimeve Laboratorike, por në asnjë rast Autoriteti nuk mund të kontrakttojë shërbime nga ofrues të tretë të Shërbimeve Laboratorike për Pacientët Ambulator të Referuar;

c) Autoriteti do të detyrojë Spitalet Referuese të paguajnë Tarifën e Shërbimit në mënyrën dhe afatin e përcaktuar;

Në aspektin financiar në Kreun VII, pika 22 të kontratës janë përcaktuar Tarifat dhe Tavanet e Buxhetit si më poshtë:

Tarifat dhe Tavanet e Buxhetit

22.1(Tarifat) Duke filluar nga data reale e komisionit të objektivit laboratorik për secilin Spital referues, Autoriteti siguron që këto spitale referuese ti paguajnë koncesionarit tarifën e shërbimit për të gjithë analizat e kryera në bazë të rekomandimeve të mjekëve referues, gjithmonë mbi bazën e tavanit të buxhetit;

22.1.1. Tarifat e Shërbimit për një Spitali Referues llogaritet në përputhje me tarifën e parashikuar në Shtojcën 3 (Analiza dhe Tarifat e Shërbimit), në bazë të analizave të kryera nga Koncesionari gjatë një periudhë buxhetore për Pacientët e Referuar nga ai Spitali Referues;

22.4(Tavanet e Buxhetit)

22.4.1. Në çdo periudhë të caktuar Buxhetore, Koncesionari do të njoftojë Drejtorinë e Spitalit Referues, duke vënë në dijeni gjithashtu dhe Përfaqësuesin e Autoritetit dhe Përfaqësuesin e FSDKSH, brenda 2 ditëve nga data kur Tarifat e Shërbimeve të pagueshme për numrin e përgjithshëm të Analizave të kryera nga Koncesionari për çdo Spital Referues tejkalojnë:

- a) Pesëdhjetë përqind (50%)
- b) Shtatëdhjetë e pesë përqind (75%), dhe
- c) Njëqind përqind (100%)

22.4.2. Kur në një periudhë të vetme buxhetore, Tarifat e Shërbimeve të pagueshme për numrin e përgjithshëm të Analizave të kryera nga Koncesionari për një Spital Referues arrijnë në 75% të Tavanit të Buxhetit dhe Koncesionari duhet të njoftojë Drejtorinë e Spitalit referues në përputhje me nenin 22.4.1, Drejtori i Spitalit Referues brenda 3(tre) ditësh informon me shkrim koncesionarin duke vënë në kopje Autoritetin dhe FSDKSH-në, në lidhje me vendimin e tij për të:

Vazhduar marrjen e Shërbimeve Mjekësore për të gjithë pacientët e trajtuar deri sa të arrihet 100% e Tavanit të Buxhetit (**Alternativa A**), ose:

- a) Vazhduar marrjen e Shërbimeve Mjekësore vetëm për analizat urgjente deri sa të arrihet 100% e Tavanit të Buxhetit (**Alternativa B**)

Nëse Koncesionari nuk merr përgjigje brenda 3(tre) ditësh ai vazhdon të ofrojë Shërbimet Mjekësore për Spitalin Referues në bazë të **Alternativës B**

Tavanet buxhetore të cdo muaji janë përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.23, datë 18.01.2023, vendim i cili përvec buxhetit të miratuar për cdo shërbim spitalor ka të përfshirë financimin e kontratës koncesionare të laboratorit të ndarë sipas muajve respektive. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga korrespondenca e Spitalit me

Koncesionarin rezulton se ka tejkalim të Tavanit Buxhetor konkretisht për vitin 2021 në masën 116 %, vitin 2022 në masën 100.7 % dhe vitin 2023 në masën 109.3% si më poshtë:

Tavani buxhetor viti	Planifikuar	Realizuar	Diferenca	Realizuar në %
2021	51,063,000	59,651,844	8,588,844	116 %
2022	89,131,000	89,807,900	676,900	100.7 %
2023	90,000,000	98,380,224	8,380,224	109.3 %

Përlllogaritja apo tavani i përcaktuar është kryer me Vendim të Këshillit të Ministrave, parashikuar nga grupi i ekspertëve i ngritur si bashkëpunimi i IFC me MSHMS dhe MFE. Pra referuar zbatimit të kontratës rezulton se është tejkaluar Tavani Buxhetor i përcaktuar si dhe bazuar nenin 22.4.1, alternativa b) të kësaj kontrate është vazhduar me marrjen e shërbimeve mjekësore vetëm për analizat urgjente duke lenë një pjesë të popullatës pa analiza të kryera. Referuar emailit të dërguar në datën 24 Janar 2020, tavani buxhetor përcaktohet nga të dhënat statistikore që dërgohen nga Drejtoria e Spitalit mbi aktivitetin që kryhet. Tavani buxhetor i tejkaluar është në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 22.4 si dhe V.K.M nr. 23, datë 18.01.2023, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. Veprimet e kryera janë në mospërputhje me Kreu VII, pika 22, Kontrata Koncesionare e lidhur ndërmjet MSHMS dhe anëtarëve të Konsorciumit, “E. S.” Shoqëri Franceze (25%), “L.” Shoqëri Shqiptare (41.7%), A. L. S. B.V Shoqëri Hollandeze (33.3%) me nr. 1924/2 prot, datë 10.04.2019, “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore” me nr.1924/2 datë 10.04.2019.

IV. REKOMANDIMET

A. MASAT ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit të SRE, të audituara me përzgjedhje 40 dosje, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk janë respektuar të gjitha kriteret e Urdhrit Nr.511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, “*Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e personelit të Spitalit Rajonal Elbasan, konstatohet se në përgjithësi mungesat e dokumentacionit janë kryesisht ato të karakterit formal siç janë vërtetim nga prokuroria që nuk ka çështje të hapur në proces, vërtetim gjendje gjyqësore që nuk ka qenë i dënuar më parë, si dhe vlerësime periodike në punë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 22-25, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

1.1. Rekomandimi: AK, strukturat drejtuese, të plotësojnë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosjet e personelit si vërtetim nga prokuroria, vërtetim gjendjes gjyqësore si dhe të kryejnë vlerësime periodike në punë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procesin e inventarizimit të kryer sa i përket aktiveve (aparaturave të Hemodializës) duke u mbështetur në të dhënat e inventarizimit të kryer në mënyrë periodike cdo vit rezultoi se 8 aparatura janë të viteve 2004 dhe tërësisht të amortizuara pasi jetëgjatësia e tyre është mesatarisht 10 vjet, ndërkohë që 2 aparatura, konkretisht me nr.9, nr.10, janë të amortizuara por në vitin 2016 që përkon me fillimin e kontratës koncesionare kanë qenë të reja dhe në gjendje pune. Nga ana e Ministrisë si organ qëndror si dhe nga Drejtoria e Spitalit nuk është kryer asnjë veprim praktik apo korrespondence në lidhje me procedurën që do të ndiqet, përpara, gjatë dhe pas lidhjes koncesionare për ato aparaturat e reja dhe në gjendje pune. Si rrjedhojë duhet të ishin marr masa dhe të ishte përcaktuar një procedurë si psh (*nxjerr jashtë përdorimit të tyre, dhurimi i tyre një Spitali Rajonal etj*). Nga ana e Institucionit këto pajise gjithashtu mund të ishin dhuruar për një Spital Rajonal apo Bashkiak, pasi duke qenë se ofrimi i shërbimit të dializës nënkupton një proces të vështirë dhe specifik: kur një i sëmurë humb përfundimisht funksionin e veshkave, i sëmurë i nënshtrohet procesit të mjekimit me veshkë artificiale (Hemodializë apo Dializë Peritoneale). Pra në këtë rast dhënia e aparaturave për një Spital tjetër Rajonal apo Bashkiak do të lehtësonte marrjen e mjekimit për pacientët në nevojë dhe lart qytetit të Tiranës. Veprime e kryera janë në kundërshtim me Ligjin nr.10 2096, datë 08.07.2010 “*Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nenin 8, pika 1, 8,a), b), c), d)* si dhe Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pika 5.

2.1. Rekomandimi: AK, strukturat drejtuese, nëpërmjet komisionit të inventarizimit të aktiveve për aparaturat e dializës që gjenden të magazinuara, tërësisht të amortizuara dhe jashtë funksionit duhet të kryejnë procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit pasi janë jo në gjendje pune dhe nuk i shërbejnë më Spitalit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Kontrata Koncesionare e lidhur ndërmjet MSHMS dhe anëtarëve të Konsorciumit, “E. S.” Shoqëri Franceze (25%), “L.” Shoqëri Shqiptare (41.7%), A. L. S.B.V Shoqëri Hollandeze (33.3%) me nr. 1924/2 prot, datë 10.04.2019, “*Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore*”. Ministria e Shëndetësisë i ka dërguar për ndjekje Kontratën e koncesionit/PPP “*Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore*” me anëtarët e Konsorciumit nënshkruar nga MSHMS në Prill 2019, me qëllim sigurimin apo ofrimin e Shërbimeve Laboratorike Mjekësore për Popullatën nëpërmjet disa kushteve, rregullave apo udhëzimeve të përcaktuara në kontratë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga korrespondenca e Spitalit me Koncesionarin rezulton se ka tejkalim të Tavanit

Buxhetor konkretisht për vitin 2021 në masën 116 %, vitin 2022 në masën 100.7 % dhe vitin 2023 në masën 109.3%. Përlllogaritja apo taveni i përcaktuar është kryer me Vendim të Këshillit të Ministrave, parashikuar nga grupi i ekspertëve i ngritur si bashkëpunimi i IFC me MSHMS dhe MFE. Pra referuar zbatimit të kontratës rezulton se është tejkaluar Taveni Buxhetor i përcaktuar si dhe bazuar nenin 2.4.1, alternativa b) të kësaj kontrate është vazhduar me marrjen e shërbimeve mjekësore vetëm për analizat urgjente. Referuar email të dërguar në datën 24 Janar 2020, taveni buxhetor përcaktohet nga të dhënat statistikore që dërgohen nga Drejtoria e Spitalit mbi aktivitetin që kryhet. Taveni buxhetor i tejkaluar është në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 22.4 si dhe V.K.M nr. 23, datë 18.01.2023, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 120-125, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit, në bashkëpunim me komisionin IFC, MSHMS, MFE të planifikojnë saktë tavanet buxhetore pasi tejkalimi i tyre jo vetëm që rëndon buxhetin e Spitalit por bën që të vazhdohet me kryerjen e analizave vetëm për raste urgjente duke mos dhënë shërbim mjekësor (kryerje analizash) për të gjithë pacientët. Gjithashtu të ngrihet një komision për monitorimin e kontratës dhe për çdo anomali të konstatuar të raportohet pranë Drejtorisë së Spitalit, MSHMS-së, FSDKSH-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga Spitali Rajonal Elbasan nuk është kryer një planifikim i saktë, ku t’i referohej kërkesave reale buxhetore. Në hartimin e Projekt Buxheteve nuk janë identifikuar nevojat dhe nuk janë paraqitur kërkesat nga departamentet sipas strukturës organizative, pasi nuk ka shkresa të përgjegjësve të sektorëve apo shërbimeve dërguar grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit.

Përsa i përket planifikimit për barna dhe materiale mjekësore (sipas dokumentacionit të vëne në dispozicion) për vitin 2020-2024 ato janë hartuar nga sektori i kostos dhe planifikimit duke mos u bazuar në kërkesat nga shefat e shërbimit dhe farmacia. Sipas informacioneve nga punonjës të farmacisë kjo mënyre planifikimi për barna dhe materiale mjekësore ka sjellë probleme për vitin 2023-2024, duke shkaktuar mangësi për një sasi të konsiderueshme barnash, duke detyruar Autoritetin Kontraktor të zhvillojë procedura prokurimi veçmas nga procedurat që zhvillon MSHMS. Kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29.

Buxheti për të gjitha vitet e auditimit është miratuar nga titullari i institucionit si pasojë e mos ekzistencës së Bordit Drejtues, i cili është krijuar në vitin 2023, me urdhrin me Nr.1507 prot, datë 07.09.2023 në mbështetje të ligjit nr.55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 të VKM-së nr. 36, datë 27.01.2023, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e spitaleve rajonale, terciare dhe qendrave spitalore rajonale publike”, si dhe shkresës, nr. 720/14, datë 28.08.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 15-21, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga ana e SRE të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar.

4.2. Rekomandimi: Nga ana e SRE të merren masa që strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të kryejnë analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatës, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

4.3. Rekomandimi: Bordi Drejtues i SRE të bëjë diskutimin e projekt buxhetit dhe raportit vjetor për ekzekutimin e tij për shërbimet e ofruara, duke siguruar që fondet buxhetore të spitalit dhe përdorimin tyre të bëhen objekt diskutimi dhe miratimi nga kjo strukturë, në cilësinë e organit më të lartë drejtues të institucionit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të auditimit të brendshëm si një element i sistemit të kontrollit të brendshëm u evidentua se me strukturën periudhë auditimi, ka vetëm një punonjës, ende i pa certifikuar. Bazuar në strukturën organike të institucionit, ky punonjës është pjesë përbërëse e Sektorit të Çështjeve Ligjore dhe Auditimit, pra audit i brendshëm nuk funksionon si strukturë më vete. Këto veprime nuk përputhen me përcaktimet e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 116-119, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa për krijimin e njësisë së auditit të brendshëm si strukturë më vete. Gjithashtu të plotësohet kjo strukturë me të paktën tre auditues, prej të cilëve minimalisht një të jetë i certifikuar si auditues i brendshëm.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Organet kolegjiale si Këshilli Administrativ dhe Komisioni Mjekësor nuk funksionojnë pasi nuk ka dokumentacion mbi mbledhjet zhvilluara nga këto organe si dhe vendimet e marra në lidhje me to. Si rrjedhojë, Spitali Rajonal nuk e ka kryer organizimin dhe funksionimin mbështetur në nenet 13, 14, 15 të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH”.

Organet e autoritet spitalor të qarkut janë këshilli administrativ, komisioni mjekësor dhe drejtoria. Komisioni mjekësor është organ këshillimi teknik i drejtorisë dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve. Këshilli administrativ përbëhet nga disa anëtarë dhe ka disa funksione si: miraton politikat, harton programet tekniko-financiare për konkretizimin e planeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e shërbimit spitalor të qarkut, në përputhje me strategjinë dhe politikat shtetërore shëndetësore etj. Mosfunksionimi i organeve kolegjiale si Këshilli Administrativ dhe Komisioni Mjekësor ndikon në përmbushjen e funksioneve të tyre nga Drejtori i Spitali si dhe cenon sigurinë dhe efektivitetin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjithashtu ndikon në mos miratimin e planit spitalor në nivel qarku i cili miratohet nga këshilli administrativ, në përputhje me planin shtetëror spitalor, dhe përcakton parashikimin e ndërhyrjeve në qark të lidhura me ngritjen e spitaleve të reja, me transformimin, modernizimin, nevojave për ndërhyrje në infrastrukture etj. Me urdhrin nr.1507 prot, datë 07.09.2023 u krijua Bordi Drejtues i Spitalit Elbasan me organet drejtuese: Drejtori i Përgjithshëm, Bordi Drejtues dhe Komisioni Mjekësor, duke bërë që organet kolegjiale tashmë janë Bordi Drejtues dhe Komisioni Mjekësor, në mbështetje të ligjit nr.55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11-14, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

6.1. Rekomandimi: Organet drejtuese kolegjiale si Bordi Drejtues dhe Komisioni Mjekësor, duhet të përmbushin funksionet si organe kolegjiale si dhe të mblidhen sa herë e parashikon rregullorja, Ligji dhe VKM, nga ku të dokumentohen mbledhjet e realizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Institucioni nuk ka hartuar statut apo rregullore e cila përcakton funksionet, strukturën, misionin, vizionin, rregullat e spitalit, të drejtat dhe detyrat e personelit, financat dhe çështje të tjera të lidhura me personelin. Ndryshimi i emërtesës të zv. Drejtorëve është bërë pa një VKM të caktuar. Statuti apo rregullorja në të cilën mbështetet institucioni i përket një rregulloreje të vjetër e cila nuk është përditësuar, nuk siguron një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/punonjësve, duke krijuar boshllëk në sistemet e menaxhimit të brendshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11-14, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

7.1. Rekomandimi: Statuti, rregullorja dhe të gjithë dokumentet e nevojshëm për funksionimin e Spitalit të miratohen në mbledhjet e ardhshme të Bordit Drejtues. Përcaktimi i emërtesës të zv/drejtorëve të bëhet sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit për Shërbimin Spitalor.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt, “*Blerje lëndë djegëse briket pellet*”, në lidhje me ndarjen e detyrave për zyrtarët/punonjësit e përfshirë në procesin e prokurimit rezultoi se nuk është bërë një ndarje e qartë e detyrave ndërmjet tyre pasi në përcaktimin e komisioneve sipas urdhrave përkatës, nuk përcaktohet saktë komisioni i përlllogaritjes së nevojave pasi ka ndryshim të 1 (një) anëtari pa urdhër të veçantë të Titullarit, duke mos identifikuar se cili është komisioni i saktë. Gjithashtu në përcaktimin e komisioneve duhet të sigurohet një ndarje e qartë dhe përcaktimi i drejtë, referuar këtu dhe ngritjes me urdhër të veçantë të komisionit të emërtuar komisioni i identifikimit të nevojave, komisioni i cili kryen dhe funksionin e inicimit të procedurës, ndërkohë që kjo detyrë apo indicia e zhvillimit të procedurës duhet gjithmonë të jetë e referuar nga struktura përfituese e mallit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Rregullat e Prokurimit Publik*”, neni 2, pika 1, 2, a), neni 73, neni 74 si dhe Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

8.1. Rekomandimi: AK, strukturat drejtuese, në përcaktimin e komisioneve apo anëtareve të përfshirë në procesin e prokurimit të identifikojnë saktë si dhe të sigurojnë një ndarje të qartë të detyrave ndërmjet zyrtarëve/punonjësve të përfshirë në procesin e prokurimit, e cila fillon me kërkesën e paraqitur nga sektori në nevojë, vijon me ngritjen e komisionit të përlllogaritjes të fondit limit ose në rast mungese ia delegon detyrën njësisë prokurimit si dhe më pas me fazën e hartimit të dokumenteve të tenderit (DT), sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin konstatohen mangësi të cilat kanë të bëjnë me:

- Spitali Rajonal Elbasan nuk ka depozituar asnjë deklaratë apo raport vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk ka plotësuar pyetësonin e vetëvlerësimit për vitet objekt auditimi.

-Njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”.

-Elementët e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar kuptohen pak nga njësia dhe ka nevojë për përditësimin dhe rritjen e njohurive për ngritjen e një sistemi kontrolli për të ofruar siguri të arsyeshme në lidhje me arritjen e objektivave që lidhen me funksionimin, raportimin, përputhshmërinë dhe vendimmarrjen.

-Mungesa e një rregulloreje të përditësuar sipas strukturave të përditësuar organike, mungesa e vetëvlerësimit të brendshëm me anë të pyetësonit, mungesa e regjistrit të risqeve dhe elementëve të tjerë të vlerësuar në bazë të manualit për menaxhimin financiar për kontrollin, evidenton nevojën për përmirësimin e gjendjes në vazhdimësi dhe marrjen e masave për funksionimin si duhet, në bazë të vlerësimit sipas përbërësve të secilit prej pesë komponentëve.

-Në kuadër të përmirësimit të mjedisit të kontrollit, si një komponent i MFK nuk është identifikuar nevoja për hartimin e politikave, për miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë, të planit strategjik vjetor, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

-Nuk janë kryer trajnime të mjaftueshme nga institucioni për të bërë të mundur njohjen e këtyre koncepteve dhe përmbushjen e kërkesave ligjore për raportimin për gjendjen e sistemeve të kontrollit të kësaj njësie. Veprimet e mësipërme janë në mos përmbushje të ligjit nr. Nr.10 296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, neni 8, pika 8.a, neni 10, pika 2.c, neni 27, pika 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 116-119, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan të merren masa për implementimin e përcaktimeve ligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke ngritur grupin e menaxhimit strategjik, depozitimin e raporteve për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përmirësimin e mjedisit të kontrollit, trajnimin e stafit dhe përcaktime të tjera.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Tarifa e parkimit të automjeteve në ambientet e spitalit është përcaktuar nga administrata e spitalit në shumën 100 leke për automjet për çdo hyrje, pa përcaktim të kohës së qëndrimit, e cila është vendosur pa një analizë apo argumentim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 112-115, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Nga ana e drejtimit të Spitalit Rajonal Elbasan të merren masa për realizimin e një analize, mbi bazën e të cilës të përcaktohet çmimi i parkimit të automjeteve në ambientet e spitalit, duke mbajtur në konsideratë si anën ekonomike ashtu dhe interesin publik, pasi ky lloj shërbimi realizohet për individë që kërkojnë shërbime spitalore.

Brenda datës 30.12.2024.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatuan anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si vijon:

- Në procedurën e prokurimit “*Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve*”, është konstatuar se janë kërkuar kategori licencash si dhe automjete të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

- Në procedurën e prokurimit “*Rikonstruksion i godinës së Pediatriisë*”, në kriteret teknike janë përfshirë kategori licencash, automjete si dhe staf teknik të cilat nuk kanë lidhje me proceset e punëve të parashikuara.

- Në procedurën e prokurimit “*Shërbim i hotelerisë dhe lavaxterisë*”, në kriteret e veçanta është kërkuar staf teknik (teknik ose inxhinier elektronik/elektromekanik/mekanik), në mënyrë të pa argumentuar.

- Në procedurën e prokurimit “*Punime meremetime-lyerje në Spitalin Kirurgji-Maternitet*”, janë vendosur kriteret për disponim kategori licencimi, kamionë dhe materiale, jo në përputhje me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

- Në procedurën e prokurimit “*Supervizion për rikonstruksionin e pediatriisë*”, në kriteret e veçanta janë kërkuar kategori licencimi, si dhe staf teknik, jo në përputhje me natyrën e madhësinë e kontratës.

- Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, “*F.V pajisje të ndarjes së ambienteve spitalore*” rezultoi se në lidhje me hartimin e kriterëve teknike për procedurën e prokurimit u konstatua që hartimi i tyre është jo në përputhje me tipologjinë e kontratës pasi janë kërkuar licenca të panevojshme dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit.

Vendosja e kriterëve në mënyrë të pa argumentuar, jo në përputhje me natyrën, madhësinë dhe aftësinë zbatuese të kontratës, ulë konkurrencën, ngushton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, duke lënë jashtë konkurrimit OE të cilët kanë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe mund të ofertojnë me vlera më të ulëta, e si rezultat ndikon negativisht në mundësinë e marrjes së një oferte fituese me vlerë më të vogël.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar neni 41, pika 2. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” (shfuqizuar) neni 26, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, të merren masa për vendosjen e kriterëve teknike ekonomike në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruktion i poliklinikës së specialitetëve*”, komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga punonjës, asnjë prej të cilëve nuk është ekspert i fushës për të cilën realizohet procedura e prokurimit, Mungesa e specialistit të fushës krijon vështirësi në shqyrtimin e ofertave për anëtarët e komisionit, sidomos sa i takon dokumentacionit teknik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 75, pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Spitali Rajonal Elbasan, në mungesë të specialistëve të fushës në strukturën organike, të marrë masa për kontraktimin e tyre, duke kërkuar edhe nga institucione të tjera.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “*Shërbim i hotelerisë dhe lavanterisë*” kanë marrë pjesë 4 OE, nga të cilët tre OE nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë.

OE “S.C.” Shpk, është skualifikuar për arsye se nuk provon se ka ambient ku ushtrohet veprimtaria e shërbimit të lavanderisë (pasi dokumentacioni i pronës cilëson se është ndërtuar në tokë arë), si dhe nuk ka paraqitur vetë deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sipas Shtojcës 7. Sa i takon ambientit, nga ana e kontraktorit është vërtetuar se objekti është në proces legalizimi. Sa i takon mos plotësimit të shtojcës 7, është mangësi, por ka paraqitur vërtetime të cilat plotësojnë kërkesat e kësaj shtojce.

Nga ana e KVO, nuk janë kryer verifikime si dhe nuk janë kërkuar sqarime referuar ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” (i shfuqizuar), neni 53, pika 1, pavarësisht se OE i skualifikuar ka kontrata në proces me autoritete të tjerë kontraktorë, ka paraqitur disa vërtetime për plotësimin e kriterëve të përgjithshme. Nuk është marrë në konsideratë kriteri i çmimit më të ulët sipas seksionit 4.2 të dokumenteve të tenderit. OE ”S. C.”, ka paraqitur ofertë më të ulët se oferta financiare e OE fitues me vlerë 4,881,420 lekë (112,272,660 lekë – 107,391,240 lekë). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Për realizimin e procedurave në vijimësi, të merren masa për angazhimin e punonjësve me eksperiencë në fushën e prokurimit publik, në mënyrë që procedurat të zhvillohen duke plotësuar kërkesat e ligjit dhe parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Përlllogaritja e fondit limit për procedurën “*Blerje lëndë djegëse briket pellet*” është kryer jo në përmbajtje me parimet e Ligjit për MFK, pasi në identifikimin e sasisë së lëndës djegëse, në përcaktimin e kohëzgjatjes së orarit të ndezjes së kaldajave duke qenë se nuk ka një bazë ligjore të cilës mund ti referohet, AK mund të ishte mbështetur në praktikat më të efektshme apo më të dobishme të realizuara nga Institucione të ngjashme pasi kohëzgjatja e ndezjes si dhe sasia e përlllogaritur nga AK është më e lartë se ajo e realizuar nga këto Institucione të ngjashme. Më konkretisht komisioni i ngritur i identifikimit të nevojave dhe përlllogaritjes të vlerës limit të kontratës kreu përlllogaritjen e fondit limit për periudhën, (01.01.2023-15.03.2023) dhe (15.11.2023-31.12.2023), e përkthyer 120 ditë kalendarike, që përkon me sezonin e dimrit ose sezoni i ndezjes së kaldajave. Vlera e fondit limit të përlllogaritur rezultoi 8,252,268 leke pa TVSH. Në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, në përcaktimin e sasisë rezultoi se: Komisioni, është mbështetur mbi bazën e konsumit apo harxhimit të lëndës djegëse (briket pelet), të mbajtur ndezur për 12 orë pune pranë godinave në të cilat ndodhen kaldajat. Sipas procesverbalit të hartuar rezultoi se konsumi i lëndës djegëse është 1740 kg për të gjitha godinat spitalore. Në gjykimin e audituesve, në përcaktimin e kohëzgjatjes të ndezjes së kaldajave prej 12 orësh, AK nuk ka një bazë ligjore apo një VKM në fuqi, (*referimin ligjor, normativat e përcaktuara nga institucione përgjegjëse, udhëzim të MSHMS etj.*), e cila argumenton apo justifikon orarin apo kohëzgjatjen e përcaktuar. Grupi i

auditimit siguroi të dhëna në lidhje me praktikat e ndjekura nga Institucione të ngjashme me të njëjtën natyrë shërbimi, me të njëjtat kushte klimaterike nga Spitali Rajonal Berat, Spitali Rajonal Gjirokastrë, në të cilat kontratat e realizuara janë të suksesshme dhe nuk janë evidentuar problematika sa i përket sigurimit me ngrohje, nga ku rezultoi se kohëzgjatja e përcaktuar është mesatarisht 6-9 orë ndezje. Pra në rast se AK do ti referohej praktikave të ndjekura nga këto Institucione, marrë si referim 9 orë në ditë sasia e përlogaritur do ishte 1305 kg, në çdo rast e shoqëruar me analizë nëse kjo kohëzgjatje e përcaktuar është e mundur të realizohet nga Institucioni. Pra nga ana e Institucionit nuk janë marrë praktikat më të mira të ngjashme të cilat i sjellin shpenzim me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

14.1. Rekomandimi: AK, zyrtarët e përfshirë në procesin e prokurimit, në zbatim të detyrave funksionale, referuar përlogaritjes së fondit limit si dhe proceseve të tjera të procedurës duhet t'i referohen praktikave të mira të cilat janë të dobishme si dhe i sjellin Institucionit përdorim me ekonomikitet të fondeve në zbatim të parimeve të Ligjit për MFK. Pra referuar procedurës, “Blerje briket pellet” AK, mund të marr në konsideratë praktikat e ndjekura nga Spitalet e tjera Rajonale, metodologjinë e ndjekur nga ana e tyre, në të cilat kontratat e lidhura me kontraktor privat kanë rezultuar të suksesshme dhe vlera e realizuar është më e ulët se ajo e Spitalit Rajonal Elbasan.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurën “Blerje lëndë djegëse briket pellet” nuk janë argumentuar kriteret e vendosura nga AK, e cila mjaftohet vetëm me listimin e tyre në terma të përgjithshëm në të cilën evidentohet vetëm baza ligjore të cilën i referohet AK por pa u kryer asnjë argumentim teknik referuar kapaciteteve teknike, specifitimeve teknike. Më konkretisht kërkesa apo kriteri i përcaktuar që OE pjesëmarrës duhet të disponojnë 2 kaldaja është e pa argumentuar nga ana e NJP, pasi nuk ka dhënë arsytimin mbi nevojën se përse OE duhet të disponojnë apo të kenë në pronësi 2 kaldaja për më tepër që nuk ka udhëzim për këto OE se si duhet te veprojnë në lidhje me kaldajat si p.sh. *(kaldajat duhet të jenë në pronësi pasi malli duhet të përputhet me to, kaldajat duhet të dorëzojë pranë AK pasi AK nuk ka mjaftueshëm buxhet të sigurojë blerjen e tyre, OE duhet të disponojë kaldaja pasi në rast konstatim defekti duhet të riparohet apo zëvendësojë ato, etj).* Mos përcaktimi i drejtë i tipologjisë së kontratës dhe mos argumentimi i kriterëve teknike është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, neni 78, pika 2, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 5, neni 8, neni 12. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

15.1. Rekomandimi: AK, strukturat drejtuese, NJP duhet të mirë argumentojnë çdo kërkesë apo kriter të mundshëm në mënyrë të tillë që ato kërkesa apo kriteret të kuptohen qartë, të jenë të lidhura ngushtë me tipologjinë e kontratës si dhe duhet të sigurojnë një trajtim të barabartë ndërmjet ofertuesve. Gjithashtu, të përcaktohet drejtë tipologjia e kontratës pasi nëse AK përveç nevojës mallit “briket pellet”, kërkon nga OE që të dorëzojnë dhe kaldajat, duhet të ndahet procedura me lote pasi mos ndarja me lote nuk nxit konkurrencën dhe ul numrin e pjesëmarrësve duke qenë se një pjesë e OE në treg operojnë vetëm në tregtimin e mallit pellet.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të OE “F.&B.” shpk të shpallur fitues për procedurën “Blerje lëndë djegëse briket pellet”, rezultoi se ky OE nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DT pika (2.2 kapaciteti teknik, pika 4) pasi katalogu i paraqitur në SPE dhe në dokumentacionin fizik rezultoi se nuk është i vulusur nga ofertuesi, nuk ka të markuar modelet për artikujt që ofron sipas specifitimeve teknike, nuk është deklaruar numri i fletëve si dhe nuk identifikohet firma prodhuese. Pra nga ana e KVO është bërë vlerësim jo i drejtë i OE pjesëmarrës. Veprimet e kryera në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

16.1. Rekomandimi: AK, KVO, në ato raste ku gjykon që përmbushja e kërkesave apo kritereve nuk cenon thelbësisht kushtet, karakteristikat apo kriteret e tjera të kontratës të kualifikojë OE me ofertën më të ulët, duke e konsideruar raste devijimesh të vogla, në të kundërt në ato raste ku këto kushte, karakteristika cenohen të s’kualifikohen këto oferta.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit, “*Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike*”, rezultoi se, sipas një analize të bërë nga grupi auditimit vlera e fondit limit të përlllogaritur nga audituesit rezulton **9,916,344 lekë pa TVSH** më e ulët se ajo e përlllogaritur nga AK.

Komisioni i përlllogaritjes të fondit limit, në përcaktimin e numrit të nevojshëm të mbulimit me shërbim me roje, mund të realizonte shërbimin me më pak punonjës, duke iu përmbajtur parimeve të Ligjit për MFK, e cila lidhet me një shpenzim të njësisë në mungesë të menaxhimit me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet. Më konkretisht lidhje “*përlllogaritjen e fondit limit*”, në përcaktimin e numrit të turneve 7 vend-roje me 3 turne, AK nuk i është përmbajtur parimeve të ekonomikitet pasi:

Së pari, në Godinën e Administratës si dhe Godinën e Telemjekësisë nuk është e nevojshme që mbulimi me shërbimin të ofrohet me 3 turne duke qenë se (*Godina e Administratës, Telemjekësia, Kirurgjia*) ndodhen fare pranë njëra tjetrës, në një perimetër të afërt me një fushëpamje të qartë të cilat mund të monitorohen lehtësisht nga një punonjës shërbimi pas orës 16.00 pasi bie ndjeshëm dhe fluksi lëvizjes, pra që përkon me turnin e II dhe të III.

Së dyti, në (*Godinën e Administratës dhe Telemjekësisë*) në lidhje me mbulimin me shërbim duhet të ishte marr në konsideratë që mbulimi i shërbimit të realizohet me 1.5 turne me 12 orë. Pra duke qenë se Godina e Administratës pas orarit zyrtar të punës qëndron e mbyllur si dhe Telemjekësia qëndron gjithmonë e mbyllur dhe vetëm në raste specifike përdoret nga mjeku kur vlerëson gjendjen e pacientit në distancë, mbulimi i shërbimit me 12 orë, pra 1.5 turne nuk do cenonte sigurinë Institucionit pasi ky shërbim mbulohet nga punonjësi i shërbimit i Maternitetit i përcaktuar me 3 turne, për me tepër që në rast nevojë për ndërhyrje urgjente në rast dëmtimi apo vjedhje punonjësi shërbimit njofton sallën për ndërhyrjen e shpejtë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

17.1. Rekomandimi: AK, në procedurën e ardhshme me të njëjtën tipologji kontratë, duhet të veprojnë: **Së pari**, mund të marr në konsideratë kontraktimin e shërbimit nga Shoqëria me kapital 100% shtetëror, “I.G” SHA, pasi është shoqëri me pronar të 100% të aksioneve të saj shtetin si dhe është krijuar me qëllim ofrimin e këtij shërbimi nga kjo Shoqëri e cila përfaqëson shtetin si pronar. **Së dyti**, në rast pamjaftueshmërie të buxhetit për kontraktimin e Shoqërisë “I.G” SHA të ndiqet metodologjia me më pak punonjës shërbimi në Godinën e Administratës dhe Telemjekësisë me shërbim ruajtje me 1.5 turne/12 orë nuk i cenon AK garantimin e ruajtjes dhe sigurisë si dhe lidhet me zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit e cila përbën një shpenzim të njësisë pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

Më konkretisht grupi auditimit gjykon që 5 vend-roje (Kirurgjia, Urgjenca, Godina e Sëmundjeve Interne, Materniteti si dhe Poliklinika), të mbulohen me shërbim 24 orësh me 3 turne e përlllogaritur me vlerë 38,878,660 leke pa TVSH. Ndërkohë që Godina e Administratës si dhe Godina e Telemjekësisë, përlllogaritet me vlerë 5,527,320 lekë pa TVSH, pra ky shërbim duhet të përlllogaritet më vlerë më të ulët **9,916,344 leke pa TVSH**.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*F.V pajisje mjekësore dhe hotelerie*” rezultoi se procesi i marrjes në dorëzim të mallrave është bërë duke mos i’u përmbajtur rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi kushtet që duhet të përmbushin OE në procesin e dorëzimit të mallrave, mbi dokumentacion shoqëruar të tyre gjatë dorëzimit të mallrave. Procesin e dorëzimit nuk është shoqëruar me dokumentacion justifikues

si certifikata origjinës së mallit, test-raport, certifikatë cilësie etj, bazuar në rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), me nr. 2106, datë 24.03.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

18.1. Rekomandimi: AK, zyrtarët/punonjësit e përfshirë në kontratat e tipit mall, në procesin e marrjes në dorëzim të aktiveve si dhe në proceset e tjera të prokurimit duhet t'i përmbahen rekomandimeve të APP si dhe në çdo rast ndryshimesh apo rekomandimesh të nxjerra nga APP të jenë në koherencë të plotë me rekomandimet.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit “*Blerje kite dhe reagente dhe materiale konsumabël*” për vitin 2020, 2021 u konstatua që, kërkesat kualifikuese kanë zvogëluar konkurrencën në procedurë. Specifikimet e vendosura kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik duke favorizuar vetëm një operator ekonomik. Përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Elbasan ka marrë me hua nëpërmjet kontratave të huapërdorjes aparaturat (pajisjet) nga operatori ekonomik “G.” sh.p.k. Karakteristikat teknike të përshkruara në specifikimet teknike janë njësoj me aparaturat e OE fitues dhe pa përdorur termin ekuivalent, duke orientuar procedurën e prokurimit drejt OE të shpallur fitues, me pasojë kufizimin e pjesëmarrjes dhe ngushtimin e konkurrencës. Veprimet si më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, neni 20, neni 23. pika 2 dhe 5 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, (ish fuqizuar) neni 61. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Nga njësia e prokurimit, në çdo rast të këtë në vëmendje maksimale hartimin e specifikimeve teknike të cilat të jenë në harmoni me natyrën dhe vlerën e kontratës në mënyrë që kërkesat kualifikuese të nxisin konkurrencën për shpenzime me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Përlllogaritje jo e saktë e fondit limit. Në të gjitha procedurat e prokurimit me objekt: “*Blerje kite dhe reagente dhe materiale konsumabël*”, dhe procedurat me objekt “*Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore*” të zhvilluara nga Spitali Rajonal Elbasan, të audituara, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk i është referuar edhe alternativave të tjera për përlllogaritjen e fondit limit, por vetëm kontratave të mëparshme, ku rezulton që për vite me radhë janë të njëjtët operatore ekonomike që shpallen fitues. Autoriteti kontraktor për përlllogaritjen e fondit limit të procedurave të prokurimit me objekt “*Blerje kite dhe reagente dhe materiale konsumi*” është referuar në çdo kohë vetëm kontratave të mëparshme të nënshkruara me operatorin ekonomik “G.” sh.p.k. Nëpërmjet testimit të tregut AK do të kishte krijuar hapësira për konkurrencën e hapur do të kishte patur mundësi të trajtonte në ftesat për ofertë dhe problemet me aparaturat të cilat AK nuk i dispononte (sipas të dhënave nga SRE) në momentin e zhvillimit të procedurave të prokurimit për këtë objekt. Autoriteti kontraktor për përlllogaritjen e fondit limit të procedurave të prokurimit me objekt ‘*Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore*’ i është referuar në çdo kohë vetëm kontratave të mëparshme të nënshkruara me operatorin ekonomik “E.-R.” sh.p.k. Veprimet si më sipër janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.11.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar Neni 59, pika 1 dhe 2 dhe VKM 285 date 19.05.2021, neni 76, pika 1 dhe 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

20.1. Rekomandim: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit i procedurës së prokurimit me objekt “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”, për 12 muaj”, me REF-43355-11-14-2019 u konstatua që nga e autoriteti kontraktor nuk janë marrë në konsiderate rekomandimet e APP-së të cilat janë dërguar me email, në kuadër të asistencës që APP iu jep autoriteteve kontraktore për saktësim-riformulim të kriterëve. Gjithashtu kërkesat e veçanta për kualifikim janë të paargumentuara dhe tentojnë të kufizojnë konkurrencën.

Në procedurën e prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj”, me REF-43355-11-14-2019 APP në rekomandimin e saj drejtuar AK citon se: B. Në procedurën e prokurimit në fjalë, janë evidentuar edhe kriterë të veçanta, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim. Konkretisht:

1. Në pikën 3.1 të kapacitetit ligjor/profesional të operatorëve ekonomik, AK ka kërkuar: "Leje Mjedisore Tipi B dhe Leje Mjedisore Tipi A, miratuar nga Ministria e Mjedisit, ku të përfshihen kodet përkatëse të mbetjeve sipas objektit të prokurimit".

Lidhur me pikën e mësipërme, APP sheh të nevojshme që AK të mirë argumentojë teknikisht nevojën e kërkesës së Lejen Mjedisore të Tipit B krahas lejes mjedisore të tipit A, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet ligjore për këto leje mjedisore, dhe faktin se çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

2. Në pikën 3.3.2 të kapacitetit teknik, në lidhje me numrin e punonjësve, AK ka kërkuar: "Numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës Janar - Tetor

2019 të jetë jo më i vogël se 10 (dhjete) punonjës;..."

Në lidhje me pikën e mësipërme, mbështetur në vlerën dhe tipologjinë e objektit të prokurimit, APP sheh të arsyeshme që AK të mirë argumentojë teknikisht nevojën për vendosjen e numrit të punonjësve të kërkuar për realizim e këtij shërbimi (jo më i vogël se 10 punonjës).

Veprime në kundërshtim Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjorisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 13, pika 2 .b.d. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

21.1. Rekomandimi: Nga SRE, njësia e prokurimit, në çdo rast të këtë në vëmendje maksimale hartimin e kriterëve të veçanta kualifikuese të cilat të jenë në harmoni me natyrën dhe vlerën e kontratës në mënyrë që të nxitet konkurrenca dhe që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën e kontratës dhe të shqyrtohen rekomandimet e APP si organ qendror.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Parregullsi në argumentimin e kërkesave mbi kriteret e vendosura kualifikuese. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për të dyja procedurat e prokurimit me objekt “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore” për vitin 2020, 2021 konstatohet se nuk argumentohet kërkesa për kualifikim për kriteret teknike të vendosura nga AK. Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për këtë procedurë nuk është bërë argumentimi teknik i kriterëve të vendosura por vetëm është cituar baza ligjore në kundërshtim me përcaktimet e nenit 61 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjorisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

22.1. Rekomandimi: Personat përgjegjës të hartimit të kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe çdo

informacion tjetër specifik i nevojshëm, në çdo rast duhet ti argumentojnë teknikisht dhe ligjërisht.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Kriteret e veçanta në DST janë të pa plota dhe nuk garantojnë cilësinë e mallit. Për procedurat e prokurimit “*Blerje pajisje për shërbimin e Okulistikës*” dhe “*Blerje pajisje për shërbimin e ORL*” AK për plotësimin e kapacitetit teknik, tek kriteri 2.3.6 pika, ka kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “*Për pajisjet mjekësore*”. Vendosja e këtij kriteri është i pa plotë, pasi AK duhet të kërkoj certifikatën për regjistrimin e pajisjeve mjekësore në regjistrin kombëtar të AKBPM, kjo në referim të ligjit nr. 89/2014 “*Për pajisjet mjekësore*”, neni 13 (procesi i regjistrimit) pika 1, c dhe 2 ku parashikohet se: 1. *Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga: c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore* 2. *AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Drejtoria e SRE para miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të hartuara nga grupet e punës, duhet të kërkojnë që në kriteret e veçanta të përfshijë kërkesa që parashikohen në ligjin për pajisjet mjekësore në mënyrë që të prokurojë mallra/shërbime me cilësi të lartë duke optimizuar shpenzimet për këto mallra.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit “*Blerje pajisje për shërbimin e okulistikës*” dhe “*Blerje pajisje për shërbimin e ORL-së*” u konstatua që marrja në dorëzim e mallrave është në mungesë të certifikatës së origjinës së mallit, të regjistrimit pranë AKBPM dhe pa raport testet e fabrikës. Autoriteti Kontraktor për kontratat e furnizimit të nënshkruara me OE “G.-A. F.”, për kontratën me objekt “*Blerje pajisje për shërbimin e okulistikës*” dhe kontratave të furnizimit me objekt “*Blerje pajisje për shërbimin e ORL-së*”, nuk ka përcaktuar në kushtet e kontratës që mallrat objekt i kontratës të jenë të regjistruara pranë AKBPM, duhet të shoqërohen me certifikatat e origjinës, raport testet e fabrikës si dhe çdo dokument tjetër që shërben për të vërtetuar cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë.

Operatori ekonomik “G.-A. F.”, në cilësinë e kontraktuesit, gjatë dorëzimit të mallit sipas kontratave respektive nuk ka shoqëruar mallin me certifikatën e regjistrimit pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Hartuesit e kontratave dhe komisioni i pritjes dhe kolaudimit të mallit nuk kanë marrë parasysh rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit të Publik nr. 2106 datë 24.03.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

24.1. Rekomandimi: Titullari i institucioni të marrë masa që komisioni i pranimit, gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave, të kërkojnë që mallrat të shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje pajisje mjekësore për shërbimin e okulistikës*” operatori ekonomik i kontraktuar nuk ka dorëzuar deklaratën e përputhshmërisë për pajisjet mjekësore në zbatim të ligjit 89/2014 “*Për pajisjet mjekësore*”. Për procedurën e prokurimit “*Blerje pajisje mjekësore për shërbimin e okulistikës*” Mikroskop

kirurgjikal i avancuar okulistik (cope 1), Fakoemulsifikator PHACO, (cope 1) dhe Biometer i tipit A scan (cope 1).

Pajisja mikroskop kirurgjikal i avancuar përbehet nga disa pjesë (aksesorë). Ligji 89/2014” për pajisjet mjekësore” neni 10 parashikon se: “*Procedurat e veçanta për sisteme*” 1. Çdo person, fizik ose juridik, që i bashkon së bashku pajisjet që mbartin markimin CE, brenda kufijve të përdorimit të specifikuar nga prodhuesit e tyre, me qëllim vendosjen e tyre në treg, si një sistem apo paketë procedurale, anashkalon procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe harton një deklaratë, në të cilën shprehet se: a) ka verifikuar përputhshmërinë e ndërsjellë të pajisjeve me udhëzimet e prodhuesve dhe ka kryer veprimet e tij në përputhje me këto udhëzime; b) ka paketuar sistemin ose paketën procedurale dhe ka paraqitur informacionin përkatës për përdoruesit e fundit, duke përfshirë udhëzimet përkatëse nga prodhuesit; c) i gjithë aktiviteti u nënshtrohet metodave të duhura të kontrollit dhe inspektimit të brendshëm. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion pajisjet e furnizuara nga operatori ekonomik “G. A. F.” mbartin markimin CE. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

25.1. Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshirë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt blerjen e pajisjeve për mjekësore dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, në kërkesat për kualifikim është vendosur si Specifikim i tepërt “Autorizimi nga prodhuesi” dhe “certifikatat ISO” të prodhuesit. Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, ka orientuar procedurën drejt operatorëve ekonomik që disponojnë autorizimin e prodhuesi në lidhje me një produkt të caktuar. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Rekomandimi nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3 dhe 77, t VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 93. Vendimi i Autoriteti i Konkurrencës nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17. Vendimin nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativë i Gjykatës së Lartë.

Ndërsa kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO të prodhuesit rezulton ti adresohet palëve të treta (prodhuesit/distributorit), të cilat nuk janë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit, për të cilën Agjencia e Prokurimit Publik është shprehur në Rekomandimin me nr. 8197 të datës 03.02.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

26.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Për mirëmbajtjen full-risk të pajisjeve mjekësore Autoriteti Kontraktor, para shpalljes së proceduarve nuk ka hartuar planin e mirëmbajtës së pajisjeve mjekësorë për çdo vit. Në kartelat e mbajtura për pajisjet mjekësore, nuk janë identifikuar, data e blerjes, vlera (reale ose të vlerësuar), të dhënat e historisë së riparimeve dhe të mirëmbajtjes. raportime për probleme me pajisjen mjekësore. Përshkrimi i përgjithshëm i problemit ose i shërbimit të nevojitur, pjesët e këmbimit të përdorura gjatë riparimit/mirëmbajtjes është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011 “*Menaxhimi i aktiveve në njësitë publike*” si dhe Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

27.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korigjuar këtë praktikë për mirëmbajtje full-risk/ose jo të pajisjeve, me qëllim që para shpalljes së proceduarve të prokurimit të jetë hartuar plani i mirëmbajtës së pajisjeve mjekësore.

27.2. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të mbajtur Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM/CLINGO), historinë (kartelën) e plotë të pajisjes.

27.3. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që specialistët e Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike të trajnohen për njohjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, duke rritur në këtë mënyrë kompetencën profesionale në monitorimin e kontratave dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes.

Në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore” për vitin 2023, konstatohet që kërkesat kualifikuese të vendosura tentojnë të kufizojnë konkurrencën duke orientuar procedurën drejt atyre operatoreve që përmbushin kritere specifike të pa argumentuara. Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të kualifikimit për procedurën “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore” për vitin 2023, është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës. Për të njëjtin objekt kontrate dhe në të njëjtat kushte AK ka dyfishuar numrin e punonjësve të kërkuar për realizimin e kontratës, duke mos e justifikuar këtë kërkesë, konkretisht për piken 2.3.3 të DST-ve, ku përcaktohet se: *Operatori Ekonomik duhet të ketë jo më pak se 18 persona të punësuar (e modifikuar) pas vendimit të KPP) për muajin Prill 2023. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë: Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore; Listë pagesat e deklaruara në organet tatimore për muajin Prill 2023. Në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" neni 78, Ligji 162/2020 neni 2, neni 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Personat përgjegjës të hartimit të kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, në çdo rast duhet të argumentojnë teknikisht dhe ligjërisht dhe njësisht e prokurimit, në çdo rast të këtë në vëmendje maksimale hartimin e specifikimeve teknike në harmoni me natyrën e kontratës, duke nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomike.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të procedurave të prokurimit me objekt “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”, të zhvilluara viti 2020, 2021, 2023, u konstatuan parregullsi në dokumentimin e realizimit të procesit të asgjësimit të produktit final të trajtuar (hirit) për mbetjet e rrezikshme spitalore. Nuk dokumentohet përmbushja e detyrimit ligjor për subjektet prodhuese të mbetjeve spitalore për depozitimin e produktit final të trajtuar. Nuk konstatohen gjurmë auditimi/dokumentacioni me qëllim vërtetimin e asgjësimit të mbetjeve, përkatësisht shiritat e incineratorit, etj. nga operatori

ekonomik fitues “E-R”. Rezulton e paqartë ecuria e procesit të asgjësimit të produktit final të trajtuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo. Në zbatim të kriterit mbi procedurën që vijon për depozitimin e hirit, asgjësimi i tij do të kryhet nga shoqëria koncesionare “I. E. B. S.” sh.p.k., me të cilën OE ka lidhur marrëveshje një vjeçare, për vitin, 2020, 2021, 2022.

Për procedurën e prokurimit me objekt “*Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore*”, për viti 2023, në zbatim të kriterit mbi procedurën që vijon për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimit, asgjësimi i produktit final të trajtuar do të kryhet nga shoqëria “E.-E.” sh.p.k., me të cilën OE ka lidhur marrëveshje të datës 26.05.2023, me afat deri 3 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj me të drejtë ripërtëritje nëse kushtet e marrëveshjes nuk janë shkelur.

Për të dyja shoqëritë me të cilat ka lidhur marrëveshje OE i shpallur fitues për këto procedura prokurimi, nuk ka dokumentacion për dorëzimin e produktit final të trajtuar pranë shoqërisë “E.-E.” dhe shoqërisë I. E. B. S.” sh.p.k dhe nuk ka të dhëna për ripërtëritjen e kontratës pas përfundimit e afateve të nënshkrimit.

Strukturat spitalore si krijuese të mbetjeve janë përgjegjëse deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë. Në mungesë të dokumentacionit të depozitimit të produktit final të trajtuar, të përfituar nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, nuk dihet ku derdhen këto mbetje, të cilat, nisur nga specifikat, mund të kenë ndikim të lartë në mjedis e në shëndetin publik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 463, datë 22.09.2011, “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, i ndryshuar dhe VKM 798, datë 29.9.2010 “*Për miratimin e rregullores ”Për administrimin e mbetjeve spitalore”*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

29.1 Rekomandimi: SRE Elbasan/Titullari i Institucionit të ngrejë grupet e punës për procesin e monitorimit dhe zbatimit të kontratave deri në asgjësimin e plotë mbetjeve të rrezikshme spitalore. Në çdo rast strukturat përgjegjëse të vijnë me dokumentacionin justifikues për shlyerjen e faturës, vetëm pasi të sigurohen se produkti final i trajtuar është asgjësuar, duke marrë siguri të plotë se hallka e fundit e procesit të asgjësimit ka përfunduar me sukses.

29.2. Rekomandimi: Titullari i Institucionit përpara nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik që do të trajtojë mbetjet e rrezikshme spitalore, të sigurohet nëpërmjet strukturave përgjegjëse se përgjatë periudhës që kontrata do të jetë në fuqi OE të ketë një marrëdhënie kontraktuale me një subjekt që do të kryejë asgjësimin e produktit final të trajtuar.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11 02014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë, nenet 98-102, nga ana e titullarit të autoritetit kontraktor, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në nugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit me vlerë 9,727,332 lekë, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “*Rikonstruktion i Godinës së Pediatrisë*”, u konstatuan punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike si dhe diferenca të volumeve (zërave) të punimeve të realizuara në fakt, krahasuar me ato të situacionuara si më poshtë:

- Sipas zërit të punimeve A.6.8 “*Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil, t = 5 cm + rrjetë + suva*”, u konstatua se është përdorur polisterol i thjeshtë dhe jo kompakt. Nga krahasimi i çmimit të certifikuar, krahasuar me çmimin e zërit të punimeve me polisterol të thjeshtë të

aplikuar në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit 2015, rezulton se është likuiduar më shumë vlera 2,684,647 lekë.

- Sipas zërit A.6.6 “*Tavan i varur me pllaka gipsi rezistente ndaj lagështirës tualete*”, është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 1,903,932 lekë.

- Sipas zërit A.12.2 “*Dalje për vaditje*” është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 438,000 lekë.

- Sipas zërit A.6.5 “*Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm, korridore*”, është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 89,547 lekë.

- Tek veshje fasade me pllaka qeramike sipas zërit A.6.9 “*Veshje me pllaka qeramike*”, është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 16,500 lekë.

Mos realizimi i punimeve sipas specifikimeve teknike kryesisht shtresës së polisterolit ka për pasojë mos realizimin e izolimit termik në masën e parashikuar, duke kërkuar shpenzime më të larta të energjisë elektrike.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, kreu III, pika 4.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan të marren masa duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumë **5,132,626 lekë** pa TVSH, nga **BOE “M. & A. K. & Sh.” SHPK**, për zëra punimesh të pa kryera si dhe pa respektuar specifikimet teknike sipas kontratës së lidhur me nr. 2142 prot., datë 12.02.2021 “*Rikonstruksion i godinës së pediatriisë*”, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “*Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Elbasan*”, u konstatuan punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike si dhe diferenca të punimeve të realizuara në fakt, krahasuar me ato të situacionuara si më poshtë:

- Sipas zërit A.8.9 “*Struktura të holla betoni C 16/20, për kunetat e jashtme*”, është përfshirë shtresa e betonit për ndërtimin e kunetës, nga ku rezulton se nuk ka referencë të saktë të llojit të punimeve, duke rritur çmimin për njësi. Vlera 140,230 lekë, e cila përfaqëson diferencën e çmimit nga ndërtim struktura të holla në shtresa, është certifikuar më tepër dhe përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “E.” SHPK.

- Nga verifikimi i librit të masave sipas zërit A.3.8 “*Tavan i varur me pllaka gipsi 60 cm x 60 cm*”, rezulton se në sipërfaqen e raportuar nuk është zbritur sipërfaqja që zënë ndriçuesit, duke certifikuar më tepër vlerën 105,412 lekë.

- Sipas zërit A.3.7 “*F.V tavan me kartonxhes*”, në analizën e kostos përfshihet edhe vendosje kornize dekorative. Pavarësisht se për objekte të tilla nuk aplikohet vendosja e tyre, çmimi i aplikuar duhet të rishikohej në mungesë të tyre. Për këtë zë punimi vlera 166,726 lekë, është certifikuar padrejtësisht.

- Sipas zërit A.7.4 “*Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva*”, nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike (fotografi), rezulton se nuk është vendosur polisterol kompakt jeshil, por polisterol i thjeshtë. Bazuar në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit, çmimi për vendosje polisterol i thjeshtë është më i ulët se ai i vendosjes së polistrolit kompakt jeshil. Nga përllogaritja e diferencës së çmimit sipas sasisë së certifikuar, rezulton se është certifikuar më tepër vlera 1,280,725 lekë.

- Sipas zërit A.8.13 “*Trotuar me pllaka, pa bordurën e betonit*”, rezultoi se ka diferencë të punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 270,105 lekë.

Sipas zërave A.6.1. “Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë zinkato 100 mm”, A.6.2. “Ulluk shkarkimi horizontal zinkato 33 cm”, A.6.4. “Veshje kornize me llamarinë zinkato”, punimet janë realizuar me material llamarinë të bojatisur dhe jo llamarinë me veshje zinkato.

Mos realizimi i punimeve sipas specifikimeve teknike kryesisht shtresës së polisterolit ka për pasojë mos realizimin e izolimit termik në masën e parashikuar, duke kërkuar shpenzime më të larta të energjisë elektrike.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4, si dhe specifikimet teknike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan të marren masa duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës **1,963,198 lekë** pa TVSH, nga **OE “E.” SHPK**, për zëra punimesh të pa kryera si dhe pa respektuar specifikimet teknike sipas kontratës së lidhur me datë 14.04.2023 “Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Elbasan”, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Kontrata me Nr.950/10 prot, datë 20.08.2021 lidhur ndërmjet OE “B.” shpk me NIPT J.....E si dhe AK, Spitali Rajonal “Xhaferr Kongoli” Elbasan. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është **15 ditë** kalendarike. Dorëzimi i mallrave është bërë me datë 25.10.2021 e firmosur nga përfaqësuesi i kontraktorit dhe nga anëtarët e komisionit marrjes në dorëzim të mallrave të cilët kanë përcaktuar që mallrat janë sipas specifikimeve teknike duke i marrë në dorëzim. Referuar kushteve të përcaktuara dhe afatit të marrjes në dorëzim të mallrave përcaktuar 15 ditë kalendarike 20.08.2021-03.09.2021, kontraktori ka dorëzuar mallrat 52 ditë kalendarike me vonesë. Bazuar në kontratën e furnizimit neni 24, pika 1, për dorëzim të vonuar, kontraktori duhet të penalizohet me vlerë **2,240,659 lekë** pa TVSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

3.1. Rekomandimi: Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,240,659 lekë pa TVSH**, sipas penaltetit të përlllogaritur e cila i mbahet OE “B.” shpk, sipas Kontratës me nr.950/10 prot, datë 20.08.2021.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Kontrata me Nr.950/9 prot, datë 20.08.2021 lidhur ndërmjet OE “M.” shpk me NIPT L.....A si dhe AK, Spitalit Rajonal “Xhaferr Kongoli” Elbasan. Afati i përcaktuar për dorëzimin e mallrave është 15 ditë kalendarike. Kontraktori ka kryer dorëzimin e parë të mallrave më datë 26.08.2021 brenda afatit, 6 ditë pas lidhjes së kontratës në vlerën 1,782,366 lekë ndërkohë që pjesën e mbetur e ka dorëzuar sipas fletë-hyrjes nr. 8 më datë 07.09.2021, pra 4 ditë kalendarike me vonesë nga afati **15** ditor i përcaktuar në kontratë vlera prej 9,428,072 lekë pa tvsh. Bazuar në kontratën e furnizimit neni 24, pika 1, për dorëzim të vonuar, kontraktori duhet të penalizohet me vlerë **150,849 lekë pa TVSH**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

4.1. Rekomandimi: Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **150,849 lekë pa TVSH**, sipas penaltetit të përlllogaritur e cila i mbahet OE “M.” shpk, Kontratës nr.950/9 prot, datë 20.08.2021.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Kontrata për vendosjen e një bankomati në ambientet e Spitalit Rajonal Elbasan është nënshkruar me nr 1698/1 prot datë 31.12.2019, ndërmjet Qendrës Spitalore Elbasan dhe subjektit “B. K. T.”. Kjo kontratë ishte e vlefshme nga data 01.01.2020 deri në datë 31.08.2020 dhe subjektit “BKT” i detyrohej Spitalit Rajonal Elbasan një shumë prej 15.000 lekë në muaj. Në datë 01.09.2020, është rinovuar kontrata me afat 1-vjeçar deri në datë 31.08.2021 si dhe një kontratë po me afat 1-vjeçar në datë 01.09.2021, me Nr. 1306 Prot, deri në datë 31.08.2022. Me përfundimin e kësaj kontrate nuk janë kryer më veprime ndërmjet tyre edhe pse BKT ka dërguar një shkresë zyrtare për rinovimin e kontratës. Aktualisht në ambientet e spitalit vijon të operojë përsëri ky subjekt. Duke qenë se BKT vijon të kryejë shërbimin e saj me bankomat brenda këtyre ambienteve prej datës 31.08.2022 e në vazhdim të ardhurat e munguara për Spitalin Rajonal Elbasan janë në vlerë **240.000** lekë. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2100 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 112-115, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.1.Rekomandimi: Të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, shpërblimi i dëmit me vlerën **240,000 lekë** ndaj subjektit “B.”.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve” janë skualifikuar 5 OE, nga të cilët edhe OE “B.-I.” SHPK, me argumentimin e mos likuidimit të detyrimeve dhe mungesën e një inxhinieri strukturist. Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave të detyrimeve, rezulton se OE ka paraqitur deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe kontributet sipas shtojcës 8, dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve për taksat vendore, si dhe vërtetim për pagesën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në vërtetimin e paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës, përcaktohet se OE “B.-I.” SHPK, deri me datë 01.03.2023, nuk ka asnjë detyrim tatimor të pa paguar. Në vërtetimin e paraqitur po nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës të datës 21.02.2023, përcaktohet se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 1,437,788 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej: 1,437,788 lekë; Kamatë vonesa për kontributet 0 lekë; Gjoha lidhur me kontributet 0 lekë”. Nisur nga fakti që nuk ka kamatëvonesa për pagesat në fjalë, OE është brenda afatit për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Sa i përket punësimit të një inxhinieri strukturist, nga OE “B.-I.”, për plotësimin e këtij kriteri është paraqitur inxhinier i diplomuar sipas profilit “Inxhinier për ndërtime civile dhe industriale”. Nga ana e KVO duhet të kërkoheshin sqarime nëse diplomimi i inxhinierit të paraqitur nga OE përfshin edhe profilin e përcaktuar, për të shqyrtuar mundësinë e konsiderimit si devijim i vogël.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “E.” SHPK, rezulton se:

Inxhinieri elektronik z. A. P. ka lidhur kontratë pune me OE “E.” SHPK me datë 18.11.2022. Nuk është i përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe nuk figuron në listë pagesat e tre muajve të fundit (figuron në muajin janar dhe shkurt 2023).

Pavarësisht se ky kriter, në fazën e zhvillimit të tenderit konsiderohet i realizuar me paraqitjen e deklaramit sipas shtojcës 8, OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, siç ka paraqitur për detyrimet tatimore. Plani i organizimit të punimeve përbëhet nga vetëm një skicë.

Inxhinieri strukturist i paraqitur nga OE “E.” SHPK, nuk figuron në licencën profesionale të shoqërisë, si dhe kontrata e punës me të nuk është e noterizuar.

Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se nga ana e KVO nuk është bërë vlerësimi i ofertave në mënyrën e duhur, si dhe nuk është verifikuar me saktësi dokumentacioni i paraqitur nga OE

pjesëmarrës. Si OE “B. – I.” SHPK ashtu dhe OE fitues “E.” SHPK kanë devijime të plotësimit të kriterëve, për të cilat duhet të kërkoheshin sqarimet përkatëse, për të përcaktuar nëse devijimet janë materiale apo jo. OE “B.-I.” SHPK ka paraqitur ofertën financiare me vlerë 123,589,415.2 lekë, ndërsa oferta fituese është me vlerë 135,380,607.9 lekë. Si pasojë e vlerësimit të pa saktë të ofertave të paraqitura në këtë procedurë prokurimi, është nënshkruar kontrata me vlerë më të lartë në shumën **11,791,192 lekë, vlerë e cila konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet**. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e punonjësve që angazhohen në procedurat e prokurimit në komisionet e vlerësimit të ofertave, të merren masa për shqyrtimin me korrektësi të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit, duke kërkuar sqarime dhe konsideruar oferta të pranueshme edhe ato oferta të cilat kanë devijime të vogla jo materiale, me synim prokurimin e kontratave me ekonomikitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “Blerje lëndë djegëse briket pellet” rezultoi se përllogaritja e fondit limit është kryer jo në përmbajtje me parimet e Ligjin për MFK, pasi në identifikimin e sasisë së lëndës djegëse, në përcaktimin e kohëzgjatjes së orarit të ndezjes së kaldajave duke qenë se nuk ka një bazë ligjore të cilës mund ti referohet, AK nuk është mbështetur në praktikën më të efektshme apo më të dobishme të realizuara nga Institucione të ngjashme pasi kohëzgjatja e ndezjes si dhe sasia e përllogaritur nga AK është më e lartë se ajo e realizuar nga këto Institucione të ngjashme. Më konkretisht komisioni i ngritur i identifikimit të nevojave dhe përllogaritjes të vlerës limit të kontratës kreu përllogaritjen e fondit limit për periudhën, (01.01.2023-15.03.2023) dhe (15.11.2023-31.12.2023), e përkthyer 120 ditë kalendarike, që përkon me sezonin e dimrit ose sezoni i ndezjes së kaldajave. Vlera e fondit limit të përllogaritur rezultoi 8,252,268 leke pa TVSH. Në lidhje me përllogaritjen e fondit limit, në përcaktimin e sasisë rezultoi se: komisioni, është mbështetur mbi bazën e konsumit apo harxhimit të lëndës djegëse (briket pelet), të mbajtur ndezur për 12 orë pune pranë godinave në të cilat ndodhen kaldajat. Sipas procesverbalit të hartuar rezultoi se konsumi i lëndës djegëse është 1740 kg për të gjitha godinat spitalore. Në përcaktimin e kohëzgjatjes të ndezjes së kaldajave prej 12 orësh, AK nuk ka një bazë ligjore apo një VKM në fuqi, *(referimin ligjor, normativat e përcaktuara nga institucione përgjegjëse, udhëzim të MSHMS etj)*, e cila argumenton apo justifikon orarin apo kohëzgjatjen e përcaktuar. Grupi i auditimit siguroi të dhëna në lidhje me praktikën e ndjekura nga Institucione të ngjashme me të njëjtën natyrë shërbimi, me të njëjtat kushte klimaterike nga Spitali Rajonal Berat, Spitali Rajonal Gjirokastrë, në të cilat kontratat e realizuara janë të suksesshme dhe nuk janë evidentuar problematika sa i përket sigurimit me ngrohje, nga ku rezultoi se kohëzgjatja e përcaktuar është mesatarisht 6-9 orë ndezje. Pra në rast se AK do ti referohej praktikave të ndjekura nga këto Institucione, marr si referim 9 orë në ditë sasia e përllogaritur do ishte 1305 kg dhe vlera e fondit limit të përllogaritur do ishte **3,961,980 lekë pa TVSH** më e ulët se ajo e përllogaritur nga AK. Pra nga ana e Institucionit nuk janë marrë praktikën më të mira të ngjashme të cilat i sjellin shpenzim me ekonomikitet. Veprimet e kryera janë në kundërshtim me Ligjin nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 2, pika 1, 2, a), neni 73, neni 74 si dhe Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

2.1. Rekomandimi: AK, zyrtarët e përfshirë në procesin e prokurimit, referuar përllogaritjes së fondit limit duhet t’i referohen praktikave të mira të cilat janë të dobishme me qëllim eliminimin e përdorimit pa ekonomikitet të fondeve publike në zbatim të parimeve të Ligjit për MFK. Pra referuar procedurës, “Blerje briket pellet” AK, mund të marr në konsideratë praktikën e ndjekura nga Spitalet e tjera Rajonale, metodologjinë e ndjekur nga ana e tyre, në

të cilat kontratat e lidhura kanë rezultuar të suksesshme dhe vlera e realizuar më e ulët se ajo e Spitalit Rajonal Elbasan.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit, “*Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike*”, sipas një analize të bërë nga grupi auditimit vlera e fondit limit të përlllogaritur rezulton **9,916,344 lekë pa TVSH** më e ulët se ajo e përlllogaritur nga AK. Komisioni i përlllogaritjes të fondit limit, në përcaktimin e numrit të nevojshëm të mbulimit me shërbim me roje, mund të realizonte shërbimin me më pak punonjës, duke iu përmbajtur parimeve të Ligjit për MFK, e cila lidhet me një shpenzim të njësisë në mungesë të menaxhimit me ekonomikitet. Më konkretisht në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, në përcaktimin e numrit të turneve 7 vend-roje me 3 turne, AK nuk ka vepruar drejtë pasi:

Së pari, në Godinën e Administratës si dhe Godinën e Telemjekësisë nuk është e nevojshme që mbulimi me shërbimin të ofrohet me 3 turne duke qenë se (*Godina e Administratës, Telemjekësia, Kirurgjia*) ndodhen fare pranë njëra tjetrës, në një perimetër të afërt me një fushëpamje të qartë të cilat mund të monitorohen lehtësisht nga një punonjës shërbimi pas orës 16:00 pasi bie ndjeshëm dhe fluksi lëvizjes, pra që përkon me turnin e II dhe të III.

Së dyti, në (*Godinën e Administratës dhe Telemjekësisë*) në lidhje me mbulimin me shërbim duhet të ishte marrë në konsideratë që mbulimi i shërbimit të realizohet me 1.5 turne me 12 orë. Pra, duke qenë se Godina e Administratës pas orarit zyrtar të punës qëndron e mbyllur si dhe Telemjekësia qëndron gjithmonë e mbyllur dhe vetëm në raste specifike përdoret nga mjeku kur vlerëson gjendjen e pacientit në distancë, mbulimi i shërbimit me 12 orë, pra 1.5 turne nuk do cënonte sigurinë Institucionit pasi do mbulohej nga roja i Maternitetit i përcaktuar me 3 turne, për me tepër që në rast nevojë për ndërhyrje urgjente në rast dëmtimi apo vjedhje punonjësi shërbimit njofton sallën për ndërhyrjen e shpejtë. Veprimet e kryera përbëjnë një shpenzim të njësisë pa ekonomikitet, në vlerën **9,916,344 leke pa TVSH**, në kundërshtim me parimet e Ligjit “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, neni 5, neni 8, pika 8.a, neni 10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

3.1. Rekomandimi: AK, në procedurën e ardhshme me të njëjtën tipologji kontrate, duhet të veprojë: së pari, mund të marrë në konsideratë kontraktimin e shërbimit nga Shoqëria me kapital 100% shtetëror, “I.G” SHA, pasi është shoqëri me pronar 100% të aksioneve të saj shtetin si dhe është krijuar me qëllim ofrimin e këtij shërbimi nga kjo Shoqëri e cila përfaqëson shtetin si pronar. Së dyti, në rast pamjaftueshmërie të buxhetit për kontraktimin e Shoqërisë “I.G” SHA të ndiqet metodologjia me më pak punonjës shërbimi në Godinën e Administratës dhe Telemjekësisë me shërbim ruajtje me 1.5 turne/12 orë pasi nuk i cënon AK garantimin e ruajtjes dhe sigurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Kontrata Koncesionare “*Për shërbimin e Hemodializës*” të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Tregtare “D.” shpk me nr. 1503/44 prot, datë 10.02.2016, me objekt “*Ofrimi i shërbimit të hemodializës*” pranë spitaleve rajonale Shkodër, Lezhë, Korçë, Elbasan, Vlorë. Në lidhje me kontratën koncesionare “*Për shërbimin e Hemodializës*”, është konstatuar shpenzim i njësisë në mungesë të një menaxhimi me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet pasi përpara lidhjes së kontratës koncesionare, shërbimi i Hemodializës ofrohej nga Spitali. Në vitin 2016 që përkon me fillimin e kontratës koncesionare 2 nga aparatura e blera kanë qenë të reja dhe në gjendje pune. Nga ana e Ministrisë si organ qendror si dhe nga Drejtoria e Spitalit nuk është kryer asnjë veprim praktik apo korrespondence në lidhje me procedurën që do të ndiqet, përpara, gjatë dhe pas lidhjes koncesionare për ato aparatura të reja dhe në gjendje pune. Pas lidhjes së kontratës koncesionare nuk i kanë shërbyer Spitalit madje as nuk janë dhuruar për ndonjë spital tjetër. Vlera e aparaturave e cila përbën shpenzim të njësisë pa ekonomikitet është **4,059,543 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10 2096, datë 08.07.2010

“Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 8, pika 1, 8,a), b), c), d) si dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 120-125, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

4.1. Rekomandimi: AK, strukturat drejtuese, me qëllim eliminimin e efekteve financiare negative të mirë analizojnë nevojat për blerjen e pajisjeve mjekësore të nevojshme duke iu përmbajtur parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Kontrata Koncesionare e lidhur ndërmjet MSHMS dhe anëtarëve të Konsorciumit, “E. S.” Shoqëri Franceze (25%), “L.” Shoqëri Shqiptare (41.7%), AB L. S. B.V Shoqëri Hollandeze (33.3%) me nr. 1924/2 prot, datë 10.04.2019, “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore”. Ministria e Shëndetësisë i ka dërguar për ndjekje Kontratën e koncesionit/PPP “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore” me anëtarët e Konsorciumit nënshkruar nga MSHMS në Prill 2019, me qëllim sigurimin apo ofrimin e Shërbimeve Laboratorike Mjekësore për Popullatën nëpërmjet disa kushteve, rregullave apo udhëzimeve të përcaktuara në kontratë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga korrespondenca e Spitalit me Koncesionarin rezulton se ka tejkalim të Tavanit Buxhetor konkretisht për vitin 2021 në masën 116 %, vitin 2022 në masën 100.7 % dhe vitin 2023 në masën 109.3 në vlerën **17,645,968 lekë pa TVSH** e cila përbën shpenzim të njësisë pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në kundërshtim me tavanin buxhetor të përcaktuar nenin 22.4 të kontratës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 120-125, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit, me qëllim eliminimin e efekteve financiare negative në bashkëpunim me komisionin IFC, MSHMS, MFE të planifikojnë saktë tavanet buxhetore duke mos tejkaluar buxhetin e planifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA ADMINISTRATIVE

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Drejtorit të Spitalit Rajonal Elbasan, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Elbasan, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga:**

1. “A. M.” SHPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i Godinës së Peditrisë”, pranë Spitalit Rajonal Elbasan, sipas kontratës nr. 2142 prot., datë 12.02.2021, me vlerë 328,945,549.2 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë paraqiten si më poshtë:

- Sipas zërit të punimeve A.6.8 “Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil, $t = 5 \text{ cm} + \text{rrjetë} + \text{suva}$ ”, u konstatua se është përdorur polisterol i thjeshtë dhe jo kompakt. Nga krahasimi i çmimit të certifikuar, krahasuar me çmimin e zërit të punimeve me polisterol të thjeshtë të aplikuar në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit 2015, rezulton se është likuiduar më shumë vlera 2,684,647 lekë.

- Sipas zërit A.6.6 “*Tavan i varur me pllaka gipsi rezistente ndaj lagështirës tualete*”, është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 1,903,932 lekë.
 - Sipas zërit A.12.2 “*Dalje për vaditje*” është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 438,000 lekë.
 - Sipas zërit A.6.5 “*Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm, korridore*”, është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 89,547 lekë.
 - Tek veshje fasade me pllaka qeramike sipas zërit A.6.9 “*Veshje me pllaka qeramike*”, është konstatuar diferencë e punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 16,500 lekë.
- Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. BOE “K. P.” & “I. D. & S.” SHPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në zbatimin e kontratës së punimeve civile “*Rikonstrukcion i poliklinikës së specialiteteve Elbasan*”, sipas kontratës datë 14.04.2023, me vlerë 157,039,969.4 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë paraqiten si më poshtë:

- Sipas zërit A.8.9 “*Struktura të holla betoni C 16/20, për kunetat e jashtme*”, është përfshirë shtresa e betonit për ndërtimin e kunetës, nga ku rezulton se nuk ka referencë të saktë të llojit të punimeve, duke rritur çmimin për njësi. Vlera 140,230 lekë, e cila përfaqëson diferencën e çmimit nga ndërtim struktura të holla në shtresa, është certifikuar më tepër dhe përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “E.” SHPK.
 - Nga verifikimi i librit të masave sipas zërit A.3.8 “*Tavan i varur me pllaka gipsi 60 cm x 60 cm*”, rezulton se në sipërfaqen e raportuar nuk është zbritur sipërfaqja që zënë ndriçuesit, duke certifikuar më tepër vlerën 105,412 lekë.
 - Sipas zërit A.3.7 “*F.V tavan me kartonxhes*”, në analizën e kostos përfshihet edhe vendosje kornize dekorative. Pavarësisht se për objekte të tilla nuk aplikohet vendosja e tyre, çmimi i aplikuar duhet të rishikohej në mungesë të tyre. Për këtë zë punimi vlera 166,726 lekë, është certifikuar padrejtësisht.
 - Sipas zërit A.7.4 “*Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva*”, nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike (fotografi), rezulton se nuk është vendosur polisterol kompakt jeshil, por polisterol i thjeshtë. Bazuar në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit, çmimi për vendosje polisterol i thjeshtë është më i ulët se ai i vendosjes së polistrolit kompakt jeshil. Nga përlllogaritja e diferencës së çmimit sipas sasisë së certifikuar, rezulton se është certifikuar më tepër vlera 1,280,725 lekë.
 - Sipas zërit A.8.13 “*Trotuar me pllaka, pa bordurën e betonit*”, rezultoi se ka diferencë të punimeve të certifikuara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 270,105 lekë.
- Sipas zërave A.6.1. “*Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë zinkato 100 mm*”, A.6.2. “*Ulluk shkarkimi horizontal zinkato 33 cm*”, A.6.4. “*Veshje kornize me llamarinë zinkato*”, punimet janë realizuar me material llamarinë të bojatisur dhe jo llamarinë me veshje zinkato.
- Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, kreu III, pika 4, si dhe specifikimet teknike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

E. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës “Shkeljet,

masat dhe procedura disiplinore”, pika b, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Elbasan fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

I. “Vërejtje me shkrim” për:

1. Znj. O. T., në cilësinë e anëtares së KVO dhe NJP, për arsye se:

- Sipas procedurës “Rikonstruksion i Poliklinikës së Specialiteteve”, nuk janë pasqyruar në njoftimin e fituesit të gjitha arsyet e skualifikimit, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 31.

Nuk është bërë vlerësimi i ofertave në mënyrën e duhur, si dhe nuk është verifikuar me saktësi dokumentacioni e paraqitur nga OE pjesëmarrës. Dy OE kanë paraqitur oferta me devijime të plotësisimit të kriterëve, të cilat nuk janë vlerësuar në mënyrën e duhur, duke shkaktuar shpenzime pa ekonomikitet me vlerë 11,791,192 lekë.

- Sipas procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i godinës së Peditrisë”, ka marrë pjesë në hartimin e kriterëve të pa argumentuara.

- Sipas procedurës së prokurimit “Shërbim i hotelërisë dhe lavanterisë” nuk janë kryer verifikime si dhe nuk janë kërkuar sqarime referuar Ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i shfuqizuar), neni 53, pika 1, si dhe nuk është marrë në konsideratë kriteri i çmimit më të ulët.

2. Znj. I. S., në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, për arsye se:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje kite dhe reagente”, 2021, u konstatua që kërkesat kualifikuese kanë zvogëluar konkurrencën në procedurën e prokurimit.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj”, viti 2021 u konstatua që në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për këtë procedure nuk është bërë argumentimi teknik i kriterëve të vendosura por vetëm është cituar baza ligjore.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore” për vitin 2023 Kërkesat kualifikuese të vendosura tentojnë të kufizojnë konkurrencën duke orientuar procedurën drejt një operatori ekonomik. është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës. Për të njëjtin objekt kontrate dhe në të njëjtat kushte AK ka dyfishuar numrin e punonjësve të kërkuar për realizimin e kontratës, duke mos e justifikuar këtë kërkesë.

3. Znj. Xh. K., në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, për arsye se:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore” për vitin 2023 Kërkesat kualifikuese të vendosura tentojnë të kufizojnë konkurrencën duke orientuar procedurën drejt një operatori ekonomik. është cilësuar vetëm referimi ligjor i kriterëve të përcaktuara, duke mos dhënë argumentimin teknik konkret të kriterëve të kualifikimit, në raport me natyrën e kontratës. Për të njëjtin objekt kontrate dhe në të njëjtat kushte AK ka dyfishuar numrin e punonjësve të kërkuar për realizimin e kontratës, duke mos e justifikuar këtë kërkesë.

4. Znj. I. B., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje kite dhe reagente”, 2021, u konstatua që kërkesat kualifikuese kanë zvogëluar konkurrencën në procedurat e prokurimit.

5. Znj. I. Sh., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore, për 12 muaj”, viti 2021 u konstatua që në procesverbalin e mbajtur nga njësia e

prokurimit për këtë procedure nuk është bere argumentimi teknik i kriterëve të vendosura por vetëm është cituar baza ligjore.

6. Z. D. M., në cilësinë e marrësit në dorëzim të mallrave, për arsye se:

Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje për shërbimin e okulistikës” dhe “Blerje pajisje për shërbimin e ORL-së”, marrja në dorëzim e mallrave është kryer në mungesë të certifikatës së origjinës së mallit, të regjistrimit pranë AKBPM dhe pa raport testet e fabrikës. -Për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje pajisje biomjekësore për shërbimin e okulistikës” dhe “Blerje pajisje për shërbimin e ORL-së” për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese.

7. Znj. D. K., në cilësinë e anëtarës së njësisë së prokurimit, për arsye se:

Sipas procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i godinës së Pediatriisë” ka vendosur kriterë të pa argumentuara si dhe nuk ka marrë masa për rishikimin e tyre edhe pas rekomandimeve të APP, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 26, pika 5.

8. Z. M. A., në cilësinë e komisionit të shqyrtimit të ankesave, për arsye se:

Sipas procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i godinës së Pediatriisë” kanë vendosur kriterë të pa argumentuara si dhe nuk kanë marrë masa për rishikimin e tyre edhe pas rekomandimeve të APP, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 26, pika 5.

znj. A. B. në procedurën e prokurimit “Shërbim i hotelierisë dhe lvanterisë”, nuk ka marrë në konsideratë kriterin e çmimit më të ulët.

9. Znj. Z. P., në cilësinë e personit përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave, për arsye se:

Për procedurat e prokurimit “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore”, viti 2020, 2021, 2022, 2023, janë konstatuar parregullsi në dokumentimin e realizimit të procesit të asgjësimit të produktit final të trajtuar për mbetjet e rrezikshme spitalore.

10. Znj. A. B., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Sipas procedurës së prokurimit “Shërbim i hotelierisë dhe lvanterisë”, kanë vendosur kriterë të pa argumentuara në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 26, pika 5.

11. Znj. A. Q., në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:

Sipas procedurës së prokurimit “Shërbim i hotelierisë dhe lvanterisë” nuk janë kryer verifikime si dhe nuk janë kërkuar sqarime referuar Ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i shfuqizuar), neni 53, pika 1, pavarësisht se OE i skualifikuar ka kontrata në proces me autoritete të tjerë kontraktorë, ka paraqitur disa vërtetime për plotësimin e kriterëve të përgjithshme. Nuk është marrë në konsideratë kriteri i çmimit më të ulët sipas seksionit 4.2 të dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i shfuqizuar), neni 53, pika 4.

SHËNIM:

Masa “Vërejtje me shkrim”, konsiderohet e ezauruar për punonjësit si më poshtë:

- Për z. A. K., znj. P. M. dhe z. A. M., masa “Vërejtje”, konsiderohet e ezauruar, pasi kanë realizuar detyrën si ekspertë të jashtëm, punësuar vetëm për procedurat e prokurimit përkatëse.

- znj. A. B., z. Q. H. dhe znj. B. D., kanë dalë në pension.

- Për z. L. R. dhe z. K. T., nuk propozojmë masë disiplinore, pasi janë konstatuar mangësi vetëm në një rast.

VI. ANEKSE

Aneksi nr. 1.

Procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimit (përjashtuar blerjet me vlerë të vogël), paraqiten si më poshtë:

Viti 2020				
	Objekti	Fondi limit pa TVSH	Lloji i procedurës	Vlera e likuiduar me TVSH
1	Blerje mjete mbrojtëse për Covid- 19	10,000,000	Me negociim ,pa njoftim	11,806,600
2	Blerje kite dhe reagente	1,581,000	kërkese për propozim	1,897,200
3	Blerje sete kirurgjikale për syrin	4,338,500	Kërkese me propozim	4,735,140
4	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë	5,558,107	Me negociim ,pa njoftim	6,633,728
5	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë	22,352,428	E hapur	19,853,326
6	Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi	4,713,166	Me negociim ,pa njoftim	5,651,469
7	Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore	1,242,000	Me negociim ,pa njoftim	1,490,400
8	Shërbim i hotelerisë dhe lavanadërise	7,291,890	Me negociim ,pa njoftim	8,750,268
9	Shërbim gatim dhe shpërndarje ushqimi	4,713,199	Me negociim ,pa njoftim	6,633,728
10	Blerje materiale elektrike, hidraulike ,etj	3,555,650	kërkese për propozim	3,141,672
11	Mirëmbajtje pajisje radiologjike	6,198,200	kërkese për propozim	5,594,599
12	Blerje kite dhe reagente	17,083,333	e hapur	20,475,905
13	Mirëmbajtje pajisje laborator	2,083,000	kërkese për propozim	1,458,099
14	Blerje lende djegëse briket pellet	8,333,334	E hapur	9,911,160
15	Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore	10,000,000	E hapur	10,510,000
16	Mirëmbajtje e impiantistikës spitalore	1,883,334	kërkese për propozim	1,718,360
Viti 2021				
1	F.v pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatriinë e spitalit Elbasan	22,000,000	e hapur	24,224,926
2	Mirëmbajtje full risk e pajisjes MRI e prodhuesi Philips	2,216,603	kërkese për propozim	2,550,250
3	Supervizion për rikonstruksionin e godinës së pediatriisë	3,183,559	kërkese për propozim	3,325,000
4	Mirëmbajtje pajisje laborator	2,083,000	kërkese për propozim	1,249,798
5	Blerje materiale elektrike ,hidraulike	3,500,000	kërkese për propozim	4,182,480
6	Blerje kite dhe reagente	20,000,000	e hapur	15,034,860
7	Mirëmbajtje e impiantistikës spitalore	1,661,000	kërkese për propozim	1,919,400
8	Mirëmbajtje pajisje anestezie respiratorë	6,602,000	kërkese për propozim	1,411,410
9	Mirëmbajtje pajisje radiologjike	15,756,383	e hapur	2,411,410
10	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë	44,704,858	e hapur	30,617,330
11	Blerje materiale radiologjike	3,489,100	kërkese për propozim	3,297,799
12	Blerje lende djegëse për ngrohje briket-pellet	16,666,113	e hapur	19,822,320
13	Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve	20,000,000	e hapur	19,908,000

	spitalore			
14	Rikonstruksion I godinës se pediatriisë	301,205,848	e hapur	315,309,279
	Viti 2022			
1	Riparim i mamografisë dixhitale	2,061,667	e hapur, e thjeshtuar	2,400,000
2	Blerje materiale ortopedike dhe traumatologjike	5,557,524	e hapur, e thjeshtuar	5,200,770
3	Furnizim vendosje pajisje biomjekesore për shërbimin e okulistikës	14,166,667	e hapur, e thjeshtuar	16,794,000
4	Shërbimi I ruajtjes dhe sigurisë	55,150,800	e hapur mbi kufirin monetar	52,790,310
5	Studim projektim rikonstruksioni i poliklinikës së specialiteteve	5,683,615	e hapur ,e thjeshtuar	6,005,622
6	Punime meremetime -lyerje ne spitalin kirurgji -maternitet ,kate dhe patologji	4,175,148	e hapur, e thjeshtuar	4,733,591
7	Blerje tuba për marrjen e kampioneve te gjakut dhe materiale konsumi për laboratorin	15,295,335	e hapur	12,673,800
8	Blerje medikamente delegim nga MSHMS	6,485,940	e hapur, e thjeshtuar	6,235,190
	Viti 2023			
1	Blerje materiale ortopedike dhe traumatologjike	4,500,000	e hapur ,e thjeshtuar	4,242,120
2	Blerje projekti për rikonstruksionin e godinës se patologjisë	6,673,221	e hapur ,e thjeshtuar	7,058,092
3	Mirëmbajtje e impiantistikës spitalore	2,520,650	e hapur, e thjeshtuar	2,561,140
4	Blerje materiale mjekësore për sistemin terapeutik te kurimit te plagëve	3,210,167	e hapur, e thjeshtuar	3,842,700
5	Blerje pajisje mjekësore për shërbimin e ORL	5,422,299	e hapur, e thjeshtuar	5,949,600
6	Supervizim I rikonstruksionit te poliklinikës	1,585,357	e hapur, e thjeshtuar	300,000
7	Blerje materiale radiologjike	1,550,000	e hapur, e thjeshtuar	810,000
8	Rikonstruksion I Poliklinikës se Specialiteteve	137,896,180	e hapur	147,367,452
9	Blerje lende djegëse për ngrohje pelet	8,252,268	e hapur, e thjeshtuar	8,780,567
10	Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore	8,440,740	e hapur, e thjeshtuar	9,851,222

Aneksi nr. 2

Të ardhura dytësore nga aktiviteti spitalor që kryhen për shërbimet e ofruara, për personat të cilët nuk kanë zbatuar sistemin e referimit apo janë paraqitur për të marr shërbim në spital të pasiguruar, si dhe pa rekomandimin përkatës.

Çmimet sipas viteve 2021, 2022 dhe 2023, përkatës si dhe numrin e personave për çdo vit.

		Nr pacienti viti 2023	Nr pacienti viti 2022	Nr pacienti viti 2021	Çmimet
1	A Urik	2018	2149	1940	214.3
2	Creatinine	24561	22954	15166	214.3
3	Urea	24611	23168	15196	214.3
4	Bicarbonates	43	58	98	214.3
5	Protein, Total	1996	1953	1879	214.3
6	Bilirubine total	17512	17700	12865	214.3
7	Bilirubine direct	3158	2885	1983	214.3
8	Gluc	23310	22072	14499	214.3

9	Calcium	3213	2352	1553	178.6
10	Fe	289	398	293	214.3
11	Elektrolit (Na+K+Cl)	10603	7023	3876	267.9
12	Magnesium	147	76	31	178.6
13	Phosphorus	148	84	48	437.6
14	Cholesterol	373	1614	2139	276.8
15	HDL	42	56	107	259
16	LDL	48	47	102	259
17	Triglycerids	389	1596	2127	232.2
18	Lipid Tot	3822	3637	2431	571.5
19	Albumin, serum	710	787	501	205.4
20	Hb Elektro	76	106	62	571.5
21	P Elektro	882	735	124	705.5
22	HbA1c	4306	4601	3128	500.1
23	CRP RDT	0	0	9	348.3
24	CRP Imuno	12139	10242	7047	357.2
25	Troponin I RDT	0	2	5	1562.8
26	Troponin I, quantitative Imuno	6863	4524	1821	1,053.70
27	N-proBNP / BNP	1055	352	281	1,830.70
28	Lactate	48	5	5	294.7
29	Blood gas	569	268	19	616.2
30	Blood gas full	293	146	55	1,232.30
31	Amylase, Total	2579	1946	1035	169.7
32	Pancreatic Amylase	200	223	133	2,464.70
33	CK	567	1078	906	214.3
34	CKMB	698	839	701	437.6
35	GGT	3349	2951	1374	285.8
36	G6PD	2	4	1	794.8
37	LDH	1944	1483	1041	214.3
38	ALKP	2919	2766	1763	214.3
39	Lipase	147	106	84	214.3
40	Cholinesterase	8	17	11	419.7
41	ALT-SGPT	19841	19494	13801	214.3
42	AST-SGOT	19650	19150	13264	214.3
43	Beta HCG	12	27	15	1,071.60
44	Cortisol	36	20	9	1,071.60
45	DHEAS	10	5	3	1071.6
46	Ferritin	1175	1077	1110	1071.6
47	FSH	28	31	22	1071.6
48	LH	26	23	18	1071.6
49	Progesterone	11	13	7	839.4
50	PRL	45	39	27	1071.6
51	TEST	31	19	11	1071.6
52	TSH	2554	2353	1729	1,482.40

53	FT3	378	459	602	1,071.60
54	FT4	837	807	901	1,071.60
55	U-Komp	11688	13117	9204	142.9
56	U-Sed	7	246	9	250
57	Microalbumin	5	12	10	732.3
58	TP, 24 ore	49	37	18	178.6
59	Bence Jones Proteins , Urine	3	4	1	3,080.90
62	FOBT	181	114	3	250
63	Creat Clear	4	12	282	455.4
64	OGTT	153	308	19937	571.5
66	Hemogram 5P-L	32379	31225	192	357.2
67	GjakEkzMikro	271	161	3550	625.1
68	ESR	5869	5837	35	89.3
69	Reticulocyte	70	64	4	187.5
70	Mielogram	8	14	12	1,732.40
72	LB EkzMikroskopik	15	2	3925	741.2
74	D-Dim RDT	0	2	3370	401.9
75	D-dimer, quantitative	4384	4760	2	1196.6
76	Fibrinogen Activity	4165	4602	2	267.9
77	Coagulation faktori VIII	7	2	25	1339.5
78	Plasma	7	3	2451	1,339.50
79	PT (Quick time)	22	25	100	303.6
80	PT & INR	6168	4473	99	267.9
81	aPTT	253	183	333	267.9
82	Bleeding time, (Ivy 3 Yesints)	116	152	6	410.8
83	TT	9	6	4	187.5
88	ASLO	276	302	27	392.9
89	HAV-Ab-IgM	9	6	428	1,071.60
90	HAV-Ab-IgG	3	3	7	1,071.60
91	HBsAG RDT	9	13	5	830.5
92	HBsAG, Automatike	494	547	4	1,035.90
93	anti-HBs	34	17	8	1,035.90
94	Anti Hbc (IgM & IgG)	28	16	5	1,080.50
95	Anti -Hbc IgM	26	6	43	1,080.50
96	HBeAG	34	13	356	1,009.10
97	Anti-Hbe	31	10	28	964.4
98	HIV 1&2 Anti RDT	51	45	15	250
99	Anti HCV	436	502	36	1794.9
100	Rubela IgM	10	34	16	1259.1
101	Rubela IgG	9	9	32	1259.1
102	CMV IgM	21	40	16	1,339.50
103	CMV IgG	18	12	28	1393.1
104	Toxo IgM	22	42	28	1071.6
105	Toxo IgG	20	13	19	1,071.60

106	C3	47	25		366.1
107	C4	48	25		366.1
109	Imuno-Fenotip	226	29		1,071.60
110	HLA 1 Loci	1			7010.1
113	RF	1270	1111	985	312.6
114	RF, semi-quant	0	0	5	705.5
115	ANA (Antitrupe anti-nuklear)	213	163	107	857.3
116	AMA (Antitrupe anti-mitokondrial)	97	74	28	1,000.20
117	Anti ds DNA	61	31	23	1,339.50
118	ENA	23	19	26	1339.5
119	PR3	3	2		1250.2
120	MPO-ANCA	24	15	16	1,866.40
121	Anti tissue transglutaminase antibodies, IgA	15	9	4	1,000.20
122	Anti TPO	222	107	121	1,071.60
123	Anti CCP	31	21	41	1,250.20
124	AFP	737	536	192	1071.6
125	CEA	1292	1176	654	1,071.60
126	Free PSA	80	47	45	785.8
127	PSA Tot	725	704	564	768
128	CA 125	353	339	159	1071.6
129	CA 19-9	785	765	375	1071.6
130	CA 15-3	537	538	282	1071.6
131	b2 microglobulin	1	2	2	803.7
132	free Beta hCG	1	1	2	759.1
133	Urine culture	114	226	52	571.5
134	Feceas culture	2	12	6	562.6
135	Throat sëab culture	14	12		571.5
136	Vaginal secretions culture	6	13	4	714.4
137	Vaginal discharge ëet mount	2	142	23	357.2
138	Blood culture aerobic	1	5	2	1071.6
141	Ear secretions culture	1	3		357.2
142	Nasal secretions culture	0	2		214.3
145	Bacterialëound culture	1	1		509
148	Antimicrobial susceptibility (AST)	27	54	9	339.3
150	Parasitic examination	4	27	3	446.5
151	Fungal Culture	9	16		428.6
152	Fungal Culture, Vaginal secretions	1		1	509
153	Hepatitis C Viral Load	69	77	36	13,805.80
154	Hepatitis B Viral Load	328	264	106	14430.9
155	Alchool	0		2	437.6
156	Phenobarbital	1			1330.6
157	Digoxin	1			1018
158	Tacrol	56	23		3438.1
TOTALI		275064	260127	176508	

**Tabela nga të gjitha shërbimet e kryera në leke
Viti 2023**

Te ardhurat e realizuara gjate periudhes sipas shërbimeve dhe burimit	Teardhurangazb atmimisist.Referi mit	Teardhuranga KMCAP	Teardhurangatar ifa perdokumenta	Teardhuranga KML	Teardhuratejtera nonsadhdhano	Teardhurangabu rimetetjera	Shuma totale e teardhuravegjate teperiudhes
Sherb. Mjeksis.Pergjithme	103000	0	0	0	0	0	103000
Sherb.Kirurgj.Pergj.(ortopeditraum.+urologji)	30000	0	0	0	0	0	30000
Sherbim i Pediatrie	0	0	0	0	0	0	0
Sherb. (Obstetri-Gjinekologji)	10000	0	0	0	0	0	10000
SherbimiFizioterapise	0	0	0	0	0	0	0
SherbimiHemodializes	0	0	0	0	0	0	0
Klinika e ORL	262200	0	0	0	0	0	262200
Klinika e Okulistikes	55400	0	0	0	0	0	55400
Klinika e semundjeve infektive	60600	0	0	0	0	0	60600
Sherbimi i radiologjise	1467483	0	0	0	0	0	1467483
Lab.klinik-biokik-mikr	216037	0	0	0	0	0	216037
Sherbanat+histPathollogj	31400	0	0	0	0	0	31400
Sherbime NEUROLOGJI	0	0	0	0	0	0	0
Poliklinika	3517100	0	1414000	0	0	0	11310900
Sherbimi i konsultave ambulare	38008600	0	0	0	0	0	38008600
Sherbim neurogj ambulance (kml)	0	0	0	0	0	0	0
Sherbime tjera parkim	0	0	0	0	0	839700	9143500
Totali i te ardhurave te periudhes	43761820	0	7793800	0	0	9143500	60699120

Viti 2022

Teardhurat e realizuara gjate periudhes sipas shërbimeve dhe burimit	Te ardhuran gazbatimisist.Referimit	Teardhuranga KMCAP	Teardhurangatarifa perdokumenta	Teardhuranga KML	Teardhuratejterangandi hane.e.dobritane	Teardhurangaburimetet jera	Shuma totale e teardhuravegjateperi udhes
Sherb. Mjeksis.Pergjithme	164200	0	0	0	0	0	164200
Sherb.Kirurgj.Pergj.(ortopeditraum.+urologji)	16000	0	0	0	0	0	16000
Sherbim i Pediatrie	0	0	0	0	0	0	0
Sherb. (Obstetri-Gjinekologji)	0	0	0	0	0	0	0
SherbimiFizioterapise	0	0	0	0	0	0	0
Sherbimi i Hemodializes	0	0	0	0	0	0	0
Klinika e ORL	294800	0	0	0	0	0	294800
Klinika e Okulistikes	54700	0	0	0	0	0	54700
Klinika e semundjeveinfektive	54300	0	0	0	0	0	54300
Sherbimi i radiologjise	1755850	0	0	0	0	0	1755850
Lab.klinik-biokik-mikr	439825	0	0	0	0	0	439825
Sherbanat+histPathollogj	24700	0	0	0	0	0	24700
Sherbime NEUROLOGJI	0	0	0	0	0	0	0

Poliklinika	2711500	0	13454000	0	0	0	16165500
Sherbimi i konsultave ambulatorore	39790200	0	918200	0	0	0	40708400
sherbimneurogji ambulance (kml)	2400	0	0	0	0	0	2400
Sherbime tjera	0	0	0	0	0	12348500	12348500
Totali i teardhurave te periudhes	45308475	3795780	14372200	0	0	0	72029175

Viti 2021

Teardhurat e realizuara gjate periudhes sipas sherbimeve dhe burimit	Teardhuranga zbatimisi t.Referimit	Teardhuranga KMCAP	Teardhuranga tarifa perdokumenta	Teardhuranga KML	Teardhurajtejerangandih ma e donacione	Teardhuranga burimetetj era	Shuma totale e teardhurave gjate periudhes
Sherb. Mjeksis.Pergjithme	137800	0	0	0	0	0	137800
Sherb.Kirurgj.Pergj.(ortopeditraum.+urologji)	26000	0	0	0	0	0	26000
SherbimiPediatrie	5000	0	0	0	0	0	5000
Sherb. (Obstetri-Gjinekologji)	5000	0	0	0	0	0	5000
SherbimiFizioterapise	0	0	0	0	0	0	0
SherbimiiHemodializes	0	0	0	0	0	0	0
Klinika e ORL	205200	0	0	0	0	0	205200
Klinika e Okulistikes	27600	0	0	0	0	0	27600
Klinika e semundjeveinfektive	6000	0	0	0	0	0	6000
Sherbimi I radiologjise	1441400	0	0	0	0	0	1441400
Lab.klinik-biokik-mikr	239100	0	0	0	0	0	239100
Sherbanat+histPathollogj	12200	0	0	0	0	0	12200
Sherbime NEUROLOGJI	10000	0	0	0	0	0	10000
Poliklinika	0	0	10684900	0	0	0	10684900
Sherbimi i konsultav ambulatorore	31319500	0	2392400	0	0	0	33711900
Sherbim neurogji ambulance (kml)	7133400	0	0	0	0	0	7133400
Sherbime tjera	0	0	0	0	0	8068400	8068400
Totali I teardhurave te periudhes	40568200	0	13077300	0	0	8068400	61713900

Viti 2020

Teardhurat e realizuara gjate periudhes sipas sherbimeve dhe burimit	Teardhuranga zbatimisi st.Referimit	Teardhuranga KMCAP	Teardhuranga tarifa perdokumenta	Teardhuranga KML	Teardhurajtejerangandih ma e donacione	Teardhuranga burimetetj era	Shuma totale e teardhurave gjate periudhes
Sherb. Mjeksis.Pergjithme	237000	0	0	0	0	0	237000
Sherb.Kirurgj.Pergj.(ortopeditraum.+urologji)	18500	0	0	0	0	0	18500
Sherbim i Pediatrie	0	0	0	0	0	0	0
Sherb. (Obstetri-Gjinekologji)	0	0	0	0	0	0	0
SherbimiFizioterapise	0	0	0	0	0	0	0
Sherbimi i Hemodializes	0	0	0	0	0	0	0
Klinika e ORL	306900	0	0	0	0	0	306900

Klinika e Okulistikes	111800	0	0	0	0	111800
Klinika e semundjeveinfektive	33000	0	0	0	0	33000
Sherbimi I radiologjise	795800	0	0	0	0	795800
Lab.klinik-biokik-mikr	85800	0	0	0	0	85800
Sherbanat+histPathollogj	22300	0	0	0	0	22300
Sherbimeurgjence	6000	0	0	0	0	6000
Poliklinika	0	0	9781800	0	0	9781800
Sherbimi I konsultave ambulate	29757700	0	0	0	0	29757700
Sherbim neurogj ambulance (kml)	0	0	0	0	0	0
Sherbime tjera	0	0	0	0	6814150	6814150
Totali	31374800	0	9781800	0	0	6814150
						47970750

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT